

*“Në shenjë respekti, bashkëfshatarëve të mi të Gërçecit, të cilët e njohin në thelb burrërinë dhe ndershmërinë.”*

## Përralla e gjyshit

Thuajse asnjëherë gjatë shekujve të kaluar, njerëzve të kësaj pjese të Ballkanit, pra edhe shqiptarëve nga këto troje, nuk iu ka ndodhur që certifikatën e vdekjes t'ia jep shteti (apo perandoria) në të cilën ata kanë lindur, që librin amë të lindjes dhe atë të vdekjes, ta ketë në kryeqendrën e të njëjtit shtet. Pra, atyre u ka ndodhur, për shembull, që certifikatën e lindjes ta kenë të shkruar me alfabetin e turqishtes së vjetër osmançe, e certifikatën e vdekjes të mbushur me ciriliken serbe. U ka ndodhur që fëmiu të mësoj himnin e një shteti, e pastaj atë ta harrojë dhe ta këndojë himnin e një shteti të ri ku do i jetojë vitet e pjekurisë. Ballkanasve dhe shqiptarëve në të, u ka ndodhur që gjatë një jete, t'i përkulen herë njërit dhe herë flamurit tjetër shtetërorë, të jenë lindur nën flamurin e Mbretërisë Jugosllave, të kenë rinuar nën flamurin trengjyrësh të Federatës Socialiste të Titos dhe pastaj të kenë pleqëruar në shtetet e pavarura të dala nga federata e dikurshme e sllavëve të bashkuar. Ballkanasve u ka ndodhur të shpallin shtete të përbashkëta, të lindin në monarki e të vdesin në republikë, të rriten nën diktaturë e të plaken në një sistem krejt tjetër. Popujve të Ballkanit u ka ndodhur të vëllazërohen e të miqësohen mes

veti, ta heshtin urrejtjen dhe atë ta zëvendësojnë me dashuri të rrejshme. Atyre u ka ndodhur që shumëgjuhësisht të mbrojnë një perandori, e në një tjetër të kryejnë shërbimin ushtarak, një flamuri t'i betohen për besnikëri, e tjetrit t'i shërbejnë me bindjen se mbrojnë diçka të veten.

Pra, edhe shqiptarëve u ka ndodhur të jetojnë herë së bashku herë të ndarë, herë duke i shërbyer këtij apo atij sunduesi, e herë duke u munduar të jenë të pëlqyer nga sundimtarët. Por, thuajse kurrë në të kaluarën nuk u ka ndodhur që të sundojnë vetveten, thuajse rrallë u ka ndodhur t'i betohen edhe flamurit të vet kombëtarë. Prandaj gjyshërit e këtyre trojeve kurrë nuk kanë pasur nevojë të mësojnë përralla, kurrë nuk janë përballë me nevojën që nipërve t'u rrëfejnë për shtrigat dhe kësulëkuqet: ka mjaftuar t'ua ritregojnë jetën e tyre të filluar në një shtet, e të përfunduar në tjetrin ku kanë lindur pasardhësit e tyre, e që në fund nipërit e përgjumur t'u dorëzohen ëndrrave. Gjyshërit e këtyre trojeve nuk kanë pasur nevojë as të trillojnë rrëfime ireale, për t'i vënë në gjumë pasardhësit e tyre të mitur, sepse u ka mjaftuar të rrëfejnë për të kaluarën e tyre përplot me bërje dhe zhbërje të shteteve ku e kanë kaluar jetën, e që fëmijët të trullosen dhe lehtë t'i kaploj gjumi. Kështu që, edhe ata të lindurit në shekullin e njëzetë, e të cilët sot janë gjyshër që jetojnë në Ballkanin e shteteve demokratike, nuk do e kenë gjithaq të vështirë t'i venë në gjumë nipërit e tyre: do mjaftojë atyre t'u rrëfejnë në cilin shtet kanë lindur, ku kanë kaluar rininë dhe në cilën shoqëri

plaken, që vogëlushët e tyre t'i dorëzohen gjumit si qengja që e dinë se kullosin në livadhin e vet, por nuk e dinë se kënd e kanë bari.

Gjyshërit shqiptarë të mileniumit të tretë, do rrëfejnë për vitet e kaluara si ushtarë të Titos. Për pranverat kur kanë bartur stafetën me të cilën prijësit të atëhershëm Jugosllavë ia uronin ditëlindjen me 25 maj, se si e kanë përjetuar rënien e komunizmit, luftërat mes popujve të Ballkanit që filluan në Slloveni e përfunduan në Kosovë. Mbase ata nuk do e kenë lehtë t'ua shpjegojnë nipave të tyre, se nga ai fat i ballkanasve të këtushëm që edhe hartat shtetërore t'i ndryshojnë thujse çdo katër dekadat, që edhe pas aq ndryshimeve, në vend që kufijtë shtetërorë të qartësohen, ato bëhen gjithnjë e më të koklavitur, kështu që edhe në fillim të mileniumit të tretë, Ballkani mbeti po aq i "ballkanizuar" sa edhe pas luftërave ballkanike që shënuan shkatërrimin e Perandorisë Osmane. Se edhe sot, njësoj si edhe shekuj me radhë, në këtë Ballkan ka shumë mjegull paqartësie. Mjegull nëpër të cilën shëtit hija e mosdurimeve historike mes popujve të këtyre hapësirave. E të cilët, pas zhbërjes së Perandorisë Osmane, mbase edhe kurrë nuk kanë hequr dorë nga dëshira për t'i korrigjuar "të padrejtat historike", kurrë nuk i kanë lëshuar nga duart boritë luftarake, por për një kohë, vetëm i kanë heshtur ato deri sa të rimarrin frymë e pak të çlodhen.

Nëse harta e Ballkanit do rivizatohej sipas dëshirës së popujve të këtushëm, ajo do i ngjante një arnimi të çuditshëm ku do shiheshin herë kufijtë e

hapësirave deri ku jetojnë të gjallët e një etniteti, e herë ato deri ku shtrihen varret e popujve që kanë jetuar këtu. Pra, harta e njërit popull shpjet do mbulohej nga ambiciet e tjetrit, do përziheshin “trashëgimit e gjakut dhe dheut” me ato të të gjallëve, mitet me realen, historikja me irealen. Harta e tillë e Ballkanit, do pasqyronte frustracionet dhe shpirtngushtësinë etnike të popujve të këtushëm, si dhe pamundësinë e tyre të dalin nga tuneli i hasmërive të trashëguara nga e kaluara.

Mbase në pakënaqësinë e tyre dhe në ndjenjën se historia ka qenë e padrejtë me ta, duhet kërkuar pika më bindëse që i bënë të ngjashëm të gjithë ballkanasit. Pra, te ndjenja se hartat shtetërore janë arnuar gabimisht, tek bindja se atyre u takon edhe diçka matanë kufirit të shtetit fqinjë, se janë njësoj të dëmtuar, duhet kërkuar atë frustracion aq tipik për popujt e këtyre hapësirave, e që të krijon bindjen se këto popuj ecin përpara duke e mbajtur shikimin të drejtuar nga e kaluara.

A ishte fillimëshekulli i njëzetënjë ai kandarë që do i peshonte drejtë të gjitha pakënaqësitë, nacional-romantizmat, ëndërritjet, mitet, konceptet shtetërore të ballkanasve. Të gjithë atë përzierje nga e cila bymehej e vërteta se dera nga e cila njëri popull dilte i kënaqur, ishte e njëjta nga tjetri dilte duke dënesur dhe i dëmtuar, se ditën që njëri popull e shpallte ditë festive, tjetri e shënonte në kalendarin e vet si ditë zie. A ishte pra fillimëshekulli i njëzetënjë ai që do shënonte fundin e pritjes qindravjeçare të Kosovës që të sundonte me vetveten, që do vinte baraspeshë mes

ambicieve etnike në Maqedoni, apo edhe pas këtij viti, vetëm sa do rriteshin pakënaqësitë e ballkanasve, e do shtoheshin mitet, kjo – si edhe gjithmonë më parë - nuk do varej gjithaq nga ballkanasit, por nga “kryeqendrat” e vendosjes që ishin larg këtyre hapësirave. Që do të thoshte, sa u përket ballkanasve të këtyre hapësirave, ata ishin e do mbeteshin edhe më tej të ngjashëm me “kurvat” në shtëpitë publike, të cilave shumëçka u varet nga forca dhe gjindshmëria e “makrove”, e shumë pak – thujse aspak - nga bukura dhe mjeshtëria e lëvizjeve të tyre.

Më në fund, mos shpallja sa me e shpejtë e Kosovës si shtet i pavarur në kufijtë ekzistues, do ishte dështim i plotë edhe i Evropës. I Evropës plakë, mbase me instinkte edhe të atrofuar, i Evrope me syze politike me dioptri që ia shfityronin realitetin ballkanik, kështu që nuk e vërente se në mesin e dekadës së parë të shekullit njëzetentë, ajo nuk bënte luftë me kohën vetëm për ta stabilizuar këtë pjesë të kontinentit të vet, por edhe për atë se vallë do “evropizohej” Ballkani, apo do “ballkanizohej dhe rusizohej” Evropa. Pra, zgjedhjen duhej ta bënte ajo “plake” sklerotike, e cila linte përshtypje se nuk arrinte ta kuptojë se ashtu siç shkonin punët – ma zvarritjen e shpalljes së pavarësisë së Kosovës – në hapësirën e vet, Evropa ishte duke prodhuar dy popuj “palestinezë” – palestinezët shqiptarë dhe ato serb. E kjo do ishte shumë për një Evropë të plakur, e cila qysh në Bosnje kishte dëshmuar se as syzet politike i kishte në rregull, e as bastunin arrinte ta përdorë për të ecë drejt

të ardhmes. Mbase edhe shumë kërkohej nga një “plakë” e moshuar, e lodhur. Andaj mund të thuhet se pa ndihmën dhe përkrahjen e “kaubojit” matanë Atlantikut - të cilit nuk i mungonte as vulli as energjia rinore - Kosova dhe Ballkani do mbeteshin të davaritur në pluhurin e ngritur nga mosmarrëveshjet, frustracionet dhe hasmëritë shekullore.

Pa dyshim se gjyshërit e ardhshëm shqiptarë të Maqedonisë - rinosh të dikurshëm - kur do i marrin në prehër nipat e vet që t’u rrëfejnë për rrugëtimin nga Jugosllavia e dikurshme socialiste, e deri te më shumë shtete të dala nga kjo federatë, do duhet të japin shpjegime se pse socializmin që ndërtonin nuk përfundoi ashtu siç thuhet - me parajsën komuniste - por me demokracinë dhe copëtimin e federatës së dikurshme. Ata, në ndërkohë, do duhet të kompletojnë edhe rrëfimin se si Maqedonia u bë shtet i pavarur dhe sovran, për zanafillën e sistemit shumëpartiak në këtë shtet, i cili vazhdon të luhetet në kolovajzën e dëshirave kundërthënëse të maqedonasve etnik dhe shqiptarëve. Gjyshërit shqiptarë në Maqedoninë e pas zhbërjes së Jugosllavisë, do duhet të japin shpjegime plotësuese pse Tetova, e jo Shkupi, morri bajrakun e demokratizimit të shqiptarëve të këtushëm. Si dhe për atë se si ishte e mundur që diagrami politik shumëpartiak i shqiptarëve arriti të ecë rrugën që nga kali i bardhë, kur u themelua partia e parë shqiptare në Maqedoni - Partia për Prosperitet Demokratik - e deri tek rrugaçëria partiake, e cila e tregoi fytyrën e vërtetë gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006. Apo nga

ecën e nga shkuan partitë shqiptare që nga zgjedhjet e para parlamentare të vitit 1990, deri tek viti 2006, kur vazhduan mosmarrëveshjet ndëretnike dhe ato brendashqiptare, duke harruar se në ndërkohë kishte ndodhur edhe konflikti i 2001.

Gjyshërit e ardhshëm do duhet nipërve të vet t'u shpjegojnë ç'ishte ajo që i çonte udhëheqësit e partive shqiptare të grindeshin mes veti si gjeneral të ushtrive armiqësore, e jo si rivalë politikë që duhej të luftonin për të mirën e popullit të vet dhe të Maqedonisë në përgjithësi. Apo, t'u shpjegojnë pse disa qarqeve politike të etnitetit maqedonas nuk u pengonte kjo grindje ndërsqiptare? Mos vallë ata mendonin se sa më keq e kanë shqiptarët, aq më mirë do e ketë Maqedonia, apo bëhej fjalë për qarqe që të mirën e këtij shteti e donin aq sa edhe borën e vitit të kaluar, dhe kishin nevojë që shqiptarët t'ua kryejnë punën të cilën duhej ta bënë vetë ata – shkatërrimin e shtetit. Pra, u duhej fajtori. Se mund të jetë kështu, më së miri u pa atëherë kur nuk e priste askush, atëherë kur të gjithë besonin se Maqedonia ishte nisur rrugës drejtë stabilizimit të saj – pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006 - kur mandatarin Nikolla Gruevski mohoi vullnetin shumicë politik të shqiptarëve të këtushëm, dhe në vend të fituesve në bllokun politik shqiptarë (koalicioni parazgjedhorë BDI-PPD), në koalicionin qeveritarë përfshiu PDSH - në. Kështu që krijoi përshtypjen se nga dy partitë më të mëdha shqiptare, donte të bëjë dy fraksione armiqësore që do grindeshin mes vete, dhe në këtë mënyrë ai të dëshmonte se sa mirë dinte t'i mbajë



nën kontroll shqiptarët. Gjë që i çoi të gjithë dashamirësit e Maqedonisë të pyesnin veten se ç'dëshiron të arrijë me këtë Gruevski, kur ishte e qartë se vetëm shtohet grindja ndërpartiake mes shqiptarëve, e bashkë me këtë rikthehet mosbesimi ndërëtnik. Dhe më në fund, të shtronin pyetjen, a do e bënte këtë një kryeministër i interesuar seriozisht për stabilitetin dhe ardhmërinë e shtetit, posaçërisht pasi që ishte krijuar një traditë që në koalicionet qeveritare të përfshihet edhe partia fituese të zgjedhësit shqiptarë. Gjë që nuk ishte demokratike, por gjithsesi ishte zgjidhje fatlume për një Maqedoni ku sistemi shumëpartiak ndërtohet mbi bazat e partive etnike.

Kur do rrëfejnë për periudhën e demokratizimit të Maqedonisë, gjyshërit e ardhshëm do harrojnë shumë emra, nuk do u kujtohen të gjithë prijësit partiak shqiptarë, e aq më pak parlamentarët dhe ministrat, por gjithsesi do kujtojnë Abdurrahman Alitin, që doli në krye të PPD-së pas copëtimit të saj, e i cili përfundoi si “makro” i kurvave partiake të kësaj partie, do mbajnë mend Arbër Xhaferin i cili erdhi në Tetovë si prijës i gjatëpritur, e u kthye në Prishtinë si “hero i betejave të huaja”, si deputet që gjatë tre mandateve të tij, thujse kurrë nuk tha asnjë fjalë nga foltorja e parlamentit republikan ku shqiptarët e paguanin t’i përfaqësonte kërkesat e tyre, e ai më me ëndje fliste në Tiranë ku shpaloste konceptet mbarëkombëtare. Gjyshërit e ardhshëm nuk do mund t’i rikujtojnë gjithë “heronjtë” politik të një dekade e gjysmë të demokratizimit të shoqërisë

shqiptare në Maqedoni, por gjithsesi se më me interes për nipërit e tyre do jetë rrëfimi për 2001-shin, kur pasardhësit do pyesin: “O gjysh, kush, dhe pse e filloi konfliktin në Maqedoni!” Ata, gjyshërit pra, nuk do mund të zbërthejnë detaje, por nuk do e kenë vështirë të shpjegojnë se luftën Maqedonisë ia sollën të gjithë politikanët e para 2001-shit që frustronin popullatën e këtushme, ata politikanë që mosmarrëveshjet ndëretnike i kishin të vetmen mbulesë për mossukseset tjera, kështu që ata e çonin vendin drejt vitit 2001 kur u erdhi Ali Ahmeti, jo që t’ua shkatërrojë shtetin – siç thoshin disa – por t’ua rikujtojë politikanëve të këtushëm se pamëshirshëm ia harxhonin ardhmërinë Maqedonisë. Dhe si i tillë, në rrëfimin e gjyshërve të ardhshëm, Ali Ahmeti do mbetet heroi më interesant për vogëlushët, të cilët do bien në gjumë që t’i dorëzohen botës së ëndrrave. Pra, Ali Ahmeti do mbetet ai që do i bëjë gjyshërit e ardhshëm të ndjehen krenarë, kur do rrëfejnë se Ahmeti ishte njeriu i cili në vitin 2001, shqiptarëve të Maqedonisë, ua solli vlerën më të madhe historike: shenjën e kryengritjes së parë të tyre autoktone - atë të UÇK-së - dhe Marrëveshjen e Ohrit.

Pa dyshim se gjyshërit e ardhshëm do e kenë vështirë t’u shpjegojnë nipërve të vet se pse partia e Arbër Xhaferit bëri çmos që të degradojë udhëheqësit e UÇK-së, të cilët më vonë u bënë kryesues të BDI-së, pse disa qarqe maqedonase – kryesisht të përkrahura nga VMRO-DPMNE-ja - nuk e përfillën atë që ua thoshin dashamirësit e Maqedonisë: se 2001-shi ishte një e kaluar e hidhur

nga e cila duhej të nxirrej urtësia më e çmueshme – se deri ku mund të të çojnë mosmarrëveshjet ndëretnike. Si dhe ku mund të përfundojë një shoqëri e cila bënë lojë me ndjenjat etnike, që e radikalizon popullatën duke mos kultivuar ndjenjën dhe vetëdijen parësore për një shoqëri shumëetnike, shumëreligjioze e shumëkulturore – ndjenjën e respektimit të dallimeve dhe vetëdijen se këto shoqëri janë si kopsht me lulishte të ndryshme, të cilat nuk gllabërojnë njëra tjetrën, e as mohojnë bukurinë e ndërsjellë, por vetëm atëherë kur kopshtari i mirëmban dhe i ujit të gjitha njësoj, kur nuk lejon të mbijnë kullosat e egra të mosdurimi ndëretnik.

Duke rrëfyer tregimin e tyre për të kaluarën e vet që e kanë pasur fat ta jetojnë ose si aktorë direkt, ose si simpatizantë të njëres apo tjetres parti, duke rikujtuar vitet e para të dekadës së nëntë të shekullit të njëzetë, kur një pjesë e ish-Jugosllavisë digjej e përgjakej, kur Maqedonia nuk kishte vendosur vallë të përkrahte ata që dëshironin ndarjen e subjekteve të federatës në shtete të mëvetshme, apo ata që donin të gërryenin themele të reja për një konfederatë jugosllave, gjyshërit e mileniumit të tretë mund të jenë harrimtarë të datave, mund edhe të mos mbajnë mend detaje, të mos ndërmendin se kur sindroma e ndasive kishte filluar të përhapej nëpër subjektet e federatës, por gjithsesi do u rikujtohet se e tëra filloi me 1981. Atë vit kur rinia kosovare i shkundi themelet e Jugosllavisë së Titos dhe nga kjo tronditje u zgjua nga gjumi bisha e egër e nacionalizmit serb, e

cila ishte e vetmja që kishte mundësi të bëjë atë që nuk do ia dilnin kurrë ta bënin aq lehtë të tjerët, të cilët mbase edhe ëndërronin shkatërrimin e Jugosllavisë Socialiste, por e dinin se këtë mund ta bënin vetëm punëtoritë nacionaliste serbe. Pra, ata që kishin ndjekur kujdesshëm idenë e paraluftës së dytë botërore për bashkësinë Jugosllave, e dinin se ajo ishte vetëm mbulesë për “Serbosllavinë”, se qarqet serbe do bënin çmos atë ta shpëtonin, gjë që shumë shpjet do dëshmohej si e vërtetë. Por, ai “shpëtim” do ishte ngulfatës për të tjerët, ajo “dashuri” e qarqeve nacionaliste serbe ndaj Federatës Jugosllave, do i zgjojë nga gjumi gjithë nacionalizmat tjerë, të cilët edhe ashtu të përgjumur, do arrijnë ta kuptojnë se vitet e tetëdhjeta të shekullit të njëzet, në të vërtetë do ishin ato kur punëtoritë shkencore, kulturore dhe mediatike serbe, do bashkoheshin në betejën që Jugosllavinë e mëparshme përfundimisht ta bënin atë që kishin ëndërruar, por e kishin fshehur – “Serbosllavi”.

Gjyshërit që do rrëfejnë për ish Jugosllavinë, dhe do mundohen të zbërthejnë zhbërjen e saj, njësoj si edhe ata që do merren me regjistrimin e ndodhive nga e kaluara, gjatë kohë do hamenden se vallë demonstratat e vitit 19981, të studentëve shqiptarë në Prishtinë, ishin ai kufi që përfundimisht ndau të kaluarën socialiste nga vitet tronditëse të së ardhmes kur popujt që me dekada jetuan bashkë, në fillim do grindeshin siç u ka hije vëllezërve që ndajnë pronën e trashëguar, e më vonë edhe do kacafyten në betejat e luftës, ku do përgjakeshin pamëshirshëm si ata që

ishin treguar si miq ndaj njëri tjetrit, vetëm pse u ishte dashur kohë të rrisnin armikun në vetvete, që kishin jetuar të “vëllazëruar” vetëm pse nuk kishin nga t’ia mbanin. Ata të cilët do bëjnë analizat e kësaj periudhe, do e kenë shumë vështirë të shtjellojnë si dhe kush i organizoi demonstratat e studentëve shqiptarë në Prishtinë, por nuk do e kenë fare rëndë të dëshmojnë se ato trazira, mezi i kishin pritur edhe të tjerët, se mundësuan që të fillojë prishja e kalasë federative, ku të gjithë njësojë ndjeheshin ngushtë dhe të dëmtuar. Studiuesit e ardhshëm, do i japin përgjigje edhe pyetjes se vallë trazirat studentore në Prishtinë gjatë pranverës së vitit 1981, ishin ajo plasaritja e themeleve të Federatës Jugosllave, pas të cilës ajo nuk mund më të qëndronte në këmbë siç kishte qëndruar dekada me radhë, apo atë e luhatën erërat që frynin nga veriu, e që në dekadën e nëntë u bënë shumë të furishme, por të cilat humbnin forcën deri sa i afroheshin jugut të federatës, ku çdo gjë ishte më e mjerë dhe më e shtrënguar nga kthetrat politike dhe ekonomike të Beogradit.

Mbase, pa u hapur e tërë dosja me mbititull - “Shkatërrimi i Federatës Socialiste Jugosllave”, shumëçka do mbetet e paqartë lidhur me vitet kur u dëmtuan themelet e këtij shteti. Pra, edhe shumë vite në të ardhmen, do mbetet e paqartë se kush me çka kontribuoi që Jugosllavia e Titos të përfundonte aty ku ndodhej në fillim të dekadës së nëntë të shekullit të njëzet – e ndarë në shtatë shtete. Por, krahas kësaj paqartësie, do jetojë e vërteta se socializmi vetëqeverisës të cilin e ndërtonte Jugosllavia, mbësh-

tetej mbi parimin e deklaruar të popujve dhe popull-sive të barabarta, por se sa do e jetonin popujt numerikisht më të vegjël atë barazi kushtetuese, varej nga marrëveshja mes vëllezërve numerikisht më të mëdhenj dhe ekonomikisht më të zhvilluar – serbët, kroatët dhe sllovenët. Me çka, vëllezërit e vegjël, si maqedonasit etnik, shqiptarët, malazezët dhe të tjerët, nuk kishin pse të kujdeseshin për vetveten, sepse kishte kush të mendonte për ta! Gjë që më së miri u dëshmuua gjatë zhbërjes së Jugosllavisë, kur “vëllezërit” e mëdhenj sërish u morën vesh si t’ia bënin, duke e lëshuar Sllovenin të dilte nga federata, që në ndërkohë Millosheviqi e Tugjmani, të papen-guar, ta ndanin Bosnjën dhe të dominonin mbi të tje-rët.

Sa i përket Maqedonisë, ajo edhe ashtu binte nën “zonën e interesit” serb, ajo gjithmonë konsiderohej si “provincë” veriore e Serbisë ku mjaftonte Urës së Gurit vetëm t’i rikthehej emri i dikurshëm - “Dushanov Most”, dhe çdo gjë të ishte si atëherë kur as që kishte ekzistuar ky shtet. Mbase kjo bindje e punëtorive serbomëdha, ky besim i Millosheviqit se Maqedonia ishte kopsht i serbëve ku ata ishin kopshtarë me tapi të pakontestueshme, edhe e shpëtoi Maqedoninë nga lufta në vitet kur thuajse të gjithë të tjerët rënkonin nën thundrat e vullnetarëve serb që vinin nga Serbia, shtet i cili deri në përfundim të të gjitha betejave nëpër hapësirat e ish – Jugosllavisë pohonte se nuk luftonte kundër askujt.

Ngjarjet e dy dekadave të fundit të shekullit të njëzet, kur filloi dhe përfundoi demontimi i

Federatës Jugosllave, do jenë pjesë e rrëfimeve të gjyshërve të ardhshëm të cilët pasardhësve të tyre do u shpjegojnë se posa filloi grindja mes “vëllezërve” të dikurshëm, përnjëherë u bë e dukshme se kjo federatë socialiste ishte ndërtuar si piramidë e cila edhe në themele edhe në kulm i kishte gurët e njëjtë: ato që ia kishin vënë serbët, të bindur se kështu kishin realizuar ëndrrën e tyre të jetonin së bashku në të njëjtin shtet. Në të vërtetë, serbët ishin numerikisht më dominantë dhe mbanin në duar thuajse të gjitha institucionet shtetërore të federatës, veçanërisht sistemin mbrojtës dhe atë të punëve të brendshme. Në muranën e asaj federate, shiheshin edhe muret e ngritura nga popujt tjerë, si ai kroat, slloven, boshnjak, maqedonas dhe në fund shqiptarët, por gjithmonë sipas simetrisë dhe renditjes që e përcaktonin baza dhe maja – atë që e kishte përcaktuar Beogradi dominues në të gjitha sferat shoqërore..

Rrëfimi për Jugosllavinë dhe zhbërjen e saj, mund edhe të thjeshtësohet, mund të bëhet doracak jo më shumë se dhjetëra faqe, ku do shpjegohet fenomeni se si nëpërmjet ideologjisë komuniste, Titoja arriti të vendoste baraspeshë mes urrejtjeve shekullore të popujve që përbënin federatën, të cilën ai e udhëhoqi afër katër dekada. Dhe si arriti atë federatë ta bënte vizion të besueshëm, fole ku do bënin gjumë edhe ëndrrat e popujve që nuk kishin asgjë të përbashkët me sllavët e jugut, të cilët mbase edhe nuk kishin asnjë interes të jetonin të bashkuar në një shtet me ta. Por, luftërat që u zhvilluan pas

zhbërjes së ish Jugosllavisë, dëshmuar se edhe vëllezërit nuk i besonin më konceptit jugosllav që ndoshta nuk ishte asgjë tjetër pos një Serbi e madhe, por e emëruar ndryshe, se Jugosllavia në të vërtetë kishte realizuar vetëm një ëndërr- atë të serbëve, të cilët aq sa ishin, jetonin në një shtet të njëjtë.

Dhe këtë iluzion se është e mundur të mbahen të heshtura ëndrrat kundërthënëse të popujve që përbënin Federatën Jugosllave, e morri me vete stuhia që shkatërronte themelet e shteteve socialiste në Evropë. Shtrëngatë e cila morri përmasa shkatërruese pas “Perestrojkës” së Bashkimit Sovjetik, ku gjithashtu ishin helmuar keq ëndrrat socialiste, në mes të cilave edhe ajo për jetë të përbashkët mes popujve që i bashkonte vetëm pamundësia të shkatërrojnë atë gjigantë socialist.

Nuk ka dyshim se asokohe, nuk ishin të paktë ata që besonin se Jugosllavia do e ketë më lehtë të çlirohet nga kthetrat e ideologjisë komuniste se sa vendet tjera socialiste, se sa ato shtete që ishin në aleancë ushtarake me lokomotivën socialiste – Bashkimin Sovjetik. Këtë besim të tyre e mbështesnin mbi të vërtetën se Jugosllavia nuk kishte hallin si të çlirohej nga përqafimi ngulfatës i Moskës, se ajo tashmë ishte lider i Botës së Tretë, se ndërtonte një socializëm nga pak edhe të çuditshëm – pak të kuq, e pak të kaltër, pak me punëtorë të barabartë, e pak me një “borgjezi të kuqe”, e cila “borgjezi” jetonte si edhe kapitalistët më ekstravangard të perëndimit. Besimi se Jugosllavia nuk do pësonte gjithaq nga shtrëngata antikomuniste



që rrëzonte gjithandej regjimet diktatoriale, mbështetej edhe mbi bindjen se “mbreti komunist” - Titoja – i cili e donte jetën dhe gjitha që sjell ajo me vete (e me këtë kishte mirëkuptim më shumë se diktatorët tjerë komunist për ata që gjithashtu donin të jetojnë pak më lirë se në shtetet “burgje”), pas vetes kishte lënë një “klasë punëtore” që kishte arritur të shijojë shumëçka nga ajo që ishte e paimagjinueshme për një pjesë tjetër të botës, të shteteve të lindjes. Pa dyshim se Titoja këtë e kishte arritur duke vozitur gjithmonë djathtas nëpër autostradën e majtë të rrjedhave globale. Më çka ndodhi ajo më e çuditshmja: të ndërtojë një socializëm që mbase qëndronte në plasaritjen e cila e ndante një kapitalizëm të kontrolluar dhe një dogmë ideologjike komuniste. Andaj, nuk ishte e pabazë edhe ajo pritje se Federata Jugosllave, do arrijë të tejkalojë shtrëngatat e shkatërrimit të një ideologjie më lehtë se të gjitha shtetet tjera komuniste.

Por, ata që shpresonin këtë, të përqendruar në dallimet ideologjike, nuk vërenin diçka shumë të rëndësishme: se prej moti ishte prishur baraspesha e heshtur e urrejtjeve ndëretnike, se qysh nga fillimi i viteve të tetëdhjeta, punëtoritë beogradase për mbisundim, punonin me tërë kapacitetet dhe bënë çmos që njëherë e përgjithmonë të mbyllnin çështjen shqiptare në Kosovë. Me çka, në njëfarë mënyre, edhe të tjerëve do u dëshmonin se kush është i zoti i shtëpisë. Pra, përderisa te shtetet tjera komuniste dominonin problemet klasore dhe ideologjike, Jugosllavia ishte zhytur në baltën e mosmarrëvesh-

jeve ndëretnike, baltë e cila bëhej gjithnjë më e thellë dhe më e patejkalueshme.

Në përrallat e gjyshërve të ardhshëm për historikun e dekadës së parë të demokratizmit të shqiptarëve të Maqedonisë, pa mëdyshje se do zë vend edhe kali i bardhë i mitingjeve të Partisë për Prosperitet Demokratik, i cili shënoi nisjen drejt hapësirës së të menduarit pluralist dhe ndarjes nga ideologjia e lodhshme komuniste, e cila jo që i ngulfati, por si "haraç" i pashmangshëm, shqiptarëve të Maqedonisë ua merrte dhe ua asgjësonte ato pak vlera, të cilat boshtin kurrizor profesional dhe intelektual e sforconin në Prishtinën e atëhershme. Në Prishtinë , e cila si Piemont kulturor dhe arsimor, kujdesej për bijtë e vet nga kjo anë e kufirit ashtu si i ka hije nënës së mirë. Ata që kishin sy të shohin dhe kokë të mendojnë, qysh atëherë vërejtën se nga ngutja, kali i bardhë kishte mbetur i pakrehur, përplot me bajga dhe njëkohësisht habiteshin pse shalëruesit e tij nuk shëtitën me të nëpër Shkup, por nëpër qendër të Tetovës, të cilës pa mëdyshje askush nuk mund t'ia mohojë zgjuarsinë politike dhe flijimet për ta ruajtur dhe mbrojtur identitetin etnik shqiptarë në këto vise. Pra, vërejtën fillimin e gabuar dhe një diletantizëm të pashembullt, i cili nuk dëshmonte vetëm instinktin e lokalizmit tetovarë - i cili lë përshtypje se të gjithë banorët e nënsharrit janë nipërit e parë të Makiavelit - por amatorizmin politik. Amatorizëm i cili nëse në fillim të pluralizmit politik në Maqedoni mund të arsyetohet me pengesat e shumta në të cilat hasnin themeluesit e

PPD-së, më vonë mund të quhej vetëm diletantizëm politik. Diletantizëm i cili nuk u lejoi liderëve politik shqiptarë të shohin edhe atë që ishte e dukshme për çdonjërin: se rinia dhe pjesa dërmuese e shqiptarëve të Maqedonisë, jetonte në Shkup, se ky qytet ka qenë dhe do të mbetet qendër politike dhe udhëkryq i rëndësishëm ballkanik. Dhe ky gabim ndolli me vete përplot gabime të tjera: universiteti mbiu në Reçicë të Vogël, ne vend, ta zëmë, ne pjesën veriore të Shkupit. Në Tetovë u themelua (së paku në letër) Teatri, opera dhe baleti nacional, me çka ose dikush harroi se në Shkup ekziston një "gjysmëteatri", i cili duhej të përforcohej dhe që për shumëçka më së shumti i takonte prefiksi "nacional", ose dikush deshi të kumtojë se institucionet shqiptarë të ndodhura në Shkup ishin në vend të gabuar.

Ndërkaq, Shkupi ku vinin dhe shkonin politikanë, njerëz të kulturës dhe biznesmen nga e mbarë bota, aty ky shihej dhe vlerësohej e tërë ajo që kishte Maqedonia, mbeti thajse pa asnjë parti deri në vitet e paskonfliktit të 2001 – shës, kur më në fund Ali Ahmeti, ndër të parët, e kuptoi se Shkupi është Maqedonia, dhe BDI-në e regjistroi ne kryeqendrën e shtetit ku duhej politikisht të vep-ronte. Me çka e braktisi mentalitetin provincial dhe lokalist të udhëheqësve të deriatëhershëm partiak, që partia ta kishte selinë aty ku pinte kafënë e mëngjesit kryetari i saj.

Demokratizimi i shqiptarëve të Maqedonisë filloi me një kalë të bardhë, me shumë britma dhe me en-

tuziazëm që u ka hije vetëm atyre që në ankth kishin pritur t'u dëgjohet zëri. Atyre që me vite jetonin nën trysnin e "diferencimeve" dhe "fajtorit kujdestar" për të gjitha dështimet shoqërore, ashtu si edhe gjithë shqiptarët tjerë nga kjo anë e kufirit. Dhe në vitin 2006 demokratizimi i shqiptarëve të Maqedonisë thujse e mbylli rrethin aty ku edhe e filloi – duke u përpëlitur në shtratin e ngushtë të “diktaturës” shumëpartiake. Me atë dallim "kualitativ" që deri dje "spiunimin dhe destruktivitetin e tyre antisocialist" e demaskonin komitetet qendrore dhe komunale, ndërsa më vonë "spiunimin dhe destruktivitetin e tyre antishqiptarë" e demaskonin prijësit partiak, rrëzë Sharrit. Me çka doli se të diferencuarve në kohën e demokracisë, u mbetej vetëm një ngushëllim: kur duruan njëmendësinë ideologjike, pse të mos duronin, ta zëmë, një dekadë nën sundimin e “çmendurisë” shumëpartiake?! Në ndërkohë duke iu frikësuar vetëm një gjëje: mos vallë "diferencimi" me dekada i ushtruar mbi shqiptarët, atyre u ishte vulosur në vetëdije si veprim më i drejtë politike, veprim pa të cilin nuk do mundeshin partitë e tyre dhe nga i cili nuk do të mund të shpëtonin vite të tëra!?

Ç'është e vërteta, qysh me PPD-në filloi procesi që shqiptarët të mos kishin parti, por çdo parti të kishte shqiptarët e saj të “mirëfilltë”, të pakrahasueshëm me ata që u takonin partive të tjera, pra që përkatësia partiake shqiptarët t'i ndante në taborre të largëta sa edhe ai i ushtrive armiqësore. Dhe më vonë, atë e përsosi dhe e “institucionalizoi”

PDSH-ja, e cila shqiptarët i ndau si me thikë duke ua vënë yllin e “Davidit” në krahë të gjithë atyre që nuk rreshtoheshin nën flamurin e kësaj partie. Kjo parti këtë do e arrijë pahetueshëm, duke shitur në fillim atdhetari dhe patriotizëm të flaktë, e duke u ofruar shqiptarëve të këtushëm vetëm arsyetime të akullta kur vinte në pushtet. Këtë PDSH-ja do e arrijë kryesisht nëpërmjet mediave të pakta të këtushme në gjuhën shqipe, duke plasuar nëpërmjet tyre kërcënime ndaj atyre që mendonin ndryshe, duke e mbajtur opinionin shqiptarë nën ethet e frikës se çdo shumëmendësi që nuk pajtohet me politikën e udhëheqësve partiak të PDSH-së, është “tradhti kombëtare”. Me çka, në njëfarë mënyre, u ndihmoi edhe partive tjera, që edhe ato t’i rreshtonin partizanët e vet ashtu që t’i nënshtroheshin bindjes - ç’thotë partia nuk e zhbën as pushteti, se partia është populli.

Ka shumë elemente që ndikuan te shqiptarët të arrijnë aty ku ishin pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006: të bëheshin pronë e partive, e jo qytetarë që kishin partitë e veta, që kishin lirinë e plotë të zgjidhnin opsionet politike dhe platformat partiake. Apo thënë edhe më saktë: edhe në dekadën e parë të mileniumit të tretë, të mos kenë parti me një profil të qartë, por “sekte politike”, apo lëvizje të ngjashme me atë të Lidhjes Socialiste të dikurshme, e cila bashkonte grupe njerëzish me interesa shpeshherë edhe krejt të kundërta. Pra, ndikuan shumë rrethana të cilat e karakterizonin një dekadë e gjysmë të demokratizimit të Maqedonisë së pavarur që shqi-

ptarët të mbeteshin me shumë të ashtuquajtura parti, por me pak alternativa konceptesh politike. Një ndër faktorët më të theksuar, është ai i përqindjes së madhe të të rinjve të papunë, të cilëve krerët partiak ua përcollën sinjalin se partitë ishin “entet e vetme” të punësimit. Kështu që partitë shqiptare, në njëfarë mënyre, i shlyen të gjitha vlerat individuale, duke promovuar si vlerë më të lartë përkatësinë partiake, duke shpallur “ekspertë” individët të cilët kishin vetëm një vlerë të pamohueshme: poltronizmin dhe dëgjueshmërinë e pakusht ndaj kryesuesve partiak. Pra, partitë bënë diçka shumë produktive për vetveten, por tmerrësisht të dëmshme për demokratizimin e një kolektiviteti, për sforcimin e boshtit kurrizorë të një populli dhe të një shoqëri: përcollën sinjalin se asnjë vlerë individuale nuk mund të cilësohet si vlerë nëse nuk është vërtetuar edhe me “certifikatën” partiake.

Dhe ndodhi ajo që duhej pritur: në vend që të begatohej truri i partive me individ të aftë dhe ide, ato i rritën vetëm “muskujt” partiak, i mbushën radhët e veta edhe me individë që nuk hezitonin të bënin çmos për udhëheqësit e tyre. Kështu filloi faza e fundit e destruktivitetit partiak: rrugaçërimi i veprimit të tyre. Ç’është e vërteta, me ardhjen në pushtet në vitin 2002, Bashkimi Demokratik për Integrim, filloi hapjen e partisë dhe angazhimin në funksione të larta shtetërore edhe të njerëzve që nuk kishin librezën e kësaj partie, pra të individëve që ishin dëshmuar si të aftë në profesionin e vet. Por, BDI-ja nuk arriti ta çoj deri në fund këtë proces shkaku se në ndërkohë ndodhën

zgjehjet parlamentare të vitit 2006, kur shqiptarët përsëri u bënë pronë e PDSH-së. Me çka u ndërpre procesi i depolitizimit dhe departizimit të disa sferave shoqërore, ku partive dhe politikanëve duhej t'u ishte ndaluar hyrja. Si për shembull arsimi, kultura, shëndetësia....

Pra, procesi i departizimit dhe depolitizimit të shoqërisë shqiptare, të cilin e filloi BDI-ja pas ardhjes në pushtet, u dëmtua rëndë me ardhjen e dytë në pushtet të PDSH-së në vitin 2006, e cila vazhdoi partizimin e shoqërisë shqiptare aty ku e la në vitin 2002 dhe njësoj si dikur, por tani thujse edhe më ashpër dhe më pamëshirshëm, nuk njihte vlerë më të lartë se atë që kishte simbolin e kësaj partie. Dhe kështu, thujse i tërë procesi u kthye aty ku ishte para 2001-shit, gjë që ndikoi edhe në acarimin e madh në mes të simpatizantëve partiak, e që në të vërtetë fare nuk shprehte papajtueshmërinë ideologjike, por shtyrjen me bërryla mes atyre që donin të realizonin përfitime personale.

Por, për këtë nuk duhet fajësuar vetëm partitë politike. Më në fund, cila parti nuk do donte që të gjithë krijuesit, të gjithë intelektualët, të gjithë studentët, të gjithë kuadrin arsimorë, të gjithë profesionistë..., pra cila parti nuk do donte që tërë popullin ta ketë nga ana e vetë. Por, shtrohet një pyetje e logjikshme: ku ishin profesionistët, artistët, profesorët, studentët, shoqatat joqeveritare, bashkësitë fetare..., atëherë kur partitë politike push-tonin dhe “okuponin” shoqatat e artistëve, institucionet arsimore, mediat, bashkësitë fetare, kur

ndërronin rektorët ashtu siç e vlerësonin ata se është më mirë për universitetet, kur i dhunonin studentët të cilët me brohoritma shprehnin pakënaqësi ndaj folësve që merrnin pjesë në përvjetorët e universiteteve të tyre! Ku ishin profesorët kur liderët partiak, duke pirë kafe në rektoratet e universiteteve – siç bënin ata të PDSH-së - përcillnin porosinë se nuk do lejonin partizimin dhe politizimin e këtyre institucioneve, ku ishin..., ku ishin..., ku ishin kur i kishte mbuluar vetëm heshtja. Mbase ishin atje ku edhe e kishin vendin: në bishtin e ngjarjeve, apo duke pritur që nëna parti ta shihte sa hije u kishte heshtja, e për këtë t'i shpërblente me ndonjë vend pune ku assesi nuk mund të arrinin duke u mbështetur në vlerat që kishin.

Që të mos vijë deri te etablimi i partive shqiptare, ndikuan edhe partitë më të mëdha të etnitetit maqedonas. Siç duket, partitë e etnitetit maqedonas këtë e arrinin duke i lënë në çeltirë kur i përfshinin në koalicionet qeveritare – duke mos u lejuar të realizojnë asnjë premtim që ua kishin dhënë zgjedhësve të vet, përpos punësimeve të pakta të partizanëve më të dëgjueshëm partiak, e me çka ato shpejtë delegitimoheshin te zgjedhësit e vet. Gjë që udhëheqësve partiak shqiptarë fillo t'ju konvenojë, e atyre të etnitetit maqedonas u duhej që partitë shqiptare ta kenë sa më të dëgjueshëm popullin të cilin e prezantonin. Partitë e etnitetit maqedonas kishin dobi konkrete nga partitë që kontrollonin shoqërinë shqiptare, posaçërisht gjatë zgjedhjeve presidenciale, kur thajse gjithmonë fitonte kandidati që i merrte



edhe votat e shqiptarëve. Dhe jo vetëm kaq. Në njësitë zgjedhore ku jetonin edhe shqiptarët, e ku kandidati i partive shqiptare nuk mund të merrte votat e duhura për t'u bërë parlamentarë, në ato njësi votat e shqiptarëve e shtonin numrin e deputetëve maqedonas. Kështu që ishte e rëndësishme, ta zëmë, për VMRO-DPMNE-në, që PDSH-ja të ketë sa më shumë kontroll mbi shoqërinë shqiptare, sepse kjo ishte në interes të saj. Dhe në emër të këtij qëllimi, sa herë, për shembull, që VMRO-DPMNE-ja vihej në krye të koalicionit qeveritarë, PDSH-ja bëhej “polici” dhe “gjyqtari” i shqiptarëve. Këtë e bënte edhe LSDM-ja ndaj partnerëve të saj në qeveri, duke filluar nga PPD-ja e deri te BDI-ja, por kurrë në ato përmasa dhe në sasi aq të dëmshme për shoqërinë shqiptare, sa VMRO-DPMNE-ja, e cila thjeshtë shoqërinë shqiptare ia dorëzonte në sundim PDSH-së. Kështu që sa herë që sundonte VMRO-DPMNE-ja, PDSH-ja ishte “ligj” i vetëm për shqiptarët dhe në Maqedoni ndjehej një “dyqeverisje”: qeveria zyrtare, për etnitetin maqedonas dhe “qeverisja” e PDSH-së për botën shqiptare. Gjë që nuk do ishte edhe e papranueshme për shqiptarët e këtushëm, sikur PDSH-ja të mos e përdorte këtë pozitë të saj për t'i ndarë shqiptarët në “patriot” dhe “tradhtarë”. Sikur këtë të mos e përdorte për partizimin edhe të atyre pak institucioneve që kishin shqiptarët e Maqedonisë.

E tërë kjo “dyqeverisje”, çonte drejtë asaj që qytetarët të mos i ndjejnë njësoj institucionet shtetërore. “Qeverisja” e PDSH-së mbi shqiptarët,

mbulohej në atë mënyrë që udhëheqësve të kësaj partie u lejohej edhe “trimëri” pozuese, si për shembull, sulme të herë pas hershme në adresë të qarqeve të caktuara politike të etnitetit maqedonas, me çka përpara popullatës shqiptare prezantoheshin si “atdhetarë” të flaktë. Gjë që do ndodh edhe pas zgjedhjeve parlamentare të 2006, kur sërish do qeverisë VMRO-DPMNE-ja me PDSH-në dhe partitë tjera të koalicionit, kur do vazhdojë tradita e dikurshme që do rezultojë me ngadalësimin e proceseve demokratike në shtet si dhe me kriminalizimin e komunave ku jetonin shqiptarët. Por, mbase kjo nuk u pengonte politikanëve në pushtet që ishin bërë “tregtarë” të vegjël që shisnin ardhmërinë e shtetit për përfitime të ditës, për ta rritur popullaritetin në etnitetin e vet. Ata edhe ia arrinin të rrisnin përqindjen e popullaritetit të partive të veta, por ia ulnin mundësitë shtetit që të shkojë drejt një rendi të mirëfilltë multietnik, njëlloj siç e groposnin të nesërmen e gjeneratave të reja, gjithnjë e më shumë e largonin Maqedoninë nga një koncept i pastër qytetarë, ku vlerë mbi të gjitha vlerat do ishte ajo individualja. Pra, etnitetet që jetonin në Maqedoni, i mbanin në spiralen e ndasive në baza etnike, duke përjashtuar kështu kultivimin e vetëdijes për respektim të dallimeve.

Duhet thënë se gjatë një dekade e gjysmë të pavarësisë së Maqedonisë, shqiptarët shpëtuan nga njëmendësia komuniste, por ishin zhytur në shumëmendësinë e cila sundonte me ta njësoj si komunistët e dikurshëm: partitë e shpallnin armik

cilindo individ që dilte jashtë radhëve partiake, apo që ishte kritik ndaj udhëheqësve partiake. Shikuar nga ky kënd, gjatë bashkëqeverisjes me Lidhjen Socialdemokratike të Maqedonisë, BDI-ja edhe në këtë drejtim solli një ndryshim të dukshëm: u pakësuan njolloset në baza partiake mes shqiptarëve, individët jopartiak lirshëm mundeshin të shprehnin mendimin e tyre, pa frikën se qarqet pushtetmbajtëse do ua mbyllin të gjitha dyert bile edhe për ekzistencë, siç kishte vepruar, e siç do veprojë gjithmonë kur vinte në pushtet, për shembull PDSH-ja . Por, kjo periudhë katër vjeçare, sa morri pjesë BDI-ja në koalicionin qeveritarë të udhëhequr nga LSDM-ja, nuk mjaftonte që t'i groposte të gjitha “hasmëritë” ndërpartiake që në këto hapësira i kishin mbjellë partitë e mëparshme shqiptare. Ato ishin “hasmëri” mbi të cilat PDSH-ja dhe PPD-ja gjatë një dekade kishin ndërtuar të “mirën” e shqiptarëve të Maqedonisë dhe të shtetit ky vepronin.

Kjo “diktaturë” e shumë partive mbi shqiptarët, instalohej edhe shkaku se mediat në gjuhën shqipe në Maqedoni, nuk arritën të krijojnë një pavarësi nga partitë politike. Mbase kjo shkaku se, për dallim nga biznesmenët e etnitetit maqedonas që mundeshin dhe ishin të gatshëm të ndihmonin dhe të themelonin media, ato me përkatësi shqiptare ende ishin “tregtarë” të dorës së dytë, të cilët edhe ashtu rregullisht u paguanin “haraç” partive shqiptare në pushtet, e kështu as që mundeshin të ngrenë kokë e të mendonin për të ndihmuar materialisht mediat. Prandaj ndodhi që mediat në gjuhën shqipe gjithmo-

në ishin në mëshirën e partisë shqiptare në pushtet. E partitë as që shkonin më larg se t'i bënin buletine partiake. Këtë e bënin edhe me servisin e vetëm informativ publik – Radio Televizionin e Maqedonisë. E në ndërkohë, shoqëria e etnitetit maqedonas thujse e kishte kompletuar hapësirën informative me të gjitha ngjyrimet ideologjike. Pra, përderisa mediumet në gjuhën maqedonase kishin larushmëri të barabartë me konceptet politike dhe partiake, ato në gjuhën shqipe gjithmonë reduktoheshin, dilnin “sezonalisht”, varësisht se cila parti shqiptare ishte në pushtet. Dhe kjo ndikonte që shoqëria shqiptare të kishte një informim bardh e zi. Partia shqiptare që merrte pjesë në qeveri, ishte ajo të cilën mediat në gjuhën shqipe e himnizonin aq sa do ia kishte zili edhe Enver Hoxha, e ndërkohë ajo që mbetej në opozitë, duheshite të duroj fajet edhe për ndryshimet meteorologjike të kohës.

Dhe atëherë kur shqiptarët e Maqedonisë prisnin që të ndodhnin ndryshime edhe në këtë sferë, kur shpresonin se Ali Ahmeti me BDI-në e tij do bënte ndryshime rrënjësore në ndarjen e mediave partiake nga ato që u takonin gjithë qytetarëve, këto shpresa mbetën të kota. Ç'është e vërteta, partia e Ahmetit e filloi këtë proces të departizimit të mediave publike, por në çastin kur prijësit e “komandaturave” e ndjenë se do mbeteshin pa ekranet ku do mund të paraqiteshin kur t'u kujtohej, sërish ndodhi ajo e papritura: procesi u ndërpre dhe morri kahen e dikurshme. Ku ta dish, ndoshta duke mos e njohur sa duhet ambientin politik të

Maqedonisë, i porsaardhuri nga Zvicra - në fillim si udhëheqës i UÇK-së e pastaj si kryesues i BDI-së – Ali Ahmeti, vonë do e kuptonte se shqiptarët e këtushëm më ishin mësuar të ngiheshin me fjalë boshe, se i mbanin gati çiftelitet me dy tela, se edhe vargjet nuk duhej t'i ndryshonin së tepërmi, sepse “partia” kishte të njëjtën metrikë dhe rimë me “atdhetaria”, “liria” me “shqiptaria”, njësoj si edhe mbiemrat e prijësve partiak shqiptarë që lehtë zëvendësoheshin nga “Halimi” në “Aliti”, nga “Arbër atdhetari” në “cilindo tradhtari”, e kështu me radhë. Mbase Ali Ahmeti i “dëshpëroi” shqiptarët e Maqedonisë edhe shkaku se nga ai që kishte organizuar luftën, ata prisnin pak më shumë agresivitet në pastrimin e llogarive me rivalët e tij politik dhe një qëndrim më të qartë edhe ndaj “komandantëve” të vet, të cilët nuk e dinin as parimin elementar, se vlerat e një populli nuk mund të mbyllen as të përvetësohen nga një parti, cila do qoftë ajo. Por, mbase edhe shqiptarët e Maqedonisë nuk e dinin se në të vërtetë Abazi (nofka e luftës e Ali Ahmetit) edhe në Zvicër, edhe gjatë luftës në Kosovë ku ishte një nga themeluesit e UÇK-së së atjeshme, si edhe në malet e Maqedonisë ku udhëhiqte UÇK-në e shqiptarëve të këtushëm, ishte dhe mbeti misionarë. Se me kapotën e misionarit ai u fut në “shtëpinë publike” të politikës në Maqedoni, kështu që me shumëçka dilte jashtë kallaballëkut të politikanëve shqiptarë që grindeshin.

Në të vërtetë, udhëheqësit partiak të shqiptarëve të këtushëm, ishin mësuar të mos i pyeste askush se

ku kishin mbetur premtimet e dhëna. Gjë që nuk ishte praktikë, apo më saktë jo në ato përmasa, te blloku partiak i etnitetit maqedonas, ku liderët e tyre ishin shumë më të hapur, më të ndërgjegjshëm dhe më të përgjegjshëm përpara zgjedhësve të vet. Kështu edhe ndodhi që PPD-ja të jetë tetë vite pjesë e koalicionit qeveritarë me LSDM-në, e kurrë shqiptarët të mos grumbullohen përpara selisë së kësaj partie që të pyesnin kryesuesit e saj se çka kishte ndodhur me premtimet e dhëna, në ditët, kur nëpër Tetovë shëtisnin me kalë të bardhë. Apo, në vitin 1998, shqiptarët lere që lejuan që PDSH-ja të vinte në qeveri duke pasur më pak deputet se PPD-ja - edhe atë duke përdorur si shkallë ngjitëse drejt pushtetit Universitetin e pa pranuar nga shteti në Tetovë - por ata kurrë nuk e pyetën publikisht Arbër Xhaferin se pse posa u bë “pushtet”, përnjëherë ia ktheu shpinën Fadil Sulejmanit. Pse partiakët e tij filluan ta sulmonin Sulejmanin nëpër mediat që i kontrollonte PDSH-ja, dhe në vend që ta legalizonin universitetin që ata vetë e kishin përruar si sukses madhorë të shqiptarëve, filluan një projekt të ri për arsimimin e lartë në gjuhën shqipe – Universitetit privat të Evropës Juglindore. I cili jo se ishte e tepërt dhe i dëmshëm, por i ardhur në kohë kur shqiptarët e këtushëm ende nuk kishin universitet shtetërorë. Pra, katër vite PDSH-ja ishte në qeverinë e Lubço Georgievskit, dhe shqiptarët nuk arritën që kryesuesit e kësaj partie t’i pyesnin çkadoqoftë lidhur me premtimet që ua kishin dhënë nëpër mitingjet parazgjedhore. Edhe kur dilte ndonjë

zë i rrallë që shtronte ndonjë pyetje lidhur me përgjegjësinë e tyre politike, kryesuesit e PDSH-së, ngutazi e shpallnin zë “tradhtari”, apo analist të shitur, kështu që vazhdonin të qetë të lundrimin nëpër lumin e vetëpëlqimit dhe arrogancës, e i cili lundrim i solli deri në vitin 2001 kur menjëherë pas krismave të para u delegitimuan përpara popullit. E më vonë, kur Ali Ahmeti i “amnistoi” me shpresë se do bëheshin pjesë e një Këshilli Koordinues të partive shqiptare, ata vazhduan avazin e vjetër duke e bërë PDSH-në një “shoqate aksionarësh”, e cila dëshironte të gjithë shqiptarët e Maqedonisë t’i bëjë shërbëtorë të vet. Për ta arritur këtë, Arbër Xhaferin e ndihmuan edhe mediat në gjuhën maqedonase, në të cilat “moronët” e gazetarisë së etnitetit maqedonas, thujse çdo të dytën ditë, i shpiknin ndonjë aferë nga më të marrëzishmet. Afera të cilat në mjediset shqiptare ky i përdorte që të dëshmonte hallet që kishte shkaku i angazhimit të madh për të drejtat e shqiptarëve.

Në rrethana të këtilla, në një ambient mediatik kur shpallej si “antishqiptare” çdo kritikë drejtuar veprimtarëve politik të ulur në kolltukët e kabineteve qeveritare, ishte e pamundur të kultivohet një bërthamë kritike që do ishte korrigjuese e politikës së ditës, e pa të cilën nuk mund të ketë demokraci të mirëfilltë në asnjë shoqëri. Kjo atmosferë e cila i ngjante asaj që dikur e impononte partia komuniste, e që mund shkurtimisht të përshkruhet me thënien “o me ne, o vdis”, e pengoi demokratizimin e shoqërisë shqiptare

dhe atë e partizoi në aso përmasash sa edhe zgjedhjet lokale, apo ato parlamentare, popullata shqiptare filloi t'i ndjejë si torturë dhe maltretim, e jo si mundësi të vendosë lirshëm për përfaqësuesit dhe për fatin e vet. Dhe kështu filloi rënia e përqindjes së shqiptarëve që dilnin në votime, një e vërtetë që më qartë u pa gjatë zgjedhjeve parlamentare të 2006 – tës, kur nga i gjithë elektorati i etnitetit shqiptarë, përqindja e atyre që dolën të votonin ishte nën gjysmën e numrit të atyre që kishin të drejtë të votonin. Andaj, sa do që të tingëllojë absurde, partitë shqiptare ishin ato që shqiptarëve të këtushëm ua “morën” edhe më të shenjtën që kishin si qytetarë – të drejtën lirshëm e pa frikë t'u drejtoheshin kutive të votimit. Partitë këtë e arritën duke i dhënë përparësi “rrugaçërisë” së veprimit politik, duke përdorë si instrument bindës “muskujt” partiak, shantazhin, blerjen e votave, mbushjen e kutive të votimit.... Dhe në vend që kjo t'i shqetësonte partitë shqiptare, ato thujse mezi prisnin një situatë të tillë. Mbase shkakut se sa më i paktë ishte numri i votuesve, aq më të mëdha ishin mundësitë për ata që i mbushnin kutitë. E kjo, siç u tha edhe më lartë, sado pak u konvenonte edhe partive më të mëdha të etnitetit maqedonas, sepse kështu ato i siguronin më lehtë votat e shqiptarëve për kandidatin e tyre për kryetarë shteti, apo për të rritur numrin e deputetëve. Më në fund, në përgjithësi në Maqedoni, e tek shqiptarët në përmasa më alarmuese, prej moti dihej se të zgjedhurit e popullit nuk vareshin gjithaq nga votuesit, por nga numëruesit e votave. Prandaj, në



mjediset shqiptare, në periudhat parazgjedhore nuk ishin të rastit edhe konfliktet fizike mes simpatizantëve partiake, gjë dëshmonte se rrugaçërimi i partive kishte marr përmasa shqetësuese.

Që "demokratizimi" i shqiptarëve të Maqedonisë të arrij deri aty ku ndodhej kah mesi i dekadës së parë të mileniumit të tretë, kontribut dhanë edhe partizanët e PPD-së së famshme, e cila si "femër" që martohej më kë të arrinte, u bë nënë që lindte fëmijë të retarduar. PPD-në e shpartalluan dy grupimet më dominuese, të cilët bëheshin gjithnjë e më arrogantë duke menduar se vetëm ata ishin të përcaktuar t'i prezantonin shqiptarët në institucionet më të larta shtetërore. E këto dy grupime ishin lobi i politikanëve shkupjanë, që u shndërrua në filijalë e dëgjueshme e partisë së Branko Cërvenkovskit (me çka dëshmuar bindjen perverse të disa qarqeve politike tetovare, se nga një politikan shqiptar shkupjan mund të prodhosh vetëm një mashë të qendrave politike maqedonase) dhe ai i lobit "atdhetarë" të tetovarëve, i cili atdhetarizëm shpeshherë ishte proporcional me përfitimet personale.

Në këtë ikebanë të angazhimit partiakë të shqiptarëve të Maqedonisë, nuk mund të mos përmendet e vërteta se partitë shqiptare ishin shumë negativisht të disponuara edhe ndaj intelektualëve dhe individëve të rrallë që mundoheshin të jenë korigjues të veprimit partiak. Mbase për një disponim të tillë të tyre ndaj individëve publik jopartiak, kishte ndikuar edhe sjellja e disa "intelektualëve", të cilët

mendimëlrësia u bënte gjumë në kolltukun më të afërt të ndonjë institucioni shtetërorë. Dhe në një situatë të tillë, ndodhi ajo që duhej pritur: Jerusalemi i njëmendësisë "demokratike" shqiptare - Tetova, u bë qendër nga u mbeti koka kthyer të gjithë atyre që ëndërronin pozita të larta shtetërore. Në të shumtën e rasteve, kjo u ndodhte atyre që vlerë të vetmen individuale kishin përkatësinë etnike dhe librezën partiake. E në ndërkohë, shtoheshin frustrimet te ata që nuk ishin apolitik, por nuk donin të zënë vend në fotografitë grupe partiake, që donin të japin kontributin e tyre në demokratizimin e Maqedonisë dhe të shoqërisë shqiptare në të, por mendonin se nuk është e thënë të gjithë të bëheshin politikan. Më në fund, ç'vlerë do kishte politika sikur të politizoheshin të gjitha segmentet shoqërore, kënd do e interesonte futbolla, sikur edhe publiku të zbrishte në terren e të gjithë të vraponin pas topit.

Dhe përderisa partitë politike shqiptare shkonin drejtë rrugaçerimit të veprimtarisë së tyre, shqiptarët e këtushëm kurrsesi ta kuptonin pse "dinozaurët" partiak jo vetëm se nuk e përkrahën, por dukshëm dëmtuan formimin e një elite politike shqiptare. Elitë e cila do dinte ta lexojë drejtë kalendarin e rrjedhave rajonale dhe globale në botë. Pra, shumica e udhëheqësve partiak, bënë çmos që të ngushtonin hapësirën për politikanët "urban" e të shkolluar të shqiptarëve të Maqedonisë, e cila mbeti e ngulfatur nga kabadahijtë dhe bajraktarët e këtushëm. Këta kapadahnjë, të cilët derisa ishin në opozitë nuk fillonin miting politik pa pasur përkrah Rektorin e UT-së Fa-

dil Sulejmanin, posa vinin në pushtet, as emrin nuk ia përmendin në fjalimet politike. Apo, ata që i nxitën gostivarasit të flijojnë edhe vetveten për të mbrojtur flamurin kombëtarë, posa erdhën në pushtet në vitin 1998, të gjithë mosveprimin e vet e arsyetonin me kornizën e ngushtë kushtetuese. Thujse populli këtë nuk e dinte, thujse nuk ishte obligim i tyre ta "zgjeronin" atë kornizë që ishte edhe burim i mosmarrëveshjeve ndërretnike.

Këtë mospërgjegjësi ndaj zgjedhësve të vet, partiakëve shqiptarë ua mundësonte edhe sektori i dobët civil nëpër hapësirat ku jetonin shqiptarët. Liderët që në fushatat parazgjedhore lavdëroheshin se çdo gjë do thuhet dhe do mbrohet "vetëm shqip", posa bëheshin pushtetarë, silleshin thujse nuk janë ata të mëparshmit edhe shkaku se organizimi i shqiptarëve nëpër organizatat joqeveritare dhe jopartiake ishte thujse i paevitueshëm. Kështu që thujse edhe dy dekada pas zhbërjes së Jugosllavisë Federative, shqiptarët e Maqedonisë jetonin një demokraci të çuditshme, për të cilën tani nuk mund t'i fajësonin të tjerët (apo vetëm të tjerët), por spari dhe mbi të gjitha, strukturat e veta partiake.

E sa i përket zhbërjes së ëndrrës të sllavëve të jugut, që së bashku të jetojnë në një federatë, gjyshërit e ardhshëm do rrëfejnë edhe për atë se zhbërja e kësaj Federate filloi në çastin kur të gjithë njësitë federative besuan se kishte ardhur çasti të korrigjoheshin padrejtësitë historike dhe të shpëtonin nga përqafimi ngulfatës i Beogradit. Pra, besuan se nga kërma e Jugosllavisë, do mund të

ndukshin gjymtyrët e saj më të brishta: Bosnjën e Hercegovinën, Maqedoninë dhe Kosovën. E kështu të nginin orekset e veta etnike.

Shikuar nga ky kënd, shqiptarët nuk ishin as diçka e veçantë as pjesë e rrëfimit që do dilte jashtë tingujve “nacional-romantik” të asaj kohe kur të gjithë ia këndonin “tallkenin” Jugosllavisë dhe kremtonin lindjen e shteteve të veta etnike. Shqiptarët ishin të veçantë nga të tjerët vetëm shkaku i rrethanës se edhe sa ishte gjallë Jugosllavia, njësoj si edhe në periudhën e zhbërjes së saj, ata ishin popull në margjina të ngjarjeve vendimtare dhe larg qarqeve të vendosjes, shkaku se fjalën kryesore e kishin vëllezërit sllavë që ishin acaruar mes veti në ato përmasa, sa kishin harruar se në federatën e tyre jetonin edhe josllav. Kjo e vërtetë, apo mosmarrja pjesë e shqiptarëve në qendrat e vendosjes, si për shembull në ato të armatës dhe policisë jugosllave, në gjyqësi dhe qendrat bankare, do ndikonte që askush të mos e dëgjonte zërin dhe revoltën e tyre. Kjo do ndikojë që gjatë mëvetësimit të Maqedonisë, qarqet e këtushme politike të etnitetit maqedonas, të mos u kushtojnë rëndësi të duhur kërkesave shqiptare, gjë që i zmadhoi frustrimet tek ky etniteti, kudo që ai jetonte në ish-Jugosllavi. Kjo pakënaqësi ata i çonte të pyesnin edhe publikisht se si merrej parasysh mendimi dhe vullneti i një populli aq të vogël sa ishte ai malazez, e mohojë ai i më shumë se dy milion shqiptarëve që asokohe jetonin në Jugosllavi.

Ky frustracion i shtyu shqiptarët e Maqedonisë të vepronin sipas logjikës: “të mos e lëshojmë të na

ikë treni i historisë që na ka ardhur para derës, e të mbetemi pa vagonin tonë”. Kështu që duke mbetur pa përkujdesjen e dikurshme të Kosovës, ata duheshte të vepronin ashtu që të mos i dëmtonin edhe interesat e Prishtinës. Sa për fillim, ndërmoren disa hapa që do kishin për qëllim sa të mbanin gjallë entuziazmin e popullatës, e që së shpejti do mbeteshin në harresën kolektive të shqiptarëve të këtushëm dhe të politikanëve të tyre. Siç ishte për shembull organizimi dhe mbajtja e referendumit për Autonominë “Ilirida”.

Pas zhbërjes së Jugosllavisë, të gjitha republikat e saj, cila më herët e cila më vonë, e shpallën dhe realizuan pavarësinë e tyre. Vetëm Kosova ende mbetej në pritje të fatit të saj, apo thënë më mirë, nën torturën e sistemit millosheviqian. Që do të thotë, me shqiptarët ndodhi diçka krejt tjetër: demokracia ata i ndau në gjashtë shtete të Ballkanit. Pra, jo vetëm që u vulos ndarja e mëparshme, por mes tyre u vunë kufij të rinj. Tani shqiptarët do ishin një komb, por me gjashtë pasaporta të ndryshme: atë të Serbisë, të Maqedonisë, të Shqipërisë, të Malit të Zi, të Kosovës (UNMIK-ut) dhe të Greqisë. Tendencat e sllavëve të jugut që çdonjëri të kishte shtetin e vet, shqiptarët i bëri edhe më të largët nga një lidhje e tyre kombëtare. Andaj, atyre u mbeteshin vetëm dy zgjidhje: ose të kenë durim e të presin kohë më të mira që të bashkohen në Evropën pa kufij, ose t’ju shpallin luftë të gjithë fqinjëve të tyre. E para ishte e largët, por rruga e dytë ishte udhë pa krye dhe mbase me fund shkatërrues për

shqiptarët. Pa dyshim se shqiptarët e Maqedonisë me kohë e kuptuan se duhet t'ju qëndronin larg konflikteve ndëretnike, andaj edhe vetë i lindin dhe vetë i varrosnin idetë e mëdha (si për shembull ajo për "Ili-ridën"). Ndërkohë, disa nga kryeqendrat e shteteve të posamëvetësuara, e që përballeshin me "vullnetarët" serb, ishin të interesuara që edhe shqiptarët ti fusnin në luftë.

Shqiptarët e Maqedonisë, këto lojëra lokale që duhej vendosur në mozaikun global, i bënë ashtu siç mund të pritej nga ata që vite më parë ishin mësuar Prishtina të jetë ombrellë që u bënte hije të gjithë shqiptarëve që jetonin në ish- Jugosllavi. Të përqendruar në atë se çka do të ndodhte me Kosovën, shqiptarët e Maqedonisë thujse nuk arritën të shohin me kohë se nga të gjitha republikat që shpallën pavarësinë e vet, Maqedonia më së shumti kishte trashëguar kodin "gjenetik" të federatës nga e cila u shkëput. E veçanërisht kjo kishte të bënte me marrëdhëniet ndëretnike. Andaj, Maqedonia e viteve të para pas mëvetësimit, nëpër magjistralen e demokracisë, voziste me barrën e animoziteteve ndëretnike, farën e të cilës e kishin mbjellë punëtoritë antishqiptare të Serbisë. Maqedonia, si filijalë më e dëgjueshme politike e Beogradit gjatë betejës "kundër irredentizmit dhe nacionalizmit shqiptarë", edhe shumë kohë pas mëvetësimit të saj, nuk do arrijë të çlirohet nga frika ireale për "rrezikun shqiptarë". Propaganda serbe me vite e kishte bindur opinionin e këtushëm të etnitetit maqedonas se nuk ishte e mundur të ekzistojë një

Maqedoni sovrane me shqiptarët në të. Kjo bindje e qarqeve politike të etnitetit maqedonas, do ti kushtojë shumë Maqedonisë, e veçanërisht shqiptarëve. Mbase e shtyrë nga kjo bindje e qarqeve politike të etnitetit maqedonas, Maqedonia solli kushtetutë dhe ligje të cilat ndër të tjerat, kishin për qëllim ta mbrojnë shtetin edhe nga “rreziku shqiptarë”. Me çka, lere që nuk e mbrojtën, por e rrezikuan shtetin. Apo thënë më qartë, këto zgjidhje kushtetuese dhe ligjore nuk ishin të pranueshme për shqiptarët e këtushëm dhe Maqedoninë nuk mund ta çonin më larg se tek 2001 – shi.

Në katër vitet e para të demokratizimit të Maqedonisë, partive shqiptare – apo PPD-së – i ra në hise të rikthente disa të drejta të trashëguara të shqiptarëve të këtushëm nga sistemi i mëparshëm, e të cilat u ishin marr në dekadën e fundit para se Jugosllavia të shkatërrohej. Në dekadën e tetë të shekullit të njëzet, në Shkup ishte mbyllur Akademia Pedagogjike ku shkolloheshin arsimuesit e rinisë shqiptare. Në ndërkohë, kufijtë e rinj shtetëror, ua pamundësonin të rinjve shqiptarë nga Maqedonia të shkonin në Prishtinë e të vazhdonin arsimimin e lartë në gjuhën amtare, siç bënin më parë dekada me radhë. Shikuar nga ky kënd, pas mëvetësimit të Maqedonisë, shqiptarët u gjetën në një situatë thujse edhe më të rëndë se sa në kohën e socializmit. Në vendlindje u kthyen shumica e studentëve edhe intelektualëve, të cilët dekada me radhë veprimtarinë e vet e zhvillonin në Prishtinë. Dhe tërë këtë proces thujse nuk e vërenin

pushtetarët e Maqedonisë.

Krahas problemeve ndëretnike të trashëguar nga e kaluara, Maqedonia e posa pavarësuar si shtet i mëvetshëm, u përball edhe me problemet që i sollli me vete shumëpartizmi i ndërtuar mbi baza etnike. Duke dashur që demokracia sado pak të tregohet si më progresive sesa njëmendësia e mëparshme komuniste, shteti sovran i quajtur Maqedoni, në kushtetutën e parë të vet, kishte garantuar arsimimin e mesëm në gjuhën amtare. Por, mu kjo zgjidhje pozitive kushtetuese, zgjoi mosbesim tek shqiptarët shkaku i një absurdi: përderisa Kushtetuta garantonte arsimimin e mesëm në gjuhën amtare, mbetej e paqartë se ku do shkolloheshin arsimdhënësit e këtyre shkollarëve, kur arsimi i lartë ishte i garantuar vetëm në gjuhën maqedonase. Në këtë zgjidhje kushtetuese, shqiptarët shihnin edhe një kurth: duke mos pasur ku të arsimoheshin në gjuhën shqipe specialistë nga lëmit e ndryshme, e të cilët do ligjëronin nëpër shkollat e mesme, këto shkolla do mbeteshin pa arsimtarë. Dhe kështu kjo e drejtë kushtetuese do mbetej si e paqenë. Mbase ishte kjo që i shtyu shqiptarët e këtushëm të kërkonin zgjidhje tjetër, dhe u lindi ideja për Universitetin e Tetovës. E në ndërkohë vazhdoi thellimi i mosmarrëveshjeve ndëretnike, u zgjerua hapësira për udhëheqësit partiak shqiptarë që të kishin me çka të fitonin pikë politike në fushatat parazgjedhore, duke mos mbajtur llogari se sa do i kushtonin premtimet e tyre popullit shqiptarë dhe Maqedonisë.

Pa dyshim se shqiptarët e paguan shtrenjtë çdo të



arrirë të vetën në Maqedoni. Këtë e pagoi shtrenjtë edhe vetë Maqedonia, sepse ajo e harxhoi në grindjet ndëretnike thujse një dekadë e gjysmë. Mbase kjo ndodhte sepse këto grindje u mundësonin elitave pushtetmbajtëse të fshihnin paaftësinë që ta nxirrnin shtetin nga situata katastrofale ekonomike. Sa i përket krizës ekonomike, shqiptarët mbase nuk ndjenin atë aq sa ata të etnitetit maqedonas. Pasi që edhe në kohën e socializmit ata ishin jashtë ndërmarrjeve shtetërore dhe nuk kishin jetuar nga “paga e shtetit”. Që do të thotë, se shqiptarët thujse nuk morën pjesë në privatizimin e pronës shoqërore, dhe kështu mbetën jashtë një procesi i cili do të përcaktonte edhe ardhmërinë e partive politike në këtë shtet. Do e përcaktonte fatin e partive, sepse për ato të etnitetit maqedonas, gjithmonë do kishte biznesmen të fortë që do i përkrahin materialisht fushatat e tyre parazgjedhore, duke ua kthyer kështu borxhin për privilegjet që ua ofronte pushteti për t’u bërë edhe më të pasur. Nga ana tjetër, partive shqiptare do u mbetej të financoheshin duke mbledhur “haraç” nga dyqanxhinjtë e vegjël shqiptarë.

Ajo që nuk mund t’u falet demokratëve që murrën në duar Maqedoninë në vitin 1990, nuk është gjithaq e vërteta se nuk kishin as vullnet as guxim të përballëshin me zgjidhjen e menjëhershme të të gjitha problemeve ndëretnike, sa është fakti se ata filluan t’i (keq)përdorin këto marrëdhënie të tendosura maqedono-shqiptare. Këtë e bënë që të sundonin më lehtë. Kështu që popullatën e ndanë në

“shtetformues” - etnitetin maqedonas, dhe në “shkatërrues” - etnitetin shqiptarë. Në ata që “jepnin” - maqedonasit etnik, dhe ata që pangishëm “kërkonin” - shqiptarët e këtushëm. Pra, mëkati më i madh i elitave politike të cilat e vendosnin fatin e Maqedonisë në dekadën e parë pas mëvetësimit të saj, është ai se ato u bënë të verbëta e të shurdhëta ndaj kërkesave të drejta të shqiptarëve të këtushëm. Dhe kjo do i çojë shqiptarët që punët e tyre t’i marrin në duart e veta. Bile duke mos kërkuar pëlqim as nga partitë e tyre. Vetëdija e kultivuar me vite te opinionit maqedonas se ata “janë që japin” e shqiptarët “janë që marrin”, do ndikojë të rritet mosbesimi mes këtyre dy etnitetëve në aso përmasash, sa edhe partitë e tyre nuk kishin rrugë tjetër përpos të silleshin si mbrojtëse të etnitetit që i përkisnin. Kështu që Maqedonia gjithnjë e më shumë i largohej konceptit qytetarë, e nga dita në ditë i afrohej humnerës ku do fundosej edhe ajo forcë e pakët lidhëse mes qytetarëve që jetonin në të njëjtin shtet.

## Kali i bradhë

Nga fundi i dekadës së tetë të shekullit të njëzet , filloi të bëhej më e heshtur kureshtja e atyre që shtronin pyetjen se çka do ndodhte me Federatën Jugosllave pas Titos. Ata u heshtën, sepse bëhej gjithnjë e më e qartë se ata të cilët dikur ishin betuar se “edhe pas Titos, do mbetej Titoja”, ngutshëm donin të shlyenin nga vetvetja çdo lidhje “gjenetike” me “babain” e ndjerë të federatës së popujve dhe popullsive të “vëllazëruara”. Pra, tani askush nuk pyeste se “si do mbijetojë Jugosllavia pa Titon”, por të gjithë ishin përqendruar ta harronin të kaluarën nga e cila dolën njësoj të zhgënjyer dhe me ndjenjën se ninulla aq e përhapur për “vëllazërim” të përjetshëm, ishte përdorur sa ti vinte në gjumë të përkohshëm antagonizmat ndëretnike në këtë pjesë të Ballkanit. Dhe tani kur mosëdurimet ndëretnike ishin zgjuar nga gjumi, të gjithë popujt dhe popullsitë e ish Jugosllavisë ndjeheshin ngushtë në shtratin ideologjik të Federatës Socialiste Jugosllave. Andaj edhe me padurim donin atë ta riarnonin, duke u hamendur se vallë do mjaftojë vetëm zëvendësimi i “jorganit” ideologjik me “çarçafin” shumëpartiak, apo do duhet rrënjësisht të rifarkohej krevati i ndarë në gjashtë republika dhe dy krahina autonome. Dhe

përderisa mbledhjet e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë u ngjanin gjithnjë e më shumë klubeve të grindavecëve, populli e shihte se për ardhmërinë e kësaj federate kishte aq projekte sa ishin grupet etnike të cilat e përbënin atë. Por, më hollësisht i përpunuar ishte projekti serbomadh. Ndoshta shkakun se në të ishte punuar edhe gjatë dekadave kur të tjerët bënë gjumë në shtratin e iluzionit se proletariati nuk njihte etnitet tjetër përpos atij ideologjik. Pra, bëhej gjithnjë e më e dukshme se punëtoritë nacionalistë të Beogradit, me kohë kishin bërë çmos të ngulfasin gjithë zërat që do i kundërviheshin politikës millosheviqiane, e cila përfaqësonte atë që kishin projektuar të gjitha elitat e këtij populli, në krye me Akademinë e Arteve dhe Shkencave të Serbisë. Akademi të cilës nuk i mungonin edhe elaboret nga e kaluara për spastrimet etnike dhe asgjësimin e popujve joserbë.

Vitet e fundit të dekadës së tetë të shekullit të njëzet, ishin pasqyrë ku qartë shiheshin fytyrat e moshuara të nacionalizmave të shumtë, që ishin heshtur gjatë sundimit të “mbretit komunist” të Jugosllavisë – Titos. Fytyra e këtyre nacionalizmave të shfrenuar ishte trishtuese, por të gjithë e dinin se nuk kishte kush t’i largonte ato nga skena. Millosheviqi kishte shaluar kalin e tij serbomadh dhe hapur paralajmëronte se atë që nuk do arrinte ta realizonte me fjalë, do e realizonte me armë. Këtë e shpalli hapur në Gazimestan në vitin 1989, para qindra mijërave serbëve, të cilët kishin ardhë nga të gjitha viset ku ata jetonin, edhe atë me qëllim që t’i

dëshmonin Jugosllavisë dhe shqiptarëve të Kosovës, se federata e dikurshme do bëhej atë që me vite kishin ëndërruar – Serbosllavi. Kanosjet se nëse duhej do ushtonin edhe armët, Millosheviqi i tha thujse përpara gjithë udhëheqësve të atëhershëm të Jugosllavisë, e të cilët qëmoti ishin rreshtuar në luftën kundër “nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptarë”, me çka edhe ishin bërë ushtarë dhe shërbëtorë të politikës serbomadhe. Por, ata thujse këtë ende nuk e vërenin, ndoshta duke llogaritur se kjo luftë atyre do ua mundësojë më lehtë të shpëtojnë nga përqafimi ngulfatës i politikës millosheviqiane, apo edhe duke besuar se nga dehja në kafenenë serbomadhe, do pësonin vetëm shqiptarët. Ata këtë nuk e vërenin ndoshta edhe nga se ishin të verbuar nga dëshira që të shpëtonin ideologjinë, e cila i mbante në pushtet.

Si do që të jetë, shumë shpejtë, të gjithë do e kuptojnë se Millosheviqi Kosovën e kishte urë kaluese për të arritur sa më larg në jug e veri, në lindje e perëndim, çdokundë ku kishte një shtëpi serbe e një varrë me kryqin ortodoksë në të. Me çka ngadalë dhe pahetueshëm tretej edhe iluzioni i “vëllezërit të një gjaku” se lehtë do merren veshtë si ta vazhdojnë jetesën vëllazërore në një shtet të përbashkët, ku, sipas iluzionit të tyre, çdo gjë do qetësohej pasi Serbia do i “bashkonte” pjesët që ia kishte “ndarë” nga trupi socializmi titist. Veçanërisht pasi ta ndëshkonte Kosovën, ku serbët kishin vënë në gjumë të gjitha mitet shekullore. Kosovën të cilën asokohe pamëshirshëm e shkelnin thundrat e Armatës Jugosllave dhe të forcave policore të Federatës.

Fundi i dekadës së tetë, të shekullit të kaluar, shënonte përfundimin e një epoke dhe fillimin e një përvuajtjeje të përgjakur. Ishin vitet kur Beogradi zhurmëmadh dhe arrogant, thujse i kishte ngulfatur zërat e urtësisë dhe nga çdokundë dëgjohej ulërime e çmendurisë shoviniste serbe. Kështu që këto vite ishin ato më torturueset mbi popullatën shqiptare, përfshi këtu edhe ata që jetonin në Maqedoninë socialiste, republikë e cila ishte më e dëgjueshmja e Beogradit. Këto ishin vitet e mbledhjeve të gjata të Komitetit Qendrorë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, vitet e netëve të gjata kur dëgjoheshin mendimet e mendjes së shkurtër. Net kur kryeministri i fundit i Jugosllavisë, Ante Markoviqi, mudohej të shpëtojë shtetin federativ, të cilin e kishte mbuluar hija e nacionalizmave, shtet ku Millosheviqi e ndjente veten si zotërues i situatës. Andaj edhe ndaj armatën jugosllave, ndaj buxheteve federative, filloi të sillet si ndaj pronës serbe. Dhe përderisa Markoviqi kërkonte rrugë si të dilet nga ekonomia socialiste në atë të pronës private, Millosheviqi ngutshëm hapte rrugë se si çdo gjë që ishte e përbashkët, që u takonte gjithë etniteteve të cilat e përbënin federatën jugosllave, ta vinte nën kontroll të vet. Mbase ky veprim i tij ishte vendimtar që Sllovenia ta bëjë ndryshimin e Kushtetutës së vet qysh në vitin 1989, me çka ajo do mundej t'i kundërvihej çmendurisë millosheviqiane më e përgatitur se gjitha subjektet e tjera të federatës. Dhe më lirshëm do i jetojë vitet kur hapur flitej edhe për mundësinë që nga vetëqeverisja socialiste, të

kalohet në sundim ushtarake, që socializmin jugosllavë ta shpëtonin gjeneralët e Titos.

Në vitet e fundit të dekadës së tetë të shekullit të njëzet, frynte edhe një fllad i lehtë nga veriu, por i kapur në vorbullën e shtrëngatës nacionaliste që sa vinte e rritej në republikat e jugut, të cilat bindshëm i kontrollonte Beogradi. Dhe, si çdo erë veriake, e humbte forcën e vetë deri sa arrinte në jugun e federatës së atëhershme jugosllave, ku çdo gjë ishte më e nxehtë dhe digjej nga zjarri, tani më i kallur, i nacionalizmit serb. Kjo freski e veriut, në jug do arrijë e përzier me rrufetë e Beogradit të cilat godisnin çdo lëvizje që vinte nga qendrat politike të veriut – Lubjanës dhe Zagrebit. Të cilat qendra Serbia i luftonte bile edhe me mosblerjen e mallrave që prodhoheshin në Slloveni, apo edhe duke organizuar “mitingje spontane” popullore në të gjitha qendrat ku kishte nevojë që politikanët vendorë të “kthjelloheshin”, të dëgjonin zërin e “popullit”, i cili në të vërtetë ishte zhurma e “revolucionarëve” beogradas. Dhe nëpërmjet këtyre “revolucioneve spontane”, arritën t’i rrëzonin nga pushteti sunduesit komunist në Mal të Zi dhe Vojvodinë. Por, assesi këtë nuk do arrijnë ta realizojnë edhe në Kroaci dhe Slloveni, ku duket se më ishin zgjuar nga gjumi nacionalistët e atjeshëm dhe e kishin kuptuar sa halli i Millosheviqit nuk ishte vetëm si të heshte Kosovën, por edhe si të mbisundonte mbi gjithë të tjerët. Pra, u bë e dukshme se problemi i Jugosllavisë nuk ishte Kosova, por politika serbomadhe. Kështu që, në qarqet

slovene dhe kroate, kishte filluar debati për një sistem të ri shumëpartiak, i cili përballej me “jugun” ku ende ushqej besimi se Jugosllavia do shpëtonte, se atë do e mbronte “njeriu i ri socialist”. Andaj, derisa në Lubjanë e Zagreb hapur mbroheshin qëndrimet se partia komuniste duhej të mbetej një nga shumë partitë tjera që do thurnin kurorën shumëpartiake, në republikat e tjera mbisundonte qëndrimi i komunistëve serbë, nën kapotën e të cilëve fshihej flamuri me katër “s-të”, të vendosura në katër hapësirat e formuara nga kryqi ortodoks. Kështu që, të gjithë së bashku, edhe demokratët e rinj edhe nacionalistët e porsashpallur, kishin dalë nga po e njëjta kapotë – ajo komuniste. Me çka u dëshmuua se kur një komunist i flaktë mbetet pa kishën ideologjike, atëherë ai bëhet vetëm nacionalist i tërbuar. U vërtetua se kur komunisti mbetet pa mbështetjen e emblemës ideologjike, ngutazi futet nën flamurin etnik. Andaj edhe nëse nuk dihej se kush mbronte e kush sulmonte ideologjinë e vjetër, shihej qartë se të gjithë mbronin vetëm etnitetin e vet. Kështu edhe filloi faza e shpalljes së autonomive serbe kudo që ata jetonin, edhe atë gjithmonë në emër të mbrojtjes së federatës së Jugosllavisë nga të tjerët. Kjo mbrojtje bëhej në atë mënyrë sa Federata gjithnjë e më shumë i ngjante një “serbosllavie” millosheviqiane, një shteti të kontrolluar nga Beogradi, e të cilin qëmoti e kishin projektuar akademikët serb.

Në këto vite, filloi hapur të flitet edhe për një sistem të ri shumëpartiak. Në rrjedhë të këtyre ideve



ishite edhe formimi i UJD-së, një shoqate për të ndihmuar ribërjen e Jugosllavisë mbi bazat e pluralizmit partiak. Kjo shoqatë, e cila grumbulloi rreth vetes të gjithë emrat më të shquar të asaj kohe, ishte e vonuar, sepse punëtoritë nacionaliste kishin përfunduar përgatitjet e veta. Shtabet serbomëdha kishin vendosur që Jugosllavinë ta mbronin me armë. Që në fund të dilte se armët e tyre, në të vërtetë, shkatërruan Jugosllavinë dhe i përgjakën këto hapësira. Edhe atë në kohën kur askush nuk mund ta paramendonte se në shekullin e njëzet, serbët jetonin me ëndrrat shovene të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

E ndodhur gjithmonë në bisht të ngjarjeve, Maqedonia e asokohshme, nuk merrej as me vetveten, as me ndryshime sistemore, as me pluralizëm, e bile as me flladin që frynte nga veriu drejtë jugut. Ajo më shumë ishte përqendruar të bëjë çmos që të mos e hidhëronte Beogradin dhe ta ndihmonte projektin e Millosheviqit. Qarqet politike maqedonase të asaj kohe, i ngjanin gjelit i cili gjithmonë këndonte me vonesë, pasi të kishte dëgjuar se të tjerët kishin paralajmëruar arritjen e mëngjesit. Kështu që ishte zë të cilin askush nuk e dëgjonte, pasi që dita moti kishte gdhirë. Shkupi zyrtarë i asaj kohe ishte ende filiali më i dëgjueshëm politik i Millosheviqit dhe përkrahësi më i denjë i politikës shtypëse mbi shqiptarët në Kosovë dhe Maqedoni. Gjë që i kishte kalbur marrëdhëniet ndëretnike mes maqedonasve etnik dhe shqiptarëve të cilët jetonin në Maqedoni. Prandaj në Maqedoni edhe shumëpartizmi erdhi i vonuar, thua se jo si nevojë e natyrshme e qarqeve të

këtushme politike dhe intelektuale, por si domosdoshmëri e nxitur nga të tjerët dhe nga inatet mes dy etnitetëve më të mëdha që jetonin në këtë shtet. Pra, shqiptarët do formojnë partitë e veta jo gjithaq që të shprehin konceptet demokratike, sa të mbrojnë vetveten nga politika antishqiptare e atëhershme. Dhe kjo ndodhi vetëm pasi që në Kosovë ishte themeluar Lidhja Demokratike e Kosovës me në krye Ibrahim Rugovën, parti të cilën të gjithë shqiptarët e atëhershëm që jetonin në Jugosllavinë e dikurshme, do e ndjenin si lëvizje mbarëshqiptare. Ndoshta kjo ndodhi shkak i inercionit, apo për shkak të instinktit vetëmbrojtës në çastet kur shihej qartë se të gjithë popujt e ish Jugosllavisë ngutshëm strehoheshin nën tendën e vetë etnike. Si e tillë, LDK-ja ishte ajo që jepte udhëzime se ç'duhej të bënin shqiptarët në republikat tjera: të formojnë partitë e veta, apo të bëheshin “degë” të LDK-së së Prishtinës.

Ndoshta duke e parë se Kosova nuk do mundej të vepronte si dikur – të mbronte interesat e gjithë shqiptarëve që jetonin në Jugosllavinë e cila shpërbëhej, duke filluar që nga arsimimi i tyre e deri te ngritja kulturore - Prishtina dha “pëlqimin” që shqiptarët e Maqedonisë të vetorganizoheshin dhe të themelonin partitë e veta. Kështu që, me 15 prill të vitit 1990 u formua partia e parë e shqiptarëve të Maqedonisë – Partia për Prosperitet Demokratik në krye me Nevzat Halilin – kryetar dhe Dushko Apostollovskin - sekretar i partisë. Vetë emrat e kryesuesve të saj shpjegojnë shumëçka lidhur me

kohën dhe rrethanat kur u formua kjo parti. Këta dy emra e bëjnë të dukshëm hapin e mbetur në ajër të shqiptarëve të këtushëm, të cilët hamendeshin dhe nuk e dinin se vallë më mirë do u dilte ta lëshonin këmbën në terrenin e organizimit partiak në baza etnike, apo të shkelnin mbi truallin e konceptit qytetarë. Në fund, zgjodhën “zonën” neutrale: të shtireshin se janë parti qytetare, e të vepronin si forcë politike njëetnike. Gjë që nuk ishte e lehtë, sepse bëhej fjalë për vite kur propaganda antishqiptare, e shpallte si veprimtari “shqiptaromadhe” edhe ndërtimin e ndonjë muri më të lartë rreth oborrit të shtëpive shqiptare, e lere më formimin e partisë. Prandaj tetovarët e gjindshëm zgjodhën këtë formulë: të bënin parti shqiptare, por me një maqedonas etnik në krye të saj. Edhe pse as kjo nuk i shpëtoi nga sulmet e qarqeve politike të etnitetit maqedonas, që kërkonin kjo parti të mos regjistrohet, të shpallet si e jashtëligjshme, duke e arsyetuar këtë kërkesë të tyre me vlerësimet se PPD-ja ishte parti njëetnike, se kishte për qëllim shkatërrimin e bashkëjetesës mes maqedonasve etnik dhe shqiptarëve. Kjo frymë kundër PPD-së, e çoi këtë parti që për një kohë të gjatë të merret me dhënien e shpjegimeve se nuk ishte parti e pastër njëetnike.

Kryesuesit e kësaj partie shumë më vonë do e rimarrin veten, e do çliroheshin nga sulmet e qarqeve “qytetare”. Për këtë më së shumti do u “ndihmojë” themelimi i disa partive të atëhershme të etnitetit maqedonas, të cilat kishin shenjë njohëse nacional - romantizmin, apo edhe antishqiptarizmin. Ndër të

cilat do veçohej dhe do printe VMRO - DPMNE-ja, e cila doli rrugëve me parulla të pastra antishqiptare, gjë që do të vinte baraspeshë sa u përket partive etnike maqedonase dhe shqiptare. Dhe mbase pikërisht kjo parti maqedonase i vetëdijesoi qarqet politike shqiptare: ua bëri të ditur se Maqedonia ishte projekt të cilin çdo etnitet e ëndërronte krejt ndryshe, ku nuk mungonin as qarqet politike të etnitetit maqedonas të cilat e dëshironin një shtet pa shqiptarët në të. Apo me shqiptarë të nënshtruar, të cilët do “asistojnë” që edhe etniteti maqedonas të ketë shtetin e vet. Andaj, PPD-së i ra në hise që të vë baraspeshë mes nacionalromantizmit shqiptarë dhe atij të etnitetit maqedonas, mirëpo pa e kaluar kufirin i cili e ndan nacionalizmin pozitiv me shovinizmin, e të ofendojë tërë një popull, ashtu siç bënin aktivistët e VMRO-DPMNE-së së atëhershme, të cilët, njësoj si çdokush i ushqyer me shpirtngushtësi etnike, irritoheshin edhe nga vetë prezenca fizike e shqiptarëve të Maqedonisë. Kështu që simpatizantët e kësaj partie i mbuluan vendbanimet me parulla nga më shovenet me përmbajtje: “Dhoma gazi për shqiptarët”, “Maqedoni pa shqiptarët” e të tjera.

Tërë kësaj euforie nacionaliste maqedonase, shqiptarët i përgjigjeshin me mitingjet e veta ku lartë e më lartë valëvitej shqiponja dykrenore dhe mohohet flamuri shtetërorë, si dhe çdo gjë që e simbolizonte shtetin. Që do të thoshte se “beteja” e mosdurimeve etnike rrokullisej rrugëve, se më ishin të pakuptimta debatet të cilat do zgjasin deri në ditët

e sotme, se vallë shumëpartizmi i Maqedonisë duhej ndërtuar mbi partitë etnike apo ato qytetare. Ky debat rezultoi me partitë që kishin programe qytetare, por ishin të ndara në terrenin e vet etnik. Ashtu siç do veprojnë edhe më vonë. Ashtu siç do jenë edhe atëherë kur në emrat dhe emblemat partiake nuk do ketë asnjë shenjë etnike.

PPD-ja u regjistrua dhe u legalizua me 25 maj të viti 1990. Shumë shpejtë, ajo do fillojë organizmin e saj të mëtejme. Shpejtë ajo do bëhet një lëvizje mbarëpopullore e shqiptarëve të Maqedonisë, me seli në Tetovë. Si e tillë ajo do arrijë të faktorizohet aq ngutshëm sa edhe LDK-ja e Kosovës. Kështu që edhe Tetova, ngutazi morri në duar flamurin e qendrës së tretë kombëtare, nga rrezatonte faktori politik shqiptarë në këtë Ballkan. Me çka Shkupi bëhej gjithnjë e më i largët për shqiptarët: mitingjet e partive shqiptare mbaheshin në Tetovë, e ato të etnitetit maqedonas në Shkup. Diku në mes të kësaj hapësire, mbetej e vërteta se cilido shqiptarë që kishte emblemën e PPD-së, ishte atdhetarë dhe patriot, e shumica e të mbeturve jashtë ishin ata të "dyshimit". Në ndërkohë, bëhej gjithnjë e më e qartë se populli ishte vetëm zbukurim, se PPD-ja shkonte drejtë të ardhmes pa e ditur rrugën që çon drejt saj. PPD-ja kishte repertor të pasur parullash përplot patriotizëm dhe popullit që me dekada kishte qenë dhunshëm i heshtur, që me vite kishte jetuar duke fshehur mendimet e veta politike, sa për fillim i mjaftonte edhe aq: shqip e zhurmshëm të përkrahte të zgjedhurit e vet, të cilët ua kishte ofruar

“nëna parti”. Por kësaj radhe jo ajo komuniste, por partia e tyre, e cila u fliste shqip dhe mbase edhe do i sundonte “alla shqiptarçe”.

Sado që asokohe PPD-ja e tyre forcohej, shqiptarët e Maqedonisë prapë e mbanin kokën ende të kthyer nga Kosova dhe Shqipëria. Këtij inercioni nuk do mund t’i shmangeshin as udhëheqësit e PPD-së. Në të vërtetë, në vitet e para kjo parti vepronte si “degë” e LDK-së në Maqedoni dhe ishte pjesë e një Kolegjiumi ndërpartiak që kryesohej nga kryetari i LDK-së, Ibrahim Rugova. Por, shumë shpejt edhe Tirana zyrtare do kërkojë “pjesën” e vet të ndikimit mbi partitë e shqiptarëve të Maqedonisë. Dhe posa u forcua Partia Demokratike e Sali Berishës në Tiranë, ajo do pretendojë të bëhet udhërrëfyese e partive shqiptare jashtë shtetit amë. Kështu që, në njëfarë mënyre, shqiptarët e Maqedonisë qysh në fillimet e organizimit të tyre partiak, u ballafaquan me një kundërthënie: përkrahnin shumëpartizmin në Jugosllavi, por vetë donin të mbeten pjesë e ndonjë lidhjeje të re mbarëshqiptare të kryesuar nga LDK-ja e Rugovës. Mbase jo pse nuk e kuptonin dhe nuk e donin shumëpartizmin, por ndodheshin përballë nacionalizmave sllav që grindeshin mes veti, por kur bëhej fjalë për shqiptarët, lehtë merreshin veshtë dhe rreshtoheshin nën flamurin antishqiptarë.

Kjo periudhë e organizimit të tyre partiak, nuk do zgjasë shumë. Ndoshta edhe nga shkaku se edhe te udhëheqësit partiak vendorë, filloi më vrullshëm të rrah ndjenja për të qenë i pari në mjedisin e vet. Mbase kjo nxiti edhe formimin e partive të

mëvonshme, si Partinë Demokratike Popullore. PDP –ja u themelua me 23 qershor të vitit 1990, ndërsa kryetar i parë i kësaj partie me seli në Tetovë ishte Jusuf Rexhepi.

Dhe përderisa Tetova u dhuroi shqiptarëve dy parti, Shkupi i atëhershëm zyrtarë mbetej në zhurmën e debateve se a duhet lejuar apo ndaluar partitë një etnike. Maqedonia, pra, ishte e humbur në mjegullën e debatit se me çka duhej ta begatonte hartën e shumëpartizmit, ndoshta e irrituar edhe nga e vërteta se udhëheqësit e PPD-së kishin shaluar kalin e bardhë të demokracisë dhe mbanin në Tetovë mitingjet ku shprehej qartë tërë frustracioni ndaj një sistemi, i cili thuajse të gjitha të drejtat e tyre i kishte harruar të shkruara në kushtetutë, sipas së cilës ata kishin disa të drejta, por mund t'i përdornin vetëm ato që ua lejonin “pashallarët e kuq” vendorë. Kështu që fillimi i shumëpartizmit në Maqedoni, mund të përshkruhet me pak fjali sa u përket shqiptarëve: ata shalnin kalin e bardhë të një nacionalromantizmi, i cili nuk guxonte të mbetej mbrapa atij të etnitetit maqedonas. Me atë dallim se disa qarqe politike maqedonase të asaj kohe hapur dilnin rrugëve me parullat për “Maqedoni pa shqiptarët në të”, e shqiptarët me britmat që tregonin se nuk do duronin më “sllavokomunizmin” torturues. Aty ku përballeshin këto dy brohoritje krejtësisht kundërthënëse, shkaktohej vorbulla e thellë e ndasive etnike, në të cilën vorbull Maqedonia e pavarur do ngulfatet vite me radhë pas pavarësimit të vet.

Pra, Maqedonia e viteve të para të dekadës së

nëntë, të shekullit të njëzet, jetonte mes shpresave të atyre që me buqetë të gatshme lulesh prisnin ardhjen e Armatës Jugosllave që t'i shpëtonte nga "zullumi" i partive njëetnike dhe të atyre që donin Beogradin ta zëvendësonin me Sofjen. E në ndërkohë, si në qarqet politike të etniteti maqedonas, po ashtu edhe në ato shqiptare, thuajse askund nuk dëgjohej zëri i atyre të cilët do e zbusnin acarimin e marrëdhënieve ndëretnike. Zëri i atyre që do ishin aq vizionarë sa të shihni se themelet e Maqedonisë shumetnike nuk duhej të gërryeshin me buldozerin e mosdurimeve ndëretnike, por me lopatën e një besimi të ndërsjellë. Kështu që Maqedonia e asokohshme i ngjante republikës, e cila jetonte ankthin e frikës se vallë do mundej ta përballë të ardhmen e saj si shtet i pavarur. E këtë frikë më së shumti e ushqenin qarqet proserbe në Maqedoni, të cilat popullatën e trishtonin herë me propagandën se mes maqedonasve etnik dhe shqiptarëve nuk mund të ketë bashkëjetesë në një shtet të përbashkët, se shqiptarët kishin vetëm një ëndërr – atë të "Shqipërisë së madhe"- e herë me propagandën për rreziqet nga qarqet probullgare. Pra, edhe në Maqedoni dikush u frynte fuqishëm borive të konfliktit ndëretnik dhe ndoshta këtë shtet nga lufta e shpëtoi vetëm e vërteta se Millosheviqi e konsideronte si "kopsht" të sigurt ku do mund të kthehej pasi t'i pastronte llogaritë me të padëgjueshmit tjerë. Apo ndoshta këtë shtet e shpëtoi edhe e vërteta se nuk kishte një përqindje më të madhe serbe, e cila do manipulohet nga Beogradi, që të fillonte ndonjë "re-



volucion” të ri në zinxhirin e të shumtëve, me anë të të cilëve serbët e vërshuan Jugosllavinë e atëhershme nga Kroacia e deri në jug të ish federatës.

Si do që të jetë, shqiptarët e Maqedonisë zgjedhjet e para shumëpartiake i pritën me dy parti të tyre dhe me shumë shpresa se më në fund do arrinin t’i realizonin ambiciet kolektive, të heshtura dekada me radhë. Zgjedhjet ndodhnin pas një dekade kur në Maqedoni thuajse ishte ngulfatur arsimimi në gjuhën amtare me të ashtuquajturat paralele të përziera nëpër shkollat e mesme, me një përqindje të vogël studentësh shqiptarë nëpër universitetet e këtushme, me mospasjen mundësi që të rinjtë e këtushëm shqiptarë të studionin si dikur në Prishtinë. Pra, shqiptarët kishin aq frustracione sa përfaqësuesit e PPD-së dhe PDP-së nuk e kishin vështirë të përpilonin parulla, të jepnin premtime nëpër mitingjet parazgjedhore. E në ndërkohë të mos kishin asnjë platformë të qartë se nga do ia fillonin me kërkesat shqiptare.

Jehona e parullave të partive shqiptare të këtushme kishte arritur deri te mërgimtarët shqiptarë në perëndim. Kështu që disa ditë para zgjedhjeve të para parlamentare shumëpartiake në Maqedoni, aeroportin e Shkupit e vërshuan kurbetçinjtë që vinin të votonin për partinë e tyre shqiptare. Dhe shumë shpejtë do dëshmohej se nga ardhja e tyre do kenë dobi vetëm agjencitë të cilat ua organizonin udhëtimin, si dhe deputetët e porsazgjedhur shqiptarë, të cilët në mitingjet parazgjedhore zëshëm shpalosnin patriotizmin e

tyre, e në bankat parlamentare, në heshtje, jetonin privilegjin e të qenurit parlamentarë. Pra, bënin atë që kishin mësuar gjatë viteve kur ishin ngrohur nën kapotën ideologjike: popullit t'ia thuash atë që dëshiron të dëgjojë, e në institucionet shtetërore të veprosh ashtu që të mos e hidhërosh “pronarin”, e të mos e rrezikosh rehatin personale.

Në zgjedhjet e para parlamentare të vitit 1991, në parlamentin prej 120 deputetësh, shqiptarët kishin gjithsejtë 23 deputet. Ata në parlamentin republikanë të Maqedonisë e sollën edhe tërë entuziazmin e zgjedhësve të vet që prisnin më në fund të bëhen “bashkëpronarë” të barabartë të shtetit ku jetonin. Entuziazmi i parlamentarëve shqiptarë ishte në kundërshti me atë të përfaqësuesve të etnitetit maqedonas, të cilët në parlament sollën bindjen se kishte ardhur koha Maqedonia të ndërtohej ashtu siç e ëndërronte etnitetit shumicë në këtë shtet. Që do të thotë, qysh në fillim Maqedonia e pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë, u gjet e ngërthyer mes dy ëndrrave të etniteteve numerikisht më të mëdha. Ajo do mbetet vite me radhë në kthetrat e këtyre dy ëndrrave, diametralisht të kundërta, deri në konfliktin e 2001, e pas tij. Kjo situatë që shkurt mund të emërohet edhe si lindja e një “princeshe”, të cilën dy të dashur e ëndërrojnë vetëm për vete, do rezultojë me shumë kundërthënie në punën e parlamentit, si dhe në vendimet e marra të cilat në periudhën e përbërjes së parë parlamentare, më së miri pasqyroheshin gjatë themelimit të qeverive, gjatë miratimit të Kushtetutës dhe gjatë shpalljes së

referendumit për pavarësinë e Maqedonisë.

Kur Maqedonia shpalli referendumin për pavarësinë e vet, mund të thuhet se deputetët shqiptarë ende nuk e kishin të qartë se vallë duhej të bëheshin ndërtues të një shteti të përbashkët, apo faktorë që do jepte ndihmën e vetë në “zgjidhjen integrale” të çështjes shqiptare në Ballkan. Pavendosmërinë e tyre e shtonte edhe veprimi politik i palës së etnitetit maqedonas, e ku dominonin dy taborre: ata që donin pavarësinë e Maqedonisë, dhe ata që mbase kishin dilema se vallë ajo do mundë të mbijetonte si e pavarur. VMRO-DPMNE-ja ishte ajo që udhëhiqte frontin antijugosllav. Por, të cilit front mediat e këtushme shpejt do ia ngjisnin emblemën probullgare dhe do e shpallnin si forcë politike që donë të bëjë vetëm zëvendësim të pozitës “vasale” të Maqedonisë, dhe nga ndikimi i Beogradit, ta çonte në përqaqim të Sofjes.

Asokohe më i koordinuar ishte tabori i cili bënte hapat e fundit që të mbante sadopak lidhjet e vjetra me vëllanë më të madh – Serbinë. Atë e përfaqësonin “luanët e rinj” të Kiro Gligorovit. Pra liderët e Lidhjes Socialdemokratike të Maqedonisë, parti e dalë nga Lidhja Komuniste e Maqedonisë. Parti e cila, në atë kohë, mbante nën kontroll mediat që krijonin opinion për atë që ndodhte në shtet dhe jashtë tij. Ashtu të fortë dhe mediatikisht të për-krahur, “luanët e rinj” të Gligorovit, arrinin disi të dominojnë me idetë e tyre. Këtë e arritën dhe gjatë debatit për pyetjen e referendumit për pavarësinë e shtetit që në të vërtetë kishte dy kuptime: të drejtën

për pavarësi dhe të drejtën që të mbetet në konfederatën e ardhshme Jugosllave. Dhe ajo pyetje e referendumit, i cili u mbajt me 8 shtatorë të vitit 1991, përmbante këtë “dypyetsorë” në vetvete: “A jeni për shtetin e pavarur e sovran të Maqedonisë, me të drejtë që të hyjë në bashkësinë e shteteve sovrane të Jugosllavisë së ardhshme.”

Gjithsesi që një pyetje e tillë e referendumit, nuk ishte e pranueshme për shqiptarët dhe për rrymën politike të cilën e udhëhiqte VMRO-DPMNE-ja. Arsyet ishin të shumta, por mbi të gjitha ajo, se qarqeve politike shqiptare më shumë u konvenonte një Maqedoni e pavarur se sa një si ajo në të cilën kishin jetuar me dekada: me mundësinë të mbetet edhe më tej e kontrolluar nga Beogradi. Asokohe e pa qartë për ta mbetej vetëm se çka do ndodhte me Kosovën. Mbase parlamentarët shqiptarë kishin vetëm një rrugë e cila do i shpëtonte edhe nga mëkati eventual që të jetojnë të ndarë nga Kosova dhe të lënë shteg për veprim ndryshe. Ajo ishte ta thirrin popullatën të bojkotojë këtë referendum.

Dhe kështu filloi “sezoni” i ndërtimit të shtetit pa pëlqimin e shqiptarëve. Ky zhvillim, më tej, do shkojë edhe drejt mosmiratimit të Kushtetutës së Maqedonisë nga parlamentarët shqiptarë, si dhe mosmarrjen pjesë në regjistrimin e popullatës në vitin 1991. E të gjitha këto veprime, mbase të ardhura si rezultat i pavendosmërisë së faktorit politik, nëse jo më shumë, lanë të hapur derën e debateve të mëvonshme lidhur me të gjitha çështjet

që kishin të bëjnë me konceptin shumetnik të Maqedonisë. Pra, një veprim i këtillë i PPD-së, sado i nxitur nga arsye të tjera, u tregua i arsyeshëm, në mos më shumë, nga shkakku se shqiptarët, që në fillim të pavarësimit të Maqedonisë, vunë një distancë ndaj shtetit, apo thënë më mirë, “problemin shqiptarë” në Maqedoni e lënë të mbetej i hapur.

Të gjitha këto veprime të rëndësishme për pavarësinë e Maqedonisë, e të cilat u bënë pa pëlqimin e shqiptarëve, pasqyronin qartë se Maqedonia e pavarur, “gjenetikisht” ishte më e ngjashme me “nënë” nga e cila kishte dalë – Jugosllavinë e dikurshme. Se në të vërtetë themelet e veta ajo i ndërtonte mbi formulën e dikurshme socialiste që nënkuptonte bashkimin e “popujve” të vëllazëruar, për të cilët do kujdeset “vëllai” i madh – kësaj radhe etniteti maqedonas. Kështu që në kushtetutë, në vend të fjalës “pakicë etnike” u përdorë “nacionalitet”. Pra, u miratua një kushtetutë me pretendime qytetare, por me bosht kurrizorë njëetnik. Gjë që më vonë do dëshmohet si burim i krizave dhe i mosmarrëveshjeve të shumta ndër-etnike. Dhe si e tillë, do ishte pasqyrë ku do të shihej fytyra e një demokracie të deformuar, që nuk shprehte shumëngjyrshmërinë etnike, kulturore dhe religjioze të Maqedonisë, por që qartë pasqyronte tendencat e qarqeve politike të etnitetit maqedonase që të mos lëshojnë pe ndaj kërkesave të shqiptarëve.

Por në ndërkohë, ata thuajse kishin harruar se shqiptarëve më u kishte dala frika e dikurshme, se pas aq mitingjeve ku ishin ushqyer me guxim dhe

kishin zbratur frustracionet nga e kaluara, tani i udhëhiqte euforia që sa më shpejtë dhe në të gjitha segmentet të jenë zot të vetvetes. Dhe vitet e para, të mëvetësimit të Maqedonisë, do karakterizohen me shumë veprime “jashtinstitucionale” të shqiptarëve, siç ishin ato të themelimit të shkollave të mesme në “të egër”, pa pëlqimin e institucioneve shtetërore. Shkolla të këtilla u hapën në Strugë dhe Kërçovë, dhe aty mësonin fëmijët shqiptarë të cilët rrezikonin që të mos u njiheshin diplomat nga askush. Në ato shkolla banonte edhe inati shqiptarë si dhe vendosmëria e tyre që t’i merrnin të drejtat të cilat u takonin, disa nga të cilat edhe i kishin para periudhës së konceptit “klimovski”, i cili kishte për qëllim të dëmtonte shkollimin e të rinjve shqiptarë. Dhe mbase këtë deri diku edhe e realizoi, sepse gjatë periudhës së fundëdekadës së tetë të shekullit të njëzet, nëpërmjet të instrumentit famëkeq të paraleleve të përziera (nxënësit shqiptarë shpërndaheshin nëpër ato paralele ku mësonin bashkëmoshatarët e tyre maqedonas dhe mësimi zhvillohej vetëm në gjuhën maqedonase), thuajse u ndërpre hovi i arsimimit të të rinjve shqiptarë, dhe veçanërisht arsimimi i femrave.

Pra, pas zgjedhjeve të para shumëpartiake në Maqedoni, parlamenti republikan ishte pasqyrë e nacionalizmave të zgjuar. Kështu që në të dominonin deputetët e VMRO-DPMNE-së, të cilët asokohe arritën famë mu me parullat antishqiptare dhe me premtimet se “Maqedonia do u takonte vetëm maqedonasve”. Me një qëndrim të tillë antishqiptarë,

ata mund të formonin qeveri vetëm nëse u bashkëngjitej PPD-ja me deputetët e saj, apo LSDM-ja (Lidhja Socialdemokratike e Maqedonisë), e kryesuar nga Branko Červenkovski. Shqiptarët as që mund ta bënin këtë mëkat apo akt vetëvrasës e të merrnin pjesë në koalicion qeveritarë të udhëhequr nga antishqiptarët e deklaruar, ndërsa LSDM-ja, e dalë nga kapota e partisë së mëhershme komuniste, e dinte se nuk do ishte në dobi të saj që aq hapur të dilte në krah të një partie, asokohe, të etiketuar si probullgare dhe të dëshmuar si antishqiptare. Kështu që Maqedonia e sapo “demokratizuar” duheshte të jep provimin më të rëndë: të zgjedhë qeveri mes krahëve politik diametralisht të kundërt. E gjetur në këtë pozitë, dhe prapë e ndihmuar nga “dhelparaku” plak që në shkollën e Titos kishte mësuar gjitha mjeshtëritë e “pajtimit” të të kundërtave, pra e ndihmuar nga Kiro Gligorovi që ishte numri një i LSDM-së së atëhershme, Maqedonia do zgjedh një qeveri ekspertësh, jopartiake. Qëllimi i kësaj qeverie mbase do ishte t’u jep kohë partive politike parlamentare që të kthjelleshin nga euforia e zgjedhjeve dhe në ndërkohë ta kuptonin se nuk do të jetë e mundur të formohet një qeveri pa aleanca mes më shumë partive.

Qeveria e parë, e udhëhequr nga Nikolla Klusev, dhe e quajtur qeveria e “ekspertëve”, përfshiu në radhët e saj edhe ministra shqiptarë. Dhe ishte shumë e qartë se ata ministra duhej të ishin shqiptarë, por të kishin mbulesën e pastërtisë “morale dhe politike”. Pra të ishin të “pranueshëm” për palën maqedonase,

gjë që pasqyrore qartë se nisma demokratike e Maqedonisë i ngjante një ikebane politike, e cila duheshite të duket e pranueshme për bashkësinë ndërkombëtare, pa mbajtur llogari se sa do ishte e pranueshme për qytetarët e saj, apo më saktë thënë për shqiptarët. Shqiptarëve iu besuan ministri të rëndësishme por edhe kjo, siç dukej, duheshite të ishte vetëm emblemë e rrejshme, e cila shërbente për të joshur të huajt që kujdesshëm vëzhgonin çka ndodh me Maqedoninë e posa shpallur sovraane dhe të mëvetshme.

E ajo që ndodhte në Maqedoni, në fillim edhe nuk ishte as gjithaq e dukshme as gjithaq e qartë. Këtë e paqartësonin sa grindjet ndëretnike, po aq edhe pluhuri i mosmarrëveshjeve brenda vetë bllokut politik të etnitetit maqedonas dhe atij shqiptarë. Përderisa shqiptarët masovikisht ende i qëndronin besnik “lëvizjes” së vet gjithëpopullore të quajtur Partia për Prosperitet Demokratik, qarqet politike maqedonase përpos që nuk ishin të njëzëshme në përgjigjet që duhej dhënë shqiptarëve, ato madje nuk arrinin dot të merren vesh të edhe mes veti. Mbase kjo vinte edhe nga shkaku i problemeve të shumta që etniteti maqedonas i kishte lidhur me identitetin etnik, me mosnjohjen e gjuhës së tyre nga disa shtet fqinjë, mospranimin e kishës si dhe vetë të qenurit popull i veçantë ndër popujt e shumtë të dalë nga sllavët e jugut. Sado që kjo situatë ishte e pafavorshme për Maqedoninë, ajo ishte shumë e frytshme për njeriun më të rëndësishëm të asaj kohe, Presidentin e Maqedonisë, Kiro Glogorovin, i cili



gjatë atyre viteve zgjidhej në parlament. Gligorovi, nga pozita e të urtit që vinte baraspeshë mes grindjeve ndëretnike dhe brendamaqedonase (njësoj si dikur Titoja në ish Jugosllavinë, që balanconte nacionalizmin serb dhe atë kroat), arriti ta promovojë veten në Maqedoni si shpëtimtarë i saj, ndërsa jashtë shtetit e krijoi imazhin si burrështetas i urtë.

Në dekadat e ardhshme, Maqedonia do e paguaj shtrenjtë këtë politikë balancuese gligoroviane, e cila këtij shteti ia harxhoi më shumë se një dekadë në grindje ndëretnike. Dhe e çoi drejtë 2001, drejtë një konflikt i cili sa nuk e zhyti shtetin në luftë ndëretnike maqedonaso – shqiptare. Pra, politika gligoroviane, e cila mbështetej mbi parimin që kërkesat e shqiptarëve t’i shtysh anësh deri sa nuk ndodhesh i mbështetur për muri, e futi Maqedoninë në dhomën e padukshme dhe me dritare të mbyllura të grindjeve ndëretnike. E sa i përket Kiro Gligorovit, ai u kthye nga Beogradi në Maqedoni mbase duke shpresuar se do bëhej pjesë e legjendës së re, një nga gurëthemet e një shteti të ri. Por, e përfundoi karrierën e vet si politikan pa fizionomi politike. Dhe mu karriera e Gligorovit është ajo që më së miri vizaton edhe rrugëtimin e Maqedonisë në vitet e para të pavarësimit të saj. Apo thënë më saktë, ai është njeriu që vulosi dekadën e parë të demokratizimit të Maqedonisë, e cila periudhë do jetë vendimtare për ardhmërinë e shtetit. E kjo dekadë shkurtimisht mund të përshkruhet si dhjetëvjeçari i hapave gjysmake që edhe Maqedoninë e çuan të ndjehet si e lënë në gjysmë të rrugës. Edhe atë jo vetëm shkaku

se shqiptarët nuk kishin dhënë pajtim për aktet më të larta shtetbërëse, por pse vetë përfaqësuesit e etnitetit maqedonas mbeteshin të pathënë rreth shumë çështjeve themelore për një shtet të porsaformuar në Ballkan. Më në fund, edhe vetë pyetja e referendumit për pavarësinë e shtetit, shpjegonte shumëçka, e në mos më shumë atë se qarqet nën ndikimin e Gligorovit kishin lënë një “derë” të hapur për të korrigjuar “pavarësinë” nëse nuk do shkonin punët siç ishin paraparë. Mbase pyetja e këtij referendumi më së miri zbardhë politikën gligoroviane, e cila emblemë njohëse kishte pavendosmërinë dhe krijimin e institucioneve shtetërore që do e mbronin shtetin nga “rreziku shqiptarë .

Para se të bëhej numër një i shtetit, Gligorovi nuk duheshite të ndryshojë vetëm letrën e njoftimit me adresë të Beogradit, por edhe kapotën e komunistit të mirë ta zëvendësojë me rrobat e demokratit që premtton. Sa për vendbanimin e ri në Shkup, nuk e kishte gjithaq të rëndë ta gjejë, sepse shumë vila të elitës së dikurshme politike në Vodno (kodrinë në anën veriore të Shkupit), ishin të zbrazura. Ndërsa sa për t’u dukur se është demokrat i lindur, i ndihmoi edhe partia më nacionaliste e atëhershme, VMRO-ja, e cila ngulte këmbë që shtetin e porsaformuar ta kurorëzojë me kryqin dhe mantinë ortodokse, kështu që për kryetar të shtetit propozoi njeriun me mantel të priftit, i cili më vonë do bëhet kryepriifti i Kishës Ortodokse Maqedonase. Dhe nëse vlerësohej realisht, për Maqedoninë shumëreligjioze dhe për shqiptarët në të, “kapota” komuniste e Kiro

Gligorovit, dukej si e dalë nga sallonet e Versaçes, nëse krahasohej me mantelin e zi të priftit që e propozonte VMRO-ja për kryetar. Edhe pse shumëkush qysh atëherë e kishte të qartë se nga një ish komunist i rreshkur, i mbetur pa mbulesën ideologjike, mund të bësh vetëm një nacionalist të maskuar në demokrat, apo demagog të diplomuar, prapë se prapë, pas zgjedhjeve të para parlamentare, Gligorovi nuk kishte kundërshtarë të denjë.

Posa u shpall si kryetar i shtetit, Gligorovi bëri të vetmen gjë që dinte ta bëjë si politikan: i balanconte mosmarrëveshjet ndërpartiake dhe ndërretnike, duke u thënë thujse të gjithëve “po”. Por mbase “po-të” e tij e bënin sadopak të pranueshëm edhe për PPD-në shqiptare, e cila besonte se kryetari i kuptonte hallet e tyre si përfaqësues të shqiptarëve dhe kërkesat e drejta të popullit të cilin e përfaqësonin. Në të vërtetë, kryesuesit e atëhershëm të PPD-së, nuk kishin as përvojë as dhunti politike që me kohë ta vërenin se Gligorovi ishte peng i bindjeve të veta komuniste dhe i orvatjeve t’i përshtatet kohës së re. Pra, ai e kishte rëndë të dilte matanë vetëdijes ideologjike për ndërtimin e shtetit shumetnik, andaj edhe i përmbahej parimit se barazia qytetare arrihet në bashkëveprim të “vëllait të madh” që kujdeset për gjithë të tjerët.

Dhe si i tillë, ai do fillojë karrierën politike si njeriu më me ndikim në Maqedoni, e në mandatin e dytë do bëhet “maskotë” e një kohe, do ketë rolin e “mbretëreshës angleze” që simbolizonte shtetin dhe

si i tillë do u thotë “po” thujse të gjitha kërkesave të PPD-së, por duke shtuar se duhet pritur kohë të volitshme që “po-ja” e tij të materializohet. Apo duke u arsyetuar se pengesë për mosrealizimin e kërkesave shqiptare ishin “VMRO-të” e shumta të atëhershme, e që kishin vetëm një strategji politike – antishqiptarizmin. Kështu që asnjëherë nuk do bëhet e qartë se kush më shumë e ndihmonte Gligorovin: partia e cila e përkrahte dhe ku ai kishte librezën partiake numër një – LSDM-ja, apo VMRO-DPMNE-ja, e cila nëpërmjet qëndrimit antishqiptarë, i endte Gligorovit mbulesë pse nuk mund të bënte diçka më shumë që të relaksoheshin marrëdhëniet ndëretnike. Gjithsesi se Gligorovit i ndihmonin edhe “poltronët” e PPD-së, si dhe udhëheqësia partiake e kësaj partie, e cila ishte më afër një amatorizmi politik, se sa pranë një platforme të qartë partiake.

Edhe pse ende çmohet si ruajtësi i paqes së këtij shteti, portreti i Gligorovit si kryetarë i parë i Maqedonisë së pavarur, është përplot me dështime. Deri sa mandati i parë i tij si kryetarë shteti mund të vlerësohet si periudhë kur ai, së bashku me të tjerët, nuk mund të parashikonte të nesërmen dhe kokën e mbante kthyer nga Beogradi me shpresë se çdo gjë do vazhdonte si dikur, pra përderisa mandati i parë i Gligorovit si kryetarë i Maqedonisë mund të përshkruhet si kohë kur i ardhuri nga Beogradi shpejtonte rrugës së demokracisë të ndërtuar me formula socialiste - duke mos pasur gjithaq mundësi t'i kushtojë rëndësi vozitjes - mandati i tij i dytë mund të definohet si kohë kur ai u identifikua dhe u

shpalos si antishqiptarë i heshtur.

Nuk mund të mos thuhet se në kohën kur Maqedonia luhatej mes frikës nga ndarja prej vëllait më të madh – Serbisë, dhe pasigurisë se ku do e shpinte rruga e mëvetësimit, një “dhelpërosh” i rreshkur komunist si Gligorovi, për shtetin e ri, ishte si i ardhur nga Zoti. Në mos më shumë, ai e dinte se premtimet janë ushqim shumë i yndyrshëm për shpresat. Andaj, as kryesuesit e PPD-së nuk do dilnin pa premtime nga kabineti i tij. E ai nuk ngurronte ata t’i presë me fjalë të ëmbla. Për këto takime bile shqiptarët e asokohe trilluan edhe një barsoletë, e cila sado që të jetë trill, shprehë një realitet se ku qëndronte Gligorovi dhe ku qëndronin disa nga udhëheqësit e atëhershëm partiak shqiptarë. E barsoleta thotë se në një takim mes Gligorovit dhe kryesuesve të PPD-së, kryetari i partisë shqiptare pyet presidentin: Zoti Kryetarë, a i keni dhëmbët të natyrshëm, apo dhëmballa të vëna. I gjetur keq, Gligorovi bëhet se nuk e dëgjon pyetjen e bashkëfolësit të vet, por barsoleta mëtej thotë se, Nevzat Halimi këmbëngulë në pyetjen e vetë të dijë se vallë dhëmbët e Gligorovit janë të natyrshëm apo të punuar nga ndonjë dentist i shkathtë. Kur Gligorovi vëren se nuk mund t’i ikë kureshtjes së kryetarit të PPD-së, përgjigjet: “Qofshin artificial apo të natyrshëm, unë mirë bluaj dhe kafshojë me ta!”. Në vitet e mëvonshme, shqiptarët do i përjetojnë të gjitha kafshimet e politikës që e përuroi Gligorovi në Maqedoni, e të cilën pa hile e zbatonin “luanët” e tij të rinj, siç i quante ai vetë të porsa-

ardhurit në krye të LSDM-së.

Koha derisa Gligorovi ishte politikani më me ndikim në Maqedoni, ishte nga ato për të cilat amerikanët thonë: kërkohet mjeshtri që pa ndërprerë të përsëritësh xha-xha, xha-xha... dhe xhi-xhi, xhi-xhi..., por kurrë të mos thuash xhaxhi! Dhe Gligorovi e filloi karrierën e kryetarit duke përsëritë pandërprerë bashkë, bashkë, bashkë... dhe jetesë, jetesë, jetesë..., por kurrë nuk shpjegoi çka nënkuptonte nën emërtimin – bashkëjetesë. Siç duket termin “kohabition”, Gligorovi e kishte kuptuar si alternativë të adaptuar për “bashkim vëllazërimin” e dikurshëm socialistë, të gatuar në furrat serbe, që shkurtimisht mund të deshifrohej si koncept politik i cili bashkëjetesën dhe barazinë ndëretnike e realizonte duke përdorur formulën e përfshirjes së elitave politike të etniteteve në majë të piramidës së pushtetit (apo thënë më saktë: duke thurë ikebanë ndëretnike me përfaqësues të sekteve partiake), por duke lënë bazamentin e institucioneve shtetërore dhe të ndërmarrjeve publike, në duart e një etniteti të vetëm – atij maqedonas.

Nëse në portretin grupor të katërvjeçarit të parë shumëpartiak të Maqedonisë përplot me kontradikta, Gligorovi ia arriti të shpëtojë shpirtin dhe të mos rrëzohet nga kolovajza politike e baraspeshimit mes ambicieve partiake dhe ndëretnike, në mandatin e dytë ai e humbi energjinë dhe si duket maska e demokratit u shkri para kohe nga djersa e një nacionalisti të lodhur. Jo vetëm se u pa se është kryetarë i teledirigjuar nga një parti e

vetme – LSDM-ja, jo vetëm për shkak të aferave të cilat “babain e kombit” e dëshmuuan si mjaft efikas në krevat (afere për dashurinë e tij me këshilltaren për kulturë), por nga shkakut se si numri një i shtetit, asnjëherë nuk dëshmoi se e ndjen veten kryetar i të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre partiake dhe etnike. Sikur të ishte ndryshe, sikur ta ndjente obligimin e njëjtë ndaj të gjithë qytetarëve të Maqedonisë, atij do i kujtohej ndonjëherë, gjatë shkuarjeve të shpeshta në vilën e vet në Ohër, duke kaluar pranë Tetovës apo Gostivarit, të kthente në këto qytete të banuara kryesisht me shqiptarë sa të dëgjonte si tingëllon shqipja dhe të kuptonte se cilat janë kërkesat e këtij etniteti. Në mos për shkak të shqiptarëve, atëherë për hatër të partisë më të madhe të tyre të atëhershme, PPD-së, e cila në zgjedhjet presidenciale të vitit 1995, nuk doli me kandidat të vetin sa të mos i bëjë probleme kryetarit të “urtë”, sa t’ia mundësojë atij që me votat e shqiptarëve të kalojë qysh në rrethin e parë zgjedhorë. Dhe që pastaj, më lirshëm të deklarojë se pas Universitetit të Tetovës qëndrojnë disa radikal shqiptarë (duke e ditur se aktin për themelimin e kishin nënshkruar të gjithë faktorët e rëndësishëm shqiptarë të asaj kohe).

Pra, ai filloi i pari klasifikimin e subjekteve politike shqiptare në “të matur” dhe “radikal”, i cili klasifikim bartë në vetvete edhe kontributin e vetë partive shqiptare, të cilat notonin nëpër lumin e paqartësive të veta se si t’i realizonin premtimet që ua kishin dhënë zgjedhësve të tyre. Pra, nëse

Gligorovi asokohe mendonte se atë nuk e meritonin ta kenë kryetarë shqiptarët “radikal” (të PDSH-së), atëherë PPD-së i ishte dhe i mbeti borxhli. Sepse kjo parti ia jepte edhe legjitimitetin e shqiptarëve, edhe pse Gligorovi me “luanët e tij të rinj” në qeveri - në krye me socialdemokratën Cërvenkovski - këtë legjitimitet do e përdorin edhe për t’i shpallur shqiptarët si fajtorë kujdestarë për të këqijat me të cilat përballej shteti. Këtë do mundohen ta bëjnë edhe nëpërmjet aferës së mëvonshme për armët, të cilat u gjetën te disa aktivistë të PPD-së, kur shumë shqiptarë u dënuan si “armiqtë brendshëm të shtetit”.

Kuptohet, do të ishte e padrejtë dhe mëkat për qëndrimin mospërfillës ndaj kërkesave të atëhershme shqiptare, të fajësohet vetëm Gligorovi. Sepse nuk është e thënë mëkot se, çdo njeri bënë vetëm atë që ia mundësojnë të tjerët. Kryetarit të dikurshëm të Maqedonisë, iu lejua që thajse të mos i përfill shqiptarët, kështu që ai nuk e ndjeu të nevojshme as të përfshijë ndonjë këshilltar shqiptarë në kabinetin e vet. I cili, në mos më shumë, do i shpjegonte se kohët kur shqiptarët dikush i ndante në të “ndershëm” dhe të “pandershëm”, kishin vdekur, se ato kohë ishin varrosur bashkë me shtetin e dikurshëm që e ndërtonin sllavët e jugut, e mbi të cilin varrë shkruante: “Këtu prehet kufoma e bashkim vëllazërimit të rrejshëm socialist”.

Asokohe, Gligorovi mund të ketë menduar se mungesën e të punësuarve shqiptarë nëpër institucionet shtetërore, do e plotësonte me



aktivistët e PPD-së, të cilët e shoqëronin herë pas herë edhe në udhëtimet vendimtare jashtë shtetit, e ku duhej të huajt të shihnin se ai ka përkrahjen e të gjithë qytetarëve. Pra, në shpurën e vetë “mbretërore”, ai shpesh merrte pas vetes edhe ndonjë parlamentarë shqiptarë, si “përcjellës” të pagojë, e disa prej të cilëve i emërtonte edhe si “bij” të tij ideologjikë.

Si do që të jetë, Gligorovi si kryetarë i parë i Maqedonisë së pavarur, ishte ai që vendosi edhe rregullat ndëretnike që do luheshin deri në vitin 2001, kur ndodhi konflikti i cili institucioneve shtetërore përnjëherë ua nxori mbulesën e rrejshme dhe i shpalosi si njëetnike, i bëri të shihej qartë se ishin në mbrojtje të interesave të vetëm një etniteti - atij maqedonas. Pra, Gligorovi dhe bashkëvendimtarët e tij të LSDM-së, ishin ata të cilët jo vetëm që vazhdonin t’i ndanin shqiptarët si dikur në të “ndershëm” dhe “radikal”, por do shkojnë edhe një hapë më tej: Maqedonisë nuk do i lejohej të dilte nga dhoma e padukshme dhe e errët e grindjeve ndëretnike. Mbase këtë veprim politik Gligorovi e imponoi i bindur se, në ndërkohë, Millosheviqi do e kryente suksesshëm misionin e tij pushtues mbi mjediset tjera në ish Jugosllavi, dhe kur do kthehej në Maqedoni, Gligorovi do ia dorëzonte atë të plotë dhe me rregulla të “favorshme” për ta sunduar Beogradin: të pangarkuar me “problemin shqiptarë”.

Por, as kjo ndarje në “parti të përshtatshme dhe radikale shqiptare”, as të gjithë ata shqiptarët që ai i thirrte me emrin “biri im”, Gligorovit nuk do i

ndihmojnë ta portretojë veten ashtu siç e ëndërronte: si politikan i urtë i cili e kishte të qartë se Maqedonia ka ardhmëri vetëm nëse ia arrin të ndërtojë ura të nevojshme të komunikimit mes etnive, kulturave dhe religjioneve të shumta që dallonin qytetarët e shtetit, në krye të të cilit ai ishte që nga fillimi e deri në vitin 2000 kur e zëvendësoi Boris Trajkovski. Pra, i dalë nga kapota komuniste, koncepti qytetarë për të ishte po aq i largët sa edhe ai i pronës private. Andaj edhe Maqedonia vite me radhë do paguaj çmimin e moszgjidhjes kushtetuese të një sistemi të qytetarëve të barabartë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre kolektive, si dhe mangësitë gjatë privatizimit të pronës shoqërore, e cila u bë në baza të përkatësisë etnike dhe partiake, e jo duke pasur parasysh të drejtën e të gjithë atyre mbi shpinën e të cilëve ishte vënë ajo pasuri. Dhe pa dyshim, se do vinte koha kur do paguheshin këto mëkate. Kur erdhi dita që Maqedonia t'i paguante llogaritë e politikës "gligoroviane" – pra viti 2001 - dhe kur edhe një herë u dëshmuua se koha është fajdexhi që nuk i harron ata të cilët i kanë borxh, ata që gabimisht apo mëkot e kanë harxhuar, Gligorovi më nuk ishte kryetar i shtetit. Por, të gjithë rikujtuan kryetarin e dikurshëm që mbeti me portet pa fizionomi të qartë politike, portret i cili do i ketë të gjitha ngjyrat e kohës dhe ngjarjeve që ndodhën deri sa ai ishte kryetar. Diku në prapavijë të portretit të tij, mbeten edhe shumë pyetje. Si për shembull ajo se çka bënë dhe, cilët ishin asokohe politikanët shqiptarë, si vepronin partitë shqiptare në vitet kur gjithashtu

ngjyrorej edhe portreti individual dhe kolektiv i shqiptarëve të këtushëm. Siç do mbetet edhe pyetja se vallë çka ishte ajo që e pengonte “lëvizjen” e atëhershme gjithëpopullore - PPD-në - që t’i artikulonte drejtë kërkesat e shqiptarëve. Të mos luhatej nga konceptet për autonomi për shqiptarët, e deri te konceptet për një Maqedoni të qytetarëve të barabartë.

Nëse maten me peshoret objektive, kuadrot e PPD-së të cilat u përfshinë në institucionet më të larta shtetërore, në të vërtetë edhe nuk mund të bënin më shumë seç mund të bëjnë ata që ishin aty për “zbukurim” të ballinës pushtetmbajtëse, e jo si përbërje domethënëse e brendisë së saj. Pra, ministrat shqiptarë në qeverinë e parë të Branko Červenkovskit, ishin profesionist të padiskutueshëm në lëmit të cilave u përkisnin, por mbi të gjitha ishin shqiptarë të cilëve nuk u besonte njeri edhe kur ishin të ardhur me certifikatën e nënshkruar nga Gligorovi si të “moralshëm e të pastër” politikisht. Sado që edhe të donin të bënin diçka për popullin që ua kishte mundësuar të uleshin në kabinetet qeveritare, ata ishin të rrethuar me administratën shtetërore plotësisht një etnike - në duart e etnitetit maqedonas. Andaj më lehtë mund të thuhet se “varësit” e tyre ministronin me ministrat shqiptarë. Kështu që nuk duhej të kalojë shumë kohë që shqiptarët të shihnin e të bindeshin se ministrat e tyre nuk kishin as aq kompetentë sa të ndërronin edhe sekretarëshat e tyre, e lere më të punësonin ndonjë shqiptarë në administratën shtetërore, ku

thuaje fare nuk ishin të pranishëm.

Por edhe si të këtille, partiakët e PPD-së të cilët ndër të parët u përfshinë në strukturat shtetërore, arritën të jenë nismëtarë të një procesi që nuk do mund të ndërpritej më kurrë: të bindnin palën e etnitetit maqedonas se nuk është e mundur një Maqedoni pa përfaqësimin e shqiptarëve në të gjitha institucionet shtetërore. Duke qenë në fillim si “zbukurim” i institucioneve shtetërore, partiakët e PPD-së e kishin më rëndë se pasardhësit e tyre. Sepse, përpos mundimit që të kryenin funksionin i cili iu ishte dhënë, ata duhej të përuronin një vetëdije të re te pala e etnitetit maqedonas, vetëdijen se nuk do lejonin më të ishin vetëm kukulla, por edhe pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e shtetit të ri.

Sa ia arritën këtë, do e dëshmojë e ardhmja. Mirëpo, gjithsesi se përfaqësuesit e PPD-së e patën më vështirë se ministrat e mëvonshëm shqiptarë, të cilët do bëhen pjesë e koalicioneve qeveritare, me ç’rast do vijnë nëpër kabinetet ministrore edhe me nga dy telefona celularë të varur në rripin e pantallonave, por duke pasur të vetmen vlerë - “certifikatën” partiake. Me çka do ndodh një fenomen i çuditshëm me pushtetarët shqiptarë: përderisa ata të viteve të para të pavarësimit të Maqedonisë nuk mund të ishin produktivë shkaku se ishin të rrethuar nga pengesat e shumta, ministrat e mëvonshëm shqiptarë do mbeten pasiv shkaku i inferioritetit të tyre përballë kolegëve të etnitetit maqedonas, si dhe shkaku i paaftësive profesionale.

Andaj edhe mund të thuhet se gjatë katër viteve

të para pas pavarësimit të Maqedonisë, PPD-ja ishte forcë politike e cila pas vetes kishte thujse të gjithë shqiptarët e këtushëm, e përballë vetes thujse të gjithë administratën shtetërore njëetnike maqedonase. E rrethuar kështu, nga premtimet që duhej realizuar, dhe nga pamundësia të bëjë diçka më shumë se sa të punësoj disa partizanë të vetë si ministra dhe zëvendës ministra, asaj nuk do i vlejë shumë as përkrahja e LDK-së së Kosovës dhe as përkrahja e Partisë Demokratike të Sali Berishës në Tiranë. Kështu që si e tillë, e fortë dhe e vetëpëlqyer, në vitin 1991 ajo do mbajë kongresin e saj të parë, ku do të mbisundonte euforia dhe arroganca.

Se sa arrogante ishte bërë PPD-ja e asokohshme, mund të vlerësohet nëpërmjet disa shkëndijave të vogla, që ndriçonin tërë horizontin vetëpëlqyes të kësaj partie: organizatorët e kongresit nuk ia dhanë akreditimin për ndjekjen e punës së tij, gazetarit më të mirë të asokohshëm të “Flakës së vëllazërimit” - Daut Dautit. Me çka, për ata që dinin gjërat e mëdha t’i vlerësonin nëpërmjet punëve të vogla, u bë e dukshme se PPD-ja ishte demokratike aq sa cila do lëvizje popullore që të lejon ta lavdërosh, por jo edhe ta kritikosh, të cilës mund t’i këndosh këngë lavdie, por jo edhe t’i thuash se është nisur rrugës së paqartë drejtë ardhmërisë. Ky moment i mosdhënies mundësi gazetarit më të mirë të “Flakës së vëllazërimit” të ndjek punën e Kongresit të parë të PPD-së, si dhe tentimi që nga foltorja e kongresit të diskreditohen edhe disa publicistë të tjerë që kishin thënë ndonjë fjalë të butë kritike ndaj udhëheqësve

partiakë, nuk u bënë shenja njohëse të këtij kongresi, por mbetën shenja paralajmëruese për atë se nga diktatura e mëparshme ideologjike, shqiptarët ishin katandisur drejtë rrugës që të bëhen “pronë” e partisë. Pra, të mos kenë parti të vetat, por parti të cilat e kanë popullin në duar.

Kongresistë e PPD-së morën përshëndetjet e të gjithë faktorëve me rëndësi politike nga Shqipëria dhe Kosova. Punën e tyre e ndiqnin me adhurim si tetovarët që kishin kthyer sytë nga Pallati i Kulturës ku mbahej kongresi, poashtu edhe të gjithë shqiptarët tjerë të Maqedonisë që lutjet i dërgonin drejtë “Mekës” së tyre të vetme politike të atëhershme – Tetovës. Si dikur në kongreset e Lidhjes Socialiste, edhe në këtë kongres të PPD-së, në rendin e parë ishin ulur edhe kryesuesit e Bashkësisë Islame të Maqedonisë, me çka u bë e qartë se edhe institucionet që nuk kishin të bëjnë me pushtetin dhe politikën, tani më ishin partizuar, ishin bërë “shërbëtore” të partive dhe si pasojë në të ardhmen gjithnjë e më shumë do bëhen instrument i lojërave partiake.

Por, përpos fjalëve të mëdha të dëgjuara nëpër mitingje dhe zgjedhjeve të organeve partiake, kongresi i parë i PPD-së nuk vu thujse asnjë udhërrëfyes të qartë se nga do shkonin shqiptarët e Maqedonisë në të ardhmen. Dhe mbase kongresi i parë i kësaj partie, i përshkuar nga euforia dhe triumfalizmi, do pasqyrojë edhe të ardhmen shqiptare njëdekadëshe kur ata, të udhëhequr nga partitë e tyre që shumë premtinin dhe thujse asgjë

nuk realizonin, do përpëliten në shtratin e ambicieve të mëdha, në krevatin e premtimeve të kota partiake dhe realizimeve të vogla. Por, në mos më shumë, Kongresi i parë i PPD-së edhe njëherë u dërgoi porosi forcave politike të etnitetit maqedonas se një pjesë e popullatës së këtij shteti – shqiptarët - ishte nisur rrugës që të realizonte ëndrrën e vet – të bëhej shtetformues në Maqedoninë, në shtetin të cilin etniteti maqedonas e ndjente vetëm si të vetin, e të “pandashëm” me të tjerët. Ëndërr të cilën duhej ta bënin jetë ata që e donin këtë njësoj sa edhe zgjedhësit e vet – parlamentarët e PPD-së - por të cilët mbase nuk dinin se si mund ta arrinin atë cak. Ndoshta ata ishin edhe ishin të hutuar nga një kohë kur çdokundë serbët shpallnin autonomit e tyre, kur nacionalistët e të gjitha ngjyrave nguteshin të shënonin dukshëm se deri ku ishte territori i tyre.

Të kapur nga kthetrat “autonomiste” dhe nacionalromantike, udhëheqësit e PPD-së luhateshin mes mundësisë edhe ata të shpallnin autonominë e tyre ne përbërje të Maqedonisë dhe mundësisë që shqiptarët të njiheshin si popull shtetformues në kushtetutë po aq sa edhe maqedonasit etnik. Andaj, edhe në këtë periudhë, veprimet e kësaj partie do shkojnë nga referendumi për Autonominë kulturore dhe politike të emëruar si “Ilirida”, e deri te mosmiratimi i kushtetutës së Maqedonisë. Gjë që shtonte hutesën te shqiptarët, i bënte të ndjeheshin si në mjegullën e paqartësisë se cila do ishte e ardhmja e tyre në Maqedoni, dhe njëkohësisht, kjo luhate politike e PPD-së mes koncepteve të skajshme,

zgjonte dyshime te të gjithë të tjerët se cili ishte qëllimi i vërtet politik i shqiptarëve të këtushëm.

Se PPD-ja ishte parti e cila edhe te bishti kishte kokë – nuk dihej nga ecë e ku shkon - ndoshta më së miri e shpjegon periudha pas rënies së qeverisë së Klusevit, kur u formua qeveria e parë partiake e Maqedonisë, e udhëhequr nga Lidhja Socialdemokratike e Maqedonisë, në krye me Branko Červenkovskin. Pjesë e koalicionit të atëhershëm qeveritarë u bë edhe PPD-ja . Që do të thotë, ajo tani u bë edhe pjesëtare direkte e një ekzekutivi që ishte shumë dorështrënguar ndaj shqiptarëve. Apo aq më shumë, PPD-ja u bë pjesë e koalicionit qeveritar në kohë kur as që mund të bëhej ministër ndonjë shqiptarë i cili nuk kishte edhe “certifikatën” e besueshmërisë së Kiro Gligorovit, kështu që përfaqësuesit e atëhershëm në qeverinë e parë partiake të Maqedonisë, u gjetën në një pozitë të çuditshme: të jenë përfaqësues të shqiptarëve, por në shërbim të një ekzekutivi që donte t’i mbajë shqiptarët të heshtur. Dhe, mbase kjo pozitë ata i çonte të funksionojnë herë si “opozitë” në qeveri, e herë si zbutës të kërkesave të popullit të cilin e përfaqësonin. Njëjtë funksiononte edhe partia të cilën ata përfaqësonin: ishte pjesë e koalicionit qeveritarë, por kundërshtonte disa nga proceset që do e çonin Maqedoninë më tej, drejtë mëvetësimit të plotë.

Këto kundërthënie të të qenurit njëkohësisht edhe opozitë edhe pozitë, do e çojnë PPD-në të mos ta votoj Kushtetutën republikane, të kërkojë nga shqiptarët të mos përkrahin referendumin për



pavarësinë e Maqedonisë, e më vonë bile të dërgojnë shkresa nëpër institucionet ndërkombëtare që ato të mos e njohin pavarësinë e këtij shteti. I pyetur nga gazetari i “Slobodna Dalmacisë” se pse kryesuesit e kësaj partie kërkojnë nga bashkësia ndërkombëtare të mos e njeh Maqedoninë si shtet të pavarur, sekretari i PPD-së i asaj kohe, Mithat Emini do përgjigjet: “Ne nuk jemi kundër pranimin të Maqedonisë, por kërkojmë që në të, të na garantohen të gjitha të drejtat. Minimumi që kërkojmë është barazia e plotë e shqiptarëve me të tjerët. Asgjë më shumë, dhe asgjë me pak! Nuk jemi për asnjë shpëputje, por deri në fund do e mohojmë Maqedoninë si demokratike, derisa shqiptarët janë në këtë pozitë!” (“Slobodna Dalmacia” 28 nëntor, 1992, f. 15).

Kjo deklaratë shpjegon shumë. Si pozitën e PPD-së në koalicionin qeveritarë, po ashtu edhe pamundësinë e kësaj partie të definojë veprimin e saj politik. Dhe si e tillë, ajo për një kohë të gjatë mbeti e ngërthyer nga nevoja të dëshmohej se është për një shtet të pavarur, por se njëkohësisht, nuk do e njeh pavarësinë e atij shteti derisa shqiptarët janë në pozitën e “qytetarëve të tjerë”. Apo thënë ndryshe, PPD-ja do merrte pjesë në institucionet shtetërore, por nuk do e përkrahte Maqedonisë si shtet i popullit shtetformues – etnitetin maqedonas.

Në një pozitë të tillë, PPD-në do e gjejnë shumë ngjarje të mëvonshme të cilat i frynin zjarrin të mos-marrëveshjeve ndëretnike. Në atë pozitë, të pa pozicionuar, PPD-ja do jetë edhe në vitin 1992 kur ndodhi e “Premtja e zezë” në Bit Pazarin e Shkupit,

kur shkaku i burgosjes së një të mituri cigareshitës, reagues shqiptarët. Dhe menjëherë pas reagimit të tyre ndërhyri me dhunë policia maqedonase, dhe “pa dashje” u vranë katër viktima të pafajshme. Pra, kjo ngjarje ndodhi asokohe kur PPD-ja ishte pjesë e qeverisë, pjesë e atyre që e përdorën dhunë mbi shqiptarët. Dhe mbase rasti i Bit-Pazarit ishte “dorashka” e parë e hedhur mbi fytyrën e shqiptarëve që t’u dëshmohej se kishin dy zgjidhje: ose do bëheshin të dëgjueshëm, ose do hanin dajak.

Se sa superior, në atë kohë, ndjeheshin qarqet politike maqedonase, më së miri dëshmon e hëna pas ngjarjes tragjike të së premtes, dita kur u bë varrimi i Shemsedin Ibrahimit (38), Safet Fejzullahut (32) dhe Sulejman Memishit (26) (në këto ngjarje u vra edhe Viktoria Geshovska). Ditë pasi ishin rralluar komentet e analitikëve maqedonas, të ngjashëm me atë të Ana Panovskës në RTM, ku për këto ngjarje ajo i akuzonte politikanët shqiptarë se qëndrojnë pas këtyre ngjarjeve dhe përkrahin kontrabandën në Maqedoni. E hëna pra, pasi Ministri i atëhershëm i Punëve të Brendshme, Ferçkovski kishte dhënë vlerësimet e veta lidhur me këto ngjarje duke theksuar se “edhe në perëndim në raste të tilla policia është e vrazhdë”. E sa i përket asaj të hëne kur u bë varrimi i tre viktimave të pafajshme nga ballafaqimi i protestuesve shqiptarë me policinë maqedonase, ja si e përshkruan atë ditë reporterit i të vetmes gazetë të asokohshme në gjuhën shqipe, “Flaka e vëllazërimit”, e që shpjegon shumë për klimën politike të asaj kohe: “E hënë. Çarshia e vjetër është

e zbrazur. Shitoret të mbyllura. Aty ku ditëve të tjera nuk mund të kalohej nga stërshitësit e ndryshëm, nuk ka asnjë njeri. Përballë (nga stacioni policorë i Bit pazarit) vijnë dy njësi policore. Me uniforma të reja, kaska të shtrënguara, të heshtur, me automatikë në duar dhe menjëherë, aty ku ditëve tjera mund të blije cigare me çmim dyfish më të ulët se ai nëpër shitore, policët ndahen në dy grupe. Të rreshtuar dhe të heshtur vazhdojnë ecjen rrugëve të çarshisë. Kanë dalë të na mbrojnë, apo të mbrohen nga ne?, - pyet një plak. Nëse kanë dalë të na mbrojnë, duhet të na tregojnë se nga na vjen rreziku. Por, nëse kanë dalë të mbrohen dhe dikë ta mbrojnë nga ne, duhet t'u thuhet qartë: vallë kur keni qenë të rrezikuar nga fëmijët tanë të cilët shesin cigare që të mund të blejnë ndonjë pallto të ngrohtë për dimër?

...Pra ditë e hënë. Ditë kur u varrosën tri viktimat e pafajshme. Pasdite e ditës kur në Butel u shënuan tri shenja të kësaj kohe plot çmenduri dhe amoral. Nga të gjitha anët e Çarshisë së Vjetër – polic. Nga ana e kundërt e Urës së Gurit, në qendër të Shkupit, ka gjithashtu grupe policësh, por ata janë civilë. Qeshin dhe bisedojnë duke u shtirë se janë kalimtarë të rastit. Domethënë, policët e dinë nga cila anë mund të vijë e keqja: nga pjesa ku jetojnë shqiptarët, ku ka stërshitës cigaresh, devizash, qeseve të najllonta...!? Nga ana e kundërt e Urës së Gurit, aty ku janë disko klubet dhe godinat e larta, fëmijët mbase nuk kanë nevojë të shesin cigare: janë nëpër banesat e ngrohta, pranë TV ekraneve, me plotë emisione për fëmijë në gjuhën e tyre amtare

nëpërmjet të cilëve edukohen dhe arsimohen. Dhe nuk janë të çmendur ta kalojnë kotë ditën në Bit-Pazar...

Ende është e hënë. Ditë kur MPB-ja jep deklarata se janë ndërmarrë të gjitha masat që të mos ndodh ndonjë konflikt. Duke i shikuar ku janë koncentruar njësitë policore, bëhet e qartë se nga cila anë MPB-së e pret “rrezikun”. Pra konfliktet mund të ndodhin atje diku, në pjesën ku banojnë shqiptarët dhe më tutje. Ndërsa matanë Vardarit, aty ku banojnë kryesisht ata të etnitetit maqedonas, çdo gjë është në rregull dhe del se andej jetojnë vetëm dashamirësit e këtij shteti! Ndërkaq, thuajse askush nga “mbrojtësi” e Maqedonisë nuk pyet veten vallë pse ana veriore e Shkupit prodhon stërshitës? Vallë, mos mendojnë se shqiptarët stërshitjen e kanë diçka gjenetikisht të trashëguar, deformim që nga lindja? Apo se prindi shqiptarë është veçanërisht i lumtur kur e sheh fëmijën e vet si dridhet nga të ftohtit duke i lutur kalimtarët të blejnë nga ai ndonjë kuti cigaresh?

‘Reagime të këtilla të policisë në çdo shtet të perëndimit janë të rëndomta, bile më të ashpra!’ – deklaroi ministri i Punëve të brendshme. Por, ministri harron të theksojë diçka qenësore: në shtetet e Perëndimit, fëmija 14-vjeçar nuk keqtrajtohet nga policia sikur të shiste edhe drogë, dhe pa praninë e ndonjërit nga prindërit nuk çohet në hetime. Ministri harron edhe diçka më të rëndësishme: në shtetet e Perëndimit policia nuk vrapon pas stërshitësve të rrugës, por gjurmon burimet prej ku vijnë maunat që sjellin mallin për shitje. Aq më

shumë, në shtetet e Perëndimit nuk mund të ndodhë që policia të vrapoj pas ndonjë të mituri, që zënia e një stërshitësi të cigareve të paguhet me katër viktima të pafajshme. Në shtetet e Perëndimit, në raste të tilla ministri i policisë bënë vetëm një gjë: ofron dorëheqje. Sepse katër viktima nuk janë pak edhe për rrethana lufte, e lere më për një aksion që në shtetet e Perëndimit mund të jetë bile ‘edhe më i ashpër’, por kurrsesi jo me viktima. Me hyrje nëpër shtëpi, me burgosje pa lidhje, me trishtim të banorëve të një qyteti të tërë. Mos vallë Frçkovski me të vërtetë nuk e dinë se nga “bursa e zezë” e Bit-pazarit më shumë fitojnë “bosat” e tij që lirshëm i fusin në shtet maunat e padoguanuar përplot cigare...” (“Flaka e vëllazërimit”, 11 nëntor, 1992, f. 12).

Ky përshkrim i një ditë të largët kur u bë varrimi i shqiptarëve të parë të rënë në Maqedoninë demokratike, shprehë qartë pozitën e pushtetarëve të atëhershëm shqiptarë: pozitën e atyre që ishin në qeveri, por nuk qeverisnin. E kjo pozitë do mbetet e tillë për shqiptarët e Maqedonisë thujse deri në vitin 2001, mirëpo gjithmonë duke e pasur parasysh se qeveritarëve të parë shqiptarë askush nuk mu t’ua mohojë vlerat profesionale, por nuk bënë gjë pasi ishin të dirigjuarit e Gligorovit, e jo nga partitë të cilës i takonin. E më vonë, ministrat shqiptarë do ishin të dëgjueshmit e partisë, por të paaftë të vepromin shkakut se partitë shqiptarë propozonin kandidatë që kishin thujse vetëm një vlerë: poltronizmin ndaj udhëheqësve partiak.

## Hapja e tregjeve partiake

E ndodhur në hapësirën që ndante pamundësinë të korrigjosh gabimet e bëra dekada me radhë sa i përket pozitës së shqiptarëve, dhe dëshirës së zgjedhësve që sa më shpejtë të realizoheshin ëndrrat e kahmoçme për barazi të plot me të tjerët që jetonin në Maqedoni, e ndërtuar si një lëvizje gjithëpopullore, e cila ngërthente në vetvete të gjitha grupet e interesit të shqiptarëve të këtushëm, e udhëhequr edhe nga individ që nuk arrinin ta lexonin drejtë orën e rrjedhave politike në shtet e rajon, e zhytur në vetëpëlqimin dhe arrogancën e atyre që papritur u bënë “autoritete” të cilëve u përkulej populli nëpër rrugë dhe kafenetë e fshatrave, e kapur në kthetrat edhe të aktivistëve të cilëve ende nuk u ishte tharë djersa nga ndërtimi i socializmit, e ndodhur në duart e të ardhurve nga e djeshmja e të cilët përnjëherë donin të duken si të sotëm që njohin shenjën e të nesërmes, PPD-ja thuajse ishte e dënuar të dështojë para se të arrijë të shohë nga është nisur e ku ka arritur. Katër vitet e para në qeveri dhe në parlament mjaftuan të shihet se PPD-ja e dinte se është nisur nga Tetova, por nuk e dinte cila rrugë të çonte drejtë realizimit të ambicieve politike të shqiptarëve të këtushëm. Apo, edhe nëse e njihte

cakun, nuk arrinte kurrsesi të bind zgjedhësit se është nisur drejtë tij dhe nuk e ka gabuar rrugën. Kështu që, veprimi i saj parlamentar, gjatë periudhës 1990-1994, mund të vlerësohet si rropatje e atij që donë të arrij diku, por pret dikush t'ia tregojë rrugën nga të shkojë. Dhe, pas katër viteve bashkëqeverisje në koalicionin qeveritarë të Cërvenkovskit, pas katër viteve diskutime të zjarra të parlamentarëve shqiptarë nga foltorja e parlamentit - ku në mos me shumë, i befasuan maqedonasit etnik se sa rrjedhshëm e flisnin gjuhën e tyre - nga një parti e shpresës së madhe, PPD-ja morri përmasat e një dështimi politik të shqiptarëve të Maqedonisë. Parlamentarët dhe pushtetarët e PPD-së, e kishin humbur betejën thuajse në të gjitha frontet përballë politikës gligoroviane, e cila ndaj kërkesave shqiptare sillej si shtëpiari ndaj lypsarit: “jepi aq sa e ke të tepërt, e jo aq sa i duhet atij që i mungojnë thuajse të gjitha!”

Duke qenë në opozitë me ata me të cilët bashkëqeveriste, katër vitet e para të veprimit parlamentar të PPD-së, u bënë simbol i një veprimi politik në kufi me të pakuptimtën: të jesh pjesëtarë i qeverisë, e cila duhet të zbatoj ligjet që janë të dëmshme për popullin që e përfaqëson dhe që është dorëlirë ndaj shqiptarëve vetëm kur duhej të përdroreshin kordonët policore. Që do të thoshte, të bëhesh mbulesë e veprimeve të cilat ngadalë, por pandërprerë, ia brenin autoritetin kësaj partie tek zgjedhësit e saj, dhe e harxhonin durimin e shqiptarëve të këtushëm. Me çka në njëfarë mënyre,

PPD-ja u bë pjesë e politikës gligoroviane, e cila elementin shqiptarë në Maqedoni e konsideronte si fatkeqësi me të cilën duhej të mësoheshin të jetojnë maqedonasit etnik. Apo që ndaj kërkesave të shqiptarëve të këtushëm sillej si i sëmuri kronik, i cili gjithmonë pranë vetes mban ilaçrat e duhur sa të mos lejojë sëmundja t'ia shkatërrojë tërë imunitetin e trupit. E ky ilaç, të cilin Gligorovi e përdorte për ta mbajtur sadopak të shëndosh trupin shumetnik të Maqedonisë, ishin mu përfaqësuesit e PPD-së në qeveri dhe në parlament. Ku edhe u jepnin legjitimitet vendimeve qeveritare edhe atëherë kur pushtetarët shqiptarë as që e dinin se çka kishte ndërmend të ndërmernte qeveria lidhur me ndonjë kërkesë të shqiptarëve. Kështu që fundin e mandatit të parë, parlamentarët dhe qeveritarët e PPD-së e pritën si ata që kishin filluar të harxhonin dhjamin e vet – durimin e popullit. Dhe u kishte mbetur vetëm edhe një mundësi që të mbijetonin: pamundësia e popullit të gjejë alternativë tjetër politike më joshëse se ajo ekzistuesja.

Pra, sa i përket rolit të parlamentarëve shqiptarë, ai thuhetse katër vite karakterizohej me fjalimet e zjarra kundër ligjeve diskriminuese për shqiptarët, të cilat miratoheshin edhe pa pëlqimin e tyre. E sa u përket ministrave shqiptarë në qeverinë e Cërvenkovskit, veprimi i tyre mbetej i padukshëm për publikun, por mund lehtë të paragjykohej se aty ku ishin, askush nuk i pyeste për asgjë. Fakt të cilin do ta pohoj edhe vetë njëri nga ministrat e atëherëshëm, i cili gjatë ngjarjeve të përgjakura në Gosti-



var, publikisht do e pranojë “se askush nuk i kishte informuar për aksionin policorë në Tetovë e Gostivar”. Pra, aktiviteti katërvjeçarë i PPD-së në parlament dhe qeveri, thuajse ishte në kundërtënie me vetveten: atë që kundërshtonin parlamentarët shqiptarë, duhej ta zbatonin ministrat e PPD-së. Ajo që parlamentarët e thoshin nga foltorja e kuvendit republikan që ta bindnin popullin se sa aktivë ishin për të mbrojtur interesat e shqiptarëve, u shërbente si mbulesë ministrave të cilët ishin thuajse kukulla në qeverinë e Cërvenkovskit. Kështu ndodhi edhe kur u miratua ligji për shtetësi dhe regjistrim të popullatës, kështu ndodhi edhe me shumë ligje tjera që në të vërtetë shkonin në vijën e asaj që nënvizon Dr. Ali Aliu në tekstin e tij “Tjetër kush vendos për pjesëmarrjen në Qeveri” ku thotë: “Këto ligje u miratuan në parlamentin e Maqedonisë në frymën e një deputeti të VMRO-së që afërisht tha kështu në një seancë: le të dihet botërisht se shteti maqedonas është i interesuar të rrisë numrin e popullatës maqedonase, të rrisë përqindjen e maqedonasve në përbërjen e tërësishme të popullatës, që do të thotë ishte jetësish i interesuar që ta zvogëlojë përqindjen e jomaqedonasve në shtetin maqedonas! Le të dihet botërisht pra se parlamenti i Maqedonisë do të miratojë, sot e tutje, ligje në këtë frymë! Më konkretisht e më qartë nuk kishte si të thuhet. Pikërisht në këtë frymë u soll ligji për shtetësi dhe për regjistrim.” (“Flaka e vëllazërimit” 8 prill 1995).

Dihej botërisht se në ç’drejtim shkonte Maqedonia, por nuk dihej nga ishin katandisur

përfaqësuesit e shqiptarëve në parlament dhe në qeveri. Pala maqedonase gjithmonë i thoshte gjërat hapur, ashtu siç i kishte hije arrogantit dhe mospërfillësit, ndërsa përfaqësuesit e PPD-së, herë belbëzonin, e herë bërtisnin. Apo thënë më mirë, qeveritarët e PPD-së belbëzonin që të mos i kuptonte njeri se si ndjeheshin kur zbatonin ligjet të cilat i kishin kundërshtuar bashkëpartiakët e tyre në parlament, e parlamentarët e PPD-së e qortonin qeverinë e cila propozonte ligje që ishin të papranueshëm për shqiptarët. Aty ku ndodhte abordazhi i këtyre belbëzimeve të qeveritarëve shqiptarë dhe britmave të parlamentarëve të PPD-së, ngrihej avulli që bëhej mjegull, e ua pamundësonte shqiptarëve të shihnin se vallë pjesëmarrja e PPD-së në qeveri i dëmtonte apo u sillte ndonjë të mirë. Se vallë ishte e mundur që demokracia për ata të ishte më dorështrënguar se socializmi, dhe kështu PPD-ja të mos arrinte të rikthente as disa të drejta të cilat shqiptarët i kishin qysh në kohën sa ishte gjallë Titoja dhe Jugosllavia e tij, si për shembull shkollat e mesme në gjuhën amtare dhe Akademinë Pedagogjike, të cilat ishin mbyllur në dekadën e tetë të shekullit të njëzetë.

Hamendja se ç'fitonin e ç'humbnin me pjesëmarrjen e PPD-së në qeveri, i çoi shqiptarët që të peshonin se vallë PPD-ja kishte bërë hap të mirë me hyrjen në koalicionin qeveritarë të Branko Červenkovskit, apo me këtë vetëm ishte bë stoli e një sistemi i cili nuk kishte për qëllim të ndërtojë institucione shtetërore që do kujdeseshin njësoj për

të gjithë qytetarët e shtetit. Dhe kishte peshore që dëshmonin se, sikur PPD-ja të mos ishte pjesë e qeverisë së atëhershme, shumëçka do shkonte më ndryshe dhe për shumëçka Maqedonia nuk do kishte mbështetjen ndërkombëtare. Siç kishte edhe peshues që tregonin se kandari i tyre peshon në anën që thotë se, më mirë të jesh brenda në kala edhe kur nuk bënë punë në te, sesa të jesh jashtë mureve të saj nga tjetri mund të të pështyjë kur të dojë. Dhe mbase e vërteta qëndronte diku në mes të këtyre vlerësimeve të skajshme: në atë se ishte mirë që PPD-ja merrte pjesë në parlament - ku në mos më shumë i afirmonte kërkesat shqiptare - por mbase gabonte që i jepte legjitimitet një qeverie e cila thujse punë parësore kishte të mbronte Maqedoninë nga “rreziku shqiptarë”. Mbase, kjo do ia mundësonte t’i ikë rrezikut që në parlament të ishte opozitë e bllokut politik të etnitetit maqedonas, e në qeveri bashkëveprimtare e Cërvenkovskit. Kështu që edhe vetë PPD-ja thujse u hutua duke vepruar si opozitë që merrte pjesë edhe në koalicionin qeveritar dhe nuk arriti të vërejë me kohë se në betejën me politikën gligoroviane, thujse gjithmonë fitonte pala e etnitetit maqedonas. Pra, e trullosur nga një veprim jo i natyrshëm partiak, kryesuesit e PPD-së nuk arrinin ta shihnin se e harxhonin besimin dhe durimin e shqiptarëve, dhe se kjo parti ngadalë, por sigurt shndërrohej në një kujtim të largët romantik të viteve të mitingjeve përplot eufori e parulla, nga të cilët siç dukej patën dobi vetëm disa partiak që u punësuan si deputet apo ministra. E të cilët mbase

shpejtë filluan të dehen nga ndjenja se ishin burrështetas me nam e nishan, e kështu të dehur harruan se atë që ata hanin e pinin, e paguante populli, se sofrën ku ata ngiheshin, mund t'ua largonte ai që ua kishte shtruar – zgjedhësit e këtushëm shqiptarë.

Shikuar nga këndi i demokracisë klasike, vitet e para të parlamentarizmit shumëpartiak në Maqedoni, nuk mundë të vlerësohen drejt nga këndvështrimi i pastër i partive në pozitë dhe opozitë. Sepse, në Maqedoninë shumëpartiake, kufiri pozitë - opozitë ishte nyje ku lidheshin blloqet etnike partiake, që për shumëçka ishin në pozita të kundërta. Maqedonia kishte një “parlament” tjetër ku rolet ishin të përcaktuara pavarësisht numrit të deputetëve në kuvendin republikan. E ai ishte “parlamenti” etnik ku shqiptarët gjithmonë kishin përballë vetes thujtë të gjitha partitë e etnitetit maqedonas, të cilat grindeshin mes veti si pozitë dhe opozitë për shumë çështje, por jo edhe për qëndrimin e tyre të përbashkët kundër kërkesave shqiptare. Dhe kjo ishte brava çelësin e së cilës PPD-ja nuk mund ta gjente dot që të hapte derën e të ishte më frutdhënëse. Ajo bravë në të vërtetë kishte tre çelësa, e të cilët, siç duket, PPD-ja e atëhershme kurrë nuk arriti t'i zbulojë se ku ndodheshin, kush i fshehte dhe si të hapnin derën. I pari ishte ai të cilin mbante në duar kryetari i atëhershëm, i cili mosrealizimin e kërkesave shqiptare e arsyetonte me rrezikun që i kanosej shtetit nga nacionalistët e etnitetit maqedonas, të cilët mund të

radikalizoheshin më shumë nëse u bëheshin lëshime shqiptarëve. Dhe PPD-ja assesi nuk e kuptonte se sa u përket kërkesave shqiptare, Gligorovi nuk kishte qëndrim aspak më ndryshe se VMRO – DPMNE-ja, se antishqiptarizmi i disa qarqeve politike të etnitetit maqedonas atij vetëm ia mundësonte ta mbuloj vet-veten. Çelësi i dytë ishte ai që e mbante kryeministri i atëhershëm Cërvenkovski, i cili shpejtë e kuptoi se partiakët e PPD-së, të etur për pushtet, lehtë bëheshin të dëgjueshmit e tij e jo të partisë që i kishte sjell aty. Kështu që shumica e atyre që uleshin në kolltukët qeveritare, e humbnin lidhjen me udhëheqësin partiak dhe bënë çmos të jenë të pëlqyer nga kryeministri. Çelësin e tretë e mbante në duar vetë udhëheqësia e PPD-së, por mbase, në lidhësen e çelësave, ai u ishte ngatërruar me ato të veturave luksoze të cilat i vozisnin dhe të banesave që ua jepte shteti për të qenë më komod. E ai çelës kishte të bëjë me gjetjen e formulës se si në ecje, kjo “lëvizje” gjithëpopullore të bëhej parti, apo edhe të bënte zgjidhje se a do të vepronte si parti në pozitë, apo në opozitë, se a do merrte rolin që ua kishte përcaktuar fati shqiptarëve – të jetë “opozitë” etnike. Sikur ta sqaronte këtë, PPD-ja edhe do e përcaktonte lehtë pozitën e vet si në parlament ashtu edhe në qeveri. Pra, ose do bënte luftë politike kundër “pozitës” etnike të quajtur maqedonase, ose do zhvillonte aktivitet partiak që nënkupton të mos nisesh nga parimi “ne jemi populli”.

Pastaj, PPD-në do e kushtojë shtrenjtë bindja e kryesuesve të saj, të cilët mendonin se ishin të pazë-

vendësueshëm. Kjo bindje ata i bënte aq të shurdhët sa mos ta dëgjojnë me kohë zhurmën që e bënin, në radhët partiake, të pakënaqurit me veprimin e partisë së tyre. E që paralajmëronte se PPD-ja shkonte rrugës së “shtatzënive” të shpeshta të cilat do ta bënin “nënë” të shumë partive të reja shqiptare. Ishte nisur rrugës e cila, ndoshta ishte edhe e pashmangshme për një “lëvizje gjithëpopullore”, e cila u tregua e paaftë që ta kuptonte me kohë se nuk ka parti e cila mund t’i bashkojë në vetvete të gjitha grupet që, shpeshherë, kishin interesa kundërtëhënësë. Se forca politike që mund t’i bashkojë interesat e të gjitha grupeve, nuk ka gjininë femërore, por atë mashkullore dhe nuk quhet parti por – front gjithëpopullor. E “frontet” janë të nevojshëm për revolucione, e jo për ovulim të natyrshme të koncepteve politike.

Por, kishte diçka edhe më keq se kjo, e që i ndodhi PPD-së. E ajo ishte e vërteta se kjo parti bënte përzierjen e veprimit që i kishte hije frontit gjithëpopullorë, me atë që i shkon për shtatit vetëm partisë. Pra, PPD-së i ndodhi të vishet me petkun e partisë, por të ngrohet nën “kapotën” e lëvizjes, e cila do e përfshijë gjithë popullin. Lëvizje që duheshte t’i realizonte interesat e tërë shoqërisë shqiptare, edhe të shoqatës së berberëve, edhe ato të profesorëve, edhe Bashkësia Islame të Maqedonisë edhe të organizatave të ateistëve, edhe të feministëve, edhe të klubeve të burrave që e dinë se gruaja e ka vendin te këmbët e burrit. PPD-ja thjeshtë u humbë diku në ambiciet ireale të kryesuesve dhe aktivistëve

më të spikatur të saj, të cilët popullit ia ofronin të mundshmen - që ishte thujse barazi me zero, dhe shtireshin se ecin rrugës e cila të çon drejt realizimit të ambicieve kolektive të shqiptarëve të këtushëm. Pra, PPD-ja realizonte ambiciet e një rrethi të ngushtë partiak, e këtë duheshte ta shesë në tregun politik si të arrirë kolektive.

Mirëpo, këtë populli e kuptoi para se kryesuesit e PPD-së ta vërenin se edhe brenda partisë kishte të atillë që e dinin se me këtë “lëvizje gjithëpopullore”, demokratizimi i shqiptarëve bëhej gjithnjë e më i palëvizshëm, mbetej në vend. Kështu që ende pa e përfunduar mandatin e parë parlamentarë dhe qeveritarë, PPD-ja u përballë me rrymat brenda partiake të cilat nuk ishin të kënaqura as me strukturën udhëheqëse të partisë, as edhe me veprimin e përfaqësuesve të saj në qeveri e në parlament, ku treguan një “aktivitet” pasiv. Andaj edhe të krijohej përshtypja se vetëm kryesuesit e kësaj partie nuk e vërenin se në partinë e tyre e kishin nisur betejën ata që kishin ambicie të ngjiteshin sa më lartë, dhe sa më shpejtë, në piramidën partiake. Si dhe ata që donin një veprim më ndryshe të partisë. Krahas këtyre betejave të brendshme partiake, edhe në Prishtinë e Tiranë ishte pjekur bindja se PPD-së i duhej një udhëheqësi e re, një freskim i kreut të saj që do mundësonte faktorizimin e duhur të popullatës shqiptare në Maqedoni. Prishtina dhe Tirana mirë e kishin vërejtur se udhëheqësia aktuale e PPD-së, i kishte humbur shqiptarët e këtushëm diku në mjegullën e një politike e cila, sa i përket

pozitës së shqiptarëve në Maqedoni, as ndreqte as prishte gjë. Se ajo thuajse u ishte nënshtruar koncepteve politike gligoroviane kur bëhej fjalë për kërkesat e shqiptarëve: të priteshin kohë më të mira që ato të realizoheshin.

Dhe ndodhi ajo që ishte e pashmangshme. Qysh në vitin 1993 disa degë të PPD-së filluan hapur të tregojnë pakënaqësinë e vet ndaj udhëheqësisë së PPD-së. Dega e Tetovës, si më e madhja, më e forta dhe më afër “burimit”, morri flamurin në dorë dhe u bë prijëse e të pakënaqurve ndaj veprimeve të PPD-së. Sa për fillim, dega e Tetovës nisi të shpaloste hapur atë që e mendonin edhe shumë të tjerë: se udhëheqësia duhej të ripërtërihej, se duhej të rivlerësojë veprimin e deriatëhershëm. E kjo mjaftoi që “kënetat” të dallgëzohet dhe të largohet myshku nga sipërfaqja e saj. Që pastaj të shiheshin të gjitha “mbeturinat” politike, të fshehura në fundin e saj. Mjaftonte kjo që të shihej se shumëkush në këtë parti mezi kishte pritur të del njëri i cili i pari që do thotë: duam ndryshime.

Dhe kështu filloi historia e re e shumëpartizmit të shqiptarëve në Maqedoni, që do ecë rrugën deri te dhjetëra parti, nga të cilat asnjëra, përpos PDSH-së, nuk arriti të faktorizohej. E bërthamën e PDSH-së e përbënin ata që bënë çmos ta copëtonin PPD-në dhe të cilët deri në zgjedhjet e 2006-tës do i mbeten besnik vetëm një parimi të tyre: nxitjen e grindjeve ndërpartiake mes shqiptarëve. Mbase këtë do ua imponojë kodi gjenetik i trashëguar qysh nga lindja dhe nga “prindërit” e tyre, njëri prej të cilit thuhet se



mund të jetë edhe nga strukturat policore të Maqedonisë.

Sido që të jetë, me ndarjen e PPD-së, nisi rrugëtimi i kësaj partie drejt margjinalizimi të plotë të saj, rrugëtim i cili vazhdoi deri te copëzimi i faktorit politik shqiptarë në përmasa perverse. Apo deri në ato përmasa sa thuhetse çdo aktivistë i PPD-së me ambicie të jetë i pari, bëri çmos që të ketë partinë e vet.

Kështu pra filloi një shumpartizëm i ri i shqiptarëve të Maqedonisë, që në vitin 2006 do rezultojë si një kamp grindavecësh, të cilët as të huajt nuk do mund t'i çonin të jenë më të kujdesshëm ndaj rivalëve të tyre politik. E që shumëpartizmi shqiptarëve të nisej kësaj rruge, kontribut të veçantë dhanë edhe Tirana edhe Prishtina. Sepse, menjëherë pasi PPD-ja u përballë me rrymat brendapartiake, Tirana zyrtare u ngutë të përdorë këtë situatë për të shtuar ndikimin e vetë në hapësirën politike të shqiptarëve të Maqedonisë. Dhe kur e pa se forcohej krahu i Arbër Xhaferit - i cili asokohe ishte kthyer në Tetovë si njeri që do mundë t'i bashkonte rrymat e konfrontuara brendapartiake të PPD-së - Shqipëria zyrtare çoi një sinjal shumë të papritur, që të tregonte se cilën anë përkrahte: komentin pervers të ATSH-së, në të cilin thuhetse të gjithë udhëheqësit dhe aktivistët më me emër të PPD-së shpallehin si bashkëpunëtorë të strukturave policore të ish Jugosllavisë dhe Maqedonisë. Dhe mjaftonte ky koment që udhëheqësit e PPD-së të gjunjëzoheshin dhe t'i takonin historisë. Me çka u hap rruga për kra-

hun e prirë nga dega partiake e Tetovës, e cila nga fundi i vitit 1993, arriti të del në krye të Këshillit të Përkohshëm të emëruar në të ashtuquajturin “Kuvend historik të Gostivarit”. Ky këshill, të cilin e përbënin tre anëtarë nga Tetova, dy nga Gostivari dhe nga një nga Dibra e Struga, së shpejti do propozojë edhe mbajtjen e kongresit të jashtëzakonshëm të partisë. Siç shihej edhe nga përbërja e atij Këshilli, aty bënin pjesë ata që të parët kishin kërkuar dorëheqjen e kryesisë së partisë. Në përbërjen e këtij këshilli mungonin përfaqësuesit e “lobit” shkupjan, i cili ishte rreshtuar në përkrahje të vijës së deriatëhershme të veprimit partiak.

Dhe nëse Tirana zyrtare kishte vendosur të merrte pjesë aktive në përçarjen e PPD-së, duke treguar hapur se qëndronte pas krahut të Arbër Xhaferit, kryetari i Kolegjiut ndërpartiak të shqiptarëve, e njëkohësisht edhe kryetar i LDK-së, si edhe ndaj shumëçka tjetër, edhe ndaj grindjeve brendapartiake në PPD-së, u soll me mospërfillje. Ky Kolegjiut që moti ishte shndërruar në diçka e mbetur vetëm në letër dhe thuajse sa për t’ia rritur namin Ibrahim Rugovës. Dhe si i tillë nuk ndërmoi asgjë kur filluan shenjat e para të përçarjes së PPD-së. Për më keq, nuk bëri përpjekje as për informim të drejtë të opinionit për atë që ndodhte në këtë parti. Ibrahim Rugova priste e përcillte përfaqësuesit e të dy krahëve të PPD-së, të cilët e braktisnin zyrën e tij njësoj të bindur se kishin përkrahjen e LDS-së. Lidhur me këtë, Dr. Ali Aliu shkruan: “Duke mos qenë i informuar mirë dhe duke mos qenë i qartë në

qëndrime gjatë bisedave me ta, kryetari i Kolegjiut u linte shteg bisedave që secili t'i interpretonte në raste kur abuzohej në emër të tij, me justifikim se gjoja e ka parim të mos përgënjeshtrojë në raste të ngjashme. Pra ai (mendon në Ibrahim Rugovën - v.i.) e konsideronte më të rëndësishme mosprishjen e këtij parimi dhe imazhi, nga dëmet që do sillte për lëvizjen politike të shqiptarëve të Maqedonisë, mosqarimi dhe mosdeklarimi i prerë i tij lidhur me çështjen në fjalë. Është e sigurt se asokohe, Kolegjiu ndëretnik, e sidomos kryetari i tij, mund të luanin rol vendimtar sikur të dilnin publikisht me qëndrim të qartë..." ("Flaka e vëllazërimit", 6 prill, 1995).

Përderisa Prishtina e përkrahu përçarjen duke ndenjtur anësh, Tirana veprooi ashtu siç do ia kishte zili edhe Enver Hoxha. Kështu që "tradhtarët" e shpallur si të tillë në komentin famëkeq të ATSH-së, tashmë kishin dhënë dorëheqje kolektive. Por, kjo fare nuk do të thoshte se ishte thyer plotësisht krahu partiak, i cili e dinte se me emblemën e PPD-së do mund të mbijetonte edhe ndonjë vit në skenën politike të Maqedonisë. Apo edhe që shpresonin se edhe të dobësuar do arrijnë ta rimarrin veten, gjë që në të vërtetë kurrë nuk do ndodh në të ardhmen. Kështu që u bë e dukshme se PPD-ja do ndahej, se asgjë më nuk mund t'i mbante bashkë "tradhtarët" dhe "revolucionarët" e udhëhequr nga kryesuesit e degës partiake të Tetovës.

Kongresi i jashtëzakonshëm i partisë ishte caktuar për 12 shkurt të 2004. Këshilli për përgatitjen e tij, në krye me Abdurrahman Alitin, çdo gjë kishte

parashikuar, por jo edhe atë se ditën e mbajtjet së tij, krahu i prirë nga dega e Tetovës, do e braktiste sallën. Dhe pas këtij kongresi, shqiptarët e Maqedonisë u bënë me dy PPD, me çka filloi lufta mediatike se cila nga ato ishte PPD-ja e vërtetë dhe kujt do i takonin vulat e partisë. E në ndërkohë, populli kishte mbetur i vulosur me sindromën e përçarjeve, që do e shoqërojnë deri në zgjedhjet e vitit 2006.

Vulat e PPD-së asokohe i kishte marrë krahu partiak nga i cili më vonë do lind partia me dy vula (me ato të PDSH-së dhe të PDP-së). Parti e cila gjatë tërë veprimit të vet do dallohet për nga strategjia “përçajë dhe sundo”. E fillimet e veprimit politik të kësaj partie hasën në lloj - lloj pengesash. Kishte bile edhe kërkesa që ajo të ndalohej, me arsyetim se ishte shumë “radikale”. Pastaj nënkëmbëzat që i viheshin kësaj partie shkonin deri aty sa asaj i pamundësohej regjistrimi me arsyetim se simbolet ishin “irituese” për marrëdhëniet ndëretnike. Por, fati i kësaj partie qëndronte aty se në krye të saj erdhi njeriu të cilit i besonin intelektualët e këtushëm. Dhe besimin e vet e mbështesnin në atë se udhëheqësit e kësaj partie ishin të rinj, pa hipotekat e qeveritarëve dhe parlamentarëve të mëparshëm të PPD-së. Si të tillë, atyre nuk u mungonte përkrahja nga pjesa më progresive e shqiptarëve të këtushëm – të rinjve. Përkrahja e atyre që ishin ngirë nga veprimi anemik i PPD-së së atëhershme.

Dhe posa shqiptarët u bënë me dy parti – njëren me vula e tjetrën të paregjistruar dhe “ilegale” – të gjitha zënkat ndërpartiake u ngulfatën nga zhurma

lidhur me të ashtuquajturën “afëra e armëve” kur u burgosën shumë nga aktivistët më të dalluar të PPD-së. Thujse të gjithë të burgosurit, ishin po ata që paraprakisht ATSH-ja e Tiranës i kishte shpallur si “tradhtarë” të popullit dhe spiun të policisë sekrete Jugosllave. Kështu që hutesa ishte e plotë dhe populli e kishte vështirë të kuptonte se kush gënjente: pushtetarët e Maqedonisë që aktivistët më të spikatur të PPD-së i shpallën si element kundërshtetëror, apo Tirana zyrtare e cila të njëjtit i kishte njollosur si antishqiptarë. Pra, asgjë nuk ishte e qartë dhe ajo paqartësi i shtonte dilemat se mos vallë ekzistonte një bashkëveprim i koordinuar mes Shkupit dhe Tiranës zyrtare që të dobësohej PPD-ja. Apo mos vallë shqiptarëve dikush qëllimisht ua përziante “atdhetarët” dhe “tradhtarët”, që ata më në fund të mos mund t’i besonin askujt, që mosbesimi të ishte i plotë dhe megjulla e paqartësive të merrte përmasa trishtuese. Siç ndodhi në të vërtetë gjatë periudhës së mëvonshme, kur udhëheqësit e PDSH-së do prodhojnë aq “antishqiptarë” sa do ua kishte zili edhe Beogradi i kohëve të Millosheviqit, dhe kur PPD-ja u katandis rrugës së margjinalizimit të vet. Pra, gjatë periudhës kur në PPD filluan të ndërroheshin kryesuesit partiak thujse çdo gjashtë muaj, e PDSH-ja e jetonte periudhën e ndriçimit të saj si kometë e cila ra në hapësirën politike të shqiptarëve të Maqedonisë, pa e ditur ata se nga u erdhi dhe ç’rrugëtim kishte bërë deri sa kishte arritur në Tetovë.

Sa u përket kryesuesve të PPD-së, të ardhur pas

dorëheqëses së Nevzat Halimit, ata erdhën e shkuan ashtu siç kalon hija që nuk lë gjurmë andej nga kalon. Nga të gjithë ata, vetëm Abdurrahman Aliti arriti që sadopak t’ia rikthej fizionominë e duhur kësaj partie. Por ai shumë shpejt u gjet mes “fushëbetejës” ku përplaseshin shtizat e “lobit” shkupjan dhe atij tetovarë, mes dy taborëve që prapëseprapë kishte diçka që i bënte të duken si të njëjtë: pushtetin e donin më shumë se partinë dhe popullin. Andaj, duke u munduar të gjithëve t’ua plotësojë ambiciet, Abdurrahman Aliti u nisë rrugës, e cila nga lideri partiak e çoi të bëhet “makro” që kujdesej të jenë të kënaqura kurvat politike të partisë që udhëhiqte.

Pra, Abdurrahman Aliti erdhi në krye të PPD-së pasi atë kishin provuar ta drejtonin shumë të tjerë, por që nuk ia dolën të qëndronin në krye të saj. Ai erdhi në krye të kësaj partie pasi shumëkush nga aktivistët e saj, e kishte shijuar grazhdin kalorik të pushtetit dhe kishin formuar bindjen se, parti e mirë është vetëm ajo që shpejtë të ngjitë më lartë se sa ku mund të të çojnë aftësitë personale. Dhe, duke e ditur se vet nuk kishin aftësitë për të qenë udhëheqës partiak, ata kërkonin njeriun e duhur që edhe do ua mbante gjallë partinë edhe do ua mundësonte të arrinin atje ku synonin – në pushtet. Pra kërkonin prijës partiak i cili në ndërkohë do e respektonte rendin e “odës së burrave”, do vinte rend mes bërrylshtyesve. Që do kishte autoritet dhe aftësi t’i bashkonte rrymat partiake që pas copëtimit të saj në dy krahë, tani ishin më të shumta se kurdoherë më

parë.

Dhe nuk gabuan me zgjedhjen e Abdurrahman Alitit si kryetarë të PPD-së. Mbase edhe ai besonte se do arrinte të tejkalonte mosmarrëveshjet mes krahëve të ndryshëm të cilët tani e dinin se sa lehtë ndahet partia, që kishin fituar imunitet ndaj kërkesave të popullit dhe ishin bërë të shurdhër ndaj thirrjeve që të mos lejonin degëzimin e mëtejshëm të inateve shqiptare, e i cili mund të çonte deri aty sa çdo vendbanim shqiptarë të kishte partinë e vet.

Gjithsesi se, Abdurrahman Aliti nuk ishte njeri i rastit. Si juristë i aftë ai kishte pësuar qysh në vitet e tetëdhjeta të shekullit të njëzet, në vitet e “diferencimeve” të shumta që u bëheshin shqiptarëve të shkolluar. Pastaj, Aliti kishte të gjitha tiparet e njeriut me veti të larta njerëzore, njeri që nuk lakmonte gjithaq piramidën e lartë shtetërore. Si i tillë, ai shpejt do bëhej i pranueshëm për të gjitha rrymat e PPD-së. Pa dyshim se si i tillë, ai plotësonte një kusht i cili e bënte të pranueshëm për të gjitha fraksionet partiake: të gjithëve ua mundësonte që të papenguar ta përdorin emblemën partiake për të realizuar ambicie personale. Kjo mjaftonte që të kishte mbështetjen edhe të “dhelprave” partiake, të cilat ishin të mësuara t’i adaptoheshin çdo “klime” politike, por vetëm nëse ua siguroje një kolltuk të butë ku do çonin jetë të rehatshme, duke aktruar lodhje nga kryerja e punëve kombëtare dhe shtetërore. Kështu që, ai do arrijë të vë baraspeshë mes “lobit” shkupjan dhe atij tetovarë. Pra, mes dy krahëve të partisë që edhe vite me vonë, herë pas

herë, do arrijnë deri te pragu i ndarjes mes veti, por gjithmonë do pajtohen, edhe atë jo pse i kishin afruar platformat politike, por pse e dinin se të ndarë do i humbin të gjitha mundësitë të bëheshin ministra, parlamentarë apo ambasadorë dhe drejtorë të ndërmarrjeve publike.

Abdurrahman Aliti shpejtë u gjet në një pozitë të çuditshme – të mos merrej me partinë, e as me modelimin e aktiviteteve të saj, por të ketë rolin e “drejtë-trajtimin” të ambicieve të atyre që e përkrahën dhe e sollën në krye të partisë. Ai shpesh i ngjante dirigjentit të cilit asnjë nga instrumentistët nuk ia hidhte sytë. Dhe kështu edhe PPD-ja e pas zgjedhjeve të dyta parlamentare - ato të vitit 1994 - nga lëvizje gjithëpopullore, u bë “klub” i karrieristëve të kategorive të ndryshme. Ndërsa Abdurrahman Aliti u bë kryetarë i këtij “klubi”, dhe ishte ai i cili duhej të kujdesej që asnjë anëtarë të mos ndjehej i nënçmuar dhe i lënë më poshtë se të tjerët, e të cilët shenjë njohëse kishin famën e dikurshme të PPD-së.

Asokohe LSDM-ja u mundua mjaft ta ndihmonte PPD-në që ta rimerrte veten. Mbase Cërvenkovski ndërkohë e kishte kuptuar se më lehtë do e kishte me të dëgjueshmit e PPD-së, se sa me “radikalët” e Arbër Xhaferit, të cilët asokohe lëre që nga goja nxirrnin zjarr, por flaka e tij gjithmonë shndërrohej në shqiponjë dykrerëshe. Andaj, LSDM-ja bëri çmos që ta bllokonte veprimtarinë e PDSH-së. Por, Alitit të kujdesshëm që të mos nxiste grindje brendashqiptare, as që i shkonte ndër mend të



përdorte këtë përparësi dhe pozitën e partisë parlamentare dhe qeveritare. Pastaj, PPD-ja e kishte të garantuar fitoren e votës shqiptare në zgjedhjet parlamentare të vitit 1994, shkaku se PDSH-së nuk i lejohej veprim i lirshëm politik. Por, mu kjo pozitë e atëhershme, PDSH-së ia garantoj ardhmërinë. E gjatë kësaj ardhmërie disavjeçare Arbër Xhaferi do bëj çmos ta brejë sa më shumë trupin partiak të PPD-së, do bëjë të pamundurën të imponohet si parti më dominante te popullata shqiptare e këtushme, edhe pse kurrë nuk do e arrijë këtë. Sepse sa më shumë plakej PDSH-ja, aq më e dyshimtë bëhej e kaluara e sajë rinore për shqiptarët e Maqedonisë, sa më atdhetarë bëhej Arbër Xhaferi, aq më shumë shqiptarët e këtushëm flisnin për pasurinë e tij në Prishtinë. Kështu që PDSH-ja kurrë nuk arriti të fitojë besimin politik të shumicës së shqiptarëve të Maqedonisë, por Arbër Xhaferi arriti të bëhet dy herë pjesë e koalicionit qeveritarë të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja. Dhe gjithmonë duke e arsyetuar këtë si vepër “atdhetare” që ndihmonte demokratizimin e shoqërisë së shqiptarëve të Maqedonisë. E në ndërkohë, Abdurrahman Aliti dështonte përball Xhaferit mbase pse nuk dinte të aktroj rolin e atdhetarit të rrejshëm.

Gjatë pjesëmarrjes së saj të dytë në pushtet dhe në parlament, PPD-ja u bë parti me një kryetarë, por me shumë udhëheqës. E, Aliti këtë situatë mendohej ta tejkaloj duke ua plotësuar dëshirën të gjithëve që kishte rreth vetes, duke harruar se edhe një perandori e tërë nuk do të mjaftonte ti kënaqte

kërkesat e të gjithë karrieristëve të tij. Pra, duke harruar se posa e kënaqte njërin, vinte tjetri që priste radhën përpara zyrës së tij. Kështu që përderisa fitonte mbështetës të cilët ishin të kënaqur me të, shtohesh numri i atyre që e fajësonin për gjitha të metat e veprimtariak, e që në përkthim do të thoshte – ishin të pakënaqur me pozitën vetë. Ai dërgonte ambasadorë njerëz të cilët tërë jetën kishin librezën vetëm të një partie – atë të KFE (Kah Frynë Era), bëri ministra ata që nuk arrinin të “minsitrojnë” me ambiciet e veta të pamatura, bëri drejtorë ndërmarrjesh publike edhe të atillë që në Shkup vinin vetëm sa për ta marr pagën mujore, mirëpo assesit nuk ia doli PPD-në ta bëjë parti. Gjë të cilën e bënte suksesshëm Arbër Xhaferi me PDSH-në.

Rruga nëpër të cilën e çonte Aliti PPD-në, gjithsesi se nuk shkonte më larg se te dobësimi i saj dhe forcimi i PDSH-së, e cila asokohe vepronte si parti opozitare e “jashtëligjshme”. Gjatë këtij rrugëtimit, PPD-ja do e kalojë edhe periudhën e zgjedhjeve parlamentare të 1998, kur Abdurrahman Aliti erdhi në situatë të bëjë koalicion parazgjedhorë me tinëzarin dhe të paparashikueshmin, Arbër Xhaferin. Këtë e bëri mbase shkak se nuk e dinte se ndërkohë Arbër Xhaferi kishte vënë lidhje të shëndosha me elemente të partisë së atëhershme më anti-shqiptare – VMRO-DPMNE-në, për të cilën dihej se do i fitojë zgjedhjet në bllokun politik të etnitetit maqedonas.

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1998, më në fund edhe vet Abdurrahman Aliti do e kuptojë se

nuk ishte udhëheqës partiak, por “shef” i një grup njerëzish që i interesonte vetëm mirëqenia personale. Dhe do fillojë hapur të sillet si i tillë. Këtë do e dëshmojë derisa ishte parti opozitare pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1998. Më saktë, këtë do e bëjë “publike” gjatë një seance parlamentare kur votohej për (mos)besim ndaj qeverisë së atëhershme të VMRO-DPMNE-së ku bënte pjesë edhe PDSH-ja, dhe kur me votat e PPD-së qeveria e Georgievskit sigurisht do rrëzohej. Por, për çudinë e të gjithëve, disa nga deputetët e PPD-së e shpëtuan qeverinë e Georgievskit. I pyetur se si ishte e mundur një parti opozitare të votonte për qeverinë, të cilën në çdo mbledhje parlamentare PPD-ja e sulmonte si anti-shqiptare, Aliti do përgjigjet se “do donte të bie qeveria e Georgievskit, por jo me votat e partisë së tij”. E që shqiptarët mbase thënieën e tij edhe e përkthyen drejtë dhe ia dhanë kuptimin e duhur: “Ne nuk e duam këtë qeveri, por arritëm të shitemi shtrenjtë”.

Pas kësaj, çdo gjë më u bë e qartë edhe për ata që vështirë i zbërthenin lojërat politike të vendeve pos-socialiste në Ballkan. Abdurrahman Aliti me këtë e vulosi fatin e vet politik si udhëheqës partiak dhe populli më e shihte si “tregtar” që shiste mallin të cilin e kishte në disponim – partiakët që herë i bënin shërbime opozitës, e herë pozitës. Me çka, në njëfarë mënyre, e vulosi edhe fatin e PPD-së, e cila nga “klubi” disa anëtarësh, ngadalë të bëhej pronë private e disa njerëzve të pasur të kësaj partie. Pronë e atyre që mund ta mirëmbanin financiarisht sa të mos

vdiste plotësisht. Kështu që Abdurrahman Aliti e çoi këtë parti rrugës nga ajo filloi të dukej si një nga pompat e karburantit të kompanisë së kryetarit të ardhshëm të kësaj partie, të atij kryetari i cili pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, arriti PPD-në ta bëjë parti më të çuditshme – të jetë edhe pjesë e koalicionit qeveritarë edhe pjesë e opozitës. Pra, si e tillë, PPD-ja nuk u bë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2002, kur Abdurrahman Aliti, si deputet i vetëm nga Tetova i zgjedhur nga kjo parti, vendin e vet do ia lëshojë pronarit të kompanisë private "ATA-Kompani", por e tillë PPD-ja ishte bërë qysh më parë.

Dhe kështu u mbyll edhe një rreth i dështimeve politike të PPD-së. Ky ishte rrethi të cilin kjo parti e eci e udhëhequr nga Abdurrahman Aliti. Rreth që mund të përshkruhet shkurt si rrugëtim mes dy stacioneve: i pari me shenjën e “udhëheqës” partiak, e i fundit me atë të “makroit” i cili mbikëqyrte kurvat politike të partisë së vet. Mbase kjo pjesë e rrugëtimit të PPD-së dëshmonte se sa vështirë – madje në kufi të të pamundurës - është që në këto hapësira të merresh me politikë, e të mbetesh i panjollësor. Apo se sa e vështirë është kjo veprimtari për ata të cilët nuk kanë sistem mbrojtës nga “ujqit” partiak që hanë edhe kokën e partisë, nëse nuk i arrijnë qëllimet personale. Ose ndoshta rasti i Abdurrahman Alitit dëshmon atë që thuhet për politikën: se brumin njerëzorë ajo e bënë të bymehet, të bëhet krejt tjetër nga ai që ka qenë para se të kryeset me farën e privilegjeve, të cilat t’i sjellë

të qenurit në pushtet. Kështu që nga një liderë te i cili i kishin mbështetur shpresat shumica e simpatizantëve të atëhershëm të PPD-së, dhe nga një politikan të cilit i besonin shkaku se nuk kishte asnjë njollë nga e kaluara, Abdurrahman Aliti përfundoi si politikan të cilit më nuk i besonte njeri edhe atëherë kur e thoshte të vërtetën.

Aliti u largua nga kreu i partisë shkaku se nga ai më nuk kishin dobi ata që e sollën në krye të PPD-së. Dhe nuk e patën rëndë ta largonin nga aty, sepse në ndërkohë Abdurrahman Alitit kishte filluar t'i pëlqejë edhe roli i "makrosë" partiak. Andaj ai u bë i papranueshëm si kryetarë partie edhe për ata që ai vetë i ngjiti shumë lartë në piramidën partiake. Kështu që u largua nga kreu i partisë thujse vetëm sa të shihej se PPD-ja kurrë nuk arriti të etablohet si parti e mirëfilltë. Abdurrahman Aliti e lëshoi PPD-në kur ajo ishte bërë pronë e njerëzve që mendonin se interesi i zgjedhësve të tyre ishte i barabartë me maunat të cilat ata mund t'i kontrabandonin në kufirin shtetërorë pa paguar doganë. E derisa ata vazhdonin të kërkonin një kryetar tjetër, më të përshtatshëm për PPD-në, Abdurrahman Aliti u bë ambasador i Maqedonisë në Sofje. Mirë që nuk ra edhe më poshtë, mirë që Ali Ahmeti ia bëri këtë nderë kur BDI-ja erdhi në pushtet. Sikur të merreshin postet sipas meritave, me siguri se Abdurrahman Aliti nuk meritonte asgjë më shumë se ta mbyllnin në zyrat e "ATA-Kompanisë" dhe aty të rrinte me një këmbë, me shikim të drejtuar nga fotografia e pronarit të kësaj kompanie private.

Mbase në atë fotografi do e shihte edhe portretin e vet, si dhe rrugën nga ishte nisur dhe ku kishte arritur. Do e shihte se ku ishte PPD-ja kur ai erdhi ne krye të saj, e ku ndodhej ajo kur ai u largua nga posti i kryetarit. Por edhe si i tillë, në portretin gruporë të kryesuesve të partive shqiptare, deri në vitin 2001, Abdurraman Aliti ende mbetet lideri me tipparet më njerëzore e më pozitive se cilido tjetër. Gjë që të çon të klithësh e të thuash: Zot, atëherë si do kenë qenë të tjerët!



## Herói i betejave të huaja

Zgjedhjet parlamentare të viti 1998 janë shumë domethënëse si për Maqedoninë po ashtu edhe për shqiptarët e këtushëm. Për shqiptarët e Maqedonisë, këto zgjedhje do kenë shenjën e shpresës së madhe për ta korrigjuar përshtypjen e deriatëhershme të vulosur me mossakses thujse të plotë politikë të prezantuesve të tyre. Më në fund, në këto zgjedhje, së pari herë shqiptarët do shkonin me dy parti të cilat njësoj pretendonin se janë të forta dhe e kanë besimin e shumicës së popullatës – PPD-ja dhe PDSH-ja. Në të vërtetë, Arbër Xhaferi dhe partia e tij ishin ata që ua kishin kthyer shqiptarëve shpresën se më kurrë nuk do kishin shenjë njohëse të veprimit politik inferioritetin ndaj partnerëve të etnitetit maqedonas. Pastaj, partia e Arbër Xhaferit ua kishte zbukuruar mjaft ëndrrat për Universitetin e Tetovës, për atë se në Maqedoni do flitej edhe shqip, se ky shtet do e ketë të rëndë të ndërtoj ardhmëri të ndritshme pa ëndrrën shqiptare, se nëpër Maqedoni shqiponja dykrenore do fluturonte aq lirshëm, si kudo ku jetojnë shqiptarët. PDSH-ja, këto ëndrra jo vetëm që ua mbante gjallë, por paraqitej edhe si realizuese e vetme e tyre. Dhe jo se nuk kishte të drejtë ta bëjë këtë, jo se nuk i kishte hije të merr në



duar flamurin e një qëndrimi politik ndryshe nga ai i mëparshmi që stoliste shqiptarët e Maqedonisë, por për vrojtuesin e vëmendshëm qysh atëherë mund të bëhej e dukshme se kryesuesit e kësaj partie ishin paksa të vonuar me populizmin dhe nacional - romantizmin, të cilëve mbase u kishte kaluar koha. Në njëfarë mënyre, ata vazhduan aty ku i kishte lënë PPD-ja shqiptarët, në vitin 1990 – pranë parullave me shkronja të mëdha, por pa përmbajtje konkrete.

Letra më e fortë e PDSH-së për ta fituar lojën e “pokerit” politik të zgjedhjeve parlamentare të viti 1998, ishte Universiteti i Tetovës dhe Rektori i tij, Fadil Sulejmani i cili u bë “stolia” më domethënëse e gjithë mitingjeve parazgjedhore të partisë së Arbër Xhaferit. Aq më shumë, Sulejmani hapur u tha shqiptarëve se PDSH-ja ishte partia të cilës ai i besonte, me çka këtë institucion arsimorë, përfundimisht e futi në kthetrat e lojërave ndërpartiake, ku do të mbetej edhe pas legalizimit të tij. Pastaj, një vit më parë, kishte ndodhur ngjarja “Gostivari i përgjakur”, ku mbrohej flamuri kombëtarë, e që i përshkruhej si meritë partisë së Arbër Xhaferit. Meritë e cila mbase do qartësohet pasi të hapet dosja e plotë policore dhe politike e “Maqedonisë së pavarur”, nga do mund të shihet se kush dha pëlqim asokohe të burgoseshin kryetarët e dy komunave të udhëhequr nga përfaqësues të PDSH – së.

Pas tetë viteve inferioriteti politik, shqiptarët e Maqedonisë ndjenin nevojë të vijë një gjeneratë politikanësh, e cila do ua rikthej besimin në vetvete dhe

do ua shërojë dinjitetin e lënduar politik. Pas tetë viteve mjegulle të shkaktuar nga pavendosmëria dhe paqartësia e veprimit politik të PPD-së, partia e Arbër Xhaferit ishte ajo që i zgjoi shpresat te shqiptarët e këtushëm se ende nuk ishin gjunjëzuar aq, sa mos mundeshin sërish të çoheshin në këmbë e të shalonin “kalin e bardhë” të fitoreve politike. Në mënyrë të veçantë, këtë shpresë ua ushqente kryesuesi i kësaj partie, Arbër Xhaferi, i cili mbase me çdo gjë qëndronte baras, në mos edhe më lartë, se të gjithë përfaqësuesit politik të etnitetit maqedonas, të cilët tetë vite me radhë arritën të luajnë lojë me përfaqësuesit e PPD-së. Krahasuar me PPD-në, politikisht gjakdobët dhe rakitike, PDSH-ja i ngjante një buldozeri plotë vrull dhe energji, i cili lëndë djegëse kishte durimin e humbur të shqiptarëve të këtushëm.

Partitë shqiptare do hynin në zgjedhjet parlamentare me një “histori” të begatë të lënë pas vetes në tetëvjeçarin i cili mbyllej. Siç u përmend, në ndërkohë kishte ndodhur “Gostivari i përgjakur”, kur jo vetëm që me dhunë u ulë flamuri shqiptarë, por trazirat e atjeshme mes popullit, i cili e mbronte simbolin etnik, dhe policisë që atë me dhunë e nxori nga shtiza, përfundoi edhe me tri viktima të pafajshme. Pra, kishte ndodhur Gostivari kur policia maqedonase rrahu e keqtrajtoi shumë shqiptarë, pa pyetur për fajësinë eventuale. Ndërkohë, më parë kishin ndodhë edhe shumë ballafaqime tjera të rinisë shqiptare me kordonët e policisë maqedonase, si për shembull mes protestuesve që mbronin Universitetin

e Tetovës dhe policisë. Edhe në këtë përballje në mbrojtje të Universitetit të Tetovës, u vra edhe një i ri shqiptarë dhe shumë të tjerë u lënduan nga policia. Nga policia e atëhershme u dëmtuan edhe objektet e këtij Universiteti, ku disa policë maqedonas nuk harruan të mos lënë porosinë e qartë se çka i frymëzonte për t'i rrahur dhe keqtrajtuar shqiptarët: katër “s-të” serbe të vendosura në katër anët e kryqit ortodoks, e të shkruara nëpër muret e objekteve, të cilat asokohe, nga qytetarët shqiptarë, i ishin dhënë në përdorim Universitetit të Tetovës.

Nëse shqiptarët dinin të lexonin porosi të shkurta, por me përmbajtje shumëdekadëshe, duhej ta kishin të qartë se ajo që për ata ishte dikur policia serbe, tani do ishte policia e shtetit, i cili deklarohet se ndërtonte sistem demokratik, me qytetarë të barabartë. E në ndërkohë, pushtetarët e PPD-së do e kuptonin se sa gabonin që edhe më tej mbeteshin në kabinetet qeveritare, duke e shpërlarë veten edhe me deklarata nga më absurdet si ajo “se askush nuk i kishte informuar se policia do intervenonte në Tetovë dhe Gostivar”. Me këtë sqarim “antologjik” të pushtetarëve shqiptarë, ministrat e PPD-së hapur pranuan atë që ua thoshin kryesuesit e PDSH-së dhe gjithë të tjerët: se ishin vetëm kukulla pa zë, në qeverinë e dytë të Branko Cërvenkovskit dhe se ata në njëfarë mënyre i jepnin legalitet edhe politikës restriktive qeveritare ndaj kërkesave të shqiptarëve. Gjë që kontribuoj në forcimin e PDSH – së. Mbase, me veprimin e tyre, në disa raste edhe absurd, PPD-ja e çoi një pjesë të anëtarësisë së vet të veproj sipas

parimit të zgjedhësh mes dy të këqijave, njëra nga të cilat – PDSH-ja – ishte e keqe e pa provuar. Kështu që partia e Arbër Xhaferit kishte një përparësi, e cila e bënte të pakrahasueshme PPD-në, sa i përket anëve të mira – nuk kishte hipoteka nga e kaluara tetëvjeçare e demokratizimit të Maqedonisë.

Në zgjedhjet parlamentare të 1998, PPD-ja hynte e vetëpëlqyer, e bindur se atë nuk kishte kush ta rrëzojë nga fronti i përfaqësuesit legjitim të shqiptarëve të këtushëm, por edhe me ndjenjën se populli tashmë shumëçka kishte mësuar dhe se nuk do të mjaftonin vetëm arsyetime dhe shpjegime, të cilat më së miri shpalosnin paaftësitë e aktivistëve të kësaj partie kur përballeshin me politikën e “dhelparakut” të vjetër – Gligorovit. Ndërkaq, PDSH-ja tashmë ishte forcuar, pas saj qëndronte pjesa më e madhe e vrullit rinor, ata që kishin qenë të mitur kur kishte ndodhur përçarja e PPD-së dhe “Afera e armëve”, ata që donin të dëgjojnë shqip dhe vrullshëm. Ata të cilëve u pëlqenin kërcënimet e kryesuesve të PDSH – së drejtuar qeverisë, se do ndërmerrnin “hapa më radikale” nëse do vazhdonin t’i trajtojnë shqiptarët si ardhacak. Kryesuesit e PDSH-së asokohe as që jepnin deklaratat në gjuhën maqedonase – shtireshin se nuk e njohin këtë gjuhë, e ndërkaq Arbër Xhaferi kishte studiuar në Beograd - e lere më të mos theksonin se me hyrjen e tyre në parlament, e tërë Maqedoni do e mësonte shqipen. Mbase, prandaj edhe fushatën zgjedhore e filluan me thënien: “Vetëm shqip”. Gjë që tingëllonte mirë për të gjithë ata të cilët tashmë ishin ngirë nga inferiorite-

ti politik i PPD-së.

Shikuar nga jashtë, të dy partitë linin përshtypje se ishin të sigurta në fitoren e vet të blloku shqiptarë. Por, udhëheqësit e këtyre partive, e kishin të qartë se popullata ishte bërë më mosbesuese ndaj premtimeve, se nuk joshesh gjithë nga “kuajt e bardhë” të demokracisë, të cilët ktheheshin në ahurin shtetërore posa kalonin zgjedhjet. PPD-ja e dinte se rinia dhe pjesa intelektuale shqiptare qëndronte pas të gjatprurit, Arbër Xhaferit. Nga ana tjetër, edhe PDSH-ja e dinte se pas PPD-së ende qëndronte pjesa e popullatës, e cila mbante mend si ata e kishin dobësuar këtë parti dhe që ngushëllohej me thënien se “ka edhe më keq”. Pastaj, megjulla rreth paqartësive lidhur me fatin e Kosovës, i çonte shqiptarët e këtushëm të ishin më të kujdesshëm kur shalonin kalin e vrullshëm të kërkesave të tyre politike. Pra, kishte shumëçka që edhe Arbër Xhaferin, edhe Abdurrahman Alitin, i çonte të ndjeheshin të pasigurt dhe të frenonin veten. Si dhe të dyshonin se sa do arrijnë të dëshmojnë se cili nga ata kishte besimin e shqiptarëve të këtushëm.

Mbase kjo pasiguri, ata i çoi drejtë rrugës të një bashkëveprimi, - të ulëshin përballë njëri tjetrit dhe të bënin koalicion parazgjedhorë. Që do jetë një shembull i pashoq pozitiv i bashkëpunimit në çastin e duhur, shembull i cili do ndikojë të shqiptarët të dalin në këto zgjedhje pa barrën e zënkave ndërpartiake, pa tensionin e akuzave të ndërsjella, edhe pse kjo nënkuptonte se duhej të votojnë për ata që ua kishin zgjedhur partitë. Pra, ky bashkëveprim i

PPD-së dhe PDSH-së mbi një platformë të përbashkët parazgjedhore, do pritet mirë si nga qarqet shqiptare në Maqedoni, po ashtu edhe nga ato në Tiranë e Prishtinë. Sepse ky ishte shembull i rrallë i bashkëpunimit mes partive grindavece kudo që jetonin shqiptarët. Ky bashkëpunim kishte peshë të rëndësishme edhe shkakun se në njëfarë mënyre, sërish u bashkuan dy krahët e të njëjtës parti – PPD-së. Pastaj, me këtë bashkëpunim parazgjedhorë, partitë shqiptare u dërguan sinjal rivalëve të etnitetit maqedonas, se kur bëhej fjalë për kërkesat e drejta të shqiptarëve, mes tyre më nuk do kishte dallime. E në ndërkohë, ky bashkëveprim parazgjedhorë mes PPD-së e PDSH-së, thujse përgjithmonë do e infektojë bllokun partiak shqiptarë që kurrë të mos jetë e qartë se cilët janë përçarësit, e cilët bashkuesit, dhe që vite me radhë të lodhen duke kërkuar rrugë si ta bashkojnë atë që vetë e kanë copëtuar.

Sa u përket zgjedhjeve parlamentare të viti 1998, ndodhi edhe një dukuri thujse e papritur për opinionin e këtushëm: edhe partitë të cilat paraprakisht njiheshin si shalëruese të kalit nacionalist, e qetësuan atmosferën, duke u përqendruar në temat ekonomike. “Partia më e madhe opozitare, VMRO-DPMNE-ja, e cila vlen si partia më “nacionaliste” maqedonase dhe e cila deri tani përkrahësit e vet i ka tërhequr mbi çështjen e “problemit shqiptarë”, në këto zgjedhje plotësisht e ka ndryshuar qëndrimin e saj”, shkruan analisti Goran Mihajlovski, dhe vazhdon: “Lideri i partisë Lubço Georgievski, disa herë ka përsëritur se partia e

tij nuk do bënte qeveri në të cilën do uleshin edhe përfaqësues të partive shqiptare të Maqedonisë, por nuk e përjashtoi mundësinë që disa vende ministrore t'ua ofrojë shqiptarëve etnik të cilët ishin kandidatë të partisë tjetër.” (AIM Shkup, 17.09.1998). E partia tjetër, në të cilën mendonte Georgievski, që asokohe do i siguronte edhe shqiptarët, ishte Alternativa Demokratike e Vasill Tupurkovskit, e cila jo vetëm që kishte premtuar se posa t'i fitonte zgjedhjet do i sillte Maqedonisë një miliardë dollarë të lidhura me kordele të kuqe, por për një kohë të shkurtër arriti të fitojë simpati, e madje të ketë edhe degë ku anëtarësoheshin shqiptarët. Asokohe, kjo parti e shpallte veten si e vetmja parti qytetare, dhe në 17 njësi zgjedhore me shumicë të banuara nga shqiptarët, kishte kandiduar aktivistët e saj, përballë atyre të partive shqiptare. Kandidatë të cilët PPD-ja dhe PDSH-ja fare nuk e kishin vështirë t'i përjashtojnë nga gara parazgjedhore duke i shpallur si të shitur dhe të dëmshëm për shqiptarët e Maqedonisë.

Edhe partitë shqiptare në këto zgjedhje hynë më të qeta. Koalicioni PPD-PDSH ishte zgjidhje që PDSH-ja, ende e paregjistruar, të ketë mundësi “legalisht” ta provojë veten si forcë partiake. Njëkohësisht, me këtë, partitë shqiptare donin të dëshmonin se “radikalët” dhe “të maturit” e bllokut politik shqiptarë nuk dallonin me asgjë kur bëhej fjalë për kërkesat e drejta shqiptare. Ky koalicion parazgjedhorë gjithashtu ndihmoi që PDSH-ja të mos i bojkotonte zgjedhjet, gjë që do ishte e dëmshme sa për vetë shqiptarët, po aq edhe për gjithë Maq-

edoninë. Dhe më në fund, për herë të parë, në listat e kandidatëve të PPD-së dhe PDSH- u gjetën edhe emra të femrave shqiptare.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1998, Maqedonia hyri me sistemin e kombinuar zgjedhorë: atë proporcional dhe shumicë. 35 parlamentarë do zgjidheshin sipas sistemit proporcional, e 85 sipas shumicës së votave që kishin fituar kandidatët. Ajo që krijoi hutesë në opinion e këtushëm dhe në media, ishte se cila ishte mundësia që një kandidat t'i fitojë zgjedhjet qysh në rrethin e parë të votimit, apo sa vota duhet të fitoj që të konsiderohej se i ka fituar zgjedhjet.

E deri sa në Maqedoni numëroheshin votat, bota kishte filluar t'i numërojë ditët se kur do fillonte bombardimi i Jugosllavisë së mbetur të Millosheviqit. Mbase prandaj për shqiptarët e Maqedonisë edhe disi humbnin rëndësinë këto zgjedhje parlamentare. Ata ishin më shumë të preokupuar me dhembjen e Kosovës, me të ikurit që kishin filluar të jenë "mysafirë" në shtëpitë e tyre, me deklaratat e politikanëve të këtushëm, si ajo e Gligorovit se në rast të ndonjë konflikti në Kosovë, Maqedonia do siguronte "korridore" nëpërmjet të cilëve kosovarët do i depërtonte në Shqipëri. Gjë që i revoltonte shqiptarët dhe i bënte më të vendosur dhe më të gatshëm për gjithçka që mund të ndodhte me bashkëkombësit e tyre në Kosovë, përfshi edhe ndihmën konkrete në rast të ndonjë konflikti të armatosur.

Dhe ndodhën zgjedhjet. U numëruan votat, dhe



u shpallën fituesit. VMRO-DPMNE në koalicion me Alternativën Demokratike të Vasill Tupurkovskit, kishte fituar 62 deputetë. Me siguri më shumë seç kishin shpresuar edhe optimistët më të mëdhenj që i dëshironin sukses këtij koalicioni parazgjedorë. PPD-ja dhe PDSH-ja së bashku, kishin fituar 25 deputetë, që ishte numri më i madh i deri atëhershëm i parlamentarëve shqiptarë. Kështu që VMRO-DPMNE-ja mund të bënte qeveri me partnerin e vet pa lutur askënd tjetër t'i bashkëngjitej në koalicionin qeveritarë. Por, nga ana tjerët, të gjithë e kishin të qartë se deputetët shqiptarë mund ta blloktonin cilindo koalicion qeveritarë që ata nuk do e mbështesnin. Thjeshtë, nuk do ishte qeveri legjitime e Maqedonisë asnjë qeveri e cila nuk do ta kishte mbështetjen e ndonjë partie shqiptare. Duke e ditur këtë, tani të gjithë i kishin kthyer sytë nga PPD-ja dhe PDSH-ja, e veçanërisht nga Arbër Xhaferi, të cilin e mbanin si “djaloshin e keq” të politikës në Maqedoni, e i cili, duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarit të “Makedonija denes “ se si e ndjen veten pas thënies së Branko Cërvenkovskit se ai ishte “një shqiptarë i keq”, do përgjigjet: “Ndjehem si Klinton Istvudi. Si “bad guy” i cili është gjithmonë këtu kur duhet të ofrojë material për politikën e ndonjërit.”

Dhe ishte e vërtetë. Shumë qarqe politike të etnitetit maqedonas dhe media në gjuhën maqedonase, me vite ishin “ushqyer” me veprimet dhe deklaratat e Arbër Xhaferit. Edhe atë duke trilluar afera nga më monstruozet, të cilat kishin për

qëllim ta përjashtonin nga skena e këtushme politike. Por, mu këto trille dhe sulme nga mediat në gjuhën maqedonase, do e majmin popullaritetin e Xhaferit të shqiptarët. Apo, opinioni i këtushëm nuk e dinte se përballë kishte një mjeshtër për përdorimin e medieve, mjeshtër i cili e dinte se më e keqja që mund të të ndodh si politikan, nuk është ajo kur mediat të përmendin për të keq, por kur nuk të përfillin fare. Andaj edhe mund të thuhet se mediat në gjuhën maqedonase ishin ato që Arbër Xhaferin e bënë “radikal” të pashembullt, që ia mundësuan të shtegtojë në ato në gjuhën shqipe, të cilat nuk kishin si mos ta merrni në mbrojtje. Dhe kështu, përderisa mediat në gjuhën maqedonase e sulmonin, e ato në gjuhën shqipe e mbronin, Xhaferi ndërtoi kalanë e “patriotit” i cili çdo gjë flijonte për çështjen shqiptare jo vetëm në Maqedoni, por në tërë Ballkanin. Apo, sa më shumë bëhej i papëlqyer për opinionin e etnitetit maqedonas, aq më i famshëm bëhej tek shqiptarët. Dhe të gjithë humbnin apo ëndërronin, e vetëm Xhaferi fitonte.

“Bad guy” në mediat maqedonase të asaj kohe, ishte edhe Lubço Georgievski. Atij qëmoti i ishte veshur kapota probullgare, mbase jo edhe pa asnjë argument, sepse në vitin 2006 ai do merr edhe nënshtetësinë e shtetit bullgarë. Dhe mbase askush nuk besonte se kishte diçka që mund t’i çonte këta dy “djelmosha të këqij” të politikës maqedonase të bashkëpunojnë. Apo, menjëherë pas zgjedhjeve, ishte e pamundur dikush të parashikonte se do dashuroheshin “shqiponja” dhe “luani”. Këtë më së

paku mund ta besonte Abdurrahman Aliti i PPD-së, i cili në njëfarë mënyre edhe do ndjehet i “tradhtuar” pas shpalljes së rezultateve zgjedhore, sepse shumë shpejtë do shpaloset se PDSH-së i ishte dashur vetëm aq sa t’i tejkalonte problemet “teknike” zgjedhore, e më lehtë të vijë deri te njëmbëdhjetë parlamentarët e saj.

Kur PPD-ja do e kuptojë se PDSH-ja më së miri e kishte planifikuar rrjedhën e lojës paszgjedhore, të gjithë më e dinin se Xhaferi dhe Georgievski qysh më parë ishin marrë vesh që bashkë të qeverisnin me Maqedoninë. Duke e ditur se në bllokun politik maqedonas do fitojë VMRO-DPMNE-ja e Lupço Georgievskit, Arbëri mirë e kishte parashikuar se nuk do e ketë vështirë edhe me më pakë deputet se PPD-ja të bëhet pjesë e koalicionit qeveritarë. Mbase kjo edhe e kishte shtyrë atë të zgjidhte variantin më të sigurt e të pranonte edhe më pak kandidat të PDSH-së në listat zgjedhore, se sa të rrezikonte të shkonte e vetme në zgjedhje.

Pasi u bë e ditur se boshtin kurrizorë të koalicionit të ardhshëm qeveritarë do e përbënte VMRO-DPMNE-ja, filluan edhe mosmarrëveshjet mes PPD-së dhe PDSH-së. Arbër Xhaferi shumë shpejt do e shpall partinë e Lupço Georgievskit si “partner strategjik” të partisë së vet, e PPD-ja, duke e parë se është kapur në kurthin e një politikani të gjindshëm, siç ishte Arbër Xhaferi, do mbrojë qëndrimin se në politikë nuk ka strateg të përhershëm, por interes të përhershëm. Me çka e bënte të ditur se me dëshirë edhe ajo do hynte në qeverinë e

Georgievskit, duke harruar se afër tetë vite nuk e kishte thyer në besë Cërvenkovskin, se udhëheqësit të LSDM-së i kishte mbet besnike edhe kur ai shkoi në Gostivar që policëve tua urojë “suksesin” gjatë uljes së flamurit shqiptarë, ku u vranë edhe qytetarë të pafajshëm.

Shikuar nga ky kënd, Arbër Xhaferi edhe nuk rrezikonte shumë me ndarjen e lokomotivën së vet partiake nga “vagoni” i zbratur politikisht i PPD-së. Ai e dinte se shqiptarët fare nuk do i irritoj lënia e PPD-së jashtë koalicionit qeveritarë, sepse shqiptarët ishin ngirë me atë parti gjatë bashkëqeverisjes tetëvjeçare me LSDM-në. Shumica e shqiptarëve të këtushëm, mendonin se do jetë mirë që në pushtet të vijin “trimat” e PDSH-së, dhe që më në fund të provohet edhe guximi i tyre politik. Pastaj, edhe nuk ishte gjithaq e qartë se kush më shumë kundërshtonte përfshirjen e PPD-së në qeveri: Lubço Georgievski apo Arbër Xhaferi. Edhe njëri edhe tjetri, kishte arsyet e veta ta mbanin sa më larg nga koalicionit qeveritarë partinë e udhëhequr nga Abdu-rrahman Aliti. VMRO -DPMNE-ja mbase nuk donte që ta ketë në qeveri një parti, e cila qysh moti ishte shpallur si “probrankoviste”, ndërsa Arbër Xhaferi ndoshta edhe nuk donte që kulaçin qeveritarë ta ndajë edhe me PPD-në. Dhe që të dy arsyet ishin të qëndrueshme.

Për shqiptarët e këtushëm nuk ishte gjithaq e rëndësishme se cila do ketë qenë arsyeja pse Arbër Xhaferi hoqi dorë nga platforma e përbashkët parazgjedhore me PPD-në, dhe pse PDSH - ja si

parti e vetme u bë pjesë e qeverisë së Lubço Georgievskit. Për ata më rëndësi kishte shpresa e rilindur se Arbër Xhaferi do vepronte ndryshe dhe më “shqiptarçe”. Andaj edhe me padurim prisnin të shihnin se cilët do i emëronte si përfaqësues më të denjë në institucionet më të larta shtetërore. Ata pra prisnin që Xhaferi t’ju dëshmojë partnerëve të etnitetit maqedonas se edhe shqiptarët kishin politikanë që me asgjë nuk mbeteshin mbrapa atyre të partive maqedonase.

Dhe ndodhi ajo që shumëkush nuk e priste. U votua qeveria të cilën e përbënin dy të kundërtat që vite më parë dukeshin si re të zeza, të cilat nëse përballeshin do mund të shkaktonin vetëm vetëtima dhe shtrëngatë, prej së cilës do pësonin të gjithë: “nacionalistët” e VMRO - DPMNE-së dhe “radikalët” e PDSH-së - siç i quante opinionin i etnitetit maqedonas nën ndikim të politikës së Gligorovit. Kishte të atillë që këtë bashkëpunim e vlerësonin si sukses më të madh të demokracisë së brishtë të Maqedonisë. Këtë bindje të tyre e mbështesnin në besimin se këto dy parti, kështu ia pamundësonin vetes edhe më tej të luanin me letren e fortë nacionaliste. Pra, besonin se pas kësaj nuk do vlenin gjë parullat e VMRO - DPMNE-së për “Maqedoninë pa shqiptarë”, e as ato të PDSH-së për një Maqedoni e cila nëse nuk do e mësonte edhe gjuhën shqipe, nuk do i vlente gjë as cirilica. Përballë këtij vlerësimi, qëndronte ai i të tjerëve, të cilët këtë koalicion qeveritarë e quajtën aq të panatyrshëm, sa është e panatyrshme të mbyllësh në një kafaz

shqiponjën dhe luanin. Dhe këtë koalicion qeveritarë e quajtën “bashkëshortësi të panatyrshme”, lidhje që kishte ndonjë interes jashtë atij të qeverisjes me Maqedoninë. Ky krah pesimist, filloi të zbulojë “takime” të fshehta mes Xhaferit dhe Georgievskit, bënte studimin e “koncepteve” konspirative që i bashkonte këto dy kundërshti sa u përket qëndrimeve të forta nacionaliste.

Pa dyshim se kishte të vërtetë në pohimet se Arbër Xhaferi mbante lidhje të përhershme me aktivistë të VMRO – DPMNE-së. Fundja, ai atje kishte miq me të cilët i lidhte e kaluara e përbashkët socialiste në Prishtinë. Mes tyre ishte regjisori Lubisha Georgievski, kandidat për president i VMRO-DPMNE-së në vitin 1995, kur e dha deklaratën e famshme se do bënte çmos që “shqiponjës dykrerëshe t’ia priste kthetrat”. Por, e cila deklaratë siç duket nuk ndikoi në prishjen e miqësisë mes një nacionalisti të pamatur të etnitetit maqedonas dhe një “patrioti” të flaktë shqiptarë, i cili asokohe linte përshtypje se më parë do flijonte kokën e vet se sa një pendël të shqiponjës kombëtare.

Qeveria e koalicionit VMRO-DPMNE dhe PDSH, qysh në fillimet e saja do qeverisë e ngarkuar me barrën e dyshimeve të shumta. Edhe shqiptarët sadopak i hutoi kjo “bashkëshortësi” qeveritare, dhe nuk e kishin të lehtë ta shohin Xhaferin midis atyre që demokratizimin e Maqedonisë e filluan me kërkesën “Dhoma gazi për shqiptarët”. Por, siç u tha, habia u takonte atyre të cilët nuk e dinin se, posa u kthye nga Prishtina, Arbër Xhaferi i

ripërtëriu miqësitë me “vojvodat” e VMRO-DPMNE-së, e që kishin ndikim të madh te “kryevojvoda” Lubço Georgievski. Nga ana tjetër, Georgievski shpejtë e kuptoi se edhe ai duheshte t’i ketë “shqiptarët e tij”, se pa “partinë e vet” shqiptare, nuk do arrinte t’i kundërvihej Branko Cërvenkovskit dhe do i mungonte mbështetjen ndër-kombëtare. Dhe objektivisht, askush përpos PDSH – së, nuk meritonte interesin e tij. Ai me kohë e kishte vlerësuar drejtë rritën e kësaj partie tek shqiptarët, si dhe autoritetin që kishte Arbër Xhaferi në opinionin mbarëshqiptarë. Andaj, për ata që ndiqnin kujdesshëm rrjedhat politike në Maqedoni, “bashkëshortësia” VMRO -DPMNE dhe PDSH, lere që nuk ishte e panatyrshme, por ishte e vetmja mes dy partnerëve të cilët nuk kishin mundësi të mëdha të zgjidhin. Pastaj, ishin edhe “bashkëshortë” që i bashkonte karakteri i njëjtë: vrulli, energjia e veprimi, numri i antikomunistëve më të zjarrtë, disa nga të cilët posa kishin ndërpre aktivitet komuniste.

VMRO – DPMNE-ja dhe PDSH – ja, ishin dy partitë më populiste të cilat kishin përvojë disa vjeçare me nxjerrjen e qytetarëve në rrugë. Lubçoja këtë e bënte duke dashur të dëshmojë “proshqiptarizmin” e qeverive të mëparshme të Branko Cërvenkovskit, e Arbër Xhaferi këtë e bënte herë duke përdorur tragjedinë e Kosovës, e herë duke dashur të dëshmojë antishqiptarin e qeverive të cilat i udhëhiqte Cërvenkovski. Kështu që krijohet përshtypja se ajo që i bashkonte VMRO – DPMNE-në dhe PDSH-në, ishte LSDM-ja e Branko Cërvenkovskit. Por, ky bashkim

ishte i bazuar në kundërshti perverse: Lubço Georgievski e mundi Cërvenkovskin në zgjedhjet parlamentare duke e akuzuar atë se e “shqiptarizon” Maqedoninë, e Arbër Xhaferi e forcoi PDSH-në duke akuzuar koalicionin e mëparshëm qeveritarë se ishte “anti-shqiptarë”.

Në ndërkohë, PPD-ja vajtonte fatin e partiakëve të saj që ishin mësuar të jenë në grazhdin shtetëror, e të cilët tani përnjëherë u gjetën larg tij. Por, ky vajtim i tyre, nuk shkaktonte ndonjë pikëllim të shqiptarët e këtushëm. Në ndërkohë, edhe ata sadopak ishin pjekur politikisht dhe e kishin kuptuar se kur qanë politikani, diçka i buzëqeshë popullit, se kur qeshet pushtetari, diçka do e çojë të dënësë popullin. Më në fund, shqiptarët kishin filluar ta kuptonin se politikanët gjithmonë shkojnë në dy drejtime: drejt kënaqësive personale dhe drejt botës së harresës se kush është ai që i ka sjell në kolltukët e buta të pushtetit. Por, shqiptarët kësaj radhe bënë vetëm një gabim: nuk kërkuan nga Arbër Xhaferi të tregonte se mbi cilën platformë politike kishte hyrë në qeveri. Vallë ajo do ishte e njëjta që e kishte nënshkruar gjatë fushatës parazgjedhore me PPD-më, apo ndonjë e re. E Arbër Xhaferi kurrë nuk ka qenë aq naiv sa t’u përgjigjet edhe pyetjeve që nuk u kujtoheshin shqiptarëve t’ia shtrojnë. Kështu që, partia e tij morri pesë vende ministrore, të cilat më vonë do bëheshin si pesë “kroje” që do ushqenin me forcë dhe arrogancë këtë parti. Në mesin e tyre kishite edhe të atillë që përnjëherë bisedonin me dy telefona celularë, por fare nuk kishin lidhje “telefonike”



me postin që ushtronin. Do ketë mes tyre edhe të atillë, të cilët do e ngrenë një shkallë më lartë atë që posa kishte filluar ta përurojë PPD-ja: bindjen se partia të ngrit e të rrëzon nga majat e suksesit, pa marrë parasysh vlerat individuale. Mes pushtetarëve të PDSH-së do ketë edhe të atillë që do i nxisin trilluesit e barsoletave të tregojnë atë për ministrin shqiptarë, të cilit në ditët e para të "ministrimit" të tij, i hyn në kabinet sekretaresha e i thotë: "Zoti ministër, erdhi faksi!". E ai pa hamendje e urdhëron: "Lere le të hyjë në zyre!"

Por, as kjo barsoletë që shumëçka shpjegon lidhur me aftësitë e disa ministrave të atëhershëm të PDSH-së, nuk do u pengojë shqiptarëve të Maqedonisë në fillim. Sepse pas çdo ministri të paaftë, ata shihnin Arbër Xhaferin e shkathtë, i cili me mençurinë e vet mund të zëvendësonte një qeveri të tërë, e jo më disa ministra kukulla. Pra, shqiptarëve të Maqedonisë thujse as që u interesonte kush do i përfaqësonte në institucionet më të larta qeveritare, duke menduar se mjaftonte Arbëri që gjitha t'i bie në vend të vetë. Dhe kjo ishte fare e kuptueshme për një mjedis që ende funksiononte sipas logjikës "së të parit" të kolonës, që edhe partitë i ndërlidhte me atë që ishte në krye të sajë, e jo me piramidën e dhe konceptet partiake. Ndoshta kjo e vërtetë do jetë një nga barrët më të rënda të Arbër Xhaferit gjatë tërë karrierës së tij politike në Maqedoni. Pra, ai do bëhej udhëheqës i PDSH-së me barrën e njeriut i cili e ka domethënien e vet partisë, e jo të njërit nga të shumtit që e bëjnë atë. Pa dyshim

se këtu edhe shqiptarët do e shohin dështimin e tij, posaçërisht në vitet kur do bëhet gjithnjë e më e qartë se thujse të gjithë anëtarët e kësaj partie janë në punë të përkohshme të “pronari” i saj – nënkryetari i PDSH – së. Por, kur shqiptarët e kuptuan këtë, asgjë më nuk do mund të korrigjohej. Sepse vëllazëria VMRO-DPMNE dhe PDSH, kishte arritur aty ku askush nuk i kishte kthyer sytë dhe nuk kishte besuar se janë nisur: drejt përfitimeve personale të krerëve partiak, drejt një arrogance e cila do i shpie deri aty sa vetë kryeministri të pranojë se fitimi i tij material, është sa i një biznesmeni të rëndomtë.

Shikuar objektivisht, qeverinë e Georgievskit e përcollën shumë të papritura, të cilat në njëfarë mënyre nuk e lejuan të qeveriste e papenguar deri në fund të mandatit. Gjatë qeverisjes VMRO-DPMNE dhe PDSH, ndodhi bombardimi i trupave të NATO-së mbi Jugosllavinë e Millosheviqit, ndodhi eksodi biblik i shqiptarëve të dëbuar nga Kosova, kështu që qeveria u gjet e paralizuar. Roli i PDSH-së gjatë kësaj krize, ishte shumë i rëndësishëm dhe fare pa hamendje, veprim që mund t’i përshkruhet si meritë e pamohueshme Arbër Xhaferit. Në mos më shumë, shkaku se në vitin 1999 ai duheshte politikisht të jetojë mes kërkesave të disa qarqeve shqiptare që ta braktiste qeverinë e cila në fillimet e luftës së Kosovës sillej çuditshëm (herë e mbyllte, e herë e hapte kufirin për shqiptarët e dëbuar), dhe të vlerësimeve se PDSH-ja duhej të mbetet në qeveri, ku në mos me shumë, mund tua vështirësonte punën atyre që kishin qëllime antishqiptare. Arbër Xhaferi e përballi

mirë këtë periudhë, mbase më të vështirën për shqiptarët dhe politikanët e tyre. Ndoshta ashtu si ai do të vepronte cilido shqiptarë tjetër, i cili e dinte se bëhej fjalë për fatin e tërë shqiptarisë, e jo vetëm për kosovarët, por është e pamohueshme se PDSH-ja kësaj radhe bëri të mundshmen dhe më të mirën që mund të bëhej.

Gjithsesi se 1999 ishte viti më i rëndë për qeverinë e Maqedonisë dhe për PDSH -në. Dhe nga e tëra, Arbër Xhaferi doli i panjollësuar, arriti të përballë edhe frustrimin e atyre që e sulmonin për tragjedinë biblike në Bllacë, kur disa ditë me radhë nuk u lejohej hyrja në Maqedoni dhe u mbajtën të ngujuar qindra mijë shqiptarë të lagur nga shiu dhe të rraskapitur nga uria. Posaçërisht kur dihet se asokohe, të mbështjellë nga dhembja për fatin e bashkëkombësve të vet në Kosovë, shqiptarët e këtu-shëm as që e dinin se fati i të dëbuarve as që varej më nga dëshira e qeveritarëve të Shkupit, e më së paku nga ajo e Arbër Xhaferit. Qëmoti dihej se vendosnin ata të cilët e kishin marrë për sipër të bënin luftë, për ta fituar paqen në Kosovë. Por, gjithsesi se edhe vendorët duheshte të “luajnë” rolin i cili u ishte përcaktuar. E Arbër Xhaferi bëri atë që pritej nga ai dhe ajo që duhej bërë.

Pa dyshim se bombat që hidhte NATO-ja mbi caqet e Millosheviqit, tronditnin edhe Maqedoninë. Sepse në këtë shtet ende ishin të forta qarqet proserbe dhe ato që donin gjithsesi Maqedoninë ta fusnin në një konflikt ndëretnike maqedonaso - shqiptarë. Gjë të cilën duhet pranuar se me mjeshtri

e bëri të pamundur qeveria e Georgievskit. Gjatë bombardimeve të NATO – së mbi caqet ushtarake të Jugosllavisë së Millosheviqit, Shkupi organizonte edhe protesta anti NATO-së dhe antishqiptare. Demonstruesit gjuanin me gurë ambasadën amerikane, dignin flamujt e këtij shteti. Këto demonstrata i kishte organizuar Partia Demokratike serbe dhe Lidhja Komuniste e Maqedonisë, të cilat krahas djegieve të flamujve amerikan, premtonin “se nuk do e jepnin Kosovën dhe Maqedoninë”. Këto porosi bënë të ditur se Maqedoni gjithmonë qëndronte pranë humnerës së luftërave ballkanike, që siç dukej ende nuk kishin përfunduar. Dhe bombardimet e NATO-së ishin ato të cilat e dëshmonin se jo të gjithë qytetarët e Maqedonisë njësoj e përjetonin atë që ndodhte pranë kufijve të shtetit të tyre. Përderisa shqiptarët me ankth prisnin që njëherë e përgjithmonë të thyhej boshti kurrizorë luftarak i Millosheviqit, një pjesë e opinionit të etnitetit maqedonas, bombat të cilat binin nëpër caqet e Serbisë, i ndjente si të shpërthenin mbi kokat e tyre. Edhe atë jo gjithaq shkaku se u dhimbseshin serbët, sa për arsye se i urrenin shqiptarët.

Në një situatë të tillë, qeveria nuk e kishte lehtë t’i dëshmojë botës se nuk ishte kundër perëndimit dhe në ndërkohë të ruante stabilitetin e brendshëm të shtetit. Dhe derisa kryetari i Amerikës, Klintoni i shkruante Gligorovit se SHBA do “jenë pranë tij dhe Maqedonisë gjatë ditëve që do pasonin”, kryeministri Lubço Georgievski theksonte se “nëse përgjegjësia për situatën katastrofale humanitare në Kosovë binte

mbi Millosheviqin, atëherë përgjegjësia për derdhjen eventuale të krizës humanitare në Maqedoni, do i binte Unionit Evropian dhe SHBA - ve”. E në ndërkohë Millosheviqi bënte çmos që konflikti t’i përfshijë edhe Shqipërinë dhe Maqedoninë. Këtë donte ta arrijë duke i dëbuar shqiptarët e Kosovës, të cilët do t’i destabilizonin këto shtete fqinje. Dhe një ndër arsyet pse nuk e arriti ta realizojë këtë “kasapi i Ballkanit”, është e vërteta se, sa do që të kishin bërë gabime, qeveritarët e Maqedonisë arritën mirë ta drejtonin valën e të dëbuarve kosovarë si dhe krizën që lehtë mund ta çonte shtetin drejt asgjësimit. Pra, roli i PDSJH-së gjatë kësaj periudhe kishte një peshë të veçantë. Në mos për tjetër, atëherë shkaku se cili do hap i gabuar i Arbër Xhaferit, do inicioonte ndonjë veprim jashtë institucional të shqiptarëve të këtushëm, i cili veprim jo vetëm që do çonte drejt destabilizimit të Maqedonisë, por në shumëçka do e komplikonte tërë operacionin luftarak të NATO-së.

Pas vitit 1999, PDSH-ja u prezantua me një fytyrë krejt tjetër. Meqenëse në njëfarë mënyre, PDSH-së i ishte lënë në duar sundimi mbi shqiptarët e Maqedonisë, nuk vonoi shumë dhe kjo parti filloi të sillet si shtëpiari i cili kur nuk ka çka t’i bëjë komshiut, i torturon familjarët e vet. Kështu që filloi një periudhë e cila shenjë njohëse kishte portretin e veprimit politik të Arbër Xhaferit, i cili, i lënë pa “materialin” politik që aq mirë e përdorte për ta rritur vetveten si patriot i pashoq përpara shqiptarëve të Maqedonisë – tragjedinë e Kosovës - filloi gjithnjë e më shumë t’i ngjajë heroit të betejave të

huaja. Një politikani i cili duhej analizuar nga dy kënde: nëpërmjet asaj që fliste dhe shkruante, dhe nëpërmjet veprave politike që la pas vetes.

E shqiptarët, Arbër Xhaferin e pritën si heroin që duhej t'ua kthente besimin në vetvete, që duhej t'ua shëronte dinjitetin dhe krenarinë e lënduar, si njeri rreth të cilit do grumbulloheshin të gjithë ata të cilët donin të jepnin kontributin e vet në ato kohë të turbullta për shoqërinë shqiptare që jetonte në Ish Jugosllavi. Pra, Arbër Xhaferi në Tetovë u rikthye si i gjatëpritur, i cili duhej t'i legjitimojë shqiptarët e Maqedonisë si popull që ka vlera edhe pse nuk ishin të paktë ata që e dinin se ai e kurrë nuk do e braktiste Prishtinën, sikur atje të mos ndjehej si peshk i vogël në akvariumin e peshqve të mëdhenj politik, siç ishin Fehmi Agani i gjeneratës së vjetër (të cilin gjatë luftës në Kosovës barbarisht e vranë serbët), Veton Surroi i brezit që vinte si edhe shumë të tjerë pranë të cilëve nga emri i Arbërit nuk mbetej as “a-ja” e vogël e mbiemrit të tij. Aq më shumë, në Tetovë arriti me valixhet bosh sa i përket ndonjë veprimtarie publike gjatë viteve të tetëdhjeta, kur shumë veprimtarë kosovarë u vunë në mbrojtje të të gjithë shqiptarëve të cilët jetonin në Jugosllavinë e Titos. Emrin e tij nuk mund ta gjeje as nëpër periodikun e këtyre viteve, kur zhvillohej një debat i ashpër serbo-shqiptarë, as në mesin e themeluesve të LDK-së, as mes atyre që kishin nënshkruar “Apelin 215”. Mbase ai ishte veprimtar i ardhur me vonesë, në vitet e nëntëdhjeta, atëherë kur çdo gjë ishte më e qartë se në dekadën e tetë kur ende nuk dihej as çka

do ndodhte me Jugosllavinë, as nga do nisej Kosova.

Por, në politikë, personalitete bëhen ata që dinë në momentin e duhur të bëjnë veprimin i cili do i rreshtojë aty nga do mundë më lehtë t'i kapë objektivi i historisë. E në fillim të dekadës së fundit të shekullit të njëzetë, Arbër Xhaferi mirë e kishte vlerësuar se më lehtë do e kishte të bëhet "hero" në një hapësirë "pasive", siç ishte asokohe shoqëria e shqiptare e Maqedonisë, se sa në një Kosovë ku gjithmonë ai do mbetej atë që kishte qenë: një ndër të tjerët e kallaballëkut të madh. Andaj edhe posa e thirrën që të bëhej strumbullar rreth të cilit do mblihdeshin taborët grindavece të PPD-së, ai erdhi në Tetovë si i ftuari që mezi ka pritur t'i kthehet vendlindjes. I porsaardhuri nga Prishtina, gjithashtu mirë e kishte vlerësuar se shqiptarët e Maqedonisë ishin lodhur nga inferioriteti politik i udhëheqësve të tyre të deriatëhershëm partiakë dhe mezi prisnin të vijë ndonjë prijës i ri, i cili denjësisht do qëndrojë ulur pranë rivalëve të vetë të etnitetit maqedonas. Kështu që Arbëri e kishte fronin e lirë kur arriti në Maqedoni. Dhe jo vetëm fronin, por shumëçka ishte në favor të tij, sepse shqiptarët e këtushëm ishin në "nokdaun" politik, andaj në "ringun" ndëretnik do mund te shkëlqente cilido "arbër" që e dinte ç'është "arbëria".

Arbër Xhaferi erdhi në Tetovë si heroi i gjatëpritur. Si i tillë ai mbase dështoi qysh në fillim kur, në vend që të bënte atë që pritej prej tij - të ruaj unitetin e partisë më të madhe të atëhershme, PPD-së dhe t'i ribashkojë rrymat që grindeshin mes veti se

kush do bëhej kryetar i saj – ai shumë shpjet u bë krah i përçarësve të kësaj partie. Gjë e cila i hutoi shqiptarët e këtushëm, por të cilët i qëndruan mbrapa mbase duke u nisur nga prirja se “atë që di Arbëri i ardhur nga Prishtina, nuk e dinin ata që ishin rritur jashtë Kosovës”. Pastaj, ato ishin kohë kur cilido që kthehej nga Prishtina, nuk kishte nevojë të “japë provimin e atdhetarisë” siç ndodhte me ata që ishin në Maqedoni. Asokohe i ardhuri nga Kosova e përvuajtur ishte pronarë i pakontestueshëm i “licencës” së atdhetarisë dhe patriotizmit. Dhe kur shqiptarët dolën nga hutesa, Arbër Xhaferi më kishte harruar se pse e kishin ftuar dhe kishte dalë në krye të Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve. Në krye të partisë e cila do udhëhiqet nga ai, por mbase do mbetet pronë private e nënkryetarit të saj, edhe në vitet e mëvonshme, kur do e ndërrojë emrin në PDSH. Dhe siç duket, në këtë “kompani aksionarësh”, të kontrolluar nga nënkryetarit i kësaj partie, Arbër Xhaferit qysh në fillim i ishte caktua roli i “aksionarit” që kishte për detyrë t’u jep legjitimitet dhe shpjegim “atdhetarë” veprimeve të një grupi njerëzish, të cilëve askush nuk u kishte treguar se në politikë ekzistojnë dy rrugë: ajo që të çon drejt të mirës kolektive, dhe ajo që të çon drejt mirëqenies personale. Se ata që ecin rrugës së parë janë politikanë, e këta të cilët ecin drejt profiteve personale quhen manipulues me ndjenjat kolektive. Kështu që Arbër Xhaferi u bë ombrellë e të gjithëve në këtë parti, ndërsa vetë ai eci nëpër të gjitha rrugët duke ia shtuar vetes edhe dy të



tjera: në Maqedoni të vepronte si politikan i heshtur, i cili shtirej se nuk e dinte se çfarë bënin shokët e tij partiak, e jashtë saj si vlerësues i rrjedhave politike në rajon. Me çka arriti që papërgjegjësini e vet politike, ta mbulojë me llafazanin joshëse. Mbase kjo i ndodhi edhe shkaku se ai – si edhe shumë të tjerë – nuk e dinte se profesioni i politikanit dhe i opinionistit të lirë, janë aq të largët sa i futbollistit dhe i adhuruesit të futbollit. Se të jesh politikanë aktiv, do të thotë të mbash përgjegjësi përpara atyre që të kanë zgjedhur, e të jesh opinionist i thjeshtë, do të thotë të dëmtosh apo ndërtosh emrin tënd si vlerësues i ngjarjeve politike.

Ndoshta, duke dashur të jetë vlerësues i të tjerëve, e jo përgjegjës ndaj atyre që ai jepnin legjitimitetin politik, ai edhe arriti t'i peshojë të gjithë ata të cilët kishin legjitimitet ta vlerësonin atë, duke harruar ta peshojë vetveten. Apo, mbase ai harroi se peshorja me të cilin e masnin shqiptarët e Maqedonisë, ishte krejt ndryshe nga ajo që e maste Tirana, se për shqiptarët e këtushëm nuk vlenin gjë analizat e tij gazetareske, por ajo se sa ishte përmirësuar statusi i tyre, në shtetin, ku ai i përfaqësonte si parlamentar apo si kryesues i partisë në koalicionin qeveritarë. Ndoshta shkaku i kësaj harrese të kryesuesit të saj, edhe PDSH-ja kurrë nuk arriti të fitojë zgjedhjet parlamentare në bllokun partiak shqiptarë.

Përderisa shqiptarët pyesnin se ç'ndodh me Arbër Xhaferin, se ku ndodhet ai gjersa nënkryetari i tij i kompletton listat e tradhtarëve dhe spiunëve

shqiptarë, ai në të vërtetë bënte atë që do ishte tipare njohëse e shumë politikanëve shqiptarë të fundshekullit të njëzet dhe të dekadës së parë të mileniumit të tretë: të bëhet veprimtarë i përmasave mbarëkombëtare, duke mos pasur pas vetes, thuajse, asnjë rezultat konkret politik në Maqedoni. Pra, të vishet me petkun e llafazanisë patriotike dhe të stoliset me diademën e pakontestueshme të një mendimtari të kthjelltë, i cili në kohën e duhur e thoshte atë që dëshironin ta dëgjonin shqiptarët në Tiranë apo në Prishtinë. Përderisa Prishtina e dinte “mallin” që ua kishte kthyer shqiptarëve, dhe atje, krahas shumë të tjerëve që e linin nën hije Arbëri, nuk ishte gjithaq mahnitës, në Tiranë ai shumë shpejtë u bë “strategu me përmasa” mbarëshqiptarë, të cilit duhej pa fjalë t’i përkuleshin të gjithë. Me të, në të vërtetë, ndodhi fenomeni aq i njohur mes shqiptarëve të shpërndarë në më shumë shtete - që gjithmonë t’u duket më i mirë ai i “Shqipërisë” fqinje.

E Arbëri këtë e arriti fal një dhuntie të cilën nuk mund t’ia mohojë askush: mjeshtëria t’i përdorë mediat, në të cilat edhe nuk paraqitej si veprimtarë aktiv në politikë, por thuajse ishte “vëzhgues” i Kombeve të Bashkuara që kishte ardhur këtu vetëm sa të zbardhte realitetin e shoqërisë shqiptarë. Dhe si i tillë, ai mbase do mbetet ndër analistët më të mirë të viteve të fundit të shekullit të njëzet, si vlerësues se si duhet të veprojnë shqiptarët kudo që janë, por duke ua treguar këtë pasi që ata të kishin përfunduar betejën politike.

Pra, fare nuk është e pakuptueshme pse Tirana e adhuronte Arbër Xhaferin, pse Prishtina sillet ndaj tij me mospërfillje, ndërsa nga disa mjedise të shqiptarëve të Maqedonisë merrte kritika. Sepse opiniononi i Tiranës atë e vlerësonte si analist të spikatur, Prishtina e kujton si “a edhe ai u bë dikush”, ndërsa shqiptarët e Maqedonisë e vlerësonin si kryetar të një partie të tyre. Andaj, mund të thuhet se kishte të drejtë edhe Tirana që e mbante për mendimtarë të ndritur, edhe ata shqiptarë të Maqedonisë që e vlerësonin si politikan të dështuar. Sepse, si analist, Arbër Xhaferi ishte dhe mbeti i pashoq, ndërsa si udhëheqës partiak, nuk shkoi më larg se tek kallaballëku i klubit të politikanëve shqiptarë, të cilët i solli me vete shtrëngata e transicionit. Si analist ai në përpikshmëri e dinte domethënien e fenomeneve, e si politikanë nuk e dinte pse për shembull në vitin 1997 thoshte se për PDSH-në e tij “çështja e Universitetit është çështje e mbyllur, për shkak se ne definitivisht jemi përcaktuar për idenë e Universitetit të Tetovës” se duhet “t’i thuhet qartazi Gligorovit se Universitetin e Tetovës nuk e përkrahin radikalët e shpifur, por e përkrahin të gjitha subjektet politike, i gjithë populli shqiptarë i këtyre hapësirave.” (“Flaka, 10 maj, 1997), pra pse atëherë mendonte kështu, ndërsa në vitin 2004 kur BDI-ja mundohej të sjellë ligjin për arsimim superior - me të cilin mund të legalizohej edhe Universiteti Shtetëror i Tetovës - Xhaferi do të thotë: “Me këtë ligj është e qartë se dublifikohen kapacitetet, anashkalohet zgjidhja e fakulteteve dhe stu-

dentëve dhe përfundimisht relativizohet një projekt kulminant siç është ai i Universitetit të Evropës Juglindore” (15 janar, 2004). E në ndërkohë nuk tregon se kur ua kishte ofruar shqiptarëve të Maqedonisë UEJ si zgjidhje përfundimtare për armimin e tyre në gjuhën amtare!? Vallë në vitet kur e përkrahte Fadil Sulejmanin, duke iu bashkangjitur nëpër protestat në Tetovë, apo kur atë e burgosën, e Xhaferi me të drejtë reagonte ashpër ndaj këtij dënimi vandalë të gjyqësisë maqedonase!? Apo ndoshta këtë projekt madhorë për Universitetin e “shtulit”, Arbëri e kishte mbajtur sekret nga të gjithë ata që më vonë do themelojnë me dhjetëra universitete private?

Sa i përket analistit Arbër Xhaferi, ai arriti t'i mbrojë suksesshëm të gjitha veprimet e PDSH-së. Por edhe këtë e bënte më shpesh në Tiranë, e shumë rrallë në Shkup. Mjeshtërinë që të shpallë vepër atdhetare edhe veprimet partiake të cilat me atdhetarin janë të largëta sa qielli dhe toka, Xhaferi e dëshmoi edhe në ditët kur Tirana ishte e “tronditur” nga lajmi se ai do e braktisë kreun e PDSH-së. I pyetur nga një gazetar se “a mund të bëhet realitet në Maqedoni që shqiptarët të kenë një koalicion të përbashkët, i cili më pas do të hynte në aleancë me çdo qeveri maqedonase” dhe mos vallë “kjo përçarje kaq e madhe, e dëmton çështjen shqiptare?”, Arbëri do përgjigjet pastër e shqip “se duhet të kemi parasysh argumentin e faktorëve të ndryshëm që i cilësojnë shqiptarët si rrezik, jo vetëm për Maqedoninë, por për gjithë rajonin. Çdo homogjenizim i shqiptarëve në Maqedoni sidomos

tani kur vendoset fati i Kosovës do të vlerësohej me dyshim....”. ( “Shqip”, 30.06.2007). Me çka përfundimisht shqiptarët e Maqedonisë e kuptuan pse ai kurrë nuk kontribuoi për bashkëveprim mes partive të shqiptarëve të këtushëm. Dhe më në fund, ata mbase e kuptuan se për ardhmërinë e Kosovës, na qenkan shumë të dobishme edhe konfliktet fizike parazgjedhore të vitit 2006 mes përkrahësve të BDI-së dhe PDSH-së, nga të cilat Arbër Xhaferi kurrë nuk u distanca. Apo se përçarjet ndërpartiake në Shqipëri dhe në Prishtinë, nuk na qenkan vetëm kontribut madhor për pavarësinë Kosovës, por edhe dëshmi e paluhatshme përpara demokracisë evropiane se nuk kanoset asnjë rrezik nga ndonjë “homogjenizim” i shqiptarëve!? Andaj, rroftë përçarja!?

Por, i tillë ishte, dhe i tillë do mbetej përgjithmonë Arbër Xhaferi: cilindo veprim të vetin ta shpall si kontribut për çështjen mbarëshqiptare. Pra, ishte udhëheqës partiak që bënte gjumë në shtratin politik të Maqedonisë, e mbulohej me çarçafët e endur nga (dis)fati i Kosovës, heshtte në parlament ku shqiptarët e paguanin të fliste, e mbante ligjërata atdhetare në Tiranë. I tillë arriti të mbetet edhe falë mundësisë që ia ofronin “muskujt” partiak: t’i heshtë të gjithë shqiptarët e Maqedonisë që e pyesnin se cilat janë rezultatet të cilat i kishte arritur PDSH-ja e tij gjatë bashkëqeverisjes me VMRO-DPMNE-në.

Si do që të jetë, Arbër Xhaferi arriti diçka të pamohueshme: shqiptarët e Maqedonisë të kenë një

udhëheqës të vetin që do e çmojë lartë pala e etnitetit maqedonas dikur e deklaruar si antishqiptare – VMRO-DPMNE-ja, dhe të cilin do e adhurojë Tirana. Në ndërkohë, edhe më tej do mbetet enigma se sa kanë të drejtë ata që thoshin se PDSH-ja ishte fëmijë i ngjizur në laboratorët e policisë maqedonase, e sa ata që pohonin se prindërit zyrtarë të kësaj partie dihehin: nënë kishte partinë e dikurshme më të madhe shqiptare – PPD-në, ndërsa baba, Sali Berishën.

Shikuar nga ky kënd, shërbimet e dikurshme policore kanë mundur të jenë vetëm “inkubatorë” që ka ndihmuar rritjen më të shpjegueshme të “foshnjës” partiake, siç bënin asokohe edhe me shumë parti tjera të Maqedonisë, e të cilat e mbanin epitetin “nacionaliste”. Ndërkohë, Tirana zyrtare e fillimit të dekadës së nëntë të shekullit të njëzetë, duke e ditur se “lehona” – PPP-ja – ishte para “lindjes”, i aktivizoi të gjitha “mamiçat” që foshnja të vinte në jetë me sa më pak dhembje, duke mos e fshehur se ky fëmijë do ishte nën kujdesin saj. Dhe kuptohet, priste që fëmiju gjithmonë t’i mbetet mirënjohës dhe besnik për këtë. Por, Tirana zyrtare e asaj kohe ende nuk e dinte se Arbër Xhaferi vepronte tetovarçe, por kishte ambicie mbarëkombëtare. Se shqiptarët e Maqedonisë ai i llogariste vetëm si një tullë që do e vinte nën këmbët e atdhetarisë, që më pas të shkonte në Tiranë dhe Prishtinë si një “princ” nga shumë principatat shqiptare. Dhe si i tillë, ai edhe ndaj Berishës do vepronte si fëmiju që dëshiron të çlirohet nga hija e babait të famshëm: duke mos mundur ta

asgjësojë atë, do jetojë me dëshirën që një ditë ta sheh të gjunjëzuar përpara madhësisë së vet. Dhe shumë shpjet pas rënies së Sali Berishës, Arbëri do dijë me kënd duhet të fotografohet në mënyrë që në Tetovë ta çmojnë si të madh ne mesin e të mëdhenjve.

Mbase Arbër Xhaferi dhe PDSH-ja e tij edhe nuk mund të bënin asgjë më shumë, përpos ta ecnin suksesshëm rrugën që të çon nga kapota e komunizmit, e deri te parullat atdhetare. Pra, kryesuesi i PDSH-së, e drejtoi këtë parti andej nga ishin katandisur edhe partitë tjera të shqiptarëve të Maqedonisë: nëpër rrugën e pllakosur me premtime të mëdha, e të rrethuar me gjembat e arsyetimeve pse ato premtime nuk mund të jetësoheshin kur bëheshin pjesë e koalicioneve qeveritarë. Arbër Xhaferi pra, eci rrugës politike e cila ishte e hapur vetëm në demokracinë e shoqërive shqiptare: të bësh emër duke treguar jo çka ke bërë, por ç'duhet të bëjnë të tjerët. Prandaj edhe Xhaferi mbeti i humbur diku mes politikanit të dështuar dhe analistit të mrekullueshëm. Apo, mbeti si politikan pa fizionomi të qartë politike, e me portret të ndritshëm si opinionist i rëndomtë dhe analizues i betejave të huaja. E kjo ishte e mundur, sepse vetëm në shoqërinë shqiptare mundeshe të bëheshe “hero kombëtarë”, pa marrë pjesë në asnjë betejë dhe duke i komentuar ngjarjet na kafeneja “Dora” në Tetovë.





## Rrënja katrore e vitit zero - 2001

Pyllin mbi të cilin dendësohet mjegulla, herdo kurdo e përfshinë shtrëngata. Dhe aty ku askush nuk e thanë lagështinë që e ka kapluar brendinë e shtëpisë, e kotë është të pyesësh pse janë kalbur orenditë, pse aq lehtë është rrëzuar pullazi. Kështu shkurtimisht mund t'u përgjigjet njeriu atyre që shtrojnë pyetjen se pse u përball Maqedonia me vitin 2001, dhe se a ishte e mundur gjitha të arriheshin pa krismat e armëve. Pra, kështu mund njeriu shkurtimisht t'u përgjigjet pyetjeve që i shtronin ata të cilët një dekadë të tërë nuk e kishin pyetur veten se ku e çonte Maqedoninë ajo ndasi ndëretnike, se ku do arrinte ky shtet me tërë atë pakënaqësi të popullatës shqiptare ndaj institucioneve shtetërore, ndaj përfaqësuesve të vet të cilët nuk ia dilnin dot të zgjidhin shumëçka që kishin premtuar e që kishte të bëjë me të drejtat e një pjese të qytetarëve të Maqedonisë, të drejta të cilat askush nuk kishte argument të qëndrueshëm të thotë se dilnin jashtë të drejtave që i takonin një etniteti autokton në shtetin ku jetonte.

Gjatë një dekade të tërë, qarqet politike, intelektuale dhe publicistike shqiptare, theksonin se kushtetuta e shtetit ishte kornizë e cila thuajse ishte

bërë vetëm me një qëllim: që maqedonasit etnik ta kenë sa më gjerë, e të tjerët aq ngushtë sa mos ngulfaten tërësisht. Ata që ia donin të mirën këtij shteti, një dekadë me radhë përsërisnin se kjo kushtetutë prodhonte vetëm mosmarrëveshje, se thellë nën nenet e saj fshihej një “mosmarrëveshje” e madhe mes ambicieve të etnitetit maqedonas që me askënd të mos e “ndante” shtetformësimin – atë që u takonte të gjithë banorëve të këtij shtetit - dhe ambiciet e të tjerëve që donin shteti të jetë edhe i tyre. Pra, derisa qarqet shqiptare theksonin se janë të pakënaqura nga vendi të cilin ua përcaktonte kushtetuta e shtetit, qarqet politike, intelektuale, si dhe pjesa më e madhe e opinionit të këtushëm maqedonas, kushtetutën e kishin ngritur në lartësitë e “Biblës” së paprekshme. Ishin mbuluar me “shenjtërinë” e një dokumenti që e kishin shkruar një grup ekspertësh, e të cilët linin përshtypje si të kishin qenë mjeshtrë që duan të dëshmojnë se materiali nuk e përcakton ndërtesën, por e muruara e ndryshon materien e elementeve ndërtimore. Kështu që, kur shqiptarët pyesnin se si do zgjidheshin kërkesat e tyre kur “Bibla” thoshte “jo”, ata propozonin që të pritet kohë më e volitshme kur nuk do kishte nevojë të ndryshohet kushtetuta, por do ndryshonin lexuesit e saj. Që do të thoshte se edhe “Biblën” çdokush e lexonte ashtu siç i pëlqente dhe mbase edhe ishte shkruar në një formë që shumëçka të varej nga përkatësia etnike e lexuesit të saj, e jo nga fjalitë të cilat e përbënin.

Dhe shqiptarët jo se nuk pritën: ata që ishin

fëmijë dhjetëvjeçarë kur u soll kushtetuta e parë e Maqedonisë së pavarur, u bënë djelmosha me të drejtë vote, e u rritën, duke dëgjuar se i përkisnin popullit i cili vetëm “kërkonte” që tjetri t’ia jepte atë e cila ishte e tija. Fëmijët e etnitetit maqedonas, të cilët në kohën e mëvetësimit të shtetit nuk kishin më shumë se një dekadë jete, u rritën dhe u bënë për martesë duke dëgjuar të njëjtën melodi, por me nota të tjera – se si shqiptarët pandërprerë vetëm diçka “kërkonin” të marrin nga ajo që ishte vetëm e tyrja, se ata duhej gjithmonë të ishin dorëlirë e të japin. Pra, Maqedonia tashmë kishte rritur gjeneratat e atyre që ishin larguar nga një e vërtetë thelbësore kur bëhet fjalë për shtetet shumetnike, shumëkulturore e shumëreligjioze, për shtetet me koncept të qartë qytetare, e ku e drejta individuale është e pamundur të arrihet pa të drejtat kolektive. Maqedonia, pra, kishte rritur gjeneratat e dy etniteteve numerikisht më të mëdha – ato të etnitetit maqedonas dhe shqiptarët – me bindjen se të parët duhet të mbajnë gjithmonë dorën e djathtë të shtrirë për të dhënë, e shqiptarët gjithmonë me dorën e majtë të gatshme për të marrë. Apo thjeshtë, Maqedonia kultivonte gjenerata e “lypsarëve” të pa ngirë – shqiptarëve, dhe “dorëlirëve” zemërgjerë që ishin lodhur duke dhënë – maqedonasve etnik.

Në të vërtetë, jo se të rinjtë shqiptarë dhe ata maqedonas nuk ia bënë me dije shtetit se si edukoheshin ata të cilëve dikush ua harxhonte ardhmërinë. Ata dilnin rrugëve të Shkupit apo të Tetovës. Kështu që të rinjtë e etnitetit maqedonas

protestonin kundër hapjes së shkollave me mësim në gjuhën shqipe, madje edhe duke ngritur tenda përpara kuvendit republikan e duke bërë grevë urie. E nga ana tjetër, të rinjtë shqiptarë i vërshonin rrugët e Tetovës që të tregojnë se sa e nevojshëm u ishte arsimimi në gjuhën amtare. Në të shpeshtën e rasteve, të rinjtë e etnitetit maqedonas që protestonin, ishin të shoqëruar nga parlamentarët e ndonjë partie të tyre, dhe të shumtit nga ata që organizonin këto protesta, e kishin të siguruara karrierën politike në VMRO-DPMNE. Të gjitha ata filipat, milloshovskat, gjoçevskat..., në vitet e mëvonshme do bëhen politikan me karrierë që do marrin rroga mujore edhe nga taksat që do paguajnë moshatarët e tyre shqiptarë të cilëve dikur ua kishin kundërshtuar mësimin në gjuhën amtare. Ndaj protestuesve të rinj të etnitetit maqedonas, institucionet shtetërore do tregoheshin të kujdesshme, ndaj tyre do ishin aq të ndjeshme e të kujdesshme, sa i ftonin liderët e protestave t'i shpalosnin qëndrimet e tyre edhe nga foltoerja e parlamentit. Ndërsa, demonstruesit e rinj shqiptarë, të vetëm, duke mos pasur mundësi të komunikonin as me përfaqësuesit e vetë në pushtet, përballeshin vetëm kordonët e policisë. Kishte diçka që i bënte të njëjtë këta protestues të rinj: edhe njëra palë, edhe tjetra, në të vërtetë, në rrugë përcillnin atë që ua kishin mësuar prindërit e tyre, atë që dëgjonin nëpër shtëpitë e veta ku rriteshin, atë që prodhonte një sistem i dështuar arsimorë, apo vetëdijen të cilën një dekadë të tërë e kishin kultivuar mediat e këtushme, të cilat Maqedoninë e portretonin si dy-

ngjyrëshe; në “mbrojtësit” e shtetit - etnitetin maqedonas, dhe shqiptarët e pangishëm dhe jo mirënjohës.

Që ky portret i të mirëve dhe të këqijve të ishte më bindës, ishin vënë në shërbim “ekspert” të kategorive të ndryshme të dalë nga shkollat e mëparshme antishqiptare, të cilët shkonin aq larg sa edhe lajmet nëpër gazeta, i vinin në funksion që të dëshmojnë “destruktivitetin” e palës shqiptare. Kështu që për çdo hajdut, dilerë, narkoman... shqiptarë nuk harrohej pranë emrit dhe mbiemrit të shënohet edhe përkatësia etnike. Apo thjeshtë, disa nga mediat në gjuhën maqedonas u shndërruan në buletine të mosdurimeve ndëretnike, pasqyrë e të gjitha vetitë negative që i ka çdo popull, por ku thuajse kurrë nuk do botohet diçka për ndonjë të arrirë kulturore të shqiptarëve, apo çka do qoftë e pozitive nga ndonjë sferë tjetër e jetës. Shkurt, përdorej metoda e njohur se si një kolektivitetit të tërë mund ta portretesh si të “shëmtuar”: duke publikuar “fotografinë” ku shihen vetëm shëmtitë i ka çdo kolektivitet, e cila “foto” më në fund ngulet në kokë si “letër njohëse” për një popull të tërë. Nga ana tjetër, edhe mediat në gjuhën shqipe e këndonin të njëjtën këngë të shkurtëpamësisë: duke i amnistuar partiakët shqiptarë nga çdo përgjegjësi, dhe duke i shpallur si burim i së keqes kolektive vetëm qarqet politike dhe intelektuale të etnitetit maqedonas. Kështu pra Maqedonia rriti dhe edukoi disa gjenerata të rinjsh, të cilat jetonin në të njëjtën ujdhesë, por në botë paralele, që ndanin të njëjtën hapësirë, por

çdonjëri ngopej me frustrime të kundërta nga ai që bartte tjetri, që ishin nën përkujdesjen e të njëjtave institucione shtetërore, por nuk kishin shërbim të njëjtë nga ato.

Maqedonia e dekadës së parë si shtet i mëvetshëm, ishte shtet ku elitat politike bashkëpunonin shkëlqyeshëm sa i përket mbulesës së problemeve madhore, por etnitetet bëheshin gjithnjë e më të largët mes veti. Mu kjo largësi maqedonase – shqiptare, ua mundësonte elitave politike që të mbulojnë vetveten për mospjekjet në sferën e ekonomisë dhe papunësisë së madhe. Pra, elitat partiake, “të vëllazëruara”, të gatshme që edhe të sotmen e shtetit ta lënë që qytetarët ta jetonin në të ardhmen, më lehtë e kishin të shtonin mjegullën e animoziteteve ndëretnike mbi shtet. Sepse vetëm kjo mjegull ua mundësonte të fshihnin atë që duhej parë me kohë: se “lagështia” që i mykte muret e Maqedonisë, nuk vinte nga “rreziku shqiptarë”, por nga se elitat politike dhe intelektuale nuk kishin as vullnet, as guxim politik t’i zgjidhnin problemet ndëretnike, të cilat sa vinin dhe shtoheshin. Nuk kishin, pra, as vullnet dhe as guxim politik të dilnin përpara shqiptarëve e t’u tregonin se sa duhej të prisnin që të realizoheshin kërkesat e tyre, të cilat askush nuk i kontestonte. Të rinjtë shqiptarë askush nuk i ftoi në parlamentin republikan që atje dikush t’ju shpjegonte se kush ishte ai që duhej t’ua zgjidhte problemet. Andaj edhe sa herë që burrshtetasve apo partiakëve të asaj kohe u haste sharra në gozhdë, ata i nxirrnin në rrugë të rinjtë sa ta trembnin popullin të

heshte e të thoshte: “ule kokën, se ka edhe më keq”.

E jo se nuk kishte edhe më keq se e keqja e cila e mundonte Maqedoninë. Në shumë hapësira ballkanike asokohe zhvilloheshin luftëra, shfaroseshin myslimanët e Bosnjës, shqiptarët në Kosovë rënkonin nën thundrat e policisë dhe armatës së Jugosllavisë së Millosheviqit. Kështu që Maqedonia e asokohshme dukej si një “oazë” e çuditshme ku në paqe jetonin dy etni, të cilat thuajse asgjë nuk i bashkonte, përpos pakënaqësia e ndërsjellë: maqedonasit etnik të pakënaqur shkaku i bindjes se çdo e keqe u vinte pse kishin “disfatën” të ndërtonin shtet me shqiptarët, e shqiptarët duke u ndje sikur ishin nën sundimin e ndonjë “millosheviqi” të padeklaruar si i tillë.

Nga mjegulla e marrëdhënieve të acaruar ndër-etnike, rrallëkush shihte se në të vërtetë “oaza e paqes” nuk kishte asgjë të përbashkët me atë emërtim që mburshëm ia kishte vënë Gligorovi, por më shumë i ngjante një burimi të pashtershëm pakënaqësish ndër-etnike. Gjatë dhjetë viteve të paqes së rrejshme, Maqedonia më shumë i ngjante një pushimoreje ku maqedonasit etnik dhe shqiptarët ishin ulur dhe prisnin të shohin se si do t’ia dalin të tjerët në luftërat e përgjakura, që pastaj edhe ata të vendosnin ç’rrugë do marrin. Më në fund, thuajse deri në mesin e dekadës së nëntë të shekullit të njëzet, shumë qarqe maqedonase ende shpresonin se Millosheviqi do ia del t’ua thyej boshtin kurrizorë të gjithë të tjerëve, e veçanërisht kosovarëve, e nga ana tjetër shqiptarët e Maqedonisë, ende nuk e kishin

gjithaq me rëndësi hallin se ç' do bëhej me ta, sa atë se ç'ka do ndodhte me plagën gjithëshqiptare - Kosovën. Dhe mbase ky moment ishte ai që kishte vënë “baraspeshën” mes dy nacionalizmave më dominant në Maqedoni, baraspeshën që nuk lejonte të tejkalohet kufiri dhe nga grindja verbale të shkohej drejt ndonjë konflikti ndëretnik të cilin asokohe edhe e stimulonte Beogradi. Thënë ndryshe: maqedonasit etnik dhe shqiptarët, rrinin “urtë” sepse e kishin prapanicën cullak. Dhe nga do që atë ta kthenin, ajo u mbetej e pambrojtur dhe e rrezikuar. Ata e dinin se cili do konflikt ndëretnik në Maqedoni, do u shërbente disa fqinjëve që këtë shtet, përfundimisht ta fshinin nga harta e botës.

Për një dekadë të tërë, Maqedonia nuk kishte bërë gjë tjetër përpos që u shndërrua në kënetë zënkash ndëretnike ku njëra palë – ajo e etnitetit maqedonas- mbronte “Biblën” të cilën nuk kishte burrë që mund ta prekte, dhe ajo tjetra – pala e etnitetit shqiptarë – që thoshte se, ose Maqedonia do bëhet shtet i etnive të barabarta, ose ata do “ndërronin strategjinë e veprimit”. Dhe e keqja e Maqedonisë qëndronte aty se politikanët nuk e deshifronin mirë këtë porosi që ua përcillnin shqiptarët dhe maqedonasit etnik, se ata mendonin se këto zënka një ditë do bëheshin beton i cili do sforconte themelet e shtetit. Aq më shumë, duke u propozuar shqiptarëve të prisnin kohë më të mira për kërkesat e tyre, politikanët maqedonas donin të blinin kohë, duke mos parë se ia harxhonin të ardhmenë këtë shtet. Këtë nuk e shihnin as partiakët shqiptarë, të



cilët mendonin se koha nuk kalon nëse ke arsytetime pse nuk i realizonin premtimet, nëse u thua shqiptarëve atë që ata e dinin: se kushtetuta e shtetit nuk lejonte mundësi të flitej për barazi arsimuese, gjuhësore e bile edhe sociale.

Pra, as politikanët e etnitetit maqedonas, e as ata të partive shqiptare, nuk e lexonin drejtë orën e bardhë të rrjedhave shoqërore, nuk e shihnin se Maqedonisë prej moti ia kishin harxhuar kohën për të pritur, se shqiptarët bëheshin gjithnjë e më të padurueshëm, se ishin lodhur nga mbrojta e interesave të veta nëpër rrugë, se nuk kishin më ç'farë argumenti të përdorin që ta dëshmonin se në këtë shtet shumëçka dukej e zhvendosur: nëpër autobusë dhe rrugëve i gjeje shqiptarët çdo kund, por nëpër institucionet shtetërore më parë mund të hasje në ndonjë ari polar, se sa në ndonjë administratorë shqiptarë. Dhe i vetmi vend ku ata ishin denjësisht të përfaqësuar - bile në përqindje thujse ishin populli dominues në Maqedoni - ishte burgu në Idrizovë, si dhe në ndërmarrjet komunale për pastrimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen e parqeve të qyteteve. Apo thënë më saktë, në dekadën e nëntë të shekullit të njëzetë, punësimi i shqiptarëve, si për shembull në polici, armatë dhe nëpër institucionet tjera shtetërore dhe sipërmarrjet publike, nuk e tejkalonte as 2%. Apo ai i studentëve shqiptarë të regjistruar në të gjitha vitet dhe në të gjitha fakultetet e universiteteve shtetërore, edhe atë gjatë gjithë dekadave të mëparshme, nuk ishte as aq sa numri i të rinjve të etnitetit maqedonas që diplomonin vetën gjatë në një

viti shkollor, edhe atë në një fakultet të vetëm.

Kështu që shqiptarët ishin jashtë institucioneve shtetërore. Ata as që e njihnin shtetin se si ishte organizuar nga brenda. Kishin mbetur jashtë “mureve” të “kalasë”, nuk i ndjenin si të vetat institucionet shtetërore, kështu që tingëllonin absurde edhe akuzat e qarqeve të etnitetit maqedonas pse ata kishin zgjedhur “demokracinë e rrugës” për t’i realizuar të drejtat e tyre. E të gjithë e dinin se shqiptarët ishin qytetarë që qëndronin të përkulur nga kjo anë e sporteleve, ndërkohë askund nuk i gjeje matanë xhamit ku qëndronte administrata shtetërore. Kjo binte në sy edhe në vendbanimet ku përqindja e banorëve shqiptarë ishte dominuese, si për shembull në Tetovë e Gostivar. Institucionet shtetërore, shqiptarët i njihnin nëpërmjet intervenimeve policore, kështu që atyre thuajse u ishte mbushur mendja se dialogu demokratik, të cilin ata donin ta zhvillonin me shtetin, në të vërtetë i ishte lënë në duar vetëm një nga ministrive qeveritare – asaj të policisë. Pra, thuajse një dekadë të tërë, dialogu mes shtetit dhe shqiptarëve në Maqedoni zhvillohej nëpërmjet kordonëve policore. Andaj edhe lirisht mund të thuhet se nuk është e vërtetë se konflikti i 2001 nisi në muajin mars, të po këtij viti, me krismat e para në fshatin Tanushë në kufi me Kosovën. Aty ai vetëm dha zë, shpërtheu, se përndryshe konflikti politik maqedonas - shqiptarë kishte filluar qysh nga dita kur Maqedonia shpalli pavarësinë e saj. Në Tanushë vetëm u bë e ditur se shqiptarët e kishin kuptuar se duhej ta ndërronin

strategjinë e veprimit, se koha për pritje ishte harxhuar, se kësaj radhe ata ishin të gatshëm të pranonin edhe mënyrën e dialogut që ua impononte me vite shteti i tyre: atë me kordonët e armatosur policor.

Pra, “konflikti” kishte filluar qysh ditën kur Maqedonia shpalli pavarësinë, kushtetutën dhe referendumin për pavarësi pa pëlqimin dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve. Më në fund, edhe shampanjën për pavarësinë e shtetit në sheshin e Shkupit, burrështetasit maqedonas e pinë pa pasur pranë vetes asnjë shqiptarë që edhe me të t’i cakërronin gotat për jetëgjatësinë e shtetit. Por, asokohe shqiptarët ende shpresonin se me hyrjen e partive të tyre nëpër institucionet më të larta shtetërore, diçka do ndryshonte. Shqiptarët nuk kishin edhe pse të mos i besonin thënies se nuk mund të korrigjoheshin brenda natës gabimet që ishin bërë me dekada. Pastaj ata e dinin se shumë nga problemet, ishin të trashëguar nga e kaluara. Por ata habiteshin se si ishte e mundur ajo “natë” të zgjaste dhjetë vite, dhe si ishte e mundur që edhe përfaqësuesit e tyre aq lehtë të pajtoheshin se “Bibla” gjithmonë do mbetej e paprekshme, se partiakët e tyre gjithmonë do arrijnë të vijnë e të largohen nga pushteti me premtime të kota, duke përdorur pakënaqësinë e popullatës së vet që të ngjiten në pushtet, pra duke shkuar në pushtet nëpërmjet protestave për Universitetin Tetovës, e që pastaj të ofrojnë projekte tjera më “proevropiane”. Me çka ndoshta edhe ia bënin popullit të vet përbuzjen më të madhe: e bënin të duket përpara tjerëve si

kope e cila shpjet gënjehet dhe shumë më lehtë harron.

Që nga viti i mëvetësimit të saj, Maqedonia i ngjante kashtës së lagshtë, e të ndezur, të cilës i duhej kohë që të lëshoj flakë. Kashtë e cila ashtu e mykur nga lojërat ndëretnike të elitave të këtushme partiake, tymonte ngadalë dhe e mbulonte shtetin duke ua mundësuar kështu “pronarëve” politik, t’i fshihnin prej popullit të gjitha veprimet që elitat e këtushme politike i çonin drejtë udhës të bëheshin kapitalistë të pasur. Thujse një dekadë të tërë, askush nuk e përfillte rrezikun nga ky zjarr i kallur nga xixat e rrezikshme të mosdurimeve ndëretnike. Më në fund, mosdurimi ndëretnik u bë “biznes” fitimprurës si për politikanët, po ashtu edhe për “analistët” dhe “intelektualët e pavarur” të kategorive të ndryshme, që bënë emër dhe famë duke shkruar dhe analizuar “marrëdhëniet ndëretnike”. Apo thënë më qartë: duke zberthyer “rrezikun shqiptarë”. Dhe nga dita në ditë, gjithnjë e më i thellë bëhet hendeku, i cili ndante elitat e etnitetit maqedonas që ishin mospërfillëse ndaj kërkesave të shqiptare, dhe të atyre shqiptare, të cilave gjithnjë e më shumë u ngushtohej hapësira për të arsyetuar tërë atë inferioritet ndaj palës së etnitetit numerikisht më të madh në Maqedoni.

Thujse tërë dekadën e nëntë të shekullit të njëzet, Maqedonia e kishte humbur diku në zhurmën e debatit ndëretnik, që shkurtazi mund të përshkruhet si britmë e dy grupeve, të cilat qëndrojnë në anë të kundërta të bregut, dhe fajësojnë

njëra tjetrën për mosndërtimin e urës. E në ndërkohë, as që dëgjohej mes veti, sepse ishin larguar aq sa jehona humbiste në thellësinë e mosmarrëveshjeve të thella, duke e bërë etnitetin maqedonas të mendonte se kishte ndërtuar shtetin më demokratik në botë, e shqiptarët ishin të bindur se prej një torture “sllavokomuniste”, kishin rënë në kthetrat e një padrejtësie “maqedonodemokratike”. Në ndërkohë, edhe te njëra edhe te tjetra palë, nuk kishte politikanë të denjë e vizionarë, që dinin të ndërtojnë ura, që kishin guxim të flijojnë popullaritetin e të sotmes i cili u sillte vota, për të ardhmen që shtetit do i garantonte stabilitet dhe harmoni qytetare. Pra, Maqedonisë i mungonin elita që e dinin se urat janë objekte më të ndërlikuara për ndërtim, se ato duhet të jenë elastike, se përpos që duhet ta bartin vetveten, duhet të mbajnë edhe peshën që kalon mbi to.

Pakënaqësia e shqiptarëve u bë shumë fitimprurës edhe për partitë e kësaj popullate: ajo ato i sillte në pushtet, ku askush më nuk ua pengonte përfitimet personale dhe punësimin e anëtarëve më të afërt partiak. E që më vonë, kur jehona e krismave në Tanushë arriti deri në Shkup, të gjithë së bashku, politikanë të majtë e të djathtë, shqiptarë dhe ata të etnitetit maqedonas, intelektual dhe publicistë, të shtrojnë pyetjen absurde: kujt i nevojitet konflikti, a mundej Maqedonia të shpëtonte pa krismat e 2001? Apo shumë nga ata që ndërtonin opinionin vendorë, t’i çojë ngutshëm të sjellin përfundimin se këto krisma të ardhura nga ky fshat ndërkufitarë nuk shpreh-

nin revoltën shqiptare, por atë të trafikantëve dhe kriminelëve të kësaj popullate?! Dhe kjo ndodhte, mbase, shkakun se këtu me vite ishte ndërtuar bindja se shqiptari i “ndershëm” është vetëm ai që pret dhe i cili mban kokën ulur. Duke harruar në ndërkohë se ka të vërtetë në atë se thujse çdo vendbanim ndërkufitarë në botë, si për shembull edhe shumë nga ato mes Gjermanisë e Zvicrës, mes Meksikos dhe Amerikës..., janë “biruca” nga hapin derën ata që nuk mund të hyjnë nëpërmjet “portës” së madhe, por njëkohësisht, nëpërmjet këtyre vendeve më së lehti vlerësohet stabiliteti i një shteti, si dhe funksionimi i institucioneve të një shoqërie.

Krismat në Tanushë, opinionin maqedonas i priti me të njëjtën bindje dhe vetëbesim siç i kishte pritur vite me parë të gjitha kërkesat të cilat u vinin nga shqiptarët, qofshin ato kërkesë të shkruar në letër, apo të shprehura zëshëm nëpërmjet protestave: me bindjen se edhe kësaj radhe shqiptarët do e hanë dajakun dhe do tërhiqen!. Por, kësaj radhe nuk e kishin vlerësuar mirë, nuk e kishin parë me kohë se gota e durimit ishte stërm bushur. Andaj edhe të kota ishin orvatjet që e tëra t’u përshkruhet grupeve kriminale, dhe revolta e të rinjve shqiptarë të përdoret për opinionin e jashtëm edhe si një argument se shqiptarët në të vërtetë nuk kishin probleme me institucionet e shtetit, por me shoqërinë e vet të kriminalizuar. Mbase kjo dëshirë e tyre aq i kishte verbuar qarqet politike, intelektuale dhe mediatike të etnitetit maqedonase, sa të mos vërejnë se në ndërkohë të rinjtë shqiptarë

masovikisht kishin veshur uniformat e UÇK-së dhe kishin dalë nëpër malet e Maqedonisë. Por, edhe pasi ndodhi kjo, të njëjtat qarqe të etnitetit maqedonas vazhduan të aktrojnë rolin e viktimës, të një viktime të çuditshme që ankohej se dikush pa merita të tyre donte t'i fuste në vorbullën e luftës, se konflikti ishte mall i huaj – i ardhur nga Kosova – duke mos ia shtruar vetes pyetjen më të logjikshme dhe më elementare në situata të tilla: edhe sikur të ishte ashtu siç vlerësonin ata, atëherë pse Maqedoni kishte lejuar të bëhet arë pjellore në të cilën nga disa krisma do mbinte aq lehtë fara e luftës?

Pas krismave të para në Tanushë, një gjë u shpalos sikur ta kishte marr me vete era e lehtë e asaj pranvere të hershme - institucionet shtetërore, të cilat me plot arrogancë dhe mospërfillje vazhduan sipas avazit të vjetër: nuk donin të pranojnë asnjë farë bisede me shqiptarët e rebeluar duke thënë se dialogu duhet zhvilluar nëpër institucionet shtetërore dhe me metoda demokratike. Shteti maqedonas asokohe hapur e mbronte qëndrimin se me shqiptarët do bisedonte pasi ata t'i gjunjëzonte dhe t'i mposhte me armë. Disa qarqe të këtushme intelektuale këshillonin pushtetmbajtësit që së pari të ngulte flamurin shtetërorë në të gjitha fshatrat nga dëgjoheshin krismat, e pastaj të bisedohej për kërkesat e tyre. Këtë e përkrahën asokohe edhe kryesuesit e PDSH-së, të cilët atëherë ishin pjesë e koalicionit qeveritarë të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja. Ja se ç'shkruan Mirjana Malevska në tekstin e saj me titull "Ballafaqime të dhembshme" të

botuar në “New Balkan Politics”, lidhur me fillimin e konfliktit në Maqedoni: “Kur nga fundi i shkurtit, në fshatin kufitar Tanushë, për të cilin deri atëherë shumica e qytetarëve të Maqedonisë as që e dinin se ekziston, u vranë tre ushtarë të armatës së Maqedonisë, me çka edhe filloi kriza, koalicioni qeveritar i kryeministrit L. Georgievski, si dhe parlamenti, i dënuan “grupet e armatosura ekstremiste” dhe kërkuan ndihmë të huaj ushtarake. Opinioni ishte i trembur, i hutuar dhe i papërgatitur për atë që e priste, dhe duhet të thuhet se në atë moment liderët politik shqiptarë treguan një shkallë të lartë të lojalitetit. Në këtë kontekst është deklarata se, nëse duhet do mbrohet integriteti territorial i Maqedonisë...”.

Pa dyshim se Malevska ka të dejtë kur konstaton se opinioni i këtushëm ishte i hutuar. Sepse ai ndodhej në mes të mjegullës politike dhjetëvjeçare, gjatë së cilës i kishin bindur të besojnë se jetonte në “oazë të paqes”. Ajo me të drejtë e lavdëron edhe lojalitetit e politikanëve shqiptarë. E si mundeshin të mos jenë lojal kur e dinin se krismat në Tanushë ishin edhe rezultat i aktivitetit të tyre të dyfishtë: të radikalizojnë popullin gjatë fushatave parazgjedhore, e ta qetësojnë pasi vinin në qeveri. Dhe nga këto “tkurrje” e “zgjerime” të ndjenjave të tyre, shqiptarët më ishin bërë të pandjeshëm ndaj asaj që ato ditë e thoshin liderët e tyre. Atyre më nuk u bënë përshypje as deklaratat fillestare të Arbër Xhaferit kur thoshte se ata që kishin marrë armët ishin “rambo” që nuk e dinin se dëmtojnë çështjen shqiptare. Apo



thënien e një ministri të atëhershëm i cili ata që i morën të parët armët në duar, i vlerësoi si “qenin e keq, që ta sjell ujkun në stan”. Për shqiptarët nuk vlenin gjë as deklaratat arrogante të udhëheqësve të PDSH-së, se shteti do mbronte sovranitetin e vet me të gjitha mjetet, e as ngutja e Georgievskit që të blinte sa më shumë armë nëpër shtetet fqinje si dhe në Ukrainë e Bjellorusi.

Sa u përket partiakëve të PDSH-së, ata shumë shpejtë do i harrojnë deklaratat fillestare dhe ngutshëm do bëjnë çmos që sa më shumë t’i afrohen Ali Ahmetit. Sepse në ndërkohë ata e panë se jo vetëm që kishin mbetur kukulla që askush nuk i përfillte në institucionet qeveritare, por edhe pa anëtarët partiak, të cilët në numër të madh kishin shkuar në njësitë e UÇK-së. Kështu që, thujse brenda një muaji, UÇK-ja ishte bërë përfaqësuese e vetme legjitime e shqiptarëve të Maqedonisë. Partitë e shqiptarëve ishin humbur diku në fjalët boshe, të cilat ia kishin thënë popullit gjatë një dekade. As partitë shqiptare e as ato të etnitetit maqedonas, nuk mundeshin më të fshiheshin pas asaj të cilën Mirjana Malevska e vlerëson si kotësi dhe “floskulë “ të thjeshtë, e që kishte të bëjë me deklaratat se dialogu kurrë nuk ishte ndërpre dhe kishte zgjatur dhjetë vite me radhë. Arsyeja se pse pushteti maqedonas nuk donte assesit të bashkëbisedojë me “terroristët” – arsye e përkrahur thujse nga të gjitha qarqet politike dhe intelektuale të etnitetit maqedonas – ishte ajo se pa një fitore të plotë mbi “terroristët”, shteti do duhej t’i pranonte të gjitha gabimet e veta

të mëparshme. Andaj kjo u bë kërkesë pas të cilës qëndronin edhe institucionet shtetërore, mirëpo edhe “mendimtarët e lirë” të etnitetit maqedonas. Lidhur me këtë qëndrim të tyre, Malevska thekson se ai ishte “arsyetimi më i dashur jo vetëm i politikanëve, por edhe i intelektualëve maqedonas, e me qëllim që t’i iket cilit do ndryshim në drejtim të pjesëmarrjes më të madhe të shqiptarëve në “ndarjen e forcës”. Me këtë dhanë kontribut të turpshëm në thellimin e krizës.”

Dhe kështu kriza u thellua aq sa Maqedoninë e solli buzë greminës së konfliktit ndëretnik, aq sa vorbulla e konfliktit lehtë mund ta ngulfaste këtë shtet, i cili mbase sipas shumë parametrave më shumë i ngjante një “kreature” shtetërore, se sa një shteti të ndërtuar mbi një projekt të qartë. Përderisa qarqet e etnitetit maqedonas mundoheshin çdo gjë ta hedhin në hapësirën e kriminit dhe të kontrabandës, Arbër Xhaferi tashmë kishte heq dorë nga vlerësimi se shqiptarët e armatosur ishin “rambo”. Emërtim i cili nëse zbërthehej siç duhet, do të thoshte se ata që filluan konfliktin në Maqedoni, duhej të ishin “trima” abdallenj të frymëzuar nga filmat amerikan, të cilët, nga bezia se nuk kishin ç’të bënin me vetveten nëpër kafenetë, kishin dal maleve të Maqedonisë që pak të zbaviteshin dhe rrugës t’ua prishnin rehatinë pushtetarëve të këtushëm. Mbase edhe kjo bindje e pushtetarëve shqiptarë në qeverinë maqedonase, do e çojë në rrugë të gabuar Georgievskin: të besojë se pas vetes i kishte shqiptarët e “ndershëm”, se numri i tyre duhej të

ishite dominues, se bëhej fjalë për “banda” të cilat mund të gjunjëzoheshin nga disa njësite policore të armatosura mirë. Apo që edhe mund të bliheshin me disa miliona marka gjermane. Më në fund, kush mund të besonte asokohe në Maqedoni se “robi” mund t’i kundërvihet “pronarit”, se shqiptarëve u kishite ikur frika nga policët maqedonas, të cilët mbase ishin të guximshëm vetëm kur përballeshin me protestues të paarmatosur e të pambrojtur.

E në ndërkohë, fronti zgjerohej, krismat jehonin që nga fshatrat e Likovës e deri në rrëzat e Sharrit në Pollogë. Pushtetarët e PDSH-së, të gjetur në çelcirë, duke parë se lojërat politike me zgjedhësit shqiptarë më kishin marrë fund, e kuptuan se u kishite rënë në hise të paguanin gjithë llogarinë edhe për gabimet e pararendësve të tyre, të cilët njësoj si edhe ata, kishin ardhur në qeveritë e Branko Cërvenkovskit me plotë llafazani, e nga pushteti ishin larguar të heshtur dhe të vetëkënaqur shkaku se ishin bërë “kapitalistë” të pasur. Në ndërkohë, Ali Ahmetit, i cili kishite hyrë në Maqedoni duke mos pasur nevojë të ketë pasaportën e këtij shteti, i kishite rënë në hise t’i jepte drejtimin e duhur revoltës dhe frustrimit të rinisë së këtushme shqiptare.

Revolta e pushtetarëve të PDSH-së nga këto krisma, do jetë e madhe. Ata kishin të drejtë të jenë më të pezmatuar se partiakët tjerë shqiptarë jo vetëm shkaku se kjo u ndodhte në kohë kur posa ia kishin marrë dorën “maunokracisë”, por edhe shkaku i një arsyeje tjetër: nuk ishin të vetmit që kishin nxitur radikalizmin te shqiptarët, dhe nuk ishin të vetmit

që e kishin lëvruar atë arë ku i papenguar do vinte Ali Ahmeti me bashkëluftëtarët e vet. Ata nuk ishin të vetmit, por mbase ia vunë kulmin revoltës së shqiptarëve të rinj që aq shumë prisnin nga Arbër Xhaferi, i cili mbase edhe shkaku i kësaj pritjeje të madhe, ishte i dënuar të dështojë. Ata shumëçka prisnin nga ai, por më së paku prisnin atë që ua ofroi partia të cilën ai udhëhiqte: terrin informativ, punësimin e anëtarëve më të dëgjueshëm partiak, fillimin e “rrugaçërimit” të aktivitetit partiak, duke forcuar jo kokën, por muskujt e partisë, shpalljen si “tradhtarë” dhe “spiunë” të Millosheviqit cilindo që asokohe guxonte të thotë edhe ndonjë mendim më të kujdesshëm kritik ndaj PDSH-së dhe qeverisë së Georgievskit. Tërë këtë, PDSH-ja asokohe e realizonte nëpërmjet mediave të pakta në gjuhën shqipe, siç ishte programi në gjuhën shqipe pranë Radio Televizionit të Maqedonisë dhe gazetës së përditshme “Fakti”, e cila asokohe u bë “gazetë muri” e PDSH-së. Në këtë gazetë “të pavarur” – si në kohën e Enver Hoxhës – publikoheshin emrat e shqiptarëve të dyshimtë dhe të dëmshëm për popullin. Dhe mu “pavarësia” e kësaj gazete e viteve sa ishte PDSH-ja pjesë e qeverisë së Georgievskit, është pasqyra më e saktë e veprimit “demokratik” të partisë së Arbër Xhaferit. Andaj edhe kompletet e kësaj gazete të viteve 1998-2002, janë pjesë e rrëfimit për rrjedhën e asokohshme të demokratizimit të shoqërisë shqiptare në Maqedoni. Ato kompletet rrëfejnë për një kohë kur, duke festuar daljen nga diferencimi ideologjik komunistë në shqiptarë të

ndershëm e të pandershëm, shqiptarët e Maqedonisë nuk e kishin vërejtur se edhe PDSH-ja i çonte drejtë rrugës së një diferencimi edhe më të ashpër dhe njësojë të pashpirt se ai i dikurshmi i njëmendësisë, por vetëm me atë dallim se tani shqiptarët në mes veti ndaheshin në “patriotë” – të dëgjueshmit e PDSH-së – dhe gjithë të tjerët, të cilët, nëse nuk i nënshtroheshin kreut partiak të PDSH-së, nuk mund të shpëtonin e të mos merrnin etiketën e tradhtarit, apo spiunit të Milloshqeviqit. Kur shqiptarët e Maqedonisë e hetuan këtë, Ali Ahmeti kishte ardhur, andaj atyre edhe nuk iu kishte mbetur ndonjë zgjidhje e madhe: o duhej të vishnin uniformën e UÇK-së, o duhej të mbanin në krahë “yllin e davidit” të ndasive ndërpartiake shqiptare.

Pra, pakënaqësia e shqiptarëve të Maqedonisë e grumbulluar një dekadë me radhë, shpërtheu në vitin kur PDSH-ja ishte pjesë e qeverisë. Që kjo të ndodhte me 2001, ndikonin shumë faktorë. Si ai që u pa ashiqare - se as Arbër Xhaferi nuk do arrinte askund më larg se pararendësit e tij që kishin qenë pjesë të koalicionit qeveritarë. Në ndërkohë ishte çliruar Kosova, kështu që shqiptarët e këtushëm kishin më shumë kohë të merreshin me fatin e vet. Dhe njëkohësisht edhe politikanët e këtushëm, të mbetur pa problemin e Kosovës me të cilin me vite e mbulonin mosveprimin e tyre në Maqedoni, tani ishin në çeltirë dhe nuk mundeshin aq lehtë të arsyetoheshin për mosrealizimin e premtimeve të dhëna nëpër mitingjet parazgjedhore. Më në fund, shqiptarët tani kishin kohë më kujdesshëm të

numërojnë: në parlamentin republikanë kishte njëzetetë deputetë shqiptarë, që së bashku me partnerët e koalicionit qeveritarë ku ishte pjesëtar edhe PDSH-së, arrinin një numër sa mund të ndryshonin edhe kushtetutën për të cilën Arbër Xhaferi me të drejtë thoshte se është pengesë për t'u realizuar disa kërkesa shqiptare. Ky numër i çonte shqiptarët të shtronin pyetje të logjikshme: pse PDSH-ja nuk bënë asnjë hap për ta ndryshuar kushtetutën e shtetit?! Por duhet thënë se mbase këtë nuk do arrinte ta bëjë me mjete demokratike asnjë forcë politike shqiptarët e Maqedonisë. Edhe atë shkaku se asnjë nga partitë e etnitetit maqedonas nuk mund ta prekte atë që me vite vet ata dhe mediat e kishin shpallur përpara popullit si diçka të paprekshme. Kështu që më nuk kishte vesh që do dëgjonte vërejtjet e qëllimshme se demokracia është proces, njësojë si edhe zhvillimi i një shoqërie, se ai ligj apo ajo kushtetutë që aprovohet sot, nesër mund të pësojë ndryshime. Dhe më absurde ishte ajo se mbrojtës më të "denjë" të saj ishin hartuesit, e të cilët menjëherë pas konfliktit të 2001, do e bindin popullin se të gjitha ndryshimet që do i pësojë kushtetuta, janë në të mirë të Maqedonisë. Këtë ata mund ta thoshin sepse Maqedonia kurrë nuk pati aso populli që do i pyeste: nëse na qenka kështu, atëherë pse dhjetë vite me radhë thoshit të kundërtën, pse ndryshimet kushtetuese që kërkonin shqiptarët i ndërldhnit me vet fatin e shtetit, pse këto ndryshime nuk i bëtë me kohë që të mos vinim deri te 2001, pse...?!

Pyetjet janë të panumërta. Dhe shpesh ato

shpalosin gjeografinë mentale të atyre që i shtronin pyetjet. Shumë nga pyetjet të cilat shtronin qytetarët e Maqedonisë në vitin 2001, ishin të vonuara. E vonuar dhe paksa jologjike do tingëllojë edhe pyetja e cila vite të tëra pas konfliktit do qarkullojë mbi qiellin politikë të Maqedonisë, e që është ajo e shumë përmendura edhe më lartë: se a ishte e domosdoshme lufta e 2001? Dhe duhet përsëritur se kjo, si edhe shumë pyetje të tjera, duheshin të shtroheshin vite më parë, në kohën kur nuk ishin të rralla zërat që thoshin se rrugës nga është katandisur Maqedonia, nuk do mund të arrij më larg se në vitin 2001. Apo që nënvizonin, se ai që donte destabilizimin e këtij shtetit, nuk duhej të bëjë asnjë veprim të veçantë, përpos ta lus Zotin që politikanët e këtushëm të vazhdonin me lojërat ndëretnike, dhe të faleshin e luteshin që ky shtet të vazhdonte të ndërtohej nga mura të cilët shtetit ia vunë kulmin pa ia betonuar siç duhet themelet. Gjë që do e dëshmojnë edhe vitet e paskonfliktit, kur shumë ekspertë të këtushëm, do mundohen ta zbërthejnë këtë konflikt duke përballur argumente të kundërta, të cilat mbetën aq të largëta sa edhe vetë maqedonasit etnik dhe shqiptarët.

Në Maqedoni do përfolej shumë edhe projekti “Të kuptuarit e historisë së sotme”. Ky projekt, i përfunduar qysh në vitin 2006 - sipas realizatorëve – duhej të krijonte modele për bisedimet lidhur me ngjarjet e vitit 2001, kur u dëgjuan krismat e para në fshatin Tanushë, në afërsi të Shkupit dhe kur filloi konflikti disamujorë, i cili përfundoi me

Marrëveshjen e Ohrit. Qëllim përfundimtar i këtij projekti ishte edhe kompletimi i librit të përbashkët historik për këto ngjarje, nga i cili do të mësonin shkollarët e të gjitha etnitetëve që jetojnë në këtë shtet. Për realizimin e këtij projekti ishin angazhuar dy organizata joqeveritare dhe dhjetëra profesorë shqiptarë dhe maqedonas të historisë. Të cilëve askush nuk mund t'ua mohonte vullnetin e mirë, por shumëkush nuk e kishte të qartë se si do e ndriçonin të vërtetën, kur dokumentacioni lidhur me këto ngjarje ende ishte i mbyllur për ata që donin të gjurmojnë të vërtetën. Andaj edhe mbetej përshtypja se realizatorët e ngutshëm të këtij projekti, thuajse donin që librat e historisë t'i zbresin në nivelin e përmbledhjeve me shpjegime të pranueshme për të dy palët - atë të etnitetit maqedonas dhe për shqiptarët - e jo nga arkivat ku ishin të mbyllura dokumentet dhe dëshmitë.

Të pretendojë të ndërthurësh të vërtetën e dyfishtë për ngjarjet e 2001 - atë të etnitetit maqedonas dhe atë të shqiptarëve - edhe atë në vitet kur ende nuk ishin shëruar plagët e marra nga konflikti, ishte njësoj sikur të vetgënjeshe se mund të ndërtoje përmendore të përbashkët në lavdi të këtij konflikti, e para të cilës do të përkuleshin edhe maqedonasit etnik që lavdëronin "shtetëmbrojtësit" e tyre, edhe shqiptarët që thurnin këngë për "çlirimtarët" e vet. Apo, i ngjante orvatjes që të shpëtosh të vërtetën e cila ishte gjetur në mes të fushëbetejës ku zhvillohej sulmi i pa kompromis i dyanshëm në mes të rrëfimeve diametralisht të kundërta



etnike lidhur me konfliktin. Pra, kjo orvatje ngjante sikur të qëndroje mes “zjarrit” të rrëfyesve të cilët kishin shpalosur flamurin e të vërtetave të veta etnike dhe as që donin t’ia dinë për faktet, të cilat këtë shtet më të ri të Ballkanit e sollën një hap pranë humnerës së luftës ndëretnike.

Të ndryshoje qasjen historike e cila mbështetet vetëm mbi dokumente, dëshmi, fakte dhe distancë kohore, të shkruaje të vërtetën për konfliktin e 2001 pa pasur në duar dosjen complete të quajtur “Mëvetësimi i Maqedonisë” – duke filluar nga qëndrimi diametralisht i kundërt lidhur me mbajtjen e referendumit për shpalljen e pavarësisë, miratimin e Kushtetutës së parë pa pëlqimin e shqiptarëve, ndriçimin e ngjarjeve lidhur me Universitetin e Tetovës, atë të Gostivarit...- mund të ishte çdo gjë tjetër, por jo edhe libër historik. Apo, mund të ishte kontribut që do dëshmonte qëllimin e mirë të atyre, të cilët nëpërmjet projekteve socio-psikologjike donin të kultivonin vetëdije publike e cila pa ngarkesa etnike do të përballet me të vërtetat, por jo edhe projekt që ka të bëjë me historinë. Më në fund, sikur historia të përbëhej nga dëshirat e mira të autorëve të saj, ajo as që do të përmbante kaptina me konflikte të përgjakura ndërnjerëzore, por do të ishte e mbushur vetëm me ditë festive. Nga librat e historisë të arnuar me projekte të lartpërmendura – socio-psikologjike – në Maqedoni mund të arrihej vetëm një efekt: ti nxiste pjesëmarrësit në konfliktin e 2001 që sa më parë t’i përfundonin librat e tyre “të bardhë”, në të cilët do të mungonin shumë të dhëna

të sakta, por jo edhe heroizmi dhe patriotizmi i autorëve. Pra, ky projekt mund ta inicionte edhe liderin e PDSH-së që më në fund të përfundonte “librin e tij të “bardhë” të paralajmëruar qysh në vitin 2005, në të cilin pa dyshim ai do e sqaronte edhe rolin e tij të “mbledhësit të mbeturinave luftarake” që ia shkaktoi Ali Ahmeti me shokët e tij.

Pasi të botoheshin të gjithë këto “libra të bardhë” e të “larmishëm”, do të kishte materiale të bollshme për librin e historisë, të cilin me vite tentonin ngutazi ta shkruanin aktivistët e degës civile dhe profesorët e historisë. Mbase gjeneratave të ardhshme, kjo histori nuk do u ndihmojë gjithaq për të zbardhur ngjarjet e 2001, por gjithsesi do u dëshmojë se kanë pasur prindër të cilët, lere që ua harxhuan ardhmërinë, por ua morën edhe të drejtën të vlerësojnë veprat e ndërtuesve të së kaluarës së tyre.

Historia mund të shkruhet në shumë mënyra, por kurrsesi jo edhe nëpërmjet negociatave ndëretnike, apo duke u mbështetur në “marrëveshje demokratike” mes dy palëve. Më në fund, atë mund ta shkruajnë ose historianët që mund t’i vlerësojnë të dhënat pa ngarkesën etnike apo religjioze, ose fituesit, varësisht se për çfarë qëllimesh shkruhet ajo: për të zbardhur të vërtetat lidhur me një periudhë kohore, apo për të lavdëruar fituesin dhe për ta përbuzur humbësin. Libra të mirëfilltë historik janë vetëm ato që mbështeten në të dhëna të paluhatshme. Vetëm prej tyre, gjeneratat e ardhshme munden të nxjerrin mësim për gabimet e bëra të cilat nuk duhen t’i përsërisin.

Fëmijëve të socializmit të deridjeshëm, u është i njohur fati i historisë të cilën e shkruajnë fituesit: edhe pas më shumë se katër dekadave të mësuarit për “Borot dhe Ramizat” (për Boro e Ramizin mësonin të gjithë në ish Jugosllavi dhe këta dy emra u bënë metaforë e bashkim-vëllazërimit mes popujve të këtij shteti të dikurshëm – njëri shqiptarë e tjetri serb), doli se nxënësit kishin mbajtur mend vetëm emrat e heronjve etnik të cilët as që përmendeshin nëpër librat shkollor të historisë, por ishin të pranishëm në orët historike që ua mbanin gjyshërit dhe prindërit e tyre për të kaluarën kolektive. Me çka u dëshmuua se historitë të cilat i shkruan fituesi, herdo - kurdo i redakton mbëmendja kolektive e një populli.

Mospasja distancë të duhur kohore, dhe pamundësia të kesh në dispozicion dokumentacionin e duhur, i cili qëndronte i mbyllur nëpër arkivat shtetërore, ishin vetëm dy nga argumentet parësore që pamundësonin kompletimin e kaptinës së historisë për ngjarjet që ndodhën gjatë më pakë se dy dekadave sa ishte edhe mosha e Maqedonisë. Jo më pak e rëndësishme ishte e vërteta se, përpara që të fillonte afrimi i rrëfimeve kundërthënëse ndëretnike për një ngjarje të njëjtë, duhej të ndërtohej sistem i vlerave të përbashkëta, që do shërbente si urë, e cila do ndihmonte të tejkaloheshin brigjet e largëta të vërtetave të dyfishta. Aq më shumë, shkruesit e lart-përmendur të historisë duhej ta dinin se ka libra më të këqij historik se ata që i shkruan fituesi: të atillë janë ata libra që kanë autorë të “dështuarit”.

Mbase të gjithë e pranojnë se krismat e para në

fshatin Tanushë të 2001, shënuan dështimin e të gjithëve, duke nisur nga hartuesit e të ashtuquajturit “shtet më demokratik në botë” – Maqedoninë e “para Ohrit” të ndërtuar mbi rendin shoqërorë të “popullit shtetformues” (etnitetin maqedonas) dhe qytetarëve të tjerë – dhe deri te elitat qeveritare maqedonase - shqiptare, të cilat harmoninë ndërretnike e mbulonin me afërsinë e tyre “vëllazërore”, ndërpartiake, të mbështetur në themelet e “maunokracisë”, e cila u sillte përfitime multietnike. Konflikti i 2001 shënoi dështimin edhe të të gjithë “ekspertëve” të dikurshëm për zgjidhjen e konflikteve dhe situatave konfliktuoze, të cilët në ndërkohë u bënë ekspert për të gjetur modele që do mundësonin afrimin e të vërtetave kundërthënëse etnike. Viti 2001 ishte dështim edhe për të gjitha organizatat joqeveritare të cilat harxhuan para të majme për tribuna dhe shkolla demokratike, duke dashur të ndërtonin kalanë e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërretnik, por e cila u shemb në të njëjtin çast kur edhe jehuan krismat e para në Tanushë. Më në fund, 2001 shënoi edhe dështimin e institucioneve ndërkombëtare, të cilat para kohe e shpallën Maqedoninë si “oaze të paqes” dhe projekt të vetëm shumetnik të suksesshëm në Ballkan. Nga konflikti i 2001 fituan vetëm profiterët e luftës dhe disa qeveritarë të asokohshëm të Maqedonisë, të cilët shfrytëzuan rastin të blinin armë e t’i mbushnin xhepat e vet.

Thënë shkurt, kaptinën historike për Maqedoninë e dekadës së fundit të shekullit të njëzet,

duhet ta shkruajnë ata të nesërmit që do munden pa ngarkesa të vlerësojnë veprat dhe punën e veprimtarëve të kësaj periudhe kohore. Në mos për hiçgjë tjetër, atëherë shkakun se në Maqedoni ishin të paktë historianët, të cilët mund të zhvishnin uniformën e subjektivizmit etnik. Konflikti i 2001 mbase nuk kishte as fitues klasik, i cili do të mund të shkruante historinë e vet të njëanshme. Nuk kishte fitues, sepse ata që e nisën konfliktin nuk donin të mposhtnin askënd tjetër, përpos konceptin shtetërorë, i cili nuk kishte as të sotme as të ardhme. Andaj, në njëfarë mënyre, këtij shteti ata ia sollën ardhmërinë. Prandaj, edhe orvatja me qëllime të mira që sa më shpjet të mbyllej kapitulli i të vërtetës për ngjarjet e 2001, mund të keqkuptohej dhe të merrej si tentim i atyre që donin sa më shpjet të mbulonin humbjen e vet, si orvatje e “humbësve”, të cilët deri dje mbronin Maqedoninë e “para Ohrit”, e pastaj dolën në radhët e para për të ndërtuar shtetin e paskonfliktit.

Mbase edhe Maqedonisë së paskonfliktit, nuk i duheshte gjithaq historia e saj bashkëkohore, sa kishte nevojë të gjejë mënyrë si t’i shmanget rrezikut që 2001 të mos bëhej djep në të cilin maqedonasit etnik do të mëkonin mitin e “viktimave të pafajshme”, e shqiptarët do rrisin trimërinë e tyre të pashembullt në këto hapësira. Sepse ky mit mund të rritej aq shumë, sa hija e tij do e mbulonte edhe ardhmërinë e gjeneratave, të cilat do vinin më vonë. Apo më në fund, sa i përket 2001, Maqedonia duhej të kujdesej që ky konflikt të mos shndërrohej në

“zënkë” të pafund, e cila do përdorej nga politikanët sa herë që do donin t’i acaronin marrëdhëniet ndëretnike, apo sa herë që do donin të nxisnin konflikte ndërpartiake te shqiptarët. Siç ndodhi në 2006, kur mandatarin Gruevski, duke dashur përpara zgjedhësve të vetë të dëshmohej si “vojvodë” që kurrë nuk ua shtrinë dorën e pajtimit “terroristëve” të Ali Ahmetit – a i ndihmuar nga partia e Arbër Xhaferit – do e shpërfillë votën shqiptare, e do e merr në koalicionin qeveritarë partinë e cila nuk ishte fituese e vullnetit shumicë të shqiptarëve të këtushëm – PDSH-në. Me çka do e nxitë debatin dhe grindjen brendashqiptare se ç’është demokracia.

Si do që të jetë, mbetet e vërteta se konflikti i 2001 mund të pengojë gjatë viteve të mëparshme, e jo në mars të atij viti kur rinia shqiptare paralajmëroi se ishte ngirë edhe nga nacionalizmi shpirtngushtë i elitave politike të etnitetit maqedonas, edhe nga premtimet laramane të prijësve të vet partiak. Vallë si duheshte të vepronin shqiptarët të përballur me të pandryshueshmen - me “Biblën”, për të cilën thuhej se do mbetej përjetë e paprekur dhe e pandryshuar, kur e dinin se kushtetuta ata i përcaktonte si “qytetarë të tjerë” të shtetit. Mbase do kishte njerëz që mendonin se edhe “Bibla” mund të pësonte ndryshime, nëse të gjallët nuk e donin “parajsën”, të cilën ua ofronte shteti ku jetonin, por zëri i tyre mbetej i papërfillur. Andaj erdhën ata që përnjëherë u bënë shumë tërheqës për rininë e këtushme shqiptare, e cila deri atëherë kishte jetuar kokulur nëpër kafenetë e tymsura: kryesuesit e UÇK-së dhe

pjesëtarët e parë të veshur me uniformën e kësaj ushtrie. Të ardhurit, që thuajse përnjëherë ua kthyen dinjitetin dhe krenarinë atyre që me dekada atë e ndjenin të lënduar, e bënë të riun shqiptarë të harrojë partitë dhe të shkojë atje ku komandonte Ali Ahmeti. Kështu që brenda disa muajve ndodhi ajo që duhej pritur: partitë shqiptare u defaktorizuan thuajse nuk kishin ekzistuar fare, mbetën vetëm me kryesitë e ngushta partiake, sepse pjesa dërmuese e votuesve ishte nën komandën e udhëheqësve të UÇK-së. Nga ana tjetër, partitë, dhe të gjitha forcat tjera të etnitetit maqedonas, u vunë në mbrojtje të institucioneve shtetërore. Ata jo se nuk e dinin nga buronte e gjithë revolta e rinisë shqiptare, por kishin ngulur këmbë që edhe kësaj radhe atë revoltë mos e përfillnin dhe të bënin çmos që asgjë të mos ndryshonte në Maqedoni. Kështu që shumë shpejtë shqiptarët u gjetën aty ku kishin qenë gjithmonë, por që nuk shihej qartë shkaku i pjesëmarrjes së një numri të caktuar elitash partiake nëpër institucionet më të larta shtetërore: jashtë institucioneve të shtetit.

Në ndërkohë, Maqedonia u mbulua nga mjegulla e një atmosfere të pakuptimtë që nga pak dukej si teatër absurd: ata që kishin marrë pushkë të realizonin kërkesat shqiptare, të cilat për një dekadë të tërë hasën në vesh të shurdhër, lajmëronin Shkupin zyrtarë se nuk janë kundër sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Maqedonisë, se nuk luftojnë për territore, por për të drejta kolektive dhe individuale. Pra, ata paralajmëronin pushtetarët se ishin të gatshëm të mbronin edhe shtetin nga ata që

një dekadë me radhë kishin bërë çmos ai të asgjësohej. Sikur të ishte ndryshe, atëherë kryesuesit e UÇK-së as që do kërkonin atë që kishin nënvizuar në “Komunikatën numër 6” të shtabit të përgjithshëm të UÇK-së me datë 09 mars të vitit 2001, ku numëroheshin kërkesat UÇK-së me këtë renditje: “Ndërmjetësim të paanshëm ndërkombëtarë në konflikt, regjistrimi i popullsisë nga një institucion ndërkombëtar, ndërrimi i kushtetutës, Maqedonia të jetë shtet i shqiptarëve dhe maqedonasve” si parakusht të zhduken padrejtësitë, apo siç thuhet në komunikatë ”të hiqet diskriminimi në jetën civile dhe ushtarake, të hiqet diskriminimi në arsim, shkencë e kulturë, të hiqet diskriminimi në ekonomi, administratë shtetërore, në jetën politike, në procedurat e marrjes së vendimeve, në procedurat e zgjedhjeve, në procedurat e ndarjes së zonave elektorale, të lirohen të burgosurit politik dhe të njihet e drejta të kthehen të ndjekurit dhe të arratisurit politik”.

Pra, UÇK-ja vetëm kishte kompletuar listën e kërkesat disavjeçare të shqiptarëve të këtushëm, listën e cila mbase ishte humbur diku nëpër sirtarët e qeverisë dhe të kryetarëve të shtetit. Nëpërmjet kësaj komunikate, Ali Ahmeti vetëm ua rikujtonte politikanëve të Maqedonisë se nuk ishte harruar lista e kërkesave shqiptare, ai njëkohësisht me këtë komunikatë ua rikujtonte partiakëve shqiptarë edhe premtimet që ia kishin dhënë popullit, e të cilat kurrë nuk i kishin realizuar. Dhe duke mos pasur përgjigje pse nuk ishin përfillur këto kërkesa,



shumica e politikanëve dhe qarqeve intelektuale e mediatike të etnitetit Maqedonas, filluan të dëshmojnë se ishin sulmuar nga Kosova. Këtë e bënin nga shumë arsye: se si shtet i sulmuar, do kishte të drejtë të përdorë tërë potencialin ushtarak e policorë për t'u mbrojtur (siç ndodhi me bombardimet e vendbanimeve shqiptare), si shtet i sulmuar nga jashtë Maqedonia do e shpërqendronte vëmendjen e ndërkombëtarëve nga e vërteta që i kishte çuar shqiptarët të merrnin armët në duar.

Qarqet e etnitetit maqedonas, asokohe, si edhe vite me vonë do shtrojnë një pyetje shumë të logjikshme, por edhe si shumë të tjera, dukshëm të vonuar: a arrihen të drejtat qytetare me armë. Duke harruar se nëpër botë luftërat bëheshin për të drejta njerëzore, e jo vetëm për pushtim të territoreve. Ata harroni logjikisht të bënin vlerësimet që lehtë do ua bënin të qartë se shqiptarët e Maqedonisë ishin ata që kishin marrë armët në dorë dhe se konflikti nuk u kishte ardhur nga Kosova. Që ta kuptonin këtë, do u mjaftonte të shihnin listën e emrave dhe të biografive të ushtarakëve që udhëhiqnin njësitet e UÇK-së, të cilët, të gjithë deri në një, ishin shqiptarë të lindur e të rritur nëpër vendbanimet e Maqedonisë. Nga ato lista do e kuptonin se shumica e udhëheqësve të UÇK-së së Maqedonisë, kishin marr pjesë edhe në organizimin e UÇK-së, e cila në vitin 1999 luftoi në Kosovë. Dhe nëse vlerësimi do bëhej sipas logjikës që e impononin qarqet e këtushme të etnitetit maqedonas, atëherë më parë mund të thuhej se luftën në Kosovë e kishin organizuar edhe shqiptarët e

Maqedonisë, se sa konfliktin e 2001 ta kishin nisur kosovarët.

Por, ishte e qartë se qarqeve politike të Maqedonisë, të përballura me disfatën e vetë, edhe e pamundshmja u dukej e mundur. Kështu që ata, nga njëra anë Kosovën e mbanin si "provincë" të Serbisë, e nga tjetra e shpallnin si sulmuese të Maqedonisë. Nëse Kosova ishte atë që e mendonin ata – vetëm një pjesë e Serbisë – atëherë pse nuk thoshin se janë të sulmuara nga Jugosllavia e atëhershme. Apo, nëse ajo ishte atë që realisht ishte – protektorat – pse nuk u shkante ndër mend se me këtë donin të thoshin se Maqedonia ishte sulmuar nga bashkësia ndërkombëtare, e cila ishte përgjegjëse për çdo gjë që ndodhte me Kosovën dhe që bënin kosovarët. Këto, dhe shumë absurditete tjera, ishin rezultat i asaj se UÇK-ja, papritur e detyroi Maqedoninë të dilte përpara pasqyrës së vet, e të shihte se sa i ishte shëmtuar fytyra gjatë një dekade derisa ishte marrë me lojëra që kishin të bëjnë me mosëdurimet ndëretnike.

Në këtë pasqyrë e panë vetveten edhe partiakët shqiptarë të të gjitha partive. Dhe, mbase, rastësisht, fytyra e PDSH-së doli më e shëmtuar, sepse asaj i ra në hise që të ishte në qeverinë, e cila jepte vendime të bombardoheshin fshatrat shqiptare, sepse ajo ishte pjesë e koalicionit qeveritarë, i cili edhe nga parat e taksapaguesve shqiptarë blinte armatime që t'i shkatërronte vendbanimet e këtij etnitetit.

Objektivisht, PDSH-ja u ndodh në një pozitë absurde: të braktisë kabinetet qeveritare, apo të mbetej

në koalicionin qeveritarë ku nuk mund të ndikonte me asgjë në vendimmarrje. Ndoshta kjo pozitë e pakuptimtë, asaj edhe do ia lehtësoj veprimin, sepse i njëjtë do ishte efekti i veprimtarëve të saj në pushtet edhe sikur ata të rrinin nëpër kafenetë e Tetovës edhe sikur partia e tyre t'i ndiqte ngjarjet nga kabinetet qeveritare. Duke ndenjtur në kabinetet qeveritare, në mos më shumë, ata kishin mundësi të shihnin dhe të përjetonin atë që dikush ua thoshte qeveritarëve të të gjitha partive shqiptare: se janë vetëm pjesë e një "ikebane" politike, e cila u jep legjitimitet qeverive dhe institucioneve të këtij shteti, që nga shqiptarët ndjeheshin si të huaja. Duke mbetur në koalicionin qeveritarë edhe gjatë konfliktit të 2001, kryesuesit e PDSH-së do duhej të shihnin më qartë se gjatë tërë periudhës së demokratizimit të Maqedonisë, ndoshta partitë shqiptare vetëm kishin përsëritur gabimin që e kishte bërë e mëparshmjat: pjesëmarrjen në qeveri. Se ndoshta sikur partitë shqiptare të mos u jepnin legjitimitet koalicioneve qeveritare të Maqedonisë, lufta e tyre parlamentare do ishte më e frytshme. Se me vet mos votimin e shumë ligjeve të disfavorshme për shqiptarët, sistemi juridik i këtij shteti do rrëzohej përpara institucioneve ndërkombëtare.

Me siguri se qeveritarët shqiptarë nuk e kishin lehtë gjatë konfliktit të 2001, pasi që ishin përballë një situatë absurde: të mbeteshin në qeveri ku askush për asgjë nuk i pyeste – që do të thoshte t'ju shërbesh si mbulesë qarqeve të vendimmarrjes të etnitetit maqedonas që kishin vendosur të përdorin tërë

potencialin ushtarak e policorë kundër mjediseve shqiptare ku vepronte UÇK-ja - apo të dalësh nga qeveria, e që do të thoshte t'i shkëputësh të gjitha lidhjet mes palës shqiptare dhe asaj të etnitetit maqedonas. Kështu që mund të thuhet se politikanët shqiptarë të kësaj kohe, si ato të PPD-së, edhe ata të PDSH-së, ndershëm e luajtën edhe pjesën e lojës politike, e cila kishte domethënien e dështimit të plotë të tyre: atë të "korrierit" që do mbante lidhjen mes Ali Ahmetit dhe kryesuesve të shtetit maqedonas. Pra, ata këtë rol e luajtën ndershëm, dhe bile shkuan edhe në Prizren që të takoheshin me udhëheqësin e UÇK-së dhe t'i shprehin dëgjueshmëri dhe besnikëri në rolin të cilin ua kishte përcaktuar fati. Gjatë këtij takimi të Ali Ahmetit me Arben Xhaferin dhe Ymer Ymerin në Prizren, të mbajtur me 22 maj të 2001, u nënshkrua edhe "Deklarata e liderëve shqiptarë të Maqedonisë lidhur me procesin paqësor e reformues në Republikën e Maqedonisë", në të cilën thuhej se ishte arritur konsensus mes liderëve shqiptarë, mbi "njohjen e faktit se reformat për të cilat angazhoheshin shqiptarët kanë qëllim ruajtjen e integritetit dhe karakterit shumetnik të Maqedonisë, njohjen se nuk ka zgjidhje 'etnike territoriale' për probleme në Republikën e Maqedonisë dhe çdo përpjekje për të copëtuar etnikisht territoret, u sjell dëm vetëm qytetarëve të Maqedonisë dhe paqes në rajon, njohjen se nuk ka zgjidhje ushtarake për problemet në RM, njohja se procesi i transformimit të RM duhet të shkojë vetëm drejt integritimeve euroatlantike, njohjen se zgjidhja do të gjendet brenda një

procesi vendor politik me lehtësimin e SHBA-së dhe BE-së...”. Por, për të gjitha këto njohje, prijësit policorë dhe ushtarakë të Maqedonisë ishin verbëruar dhe nuk e shinin se kjo Deklaratë ishte shpëtimi i Maqedonisë. Andaj edhe opinionin e këtushëm do i detyrojë Xhaferin dhe Ymerin që në njëfarë mënyre të distancoheshin nga kjo Deklaratë. Me çka u bë e qartë një gjë: se nuk ishin shqiptarët ata që donin dhe dëshironin copëtimin e Maqedonisë, por kishte qarqe të etnitetit maqedonas të cilat donin ta shfrytëzonin këtë mundësi, mbase edhe të gjatëpritur, për ndarjen territoriale dhe këmbimin të popullatës shqiptare me atë të etnitetit maqedonas. Këtë do e dëshmojë edhe propozimi i publikuar asokohe, e që i përshkruhet Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve, ku hapur kërkohet ndarja e shtetit në pjesën maqedonase dhe atë që do i jepej Shqipërisë. Kështu që, Ali Ahmetit i ra në hise të bënte edhe atë që me siguri nuk kishte mundur ta parashikojë kur kishte nisur konfliktin: t’ua bëjë me dije qarqeve të këtushme se ai e “donte Maqedoninë të tërë”, e jo vetëm një pjesë të saj, se ai - në krahasim me Arbër Xhaferin për të cilin thuhej se asokohe edhe nuk kishte qenë gjithaq kundër që shqiptarët e maqedonasit përfundimisht të ngrinin një mur të lartë, i cili do i ndante përgjithmonë - nuk e kishte ndër mend ta lejonte ndarjen e shtetit, dhe prandaj lëshoi “Komunikatën” e 31 majit të vitit 2001, në të cilën nën të tjerat nënvizohet se “Shtabi i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, konstaton se plani i publikuar nga ASHAM-së (MANU) edhe

njëherë vërteton politikën shoviniste të qarqeve të caktuara që kanë vepruar dhe veprojnë në kuadër të shtetit në Maqedoni:::”: Pra, Ali Ahmetit i ra në hise që krahas të drejtave të shqiptarëve, të shpëtojë edhe tërësinë e shtetit të quajtur Maqedoni.

Sa i përket “Deklaratës së Prizrenit”, ajo duhet shikuar edhe nga këndi se Ali Ahmeti u dha legjitimitet liderëve të këtushëm partiak të bëheshin ndërmjetësues të tij në bisedimet me institucionet shtetërore të Maqedonisë. Pra, ai në njëfarë mënyre atyre ua riktheu “liderllëkun” e munguar asokohe. Gjithsesi se ky ishte hap shumë i rëndësishëm që faktori politik e ushtarak shqiptarë t’i akordonte veprimet e veta dhe që më në fund pala e etnitetit maqedonas të kuptonte se ata me asgjë nuk dallonin mes vete kur bëhej fjalë për kërkesat e shqiptarëve. Me këtë Deklaratë, liderët e këtushëm shqiptarë u faktorizuan dhe u bënë partner të barabartë me palën shtetërore. Që më në fund, do kurorëzohet me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit edhe nga Arbër Xhaferi dhe Ymer Ymeri. E në ndërkohë, të gjithë e dinin se pranë nënshkrimit të këtyre kryesuesve partiak shqiptarë, qëndronte “vula” e Ali Ahmetit. Pra të gjithë e dini, se pa pëlqimin e Ali Ahmeti, të gjitha marrëveshjet do ishin të pavlera.

Kur bëhet analiza e rrjedhave të ngjarjeve të 2001, shumë analitikë dhe ekspertë nga Maqedonia, shtrojnë një pyetje gjithsesi të logjikshme: pse në fillim të konfliktit, përfaqësuesit e institucioneve kombëtare ishin kundër pjesëtarëve të UÇK-së, pse në fillim ata i quanin me emërtime përbuzëse dhe

përjashtuese, e që më vonë do të ndryshoheshin. Këtë pyetje mund ta shtrojnë vetëm ata të cilët nuk dinë t'i zbërthejnë porositë e përcjella nga dashamirësit që nuk duna të të fusin në konflikt dhe që duan të të japin sinjal të dëshmosh urtinë institucionale dhe shtetërore. Duke mbajtur anën e Shkupit zyrtarë, përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare shpresonin se në këtë mënyrë ia mundësonin Maqedonisë që ajo ngutazi t'i bindte shqiptarët se nuk kishin nevojë ashtu të shprehnin revoltën e tyre dhe të bënte hapa konkrete sa t'u dëshmonte se i konsideronte si qytetarë të barabartë dhe do i rishikonte të gjitha kërkesat e tyre si dhe qëndrimin e institucioneve shtetërore ndaj tyre. Pra, bashkësia ndërkombëtare priste zëra qetësues nga Shkupi zyrtarë, shpresonte se burrështetasit e Maqedonisë e dinin se kur rebelohet edhe një numër i vogël qytetarësh, duhet të fillosh bisedimet që ata të ulin armët, e jo menjëherë ta përdorësh dhunën. Më në fund, ato personalitete ndërkombëtarë e dinin se edhe me kidnapues, apo terroristë më ordiner, shteti i sulmuar mundohet të vë ndonjë dialog me anë të të cilit do e zgjidhte problemin pa gjakderdhje. Pra, koncepti mental i atyre ndërkombëtarëve të cilët me deklaratatë të ashpra sulmonin shqiptarët që kishin marrë armët në duar, nuk korrespondonte me mentalitetin politik të Shkupit zyrtarë, i cili dhunës menjëherë iu përgjigj me dhunë, edhe atë me intensitet disa herë më të madh se ajo që ushtronin ushtarët e UÇK-së. Kështu që Maqedonia shumë shpejtë e shpalosi fytyrën e vërtetë përpara botës si jotolerante

dhe e përcaktuar një etnikisht – si shtet që duhej ta mbrojë etnitetin maqedonas nga të tjerët, e jo si shoqëri që të gjithë qytetarët i shihte si të njëjtë përpara ligjit dhe institucioneve shtetërore. Dhe kur bota e pa se Shkupi zyrtarë mezi kishte pritur që edhe njëherë të përdorte forcën ndaj shqiptarëve, personalitetet botërore e ndërruan fjalorin. Apo më mirë thënë, e kuptuan se Shkupi zyrtarë gabimisht e kishte kuptuar porosinë që i arrinte nga Uashingtoni dhe Brukseli. Andaj edhe shumë shpjet do kërkojnë nga Maqedonia që kujdesshëm të përdorte forcat ushtarake dhe policore, si dhe ta ketë parasysh se më nuk bëhej fjalë për “grupe ekstremiste”, por për një popullatë të tërë të revoltuar dhe të gatshme edhe me armë të luftojë për të drejtat e veta.

Thënë shkurt, shumë shpejtë pas fillimit të konfliktit, institucionet e bashkësisë ndërkombëtare, të cilat ishin të interesuara për stabilitetin e Maqedonisë, u përballën me arrogancën e elitave politike, intelektuale dhe të mediave të etnitetit maqedonas, të cilat frontalisht dolën me kërkesën që “armës shteti t’i përgjigje me armë”, që të mos bisedohej me “terroristët”, se duheshin ndëshkuar fshatrat shqiptare, të cilat i përkrahnin pjesëtarët e UÇK-së. Pra, bota u përballë me diçka thujtë areale, me diçka që deri atëherë e kishte parë vetëm tek Millosheviqi: që i tërë shteti t’i kundërvihet një revolte popullore, pa u munduar të kërkoj shkaqet që e nxisnin atë revoltë. Andaj, të kota ishin edhe vërejtje e mëvonshme të qarqeve të etnitetit maqedonas se në një vend demokratik “të drejtat individuale dhe



kolektive nuk realizoheshin me armë”. Ky ishte konstatim i drejtë, por kishte një mangësi të madhe që e bënte të pavlefshëm: Maqedonia ndërtonte demokraci, por me formula të socializmit të dikurshëm Jugosllav, ndërtonte shtet të qytetarëve të “barabartë”, por duke i pasur institucionet shtetërore të mbyllura për shqiptarët. Në demokracinë të cilën e ndërtonte Maqedonia, shumëçka nuk kishte asnjë lidhje farefisnore me atë që e njihnin standardet demokratike. Kështu që, brenda dy muajve, bashkësia ndërkombëtare e pati të qartë se ata që kishin dalë në mal me pushkë në dorë, nuk ishin as “rambot” e Arbër Xhaferit, as terroristët e Georgievskit, por pjesa më e madhe e rinisë shqiptare, të cilën me vite e kishin ushqyer me gënjeshtër si politikanët e papërgjegjshëm shqiptarë, po ashtu edhe institucionet një etnike shtetërore. Pastaj, institucionet ndërkombëtare nuk e kishin vështirë të lexonin edhe diçka të papritur për ata: se disa qarqe të etnitetit maqedonas bënë çmos që zjarri i luftës ndëretnike të përhapej sa më shpejtë nëpër tërë Maqedoninë. Dhe këtë e bënë me shpresë se kishte ardhur çasti i gjatëpritur që njëherë e përgjithmonë të “pastroheshin llogaritë me shqiptarët”. Andaj nuk do vonojnë shumë, dhe nëpër Maqedoni do fillojnë të qarkullojnë hartat e Maqedonisë pa shqiptarët në të. E bile në Shkup do nxitet shpërngulja e shqiptarëve që në të, të pakësohet numri i banorëve shqiptarë. Pushtetarët ngutazi vendosën pika-kontrolli policorë, të cilat, nëse i ndiqje kujdesshëm, e mbyllnin “kufirin” e pëlqyer të ndarjes etnike nga

disa qarqe të etnitetit maqedonas dhe thujse në përpikshmëri e ndanin Maqedoninë në pjesën shqiptare dhe në atë të etnitetit maqedonas. Dhe nëpër këto pika-kontrolli, me përplot rezervistë dhe policë maqedonas, shqiptarët plaçkiteshin, u merreshin para që të kalonin nga një vendbanim në tjetrin. Edhe spitali shtetërorë u bë i padurueshëm për shqiptarët, sepse mjekët e atjeshëm me bezdi harxhonin kohë dhe ilaçra për t'i shëruar "terroristët". Që do të thoshte se emërtimi "terroristë" humbi kuptimin fillestarë dhe ai tani i përshkruhej thujse një populli të tërë.

Bashkësia ndërkombëtare shpjet e kuptoi se rrethanat dhe personazhet që e çuan Maqedoninë drejtë 2001, ishin ato dhe ata që kishin nisur "luftën" ndëretnike një dekadë më parë. E që tani, në 2001 shtireshin se nuk e dinin pse rinia shqiptare kishte marrë armët për të luftuar për atë që i takonte këtij populli. Më në fund, të zënë me hartat e ndarjeve ndëretnike, disa nga burrshtetasve maqedonas edhe nuk kishte kush t'ua rikujtojë se pyetja e referendumit të mbajtur me 8 shtatorë të 1991, e të cilin e bojkotuan shqiptarët, ishte: "A jeni për shtetin e pavarur e sovran të Maqedonisë, me të drejtë që të hyjë në bashkësinë e shteteve sovrane të Jugosllavisë së ardhshme."; se me datë 29.07.1991, grupi parlamentarë PPD-së i propozoi parlamentit republikanë të miratojë një "Deklaratë për status të barabartë të shqiptarëve të Maqedonisë" në të cilën, mes dhjetë pikave, kërkohet që "Republika e Maqedonisë të hartojë mekanizëm juridiko kush-

tetues me të cilën do të garantohet barabarësia nacionale, dhe për të gjitha çështjet të cilat u përkasin marrëdhënieve nacionale dhe interesave të përbashkët do të vendose me konsensus”, se “shqiptarët e Republikës së Maqedonisë kanë të drejtë të vendosin për fatin e tyre dhe në atë kontekst të mbajnë përgjegjësinë për fatin e republikës”, por kjo deklaratë nuk u përfill nga pala e etnitetit maqedonas; se kryetari i parlamentit republikan, Stojan Andovi në një intervistë dhënë “Zërit” me datë 07 tetor 1991, të botuar në faqen 15 të kësaj gazete, konstatimit të gazetarit se “entuziazmi për të ruajtur konfederatën e Jugosllavisë në republikat veriore shuhet, e ato që më parë nuk kanë pranuar mundësinë për të jetuar në një konfederatë, këtë nuk e bëjnë as sot dhe a s’është e përgatitur Maqedonia të jetojë vetëm”, ai do t’i përgjigjet se “referendumin nuk e organizojmë për t’u shkëputur nga Jugosllavia apo për të jetuar vetëm. Krejt puna që bëjmë shkon kah ajo që Jugosllavia të ruhet, por me kusht që ajo të shndërrohet në një bashkësi të shteteve sovrane.....”; në pyetjen e të njëjtit gazetar se a mendon se bojkotimi i referendunit nga ana e shqiptarëve mund të sjellë në pikëpyetje vlefshmërinë e referendunit në suaza ndërkombëtare, S. Andovi thotë: “Përfundimin pozitiv të referendunit nuk mund ta sjellin në pyetje shqiptarët me bojkotimin eventual. Madje mund të thosha se nuk mund të bëhet kurrfarë dëmi në validitetin e tij ndërkombëtar...”

Të gjitha këto që u përmendën më lartë janë qën-

drime dhe disa nga veprimet të cilat e sollën Maqedoninë deri te 2001. Ndoshta, prandaj disa nga politikanët që ia harxhuan ardhmërinë shtetit, me lehtësi do përkrahin planet për ndarjen e Maqedonisë. Ndër ata do jetë edhe Stojan Andovi, njeriu që dikur mbronte Konfederatën Jugosllave, i cili më vonë mendonte se shqiptarët nuk janë faktorë vendimtarë për fatin e Maqedonisë, mirëpo i cili gjatë konfliktit do kërkojë që shteti pamëshirshëm të sillet ndaj “terroristëve”. E nuk kishte njeri që në vitin 2001 t’ia rikujtojë Andovit se edhe përgjigjet e tij mospërfillëse ndaj shqiptarëve të dhënë gazetave, kontribuuan që Maqedonia të arrijë në 2001. Gjatë konfliktit thuajse u heshtën të gjithë dhe nuk kishte kush politikanëve të këtushëm t’ua rikujtojë se “konflikti” shqiptaro – maqedonas kishte filluar që nga dita e shpalljes së referendumit për pavarësinë e këtij shteti. Konfliktin e 2001 e nxitën të gjithë politikanët e llojit të Stojan Andovit, që asokohe nuk kishin vizion, por i printe situata e ditës dhe frika si do ia bënin pa Beogradin.

Rrugës së konfliktit u nisën edhe partitë shqiptare duke e radikalizuar popullatën shqiptare me premtime të mëdha të cilat pastaj humbeshin në mjegullën e dendur të pavendosmërisë se si të vepronin. Si gjatë kohës para shpalljes së referendumit për pavarësinë e Maqedonisë, po ashtu edhe pas mbajtjes së tij kur pasoi ajo vonesë e shpalljes së aktit më të lartë shtetërorë, e shkaktuar nga dilemat dhe mosmarrëveshjet rreth natyrës së Kushtetutës, e kur përfaqësuesit e PPD-së ishin njësoj të

paqartë, e të pavendosur se si duhej vepruar. E kundërshtimet e asokohshme lidhur me kushtetutën republikane vinin nga tre taborre: për kushtetutë nacionale (si shtet i etnitetit maqedonas) ngulte këmbë blloku i partive etnike maqedonase i kryesuar nga VMRO-ja, partitë me orientim të majtë ishin diku në mes dhe angazhohen për kushtetutë me elemente edhe qytetare edhe nacionale, dhe përfaqësuesit e partive politike shqiptare që angazhohen për përcaktim kushtetues të pastër qytetare. Këto dilema nuk arriti t'i evitoj as komisioni kushtetues. Ja çka deklaron në atë kohë eksperti shqiptarë i këtij Komisioni, Mithat Emini, përndryshe edhe nënkryetar i PPD-së: "Edhe gjatë punës së këtij Komisioni kushtetues është vërejtur se partitë politike të Maqedonisë, nuk kanë qëndrim të njëjtë rreth karakterit të kushtetutës së re...Derisa 'të majtët' kanë qëndrim më demokratik dhe duket se janë më afër standardeve evropiane, tek përfaqësuesit e VMRO-së vërehet egoizmi nacional që herë - herë barazohet me shovinizëm. Ata sillen sikur në Maqedoni të mos jetonte askush tjetër përpos maqedonasve." ("Zëri", 16.11.1991, F. 9)

Në këtë periudhë Maqedonia përballet edhe me një paradoks tjetër: atë më shumë e frikon pavarësia e vet, se sa tytat e tankeve serbe të cilat e rrethonin. Kështu që edhe luftëtarët më të zjarrtë të asokohshëm për pavarësinë e Maqedonisë - liderët e VMRO-së - thuajse do bëjnë çmos të vonohej shpallja e Kushtetutës. Ja çka thotë lidhur me këtë Mithat Emini: "...kur është fjala te kushtetuta, edhe

Gligorovi edhe Andovi edhe Tupurkovski etj. thonë se është bërë njëfarë përparimi në përmisimin e statusit të shqiptarëve...Ku ta dish, ndoshta atë që nuk janë në gjendje ta bëjnë politikanët e tanishëm, do ta bëjnë gjeneratat e ardhshme...” (Zëri” 16.11.1991).

Po, këtë do e bëjnë gjenerata e ardhshme, por jo ato që jetonin mbi shpinën e popullit. Këtë do e bëjë UÇK-ja e udhëhequr nga Ali Ahmeti, në vitin 2001. Andaj edhe ngjarjet dhe deklaratat e lartpërmendura, nuk shpjegojnë vetëm realitetin e asaj kohe, por edhe një mentalitet politik të partiakëve shqiptarë që veprimet e veta të mos i mbështesin tek forcat vetjake, por në ndryshimin e vetëdijes të rivalët e tyre të etnitetit maqedonas. Mb-ase politikanët e atëhershëm shqiptarë e besonin të pamundurën: se do mund të ndryshonte vetëdija ndaj çështjes ndëretnike tek politikanët e llojit të Gligorovit dhe Stojan Andovit, të cilët ishin rritur dhe plakur me bindjen se nuk ishte realiteti ai që i ndryshon shoqëritë dhe partitë, por partitë e ndryshojnë realitetin. Me çka edhe rruga e cila do e çojë Maqedoninë drejtë konfliktit të 2001, do jetë e asfaltuar edhe nga vetë përfaqësuesit politik shqiptarë që prisnin të “vijne gjeneratat e reja maqedonase”, të cilat do kenë më shumë mirëkuptim për kërkesat shqiptare. Duke harruar se në ndërkohë rriteshin gjeneratat shqiptare që donin të jetojnë të sotmen, e jo të ardhmen e premtuar. Dhe gjithashtu rriteshin gjenerata të reja të etnitetit maqedonas, të cilat do jetonin me bindjen se institucionet shtetërore kanë

vetëm një qëllim – të mbrojnë interesat e tyre etnike bile edhe nga bashkëqytetarët shqiptarë.

Lidhur me mosmarrëveshjet shqiptaro-maqedonase që ecnin rrugës së dy botërave të largëta, por të mbuluar me ikebanën gënjeshtare të një bashkëpunimi mes elitave politike shqiptaro-maqedonase, ja çka thotë kryetari i atëhershëm i Maqedonisë, Kiro Gligorovi: “..Maqedonia është shtet i maqedonasve, i shqiptarëve, i turqve dhe i të tjerëve që jetojnë këtu...Për të gjitha këto gjëra do të bisedojmë më qetë kur të qetësohen gjërat...” (“Zëri”, 21.12.1991, F. 11). Me çka ai shpalos formulën e vetme të zgjidhjes së problemeve ndëretnike që e kishte mësuar në kohën e socializmit – të blesh kohë. Pra, kërkesat e shqiptarëve t’i shtysh për më vonë, duke mos parë se kështu ai e shiste të ardhmen e shtetit, duke mos vërejtur se ai bëhej krye projektuesi i rrugës që Maqedoninë do e çonte drejtë e në kthetrat e 2001, në vitin kur politikanët ia kishin harxhuar Maqedonisë tërë kohën për pritje ditë më të mira që të zgjidheshin problemet ndëretnike.

Dhe derisa Gligorovi blinte kohë, shqiptarët bënë gati referendumin e tyre, dhe me 27 dhjetorë të vitit 1991, në Gostivar do formohet Kuvendi për Mbajtjen e Referendumit për Autonomi Politike-territoriale në Maqedoni, ndërsa më 30 dhjetorë kryetarë i tij u zgjodh Gjylis Fejzullahu nga Gostivari, i cili jep këtë shpjegim për motivet e shpalljes së këtij referendumi: “...referendumin për autonomi politike – territoriale e shpallëm pas

shterjes së të gjitha mundësive që shqiptarët të fitojnë edhe me kushtetutë status të barabartë me maqedonasit. Udhëheqja dhe Qeveria Maqedonase, njërin pas tjetrit i lëshoi të gjitha rastet për ta bërë këtë, kurse kupa u mbush me aprovimin e kushtetutës së re... ("Zëri", 11.01.1992, F. 25). Përderisa politikanët e etnitetit maqedonas i humbnin mundësitë që të ardhmen e shtetit ta betononin me një kushtetutë të qytetarëve të barabartë, përfaqësuesit e shqiptarëve, duke mos pasur koncepte të qarta të veprimit, vazhdonin popullin ta radikalizonin edhe me veprime që paraprakisht e dinin se janë të vështira të realizoheshin, siç ishte "Ilirida", e cila edhe do mbetet e humbur diku në mjegullën e dendur të hutësës politike të partiakëve shqiptarë të asaj kohe. Duke shpalosur arsyet tjera për shpalljen e këtij referendumi, Gjyljas Fejzullau do shtojë. Se "...partitë politike shqiptare deri tash nuk mundën t'i realizojnë përcaktimet e veta programore prandaj ka rrezik që të tëhuajësohet masa e gjerë. Pra, duhet bërë diçka..." ("Zëri", 11,01.1991). Pra duhej bërë diçka, por jo të tendosësh mjegullën, nuk duhej sërish prapë ta nxjerrësh popullin përpara, që ai t'u shërbente politikanëve si mbulesë për mosbërjet e tyre. Pra, duhej bërë dika, dhe PPD-ja bëri diçka që si shumëçka tjetër dilte se është asgjë, se vetëm thellonte mosëdurimet ndëretnike, dhe Maqedoninë e çonte drejtë e te krismat e para në Tanushë. Pra, u bë diçka që qysh atëherë PPD-ja e promovoi si mënyrë më të vlefshme të veprimit partiak – aty ku nuk mundesh të bësh gjë, nxirre popullin përpara



barrikadave – rreziko rininë. Gjë të cilën më vonë deri në përpikëri do e përsosnin dhe do e përdornin të gjitha partitë tjera, veçanërisht PDSH-ja e Arbër Xhaferit, e cila me politikën e saj populiste, radikalizmin e shqiptarëve e ngriti disa gradë më lartë.

Duhet thënë se deri te referendumi për autonomi Kulturore - territoriale, shqiptarët e Maqedonisë kishin arritur duke ecur nëpër rrugën me gropa të shpirtngushtësisë së politikanëve të etnitetit maqedonas. Si dhe nëpër rrugën e shtruar me premtimet e pamatura të përfaqësuesve të vet, të cilët popullit ia bënë si të mundshme edhe gjërat për të cilat ata paraprakisht e dinin se kurrë nuk do realizoheshin. Kjo rrugë ishte e ngushtë dhe e ndodhur mes dy mezhdave – nga njëra anë atë të politikanëve shpirtngushtë nacionalistë të etnitetit maqedonas dhe nga ana tjetër me mezhdën e rritur nga nacionalromantizmi i politikanëve të paaftë shqiptarë. E kjo rrugë nëpër të cilën ecnin shqiptarët e Maqedonisë, një ditë do mbushej aq shumë me rinin e pakënaqur, sa do bëhej e pakalueshme dhe do ndodhte ajo që ndodhi në 2001.

Duke u përballur me tre dështimet e tyre politike më të mëdha: regjistrimin, referendumin për pavarësinë e Maqedonisë dhe Kushtetutën që ishin bërë pa pajtimin dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve, përfaqësuesit e atëhershëm politik kërkonin mbulesë (apo donin ta kërcënonin palën e etnitetit maqedonas me diçka më të “rrezikshme” për Maqedoninë) andaj edhe shpallën autonominë e tyre. Por, arroganca e

politikanëve maqedonas asokohe ishte e mbështetur mbi “sukseset” që i arrinte Millosheviqi në Kosovë, si dhe në shpresën e tyre se tani i kishin zënë “ngushtë” shqiptarët e këtushëm dhe mundeshin të qetë t’ia vinin kulmin shtëpisë së vetme të tyre etnike.

Sa i përket referendimit për autonomi, mund të thuhet se ai pati me shumë jehonë jashtë, se sa brenda në Maqedoni. Vendorët thuajse më ishin mësuar me referendume dhe me autonomi që mbinin e vdisnin në të gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë. Kështu që asokohe vjen një akt i parë seriozë nga jashtë lidhur me këtë referendum. Në të njëjtën ditë kur botohet lajmi për takimin e Alojz Mokut me Kryeministrin e Kosovës, Bujar Bukoshin, do bëhet publike edhe deklarata e Mokut ku ai thotë: “Maqedonia duhet të respektojë vullnetin e popullatës shqiptare të shprehur në referendumin për autonomi politike-territoriale.” Kështu mendonte Moku, mbase duke mos e ditur se ata që kishin shpallur dhe organizuar referendumin, popullit të vet ende nuk i kishin shpjeguar se çka do të përfshinte kjo autonomi, sidomos nën atributin “territorial”. Apo thjeshtë, “Ilirida” ishte autonomi që nuk kishte hartën e vet, e cila si shumëçka që bënin asokohe shqiptarët e Maqedonisë, më parë i vihej emri, e pastaj fillonte ngjizja e “fëmijës”. E në ndërkohë, të dy palët bënin punën e vet: pala e etnitetit maqedonas referendumin e konsideronte si jolegjitim, dhe ajo shqiptare thuajse nuk dinte ç’të bëjë me të, prandaj kërkonte takim me Gligorovin

për të arritur marrëveshje. E Gligorovi asokohe nuk kishte kohë për referendumin e shqiptarëve, sepse kishte takime me gjeneralin Axhiq rreth tërheqjes së Armatës Jugosllave nga Maqedonia. Pra, Gligorovi vazhdonte të blejë kohë, e të cilën shqiptarët ia shisnin shumë lirë. Në ndërkohë edhe shitësit edhe blerësi i kohës, bënë të njëjtin gabim: luanin me më të rrezikshmen për Maqedoninë - me ndjenjat etnike të qytetarëve të këtij shteti të posa mëvetësuar.

Ka shumë ngjarje, ka shumë emra, ka shumë data që e shtruan rrugën që Maqedoninë e sollën deri te 2001. Njësoj siç ka shumë qarqe të cilat donin me çdo kusht këtë konflikt ta çonin të merr përmasa të luftës ndëretnike. Por, mbetet e vërteta se 2001 dhe Marrëveshja e Ohrit, arritën Maqedoninë ta barazonin me vetveten. Ta nxirrnin nga balta e vetëgënjimit, se ishte shembull për demokracinë botërore. Dhe e ndodhur përball vetvetes, Maqedonia e 2001 e kishte rëndë ta pranojë se konflikti i këtij viti ishte prodhim i saj autokton, se atë e kishin nisur dhe përfunduar të rinjtë shqiptarë të Maqedonisë të udhëhequr nga Ali Ahmeti. Më në fund, 2001 i solli Maqedonisë edhe një vetëdije të re që në të ardhmen mund ta ndihmonte më lehtë ta kuptonte se nuk ka fat për këtë shtet nëse ai është dëshirë vetëm e një etniteti – atij maqedonas. Se ardhmëria e shtetit varej edhe nga ajo se sa jo-maqedonasit atë do e ndjenin si shtet të tyre.

Nuk ka dyshim se 2001 e begatoi historinë e Maqedonisë. E Maqedonisë - si edhe shumë shteteve të këtij regjioni - i mungonte shumëçka, por jo edhe

sasia e historisë. Bile, kur bëhet fjalë për historinë, këtë shtet thujse gjithmonë e kishte përcjellë (dis)fati që thujse tërë kalendarin historik ta ketë të thurur nga data të lavdishme, të cilave shumëkush ua nxirrte rrënjën katrore dhe i shumëzon me të vërtetat kundërthënëse. Jo vetëm shkaku se historinë e dyfishtë të këtij shteti, ndaras e shkruajnë dy etnitetet numerikisht më të mëdha – maqedonasit etnik dhe shqiptarët - por edhe shkaku se shumë personazhe të lavdishme dhe data të shënuara nga e kaluara e etnitetin maqedonas, ndërliidhen edhe me lavdinë dhe historinë e disa popujve fqinjë. Kështu që një pjesë e historisë së këtij shteti mbytet në lavdinë e cila u takon edhe të tjerëve, ndërsa kalendarin bashkëkohor i Maqedonisë ngatërrohet mes datave që nuk kanë domethënie të njëjtë për të gjithë qytetarët e saj.

Kur bëhet fjalë për historinë bashkëkohore të këtij shteti, lëmsh më i ngatërruar mbetet viti i 2001 kur nga një konflikt i armatosur, i ngutshëm dhe i shkurtër, dolën aq komandant dhe heronj thujse lufta kishte përmasa botërore. Konflikt për të cilin ekzistojnë dy të vërteta, të cilat mbase vetëm e shtojnë mjegullën mbi atë që ndodhi dhe aspak nuk kontribuojnë në qartësimin e tij, konflikt që u përmbyll me dy lloj përmendoresh: ato që shteti ua ndërtonte “brانيتelave” (“mbrojtësve”), dhe ato që shqiptarët ua ngrinin çlirimtarëve të vet të rënë gjatë konfliktit.

Por, Maqedonia e pas Marrëveshjes së Ohrit, nuk kishte vetëm hallin e përmendoreve që

maqedonasit etnik ua ndërtojnë “mbrojtësve” të vet, e as brengën për lartësinë e obeliskëve që shqiptarët ua ngrinin luftëtarëve të tyre për liri e barazi të UÇK-së. Shkupi zyrtarë i dekadës së parë të mileniumit të tretë, mbytej në vorbullën e dëshirës së maqedonasve etnik që shteti të paguante harxhimet për mbrojtjen e dy të akuzuarve për krime lufte në Hagë - Lube Boshkovski ( ish Ministër i policisë) dhe Johan Tarçullovskin (funktionar i lartë policor) – dhe në vorbullën e kërkesave shqiptare që shteti të mos përdorë taksat e tyre për të paguar avokatët e dy të akuzuarve për vrasjen e shqiptarëve të pafajshëm. E ndodhur në mes të ndjenjave të maqedonasve etnik për të cilët dy të akuzuar ishin heronj dhe ndjesive të shqiptarëve për të cilët Boshkovski dhe Tarçullovski simbolizonin fatkeqësinë e shumë familjeve nga fshati Luboten në afërsi të Shkupit, qeveria e Maqedonisë e pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, ishte shndërruar në pasqyrë ku thyheshin kalendarët e të vërtetave kundërthënëse për konfliktin e 2001, e mbi të cilat të vërteta ndërtohej historia e dyfishtë e këtij shteti.

Konflikti i 2001 në Maqedoni nuk solli vetëm ndryshime rrënjësore kushtetuese, por shtetin e shndërroi në djep të ngushtë ku duhej të luhateshin dhe rriteshin e vërteta e etnitetit maqedonas se atë vit shteti ishte i sulmuar, andaj tani ai duhet të kujdeset për “mbrojtësit” e vet, si dhe e vërteta shqiptare se UÇK-ja luftoi kundër një sistemi shtetërorë që ishte diskriminues ndaj tyre, andaj edhe ai shtet duheshite t’i merr në mbrojtje familjet e dëshmorët të rënë në

luftë dhe familjet e dëmtuara nga luftimet gjatë konfliktit. Dhe përderisa mbeteshin hamendjet se vallë kryengritja e shqiptarëve ishte kundër sistemit shtetërorë, apo bëhej fjalë për paradhomën e një konflikti ndëretnik mes maqedonasve etnik dhe shqiptarëve, Shkupi zyrtarë zgjodhi që në heshtje të ndërmer m masa që të dëmshpërblej maqedonasit të cilët u dëmtuan nga lufta. Ndërkohë, familjet e të vrarëve dhe invalidët e UÇK-së, i la në duart e BDI-së së Ali Ahmetit. Me çka u zmadhua mundësia që kundërshtarët e Ahmetit të thoshin se ai ndoshta e fitoi luftën, por e humbi paqen: se krahasuar me “mbrojtësit” e etnitetit maqedonas, ata që flijuan çdo gjë për të mirën e shqiptarëve të Maqedonisë, mbetën të pambrojtur dhe pa kujdesin institucional .

Andaj edhe polemika ndëretnike se vallë Boshkovski dhe Tarçullovski ishin mbrojtës apo kriminel të luftës (gjë të cilën do e dëshmonte gjyqi i Hagës), shpjegonte shumëçka që ndoshta nuk do të jetë e përfshirë as në kaptinën e historisë për konfliktin e 2001. Mbase qëndrimi ndaj këtyre të dyve më së miri dëshmonte të vërtetën se në vetëdijen e maqedonasve etnik mbeti e gjallë bindja se shteti dhe institucionet e tij janë në shërbim të mbrojtjes vetëm të interesave të tyre. Dhe se çdo sulm kundër institucioneve shtetërore, ka kuptimin e vërsuljes mbi tërë etnitetin maqedonas. Andaj, nëse Shkupi zyrtarë dy të akuzuarit në Hagë i promovonte si “mbrojtës” të shtetit, shtrohej pyetja logjike se cilët ishin ata që sulmuan dhe donin të pushtonin Maqedoninë. Dhe për çfarë i akuzonte

gjqy i Hagës? Mos vallë ky shtet i konsideronte si “okupues” të rinjtë shqiptarë nga Maqedonia që u ngritën kundër një sistemi diskriminues shtetërorë, i cili u verifikua si i tillë me Marrëveshjen e Ohrit, në bazë të së cilës u bënë ndryshime kushtetuese.

Ndoshta konflikti i 2001 edhe më tej do mbetet i mbuluar me mjegullën e marrëdhënieve të ndjeshme shqiptaro-maqedonase dhe Shkupi zyrtarë edhe në të ardhmen, herë pas herë, do përballet me të vërtetën të cilën tani për tani askush nuk dëshiron ta pranojë: UÇK-ja nuk luftoi kundër etnitetit maqedonas, por për të drejtat e shqiptarëve. Dhe se humbës nga ky konflikt dolën vetëm elitat politike (përfshi edhe ato shqiptare), të cilat më shumë se një dekadë nuk bënë asgjë që t’i paraprinin konfliktit duke u përballur me realitetin shumetnik të Maqedonisë. Duke mos pasur forcë të përballen me këtë të vërtetë, elitat politike të Maqedonisë së pas Marrëveshjes së Ohrit, vazhduan të gjejnë zgjidhje ditore për kërkesat e “mbrojtësve” të etnitetit maqedonas. Kështu që kryeministrat (mbase edhe për të arritur pikë të zgjedhësive të tyre) lavdëroheshin se qeveria do i paguante harxhimet për mbrojtjen e dy të akuzuarve në Hagë, ndërsa pushtetarët shqiptarë arsyetoheshin se nuk ekzistonte një vendim i këtillë i qeverisë ku bënë pjesë edhe ministrat shqiptarë. Dhe as njëra as tjetra palë – ndoshta me të drejtë – nuk jepnin përgjigje se çka do bëhet me përmendoret e dyfishta që ndërtoheshin në Maqedoni dhe sa lloj dekoratash do kishte për heronjtë e konfliktit të 2001.

Maqedonia e pas Marrëveshjes së Ohrit, nuk për-

ballej vetëm me varfërinë dhe të rinjtë e papunë, por hapin e saj drejt së ardhmes e ngatërronte edhe historia e dyfishtë e saj të cilën ndaras e shkruanin maqedonasit etnik dhe shqiptarët . Në ndërkohe, dikush duheshite t’u tregojë politikanëve të këtushëm se një shtet me histori të dyfishtë, rëndom mbetet si djep i ngushtë ku bëjnë gjumë kundërthëniet të cilat rriten duke dëgjuar ninulla në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe. Dhe këto kundërthënie një ditë mund të zgjaten në hije e cila nuk do mbulojë vetëm historinë bashkëkohore të këtij shteti, por edhe rrugën drejt të ardhmes së Maqedonisë. Gjithsesi, se në historinë e re të Maqedonisë si shtet i mëvetshëm dhe sovranë, do mbetet i shënuar edhe emri i Ali Ahmetit. Dhe kjo kaptinë gjithsesi do jetë nga më të rëndësishmet për t’u zbërthyer drejtë edhe ngjarjet e 2001 dhe do duhej të mbajë titullin “Abazi, Aliu dhe zotëri Ahmeti”. Shkaku se udhëheqësi i UÇK-së, me kthimit e tij në Maqedoni, e mbylli rrethin e fatit të një gjenerate, rreth të përbërë nga tre ngjyrimet jetësore që duken si të shënonin fitoren e “olimpiadës” jetësore: atë të Aliut të përndjekur nga sigurimi Jugosllav, atë të Abazit që i ra në hise të bëhet luftarak dhe pse çdo gjë në të ishte në paqe me vetveten dhe të tjerët, dhe atë të zotëri Ahmetit, i cili do merret aktivisht me politikë duke dalë në krye të BDI-së, ku edhe si kryesues partiakë do mbetet “misionar” i cili u përkulet veprave e jo fjalëve boshe. Andaj pra, edhe roli i tij në historinë bashkëkohore shqiptare dhe atë të Maqedonisë, duhet vlerësuar me tri peshore: atë të Aliut si atdhetarë dhe kyrbetçarë



në Zvicër, atë të Abazit si themelues dhe udhëheqësi i UÇK-va shqiptare dhe atë të zotëri Ahmetit si politikan dhe udhëheqës i BDI-së.

E kur para shume vitesh (1984), i riu Ali Ahmeti u nis për në Zvicër, tërë kapitali i tij material dhe shpirtërorë, ka mundësi të kenë qenë disa valixhe me plaçka personale, ëndrrat e rrënuara rinore për një jetë të qetë, mllefi ndaj diskriminimit që ushtronte regjimi i atëhershëm i Jugosllavisë së Titos dhe mallkimit i tij drejtuar një shoqërie që e kishte detyruar të braktiste vendlindja. Kuptohet, ai pas vetes kishte lënë edhe të dhënat personale të shënuara në të gjitha listat e armiqve, në dosjen e tij policore ku e kishin nënvizuar si armik të “bashkim-vëllazërimit” të Jugosllavisë së Titos. Mbase në atë dosje kishte edhe shumë të dhëna tjera që e bënë të jetë një ndër “armiqtë” më të kërkuar nga shërbimet policore dhe sekrete të ish federatës së dikurshme socialiste.

Kur para shumë vitesh Ali Ahmeti e kishte marrë rrugën e mërgimit, ai me siguri do i ketë marrë me vete edhe idealet e gjeneratës së Jusuf Gërvallës, jehonën e këngës së Zajasit, freskinë e pyjeve të vendlindjes si dhe bekimin e nënës që kudo që të shkonte, duhej të mos harronte, se të ruash burrin dhe krenarinë vetjake, do të thoshte të bësh çmos ta ruash edhe dinjitetin e popullit të cilit i takon. Kështu që, me shkuarjen në Zvicër ai ia siguroi vetes mundësinë që të mos kishte fatin e thujse të gjithë liderëve të mëvonshëm partiak të shqiptarëve të Maqedonisë, të cilët në kohën kur

Aliu u nis rrugës së mërgimit, ata ishin komunist të devotshëm dhe jepnin kontribut konkret për të shpëtuar sistemin e “lumturisë njerëzore” - Jugosllavinë e Titos. E në kohën kur Abazi erdhi në malet e Maqedonisë, disa nga ata të njëjtit ishin bërë demokratë dhe atdhetarë të mirëfilltë që merreshin me dështimet e veta.

Njeriu mundet vetëm të paragjykojë se ç’caqe jetësore e kanë joshur Ali Ahmetin në vitet e para të mërgimitarit në Zvicër. Mbase një ditë do kompletohet tërë rrëfimi për një gjeneratë që larg atdheut ndërtonte ëndrrat për ardhmërinë më të mirë të shqiptarëve që jetonin në ish-Jugosllavi. Ajo që mundë të parashikohet si diçka e mundur për moshën dhe njeriun që asokohe iku nga vendlindja, ndoshta është mundësia se gjatë largimit ai as që ka mundur ta planifikoj mënyrën dhe kohën e kthimit, vendkalimin kufitar ku do ta pres nëna e përmalluar, e aq më pak se vitin e ri të 2002 do ta pres në Shipkovicën malore. Mbase ai vështirë se ka mundur ta pararendojë veten si Abazin që do jetë një nga themeluesit e UÇK-së së Kosovës, e më vonë do qëndrojë në krye të UÇK-së së Maqedonisë, e cila për disa muaj arriti të ç’vendos shumëçka në këtë shtet.

Tani kur shumëçka dihet edhe për Aliun, i cili iu bashkëngjiti kolonës së të rinjve që nuk i deshi vendlindja dhe morën në sy botën, si edhe për Abazin (nofka luftarake e Ali Ahmetit) të UÇK-së, nuk ka asnjë mëdyshje se për bashkëkombësit e tij në Maqedoni, emri dhe veprimtaria e tij, kanë peshë

dhe simbolikë të madhe. Pra, nuk ka mëdyshje se edhe Aliu i Zvicrës, edhe Abazi UÇK-së, janë pjesë e rrëfimit për një gjeneratë që flijoi rini dhe ardhmëri, vetëm që t'u përkushtoheshin idealeve të veta. Me çka edhe bëhet tepër i rëndësishëm çdo veprim i mëtutjeshëm i Zotit Ahmeti, figurës më karizmatike politike në historinë e re të shqiptarëve të Maqedonisë. Edhe atë sa shkak i veprimtarisë së tij atdhetare, po aq edhe nga arsytet se në prapavijën e këtij portreti qëndrojnë të gjithë komandantët e tij dhe mijëra të rinj që i besuan dhe nuk e lanë në mes të rrugës as atëherë kur rrallëkush mund ta paramendonte se si do të zhvilloheshin ngjarjet. As atëherë kur opinionin maqedonas i identifikonte si "terroristë" e vrasës, e disa politikanë shqiptarë si "rambo" të bezdisshëm që ua prishën qetësinë sunduese.

Nëse Aliun e njihnin shumë pak njerëz të qarqeve atdhetare të emigracionit shqiptarë në perëndim, ndërsa për Abazin u dëgjua në të gjitha kabinetet ushtarake dhe politike të botës, për zotëri Ahmeti e mëvonshëm si politikan, më së shumti flitej nëpër selitë e partive të shqiptarëve të Maqedonisë. Pas 2001, Ahmeti më i përfolur ishte nga udhëheqësit partiak shqiptarë, të cilët shumëçka nuk dinin për të, por dinin shumë për vetveten. Në mos më shumë, liderët shqiptarë të periudhës së parakonfliktit, e dinin se gjatë një dekade nuk kishin bërë thujtë asgjë që të përmirësohet pozita e shqiptarëve të Maqedonisë, dhe instinkti për të mbijetuar politikisht, u sinjalizon se zbritja e ish

udhëheqësit politik të UÇK-së nga Shipkovicë e Tetovës me kravatë në qafë, do mundë të kishte domethënien e rrokullisjet së tyre nga piramidat partiake. Kështu që menjëherë pas 2001 filluan thashtemet se vallë kryesuesit dhe komandantët e UÇK-së do të themelonin parti të re, apo do u bashkëngjiteshin partive ekzistuese.

Dhe këto pyetje ishin të pritura. Andaj edhe kishte të atillë që mendonin se Ali Ahmeti nuk duhet të themelonte parti të veten, se ai duhej të mbetej anësh e t'u lejonte luftëtarëve të tij që e donin atë, të anëtarësoheshin në partitë ekzistuese. Kishte edhe të atillë që mendonin se pa një subjekt të vetin politikë, udhëheqësit e UÇK-së do mbeteshin në çeltirë, të pambrojtur, se do mund të ndodhte që policët t'i mbyllnin, ndërsa partiakët shqiptarë t'i çlironin sa për të dëshmuar patriotizmin e vet. Gjithsesi, kishte shumë qëndrime lidhur me atë se si duhej të vepronte Ali Ahmeti pasi u nënshkrua Marrëveshja e Ohrit dhe Maqedonia duhej të nisej një rrugë tjetër, por Ali Ahmeti zgjodhi rrugën e vetme që njëjtte: të themelonte Këshillin Koordinues të partive shqiptare që deri në realizimin e Marrëveshjes së Ohrit të ndërpriteshin zënkat ndërpartiake rreth çështjeve madhore, të cilat duheshin të realizoheshin. Dhe mu ky veprim i tij ndoshta më së miri dëshmoi se sa edhe ai nuk i njëjtte udhëheqësit grindavec të shqiptarëve të Maqedonisë, se sa nuk e njëjtte dinakërinë e disa prijësve partiak që kishin dalë në krye të partive jo të brengosur për fatin e popullit të Maqedonisë, por të vendosur të bëhen kapitalistë.

Përderisa të tjerët parashikonin veprimet e ardhshme të Ali Ahmetit, ai kishte hall tjetër: si të ndihmoheshin familjet që mbetën pa bij, baba apo vëllezër, si të ndihmoheshin bashkëlufetarët që mbetën invalid, pa shtëpi, fëmijët të cilët mbetën jetimë.... Spekulumet se si do vepronte Ali Ahmeti pa veshjen ushtarake, lindën në kabinetet e liderëve partiakë që në paqe duan të jenë vizatues të koncepteve mbarëkombëtare, njerëz të cilët gjatë konflikteve të armatosura bëjnë politikë e jo luftë dhe që e preferojnë "maratonën e jo sprintin". Sepse vetëm atyre u konvenonte një "komprometim" sa më i shpejtë i Ali Ahmetit si politikan. Posaçërisht pasi kishte përfunduar konflikti dhe Ahmeti kishte një përparësi të madhe, pasi që i kishte lënë nën hije të gjitha figurat e udhëheqësve partiak të shqiptarëve të Maqedonisë. Mbase të prirë të njollosin çdonjërin që mund t'ua rrezikonte pozitat, qysh asokohe, para se Ali Ahmeti të shpallte themelimin e partisë, filluan akuzat perverse se ai kishte bërë luftë që të vinte në pushtet. Budallenjtë të cilët këto akuza ua drejtonin të ngjashmëve me vetveten, harronin paraprakisht t'i përgjigjen një pyetjeje: e kush i kishte garantuar Ali Ahmetit se konflikti do përfundonte ashtu siç përfundoi, dhe mos vallë ai kishte nënshkruar kontratë me Zotin se nuk do pësonte gjatë betejave me ushtrinë dhe policinë maqedonase në kohë kur të gjithë e donin kokën e tij?!

Realisht vlerësuar, nëse Zotëri Ahmeti i paskonfliktit në Maqedoni me të vërtetë dëshironte t'i mbrojë Aliun e Zvicrës dhe Abazin e UÇK-së, nëse

dëshironte të mbetej atë që ishte para se të bëhej kryesues i BDI-së - "mbi të gjitha partitë dhe i të gjithë shqiptarëve të Maqedonisë" - dhe më në fund, nëse dëshironte t'i ikë "traditës" shqiptare që çdo vepër e bërë duhet të rezultojë me kolltukun e udhëheqësit politikë, atëherë ai dhe shokët e tij nuk kishin pse të lodhnin kokën me partitë politike. Sepse shqiptarët e këtushëm kishin nevojë edhe për një "institucion" i cili do të ishte "korrigjues" i politikës së ditës dhe të cilit të gjitha partitë do t'i kishin borxh. Marrë realisht, Ali Ahmeti nuk u kishte asgjë borxh partive politike shqiptare, e aq më pak duhej t'ua kishte zili udhëheqësve partiak shqiptarë. Kryesuesve të UÇK-së asokohe u mbetej vetëm edhe një obligim: të kujdeseshin për komandantët dhe të rinjtë që u besuan, të gjenin mënyra që t'i mbronin ish luftëtarët e vet nga shantazhet e partive ekzistuese shqiptare dhe të mos përfundonin një nga një në Idrizovë "për shkak të mbajtjes së armatimit pa leje". Pra, atyre u mbetej të mos lejonin që cilado parti të stoliset me stolin që nuk e meritonin dhe nuk u kishte hije - simpatitë për UÇK-në. Aq më shumë, kur Ali Ahmeti edhe ashtu një herë ua kishte shpëtuar kokën liderëve të PPD-së dhe PDSH-së - atëherë kur për hir të interesit kombëtarë i pranoi në "raportim" në Prizren edhe pse e dinte se gjatë krismave në Tanushë dhe Tetovë, disa nga shokët e tyre i thanë Dosta Dimovskës "Bjeru motër dhe mos i kurse, se jemi pushtet e jo mahi" dhe theksonin se "Qeni i keq ta sjell ujkun në oborr" - Abazi nuk kishte nevojë të vesh pallton e politikanit. Pra, ai du-

hej të rrinte larg atyre që ua shtriu dorën kur i erdhën në Prizren, e kur mbase e dinte se Xhaferi dhe Ymeri nuk e pranuan si liderë të barabartë të shqiptarëve pse donin, e as pse drejtë lexuan orën e fatit gruporë të shqiptarëve të Maqedonisë, por pse nuk kishin ku të shkonin përpos të mbeteshin në kaptinën e demokratizimit të kotë të shoqërisë së shqiptarëve të këtushëm. Pra atëherë kur, Arbëri mbeti pa "partnerin strategjik politik" – Lubço Georgievskin, ndërsa Ymeri edhe ashtu s'kishte çka të humbte më shumë se sa syzat në ballë. Pra, në kohë kur rinia shqiptare u lodh së dëgjuari premtimet e tyre të kota dhe shkoi atje ku kishte vlerë vetëm komanda e drejtë e Plakut (Gëzim Ostrenit) dhe komandantëve të tjerë të UÇK-së.

Kur filluan përfoljet se Ali Ahmeti do mund të bëhej edhe pjesë e kryesive të partive ekzistuese shqiptare, shumëkujt iu duk e paimagjinueshme të sheh Abazin të ulur pranë kryesuesve të PDSH-së. Jo se nuk i kishte hije si i vetmi që do ishte pa mjekër, por do të dukej jo i natyrshëm portreti i tij i "misionarit" të venitur nga malli për atdheun, në mesin e dy mjekrave të cilat nuk lejonin t'i lexosh grimasat e një Makijaveli dhe të një Fusheu. Aq më pak asokohe mundeshin njerëzit ta parafytyronin Ali Ahmetit në kreun partiak të PPD-së. Sa i përket shkuarjes së përfolur asokohe të Aliu Ahmetit në partinë e Kastriot Haxhirexhës, nuk mund të thuhet asgjë konkrete, e njeriu të mos gabonte, sepse bëhej fjalë për një parti me veprim të shkurtër politik, parti e cila vepronte sipas një parimi të drejtë: kur

nuk e dinte se si duhej vepruar, bënte të kundërtën nga ajo që bënin PDSH-ja dhe PPD-ja, dhe kështu i shmangte të gjitha gabimet politike. Kjo edhe mund të ishte strategji e mirë për veprim ditorë politik, por ende nuk ishte koncept politik që do mund ta joshte Ali Ahmetin.

Dilemat e trilluara se në cilën parti do shkonte Ali Ahmeti, kishin për qëllim përfitimin e ngutshëm të partive shqiptare nga kapitali i njeriut që simbolizonte UÇK-në. Pa dyshim se të gjithë partitë e donin atë në kryesit e tyre. Veçanërisht duke e ditur se asokohe ndaj tij kishin një përparësi të madhe: i njihnin mirë intrigat politike dhe mund të paragjykohej se shumë shpejtë do e komprometonin dhe do e bënin si vetvetja. E të bëheshe si ata, nuk nevojitej as shumë mjeshtri as posedim vlerash. Mjaf-tonte të mësohesh mjeshhtërinë që të mos skuqesh edhe kur e gënjen një popull të tërë.

Gjithsesi se dilemat e trilluara se në cilën parti duhet të vazhdonte aktivitetin e vet Ali Ahmeti dhe kryesuesit e UÇK-së të çarmatosur, ishin shumë të dëmshme. Sepse sollën hutesë edhe te ish pjesëtarët tjerë të UÇK-së, të cilët u ngutën të (ri)radhiteshin në partitë ekzistuese shqiptare. Pyetja që duhej shtruar atëherë duhej të ishte ajo të cilën e shtroi Ali Ahmeti: si të mundësohej që Shipkovicat të mbetej "kongres" i përbashkët i të gjitha partive shqiptare dhe korrigjues i punës së tyre gjatë dekadës së ardhshme kur do duhej të realizohej Marrëveshja e Ohrit, e cila më vonë nuk do realizohet si duhet edhe shkak i zënkave ndërpartiake shqiptare. Pra



duhej vepruar në drejtim që Shipkovica të mbetej ndërlidhje e Aliut të Zvicrës (gjeneratave me dekada të "diferencuara" nga pushteti komunistë Jugosllavë) dhe Abazit të UÇK-së (gjeneratës që u dha fund të gjitha "diferencimeve"). Ndërlidhje e cila do të ndërpriste njëherë e përgjithmonë traditën shqiptare, e cila aktivitetin politik e nënkupton si diademë më shndritëse e çdo veprimtarie shoqërore dhe intelektuale. Vetëm kështu mund t'i ikej rrezikut së përçarjeve së pasluftës në radhët e UÇK-së, të cilën e dëshironin të gjitha partitë na Maqedoni (edhe ato shqiptare edhe ato të etnitetit maqedonas) dhe vetëm kështu mundej të shmangej rreziku që kapitali i përgjakur i UÇK-së të ndotej nga manipulimet e politikës së ditës. Vetëm kështu Ali Ahmeti me shokët e vet do mundeshin t'i ndihmonin, t'i jepnin kohë dhe hapësirë gjeneratës së re, e cila do duhej ta pushtonte hapësirën politike shqiptare në Maqedoni pas Marrëveshjes së Ohrit. Asaj gjenerate, e cila nuk do ishte e ngarkuar me barrën e hipotekave nga e kaluara dhe do të dinte të lexojë kalendarin e kohës në të cilën jetonte.

Por dihet se kjo nuk ndodhi. Ali Ahmeti dhe bashkëkomandantët e tij, themeluan Bashkimin Demokratik për Integrim. Me çka e lanë të hapur pyetjen se mos vallë me daljen në krye të BDI-së, Aliu i Zvicrës dhe Abazi i UÇK-së u bënë "viktimë" e Zotëri Ahmeti si politikan. Mos vallë me këtë ai vetëm rriti numrin e "klubeve" politike të shqiptarëve të këtushëm, mos vallë me këtë ai do bëhej edhe një më shumë ne mesin e atyre që ua

hëngrën demokracinë dhjetëvjeçare shqiptarëve të Maqedonisë si të ishte djathë i Sharrit. Mbase këto dilema do të zgjasin aq sa do zgjasë edhe karriera politike e Ali Ahmetit, gjatë së cilës kohë do mundë të bëhet vlerësimi i saktë se vallë politikani Ali Ahmeti arriti t'i shpëtojë nga vetvetja Aliun e Zvicrës dhe Abazin e UÇK-së. E kjo do varet se sa kohë do i nevojitet Aliut politikan të kuptojë se sikur disa lider partiak ta kishin ditur se ai ishte kthyer në Maqedoni nëpër ngushticat malore të Sharrit në vitin 2001, ata do bënin çmos t'ia përçanin UÇK-në dhe çdo parti të kishte shtabin e vet ushtarak. Me çka, ngjashëm si me Universitetin e Tetovë, atë që do ndërtonte njëra parti, tjetra do e prishte.

Si do që të jetë, Ali Ahmeti u bë politikanë. Ai si i tillë iu kthye jetës në Zajasin e tij të lindjes, ku mbase nëna e tij më nuk ka mallin e dikurshëm kur priste t'i kthehej në shtëpi i biri. Nëna e tij ndoshta edhe i ka rrëfyer se shumë herë kishte votuar për partitë e këtushme shqiptare me shpresë se ndonjëra nga ato do ia kthente djalin në vendlindje. Por, asnjëra parti nuk pati kapacitet politik t'ia kthejë të birin dhe të rehabilitojë fëmijët e shumë nënave të tjera që dekada me radhë i "diferençoi" kush arriti. Edhe atë jo vetëm në kohën e socializmit të ish Jugosllavisë, por edhe gjatë një dekade të "demokracisë" maqedonase. Gjë që edhe e detyroi Ali Ahmetin të hapte një vendkalim kufitarë të vetin në majat e Sharrit, nga u kthye në vendlindje pa e kontrolluar policia maqedonase. Me çka ndoshta

edhe u ndërlihdhën ëndrrat e Aliut të ri dhe shokëve të tij, të cilët dikur moti braktisën vendlindjen si armiq të Jugosllavisë së Titos, me ato të Abazit dhe komandantëve të UÇK-së. Të cilët pa dyshim se kur kishin veshur uniformat e UÇK-së, as që kishin mundur të paramendonin se do e vazhdonin ardhmërinë e vet si politikanë.

E kur bëhet fjalë për uniformat, është e qartë se Ali Ahmeti ato i ndërroi shpesh. Por mbase ai kurrë nuk arriti të zhvesh kapotën e “misionarit”. Siç duket, ai i tillë mbeti edhe kur u bë pjesë e klasës politike të Maqedonisë, si edhe në vitet kur partia e tij ishte pjesë e koalicionit qeveritarë të udhëhequr nga Lidhja Socialdemokratike e Maqedonisë. I tillë ai do mbetet edhe pas zgjedhjeve parlamentare të 2006, kur mandatarin Gruevski do përfshijë në qeveri PDSH-në e Arbër Xhaferit, e jo BDI-në, e cila kishte marrë shumicën e votave të shqiptarëve të këtushëm. “Misionar” ai do mbetet edhe pas formimit të qeverisë së Gruevskit, kur kryesuesit e PDSH-së do bënin çmos që ta njollosnin veprimtarinë e tij si kryesues i dikurshëm i UÇK-së dhe udhëheqës i BDI-së. Sepse ai e dinte se nuk duhej të bëhej mbjellës i farës së përçarjeve brendashqiptare. Se e kishte kuptuar se dikush donte që shqiptarët e Maqedonisë të ndahehin si palestinezët e gjorë: në luftëtarët e “Hezbollahut” dhe ata të “All - Fatahut”. E që në ndërkohë dikush më lehtë të sundonte me shqiptarët. Që do të thoshte, edhe në kohën kur kryesuesit e PDSH-së e fyenin sikur të ishte emri dhe mbiemri i gjitha të këqijave të shqiptarisë, Ali

Ahmeti mbeti “misionari” i heshtur që mbështetej në atë që kishte bërë, e të cilën do ta dëshmonte e ardhmja. Pra, nuk u përgjigjej akuzave duke e ditur se ka një peshore që nuk do i ikë askush nga ata që ishin marrë me veprimtari që kishte përcaktuar fatin e një kolektiviteti dhe të një shteti – peshorja e kohës.

Shikuar nga ky kënd, mund të thuhet se Ali Ahmeti në politikë hyri si “hoxha” në “klubin e pijanecëve”. Apo, ai vonë e kuptoi se aty ku ishte futur, nuk vlenin gjë as sinqeritetit, as fjala e dhënë, e as përkushtimi dhe përgjegjësia ndaj vetvetes dhe të tjerëve. Andaj edhe linte përshtypjen e “shtëpiarës” së punësuar në “shtëpi publike”. Ku ta dish, ndoshta shumë vonë ai e kuptoi se nuk është e mundur të ruash pastërtinë e “misionarit” në hapësirën e politikës, se në teatrin politik është e kotë të luash vetveten. Se aty çdonjëri luan atë rol që i sjellë më shumë përfitime në çastin e duhur. Pra, prezantohen të atillë siç donte t’i shohë publiku, e jo me fytyrën e vërtetë që kanë. Ndoshta Ali Ahmeti këtë nuk arriti ta mësojë kurrë, andaj edhe shumë herë linte përshtypjen e politikanit i cili u besonte së tepërmi atyre që nuk e dinin ç’është besa, që nuk e dinin si duket njeriut i cili flijon çdo gjë për fjalën dhe premtimin e dhënë. Më në fund, ndoshta Ali Ahmeti edhe gjithmonë do mbetet ai që ka qenë edhe në Zvicër edhe me uniformën e UÇK-së: misionar që i përgjigjet thirrjes së ndërgjegjes së tij, thirrjes e cila thujse gjithmonë ka pasur jehonën e popullit që i takonte, thirrje që të thotë – bëje atë që mundesh, pa

pritur asgjë si kundërpagesë për veprimtarinë tënde!  
Por shtrohet pyetja sa do arrijnë këtë pastërti t'ia  
ruajnë ata që nga komandantë ushtarak, shumë  
shpejtë u bënë pronarë të “komandaturave” të tyre  
territoriale dhe politike, ku edhe ua përcaktonin  
fatin zgjedhësve të vet. Posaçërisht kur dihet se të  
gjitha mëkatet e një partie me të drejtë bien mbi  
shpinën e udhëheqësve partiak dhe bëhen shenjë  
njohëse e veprimit të tyre politik.



## Selitë alternative dhe bordelet partiake

Politika është veprimtari e cila ta krijon iluzionin se duke ecur rrugës së mërzitshme dhe të ngadaltë drejtë vdekjes, lë pas vetes gjurmë të pashlyeshme, si të gdhendura mbi gurë. Pra, politikanët janë nga pak njerëz të dehur nga iluzioni gënjeshtarë, i cili i bënë edhe të humbin kontaktin me realitetin që i rrethon. Apo ndodh që edhe proceset e pashmangshme nëpër të cilat kalon një shoqëri, ata t’ia përshkruajnë si meritë vetvetes. Andaj edhe në politikë kurrë nuk mund të përcaktohet qartë se vallë “publiku” është dehur nga shfaqja që ia ofrojnë politikanët, apo “aktorët” politik jetojnë në iluzionin se e ndryshojnë botën, se me projektet e tyre mund të ven nën kontroll “materien” më të lëvizshme e më depërtuese se uji – vetëdijen njerëzore. Shpeshherë ndodh që politikanët të vdesin me bindjen se do u ngrihen përmendore të larta, apo edhe të bindur se kanë bërë vepra të cilat do mbeten të përjetshme. Por, harrojnë se kanë vdekur politikanë që kanë besuar se populli do i vuaj me vite, e të jenë harruar që të nesërmen pas vdekjes, janë varrosur politikanë që kanë qenë shenjë e kthesave me përmasa botërore, e biografite e të cilëve nuk kanë më shumë se disa rreshta në enciklopeditë e

ndryshme, mirëpo ata që kanë mbet të pashlyer kur ndiqet zhvillimi i një shoqërie apo civilizimi, janë popujt dhe njerëzit që i kanë qëndruar mbrapa një projekti politik apo një politikani.

Andaj, politika si veprimtari më pak është prodhim i elitave politike, e më shumë i vetëdijes politike të një popullate. E përmendoret e politikanëve nuk janë hiç më shumë se portretet i kulturës politike të një shoqërie, në një periudhë të caktuar. Pra, portretet e politikanëve janë vetëm ballina e librit në brendinë e së cilit mbetet e shënuar pjekuria e një kolektiviteti të tërë, ku është pasqyruar ajo vetëdije se si ai popull e ka lexuar të tashmen e vet, e cila me shumëçka është përcaktuese për të ardhmen dhe për ata që do vijnë pas tyre. Andaj, edhe nuk janë të vlefshëm politikanët të cilëve duhet ngritur përmendore vetëm për atë që kanë bërë në të shkuarën, por ata që kanë pasur vizion për të ardhmen, ata që në arën e të sotmes kanë mbjellë farën e mbarë të ardhmërisë. Kështu që askush nuk ka nevojë të shlyej apo të zmadhojë meritat e ndonjë politikani, sepse veprat e tij i shlyen vetë koha si dhe pasardhësit e tij, sepse politikanët janë kanibalë që ushqehen duke i ngrënë meritat e pararendësve të tyre. Njësoj siç nuk ka nevojë njeriu atyre t'u ngre edhe përmendore, sepse rëndom çdo e ardhme sjellë heronjtë e ri politik, të cilët më shumë se çdokush urrejnë përmendoret e politikanëve të mëparshëm dhe duan me çdo kusht që në postament të qëndrojnë statuja e tyre. Dhe prandaj ndodh që përmendoret e politikanëve shumë shpjet të bëhen të pavlefshme



dhe të shërbejnë vetëm si pushimore për shpendët e lodhur.

Gjatë historikut të vet, të gjithë ballkanasit, duke i përfshirë këtu edhe shqiptarët e Maqedonisë, u janë përkulur shumë politikanëve, kanë përhëndetur me brohoritje shumë prijës, kryetarë e perandorë. Kanë ngritur, kanë vënë lule, e më pas i kanë pështyrë përmendoret që kanë shënuar gabime në kalendarin e zhvillimit të tyre shoqëror. Pra, kanë vepruar ashtu si çdo popull tjetër që shpreson, të cilit premtimet e reja i tingëllojnë më bindëse e më joshëse se ato të mëparshmet. Por, instinkti i brendshëm për të mbijetuar, gjithmonë i ka çuar kujdesshëm të ecin edhe rrugës që e njohin, kështu që shumë rrallë emrat e politikanëve i kanë përdorur për të emërtuar rrugë apo shkolla. Madje, edhe këngët që ua kanë kënduar atyre, i kanë thurur në atë mënyrë që emri i udhëheqësit politik të mbetet gjithmonë në mes të vargut, e që më vonë lehtë të zëvendësohet me atë të pasardhësit.

Këngët të cilat kanë mbetur, që janë kënduar në të gjitha kohët, janë ato për trimat që kanë flijuar më shumë se bindjet e veta dhe parullat, janë ato të kënduara për atdhetarët të cilët kanë bë vepra pa marrë “haraç” për bëmat e veta, që janë flijuar për të përfaqësuar sa më mirë popullin e vet dhe mjedisin nga vinë. Andaj, emra më të përdorur për emërtimin e objekteve të rëndësishëm dhe rrugëve ku banojnë shqiptarët, janë Skënderbeu, Nënë Tereza, Faik Konica, Noli....., dhe shumë pak, e thuajse aspak janë përdorur emrat e politikanëve të thjeshtë.

Është e vërtetë se shqiptarët e Maqedonisë, de-

mokracinë dhe shumëpartizmin e pritën ashtu si edhe gjithë të tjerët: me entuziazmin e atij që mezi pret të merr frymë lirshëm, që me vite ka ëndërruar të vetdëshmohej dhe të vetëvendos, duke harruar se mbase dikush ashtu e kishte pritur edhe socializmin. Pra, duke mos i shkuar mendja se ndoshta dikush, dhe atje thellë në të ardhmen, do e presë me të njëjtën eufori ndonjë rend të ri shoqërorë. Dhe nga ajo largësi kohore, euforia e 1990 kur edhe shqiptarët e Maqedonisë bënë parti, do duket shumë naive dhe ndoshta edhe qesharake. Posaçërisht kur të bëhet barazimi i euforisë së investuar dhe shpresave, me atë që ka ndodhur pas saj.

Andaj, ajo që shkruhet sot për demokratizimin e Maqedonisë që nga 1990 e deri në 2006, vlerësimet e tanishme për dy dekadat e para të shumëpartizmit tek shqiptarët e këtij shteti, është vetëm kontribut që pasardhësit të mund më lehtë të krahasojnë kalendarin e vet me gjeneratat të cilat jetonin në këto vite. Si dhe të mund të kuptojnë pse aq shpejtë gjatë shumëpartizmit, tek shqiptarët e Maqedonisë u krijua bindja perverse se politika është shtrat i cili u ofron rehati të gjithëve, edhe të pafytyrëve edhe bardëve, edhe të ndershmëve edhe atyre të cilët duke kërkuar moralin e vet të humbur, i shpallin të pamoralshëm të tjerët. Se politika është kamxhik për t'i goditur të gjithë ata që nuk mendojnë si ti dhe se është stoli e cila budallain e bënë të mençur dhe të pafytyrin bard.

Kjo që shkruhet sot, për ngjarjet politike të një dekade e gjysmë pas mëvetësimin të Maqedonisë, do

jetë përplot me subjektivizëm dhe pasaktësi, por sadopak, do u shërbej gjeneratave të ardhshme të kuptojnë pse qarqet politike dhe intelektuale të shqiptarëve të këtushëm, nuk e vërejtën me kohë as atë që është ditur gjithmonë: se shpeshherë politika ushqehet me shpresat e zgjedhësve, se më lirshëm vepron aty ku ajo flet e të tjerët vetëm heshtin dhe duartrokin, se më arrogante bëhet në mjedise ku njerëzit lehtë nënshtrohen dhe besojnë pa pyetur asgjë, se shpeshherë ajo është pëlhurë e bardhë mbi të cilën, si në asnjë tjetër, dallohen njollat e vetëdijes dhe pjekurisë individuale dhe grupore dhe se ajo mund të bëhet qefin i paturpësisë dhe vulë ku qartë është vizatuar diagrami i kulturës politike të një shoqërie.

Gjatë dy dekadave të para të demokratizimit të Maqedonisë, aktorët politik të shqiptarëve të këtushëm, kishin arritur të mbulojnë të vërtetën se politika është pasqyrë ku shihet fytyra e atyre që luajnë rolet kryesore në të, por edhe e atyre në emër të të cilëve protagonistët politik e zhvillojnë lojën. Pra, në atë pasqyrë nuk duket vetëm fytyra e të zgjedhurve të popullit, por edhe portreti gruporë i vetëdijes politike të zgjedhësve. Dhe ajo pasqyrë, si gjitha të tjerat, gjithmonë qëndron përpara protagonistëve, asaj nuk mund t'i ikësh edhe kur e anashkalon, ajo lëvizë, kthehet gjithmonë nga ana ku zhvillohen ngjarjet që t'i pasqyroj fytyrat edhe atëherë kur personazhet nuk e shohin atë.

Bindja e cila kishte marrë përmasat perverse gjatë dekadës së parë të demokratizimit të Maqedonisë, se

politika është kurvë e cila bie në shtrat me të pasurin për shkak të pasurisë, dhe me injorantin për shkak se ai është më i dëgjueshëm se i mençuri, ishte rezultat i mënyrës së veprimit të disa elitave të papërgjegjshme të partive shqiptare. Elita të cilat nuk mbanin llogari siç duhej që të mbronin dinjitetin dhe nderin e anëtarësisë së vet, simpatizantëve, të një grupi njerëzish dhe bile edhe të një kolektiviteti të tërë. Nga elitat e tilla partiake, të cilat veprimin politik e kishin kuptuar si diçka që të sjellë shumë të mira pa rrezikuar gjë, që në të vërtetë silleshin si të parët e "sekteve", të cilët manipulonin me popullin e lodhur në pritje të frymonte lirshëm dhe pa hallet që ia sillte përditshmëria në skamje dhe pa perspektivë, mund të priteshin vetëm grindje të pakuptimta. Pakuptimësia e këtyre grindjeve më e dukshme bëhej gjatë fushatave parazgjedhore për kryetarë të shtetit, kur nuk kishte as gjase teorike të fitojë ndonjë kandidat shqiptarë, por kur, përkundër kësaj, me kandidat të vetin dilnin thuajse të gjitha partitë më të mëdha shqiptare. Me çka fillonte një grindje mes shtabeve zgjedhore, e cila me shumëçka i ngjante asaj të shërbëtorëve që duhet të fitojnë besimin e pronarëve të tyre. Dhe partitë e tilla mendonin se propozimi i kandidatit për kryetarë shteti është çështje çajtoresh, punë e inatesh klanore, veprim që nuk ka dimensionin e prezantimit të një grupi dhe një kolektiviteti. Andaj edhe për këtë post propozonin kandidat të dorës së "tretë". Thuajse vetëm sa të ketë një emër dhe mbiemër rreth të cilit do rrotulloheshin grindjet që duheshin të dëshmon

forcën e “muskujve” të partive, të cilat qysh moti kishin filluar t’i forcojnë gjymtyrët për goditje, e jo kokën për të menduar.

Deri ku arrinte vetëdija e veprimit politik të partive shqiptare në Maqedoni, para se të ndodhte konflikti i 2001, më së miri u pa gjatë zgjedhjeve për presidentë të vitit 1999, kur u zgjodh Boris Trajkovski i ndjerë. Dhe kur u pa qartë se pse qarqeve politike të etnitetit maqedonas edhe nuk u pengonte gjithaq rrugaçëria partiake në shoqërinë shqiptare. Kur u duk ashiqare se ky veprim i partive shqiptare atyre u mundësonte të kenë partner që do u ofroj aq vota sa të zgjidhej president njeriu të cilin ata e favorizonin. U shpalos pra një vetëdije politike të luftosh për diçka që kurrë nuk mund ta realizosh, por me qëllim që t’i bëhet shërbim “partnerit strategjik” nga blloku partiak i etnitetit maqedonas. Dhe përderisa partitë shqiptare acaronin popullin dhe luftonin për ta fituar humbjen e tyre, vëzhguesit e jashtëm të zgjedhjeve krijonin imazhin për një elektorat i cili tërësisht ishte i kapur në kthetrat e partive dhe dilte në zgjedhje jo të votojë më të mirin, por atë që ia kishte përcaktuar partia si fat. Kështu ndodhi edhe gjatë zgjedhjes së Kiro Gligorovit si kryetarë kur aktivistët e PPD-së bën çmos ai të merrte sa më shumë vota të shqiptarëve, e njëjta, në formë edhe më të vrazhdë, ndodhi edhe gjatë zgjedhjes së Boris Trajkosvkit kryetarë, për të cilin mund të thuhet se erdhi në këtë post falë kryesuesve të PDSH-së, të cilët ia dhanë thujse të gjitha votat e zgjedhësve shqiptarë të cilët as që dolën të votonin.

“Kur VMRO-DPMNE-ja në pushtet vendosi që në zgjedhjet presidenciale më 1999 të dalë me kandidat të vetin, u parashtrua pyetja se cilat janë gjasat e thujse anonimisht Boris Trajkovski përballë kundërkandidatëve shumë më të njohur si Vasil Tupurkovski, nga Alternativa Demokratike në koalicion, Tito Petkovski, nga Lidhja Socialdemokrate dhe në atë kohë liberal-demokrati Stojan Andov. Pas rrethit të parë të zgjedhjeve presidenciale Trajkovski ngecte pas Petkovskit për rreth 110.000 vota. Dukej se ky dallim është i paarritshëm. Por, nënkryetari i PDSH-së arriti që me meritë personale, Trajkovskit t`ia sigurojë së paku 245.000 vota shqiptare. Në shoqërinë e ndarë në baza etnike është vështirë edhe të paramendohet se një kandidat presidencial maqedonas mund të fitojë 35.000 vota më tepër nga votat që të dy kandidatët presidencialë shqiptarë i fituan në rrethin e parë. Nënkryetari i PDSH-së përmes njerëzve të tij nëpër vendvotimet në Maqedoninë perëndimore i ‘huazoi’ votat e shqiptarëve të cilët nuk dolën për të votuar në rrethin e dytë dhe e bëri Boris Trajkovskin kryetar të dytë të Maqedonisë së pavarur. (“Lobi”, Nr.62). Ky përshkrim i analistit të javores “Lobi” shkurtë dhe qartë shpjegon se si u bë Trajkovski kryetari i parë “ multietnik” i një Maqedonie, ku çdo gjë funksiononte një etnikisht. Gjithashtu jep shpjegim edhe pse elitave politike të etnitetit maqedonas u konvenonte që partitë shqiptare t`i mbajnë sa më të shtrënguar zgjedhësit e vet. Sepse vetëm kështu mund të bëhej tregti me votat e shqiptarëve dhe

kështu dëshmohej diçka shumë trishtuese për votuesin shqiptarë: pronarë i votës nuk ishte votuesi shqiptarë, por partitë që thirreshin në emër të tij. Dhe e keqja më e madhe nuk qëndronte në mos përcaktimin e vetë shqiptarëve se cili do ishte kryetarë i shtetit, se sa në shndërrimin e shumëpartizmit si shumëbajraktarizëm, sa në përfaqësimin e shqiptarëve të këtushëm si popull që ende jeton në periudhën fisnore të organizimit të vet, kur “plaku i katundit” vendosë për gjithë të tjerët. Ky veprim i kryesuesve partiak, në njëfarë mënyre, e tregonte madhësinë katrore të primitivizmit kolektiv politik. Për shkak se, vet guximi i aktivistëve partiak të manipulonin me votën e zgjedhësve, vetë zënkat e “shtabeve zgjedhore”, shpjegonin se PPD-ja dhe PDSH-ja që moti zgjedhësit i konsideronin si një kope të dëgjueshme, e cila vetëm pret dikush t’i tregojë se kënd duhet ta votojë.

Ofendimet që u thuheshin kandidatëve dhe jobashkëmendimtarëve gjatë fushatave parazgjedhore në dekadën e parë të shumëpartizmit të Maqedonisë, e që publikoheshin në formë të “letrave nga lexuesit”, reagimeve të “shtabeve zgjedhore” dhe deklaratave publike të kryesuesve partiak, që moti e kishin kaluar kufirin i cili e ndante politikën nga barbarizmi dhe njeriun me ambicie të shëndosha nga ai me ambicie perverse. Dhe pa fije turpi, politikanët e këtushëm, çka nuk i kishin thënë njëri tjetrit publikisht, e që më vonë prapë të uleshin si bashkëmendimtarë, të cilët i bashkonte i njëjti qëllim – e mira e zgjedhësve. Me çka aq i përbuzën dhe i

ofenduan zgjedhësit e rëndomtë, sa të gjithë mendonin se viti 2001 e kishte fshirë nga vetëdija politike një veprim të tillë servil dhe se do merrte fund rrugaçërimi i veprimit partiak që kishte filluar qysh në vitet kur PPD-ja i bënte shërbime LSDMS-së, dhe mori përmasa dramatike në vitet kur PDSH-ja u vëllazërua me VMRO-DPMNE-në. Pra, të gjithë mendonin se pas 2001 kishte ardhur fundi i politikanëve të cilët shkakun i mlllefeve të ndërsjella, ofendonin individ, anëtarë familjesh, kolektivitete të tëra.

Shqiptarëve të këtushëm mund edhe të mos u pëlqente portreti i tyre i shprehur nëpërmjet partive politike, fytyra mund t'u jetë dukur jo aq e bukur sa e paragjykonin se e kanë, por ai që kishte sy të shihte, nuk do e kishte vështirë të vërejë se një primitivizëm i këtillë partiak, nuk do e çonte këtë popull më larg se aty ku arriti – të bëhet pronë e partive politike. Nuk kishte dyshim se ai primitivizëm pikë së pari zbulonte fytyrën e vërtetë të qarqeve të vendimmarrjes të PDSH-së dhe PDP-së, si dhe injorancën e atyre që mendonin se populli as kuptonte dhe as merrte vesh të gjë nga lojërat politike. Por, ambientet parazgjedhor në kampin politik shqiptarë, gjithmonë shpjegonin diçka edhe më shumë se kaq: në rrethana kur kandidatëve partiak u mungonin tema atdhetare dhe elemente për të shpall kundërshtarin “tradhtarë”, kur mbeteshin në çeltirë dhe kur u harxhoheshin parullat patriotike, ata vërsuleshin mbi kundërshtarin politik duke e zhveshur edhe nga gjëra intime që kurrë nuk ishin, e nuk do jenë pjesë e politikës. Mbase kjo



ndodhte edhe shkaku se shumë nga kandidatët partiak dhe anëtarët e "shtabeve zgjedhore", kishin aq "vlëra" sa nëse ua nxjerrje kravatën dhe emblemën partiake, nga ata nuk do mbetej as shkronja "V" e asaj që quhet vlerë personale, e cila të mundëson të qëndrosh në këmbë e të mbetesh njeri edhe kur ecë drejtë vdekjes me iluzionin se gjurmët që lë pas do mbeten të pashlyeshme, si të gdhendura në shkëmbinj të që nuk i bren koha.

Deri në 2001, partitë e shqiptarëve të Maqedonisë, arritën vetëm një rezultat të pamohueshëm: partizimin dhe politizimin e gjitha sferave jetësore. Edhe atë në aso përmasash, sa edhe pastruesit e shkollave ndërroheshin posa vinte partia e re në koalicionin qeveritarë. Apo, aq sa edhe udhëheqësit e institucioneve fetare, si ata të Bashkësisë Islame të Maqedonisë, e dinin se tani kishte kaluar koha kur fatin e tyre e përcaktonte Lidhje Socialiste e Maqedonisë, se tani do duhej të vlerësonin vëmendshëm se cila nga partitë shqiptare ishte ajo që ta "vë" e ta nxjerr "çallmën" e të parit. Kjo filloi qysh me kongresin e parë të PPD-së, kur kryetari i atëhershëm i BIM-së ndodhej i ulur në rendin e parë mes shumë politikanëve tjerë. Kjo do vazhdojë të ndodh edhe më vonë, kur partitë, e jo besimtarët ishin ato që e dinin se cili ishte ai që më lehtë e nëpër rrugën më të shkurtër mund t'i çonte myslimanët e këtushëm në parajsë. Kjo do ndodhë edhe në 2006, kur ata që e ndërruan kryetarin e BMI-së në vitin 1999 – PDSH-ja – po të njëjtin e kthyen aty nga e kishin rrokullisur. Ndoshta shkaku se në ndërkohë

kishin lexuar librin që u botua po atë vit, libër të botuar pa emrin e autorit, e ku shpaloseshin ndodhitë në këtë institucion më të lartë fetarë ku me vite nuk mund të zgjidhej i pari i myslimanëve të Maqedonisë.

E në vitin 2006, çka nuk u tha dhe çka nuk u përfol nëpër mediat e Maqedonisë lidhur me grindjet dhe përçarjet në Bashkësinë Islame të Maqedonisë, të cilën e tronditnin mosmarrëveshjet, të cilat nuk e linin të dilte nga një situatë kaotike ku thuajse çdonjëri ishte kundër të gjithëve. Vlerësimet e veta i thanë bile edhe të huajt, si për shembull një “ekspert” francez, i cili përkufizoi grupet “fundamentaliste” e “liberale” në këtë bashkësi. Thëniet e këtij “askperti” francez i cituan të gjithë mediat maqedonase, duke u nisur nga parimi se nëse një i huaj thotë se gjeli bënë ve, ne duhet menjëherë të dyshojmë se mos vallë pula ka herdhe.

Sido që të jetë, rrëfimi për situatën në BIM-së nuk ishte aq i ndërlikuar sa donin ta shpallin disa qarqe fetare dhe shtetërore për ta përdorur si argument për rrezikun nga “fundamentalizmi” islam. Në BIM-së nuk zhvillohet luftë as mes “mjekroshëve” dhe atyre pa mjekra, as mes “fundamentalistëve” dhe “liberalëve” fetarë. Por bëhej betejë se kush do ta ketë në duar këtë institucion financiarisht të pasur dhe me influencë të popullata shqiptare e Maqedonisë, e cila kryesisht i takonte religjionit islam. Pra, nuk ishte në pyetje as gjatësia e mjekrave, e as ngjyra e flamurit fetarë, por vetëm thellësia e xhepit të kapotave të prijësve fetarë, i cili

duhej mbushur me përfitime personale. Andaj, asokohe ishin naive rrëfimet për luftë drejtimesh ndërjetare. Jo se ato rryma nuk ekzistonin dhe nuk do i ketë edhe në të ardhmen, por ato tani përdorshin vetëm si mbulesë për t'u fshehur qëllimi i vërtetë i palëve të konfrontuara: kush do e kontrollojë pasurinë e madhe të këtij institucioni të shprehur në shumë dyqane, në lokacionet me të shtrenjta në Shkup dhe në qytetet tjera të Maqedonisë. Pra cila parti do kishte ndikim më të madh mbi një institucion që prezantonte numrin më të madh të zgjedhësve të tyre dhe që kishte në dorë thesar të begatë.

Sidoqoftë, asokohe ndodhi ajo që ndodhi dhe vazhdoi të ndodhte ajo që duhej pritur nga një institucion që partitë e kishin kapur në kthetrat e veta. Dhe BIM vazhdoi të paguaj llogaritë e të kaluarës. Sepse koha, si "fajdexhi" i saktë, herdo - kurdo vjen dhe e merr pagën që ia ke borxh. Nuk ka dyshim se rruga nëpër të cilën ecte BIM-së gjatë një dekade e gjysmë të demokratizimit të Maqedonisë, ishte e njëjtë me atë që e ecnin të gjitha institucionet tjera të pakta që i kishin shqiptarët e Maqedonisë. Ajo ishte rruga e daljes nga kthetrat e kontrollit komunistë, dhe e kapjes në ato të partive të këtushme shqiptare. Andaj edhe çdokundë kishin filluar grindjet. E ky argument u shërbente edhe qëllimkëqijve që nga ndonjëherë të sjellin përfundimin e saktë se, aty ku qortohen prijësit fetarë apo politikanët, nuk është në pyetje as feja as konceptet politike, por ose parat ose ndonjë grua.

Apo, se politikanët dhe prijësit fetarë janë të singërtë vetëm kur nxjerrin të palarat e njëri tjetrit. Atëherë ata kanë vetëm një qëllim: nuk u intereson as ferri as parajsa e asaj bote, por luftojnë për gjërat e lezetshme, të cilat Zoti i ka dërguar në këtë botë.

Por, i tërë ky partizim, të gjitha këto lojëra partiake, të mbuluara me kapotën e hoxhallarëve apo me kravatat e “intelektualëve të pavarur”, nuk morën fund ashtu siç shpresonin shqiptarët e këtushëm: me konfliktin e 2001, i cili vit dëshmoi se ku mund të arrijë një shoqëri e ushqyer me gënjeshtër dhe frustracione politike. Mbase kjo nuk u realizua, sepse pas 2001, Ahmeti dhe shokët e tij, nuk e njihnin sa duhet as realitetin e këtushëm politikë, e as të kaluarën shumëpartiake të shqiptarëve të këtushëm.

Abazi, i cili pas përfundimit të konfliktit të 2001, duheshte të vë kollaren e politikanit dhe të nisë një betejë të re, nuk kishte njohuri të mëdha për veprimin politik, por gjithsesi se qysh në takimet e para me liderët e partive të këtushme shqiptare, është dashur ta ketë hetuar se veprimi politik është shumë më ndryshe nga ai me të cilin Ahmeti ishte marrë në mënyrë sekrete në Zvicër dhe nga puna që kishte bërë si komandant dhe përfaqësues politik i UÇK-së. Pasi që politika ishte larg asaj me të cilën ishte marrë ai më parë – veprimtari që kërkonte gjithmonë të kujdesesh për fatin e shokut, të bësh çmos që të ndihmohet ata që ke përreth, të jesh i vetëdijshëm se urdhrat tua kanë të bëjnë me fatet njerëzore – shumë shpejt pasi e zhveshi uniformën e

UÇK-së, Ahmeti do e bëjë “gabimin” e parë dhe do e përjetojë dështimin e parë politikë, i cili do t’i kushtonte shumë: donte t’i grumbullojë rreth vetes të gjithë udhëheqësit e partive shqiptare. Pra, idealistë siç ishte, ai donte të realizojë të pamundurën, dhe do propozojë formimin e Këshillit Koordinues. I cili Këshillë, kishte për qëllim “të forcojë unitetin e brendshëm shqiptar në funksion të përshpejtimit të transformimit demokratik të bashkësisë shqiptare, së këndejmi edhe të vetë Maqedonisë; t’i maksimalizojë potencialet politike, ekonomike, sociale, kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë; të rris kredibilitetin e subjektit politik shqiptar si garantues i procesit të paqes dhe transformimit demokratik të Maqedonisë; të krijojë kushte më stabile për vendosje të marrëdhënieve më të qëndrueshme në mes të faktorit politik shqiptarë dhe faktorit ndërkombëtarë; të përshpejtojë procesin e implementimit të mirëfilltë të marrëveshjes së Ohrit; të përshpejtojë procesin e mirëbesimit, pajtimit ndëretnik...”

Në fillim u duk se propozimi ishte i qëlluar dhe se partitë ishin të gatshme për një bashkëpunim të këtillë. Po kështu u duk për ata që nuk e dinin se udhëheqësit e PPD-së dhe PDSH-së, asokohe do pranonin nga Ali Ahmeti edhe sikur ai nga ata të kërkonte të bëheshin anëtarë të ndonjë grupi folkloristik, ku do këndonin vetëm për heroizmin e luftëtarëve të UÇK-së, e jo më të anëtarëshoheshin në këtë Këshill koordinues i të gjitha partive shqiptare. Dhe këtë do e bënin sepse udhëheqësit partiakë, e

dinin se ishin delegitimuar përpara zgjedhësve dhe anëtarësisë, kështu që kishin nevojë që Ali Ahmeti t'ju jepte pak nga fama e atëhershme e UÇK-së, t'ua kthente legjitimitetin e humbur gjatë konfliktit.

Siç u cekë edhe më parë, Ymer Ymeri, Arbër Xhaferi dhe Kastriot Haxhirexha, qysh para se Ali Ahmeti të dilte me propozimin për themelimin e këtij këshilli, kishin filluar atë ta joshnin me ftesat publike që të bëhej pjesë e udhëheqësive të tyre partiake. Këtë nuk e bënë nga që ishin aq të brengosur për fatin e tij politik, por nga se e dinin se ai mund t'ua siguronte ardhmërinë e qetë partiake. Kur e panë se kjo nuk pinte ujë, ata s'kishin si mos e pranonin propozimin e Ahmetit për një këshill, i cili, siç thuhej në Shpalljen e 26 shkurtit të 2002, ishte rezultat i nevojës “për konsolidim urgjent të subjektit politik shqiptarë që në mënyrë më efikas të përballlet me kërkesat, sfidat e konteksti të ri historik”.

Dhe ndoshta Ali Ahmeti mirë e kishte lexuar kontekstin e ri historik, por gabimisht e kishte vlerësuar se ata të cilët donte t'i ketë bashkëveprimtarë në përballjen me këtë kontekst të ri shoqërorë, kryesisht ishin individ që ndryshimet shoqërore i masnin me të nesërmen e cila u sillte privilegje individuale. Ai edhe nuk kishte kohë të vlerësonte drejtë se përballë kishte një Ymer Ymeri që as vetë nuk e dinte se partia e tij ku e ka bishtin e ku kokën, se kishte përballë një Arbër Xhaferi që në parti ishte si punëtorë “sezonal” sa t'i jepte legjitimitet “maunokracisë”, të cilën e zhvillonte

nënkryetari i tij dhe në fund, se kishte përballë një Kastriot Haxhirexhën i cili politikës i dha çdo gjë që mundej, që nga ajo të merrte urtësinë se të jesh i sinqertë në politikë, është njësoj sikur të hysh cullak në hamamet e Stambollit.

Pra, udhëheqësit partiak nuk kishin si ta kundërshtoni propozimin e Ali Ahmetit për themelimin e një këshilli koordinues të partive shqiptare, ku do bënin pjesë përfaqësuesit e tri partive nënshkruese të kësaj marrëveshje: PPD, PDSH dhe PDK (Partia Demokratike Kombëtare). Shpalljen për themelimin e këtij Këshilli e nënshkruan të tre liderët partiak, me në krye Ali Ahmetin, i cili edhe duhej ta udhëhiqte këtë organ të përbashkët të partive shqiptare në Maqedoni. I entuziazmuar nga kjo e arrirë, Ahmeti as që mund ta paramendonte se ende pa u tharë ngjyra e nënshkrimeve, do fillonin lojërat ndërpartiake, të cilat shprehnin mosëdurimet e ndërjella të trashëguara nga vitet e parakonfliktit. Nuk do mund ta paramendojë se kryesuesit e PPD-së dhe PDSH-së, u pajtuan të merrnin pjesë në këtë Këshill, sepse dinin diçka që asokohe nuk e dinte sa duhet Ali Ahmeti: që të mbijetojë në politikë, politikani i mirë e bënë të domosdoshmen, e jo atë që donë. Pastaj, Ali Ahmeti përballë i kishte politikanët që kishin shijuar “grazhdin” kalorik të shtetit, dhe si të tillë, ishin të gatshëm të pranonin çka do qoftë që do i mbante edhe më tej sa më pranë kalorive. Pra e dinin se vetëm emblema e UÇK-së ishte ajo që mund t’i mbante ende politikisht të gjallë. Më në fund, kryesuesit e PPD-së dhe të PDSH-së, e dinin se me

përkrahjen e këtij propozimi, fitonin shumë e nuk humbnin asgjë. Fitonin një pjesë të shkronjave të UÇK-së dhe bindjen e popullatës se ata tani do e ndihmonin Ahmetin të gjente më mirë vetveten në kënetën politike të Maqedonisë. Pastaj, ata dinin diçka për të cilën asokohe Ali Ahmetit nuk mund t'i shkonte mendja: se politika është veprimtari ku është shumë i vlefshëm parimi që në çastin e duhur të bësh veprimin, i cili të shpëton nga harresa, që ta shton peshën edhe kur je i lehtë sa një pendël pule.

Pra, kryesuesit e PPD-së, të PDSH-së dhe të PDK-së, pa hamendje e pranuan propozimin për formimin e Këshillit Koordinues të partive shqiptare. Dhe u përqaftuan me Ali Ahmetin sikur të kishin qenë gjithmonë në të njëjtat fushëbeteja. Me këtë Ali Ahmeti në të vërtetë do e përqafojë dështimin e vetë të parë politik pas kthimit në Maqedoni. Me këtë ai në të vërtetë i rilegjitimoi disa nga udhëheqësit e partive të këtushme dhe e çoi popullin të besojë se edhe udhëheqësit partiak mund të bashkëpunojnë, e çoi pra popullin të mendojë se, pasi “ua fali fajin” Aliu, atëherë s’kishte pse të rikujtoheshin bëmat dhe zënkat e mëparshme.

Nuk është gjithaq enigmatike se ç’donte të arrijë Ali Ahmeti me themelimin e këtij Këshilli Koordinues. I dal nga “celulat” ideologjike të Zvicrës, ku të gjithë mërgatën atdhetare e mbante lidhur ideja se “bashkimi bënë fuqinë”, ai donte edhe këtu ta arrijë të njëjtën gjë. Donte që potenciali politik i shqiptarëve të këtushëm të jetë i bashkuar në çështjet madhore, të cilat përmenden në shpalljen



e bërë publike për themelimin e këtij Këshilli. Ai e dinte se me këtë marrëveshje nga pak edhe humbte kuptim shumëpartizmi i shqiptarëve të Maqedonisë, por gjithashtu e dinte se disa vite me radhë nuk do vlenin gjë programet partiake dhe platformat parazgjedhore, sepse për të gjitha ato forca partiake, Marrëveshja e Ohrit do ishte platformë të cilën do duhej ta realizonin. Dhe nëse ishte kështu, atëherë Ahmeti e kishte vlerësuar drejtë se partitë do duhej të vepronin të koordinuara lidhur me këtë çështje. Dhe se një veprim i bashkëkoordinuar do u jepte fund zënkave politike brendashqiptare.

Mund vetëm të paragjykohet se kush i pari tha “më mirë ndarë se sa të bashkuar”, por dihet se kryesuesit e PDSH-së ishin ata që të parët e braktisën Këshillin Koordinues. Edhe atë duke përdorur si shkak një sulm të armatosur nga persona të panjohur që asokohe iu bë “selisë alternative” të PDSH-së – kafenesë “Dora” në Tetovë. Sulm që me të drejtë i shqetësoi shqiptarët, sepse ishte paralajmërim ogurzi: se aktiviteti partiak tani kishte marrë përmasa edhe më trishtuese dhe në veprimtarinë e vet kishte futur edhe armët si instrument demokratik. Kuptohet, askush nuk mund ta dinte se kush ishin ata të cilët e bënë këtë vepër të shëmtuar në kohë kur shqiptarët prisnin bashkëpunim mes partive të tyre, e jo acarim të marrëdhënieve të ndërsjella, në kohën kur kryesuesit e partive kishin nënshkruar marrëveshjen për themelimin e Këshillit Koordinues.

Pas këtij sulmi të kafenesë “Dora”, filluan akuzat ndërpartiake mes PPD-së dhe PDSH-së. Disa qarqe

të PPD-së, e shprehën hapur mendimin se ky sulm kishte të bënte me “maunokracinë” e udhëheqësve të PDSH-së, ndërsa partia e Arbër Xhaferit kërkonte nga Ali Ahmeti që të distancohej nga këto vlerësime të kundërshtarëve politik. Mbase kjo ishte hera e parë kur Ali Ahmeti u gjet në mes një beteje të cilën ai nuk e njihte: atë të perversitetit politik, të cilin PDSH-ja e kishte ngritur deri në atë shkallë sa të vllente parimi se “arritja e cakut i arsyeton të gjitha mjetet”. Disa ditë pas këtij sulmi, nënkryetari i PDSH-së filloi të sfidojë edhe autoritetin e Ali Ahmetit me thënien: “Kush e ka autorizuar atë të vihet ne krye të këshillit?”. E Arbër Xhaferi, si gjithmonë, rrinte anësh dhe bënte pjesën e lojës që i takonte: t’i shpall si legjitime thëniet e nënkryetarit të tij. Dhe të thotë se pas nënkryetarit të PDSH-së “ka një strukturë të fortë (aludon në PDSH-në), dhe nëse kjo strukturë kërkon që unë të bëhem lider i saj, unë do ta pranoja ofertën.”

Pas gjithë kësaj, ishte e qartë se PDSH-ja mezi kishte pritur të gjejë shkak që të tërhiqej nga Këshilli Koordinues. Për këtë i shërbeu sulmi mbi kafenenë “Dora”. Sulm që do mbetet i pazbardhur deri sa të hapen të gjitha dosjet për ndodhitë e dy dekadave të para të demokratizimit të Maqedonisë. Siç do mbeten të pa shpalosura edhe arsyet e vërteta që e shtynë PDSH-në të shkatërronte një projekt, i cili pa dyshim se do e bënte më të fortë subjektin politik të shqiptarëve të Maqedonisë. Ajo që dihet është e vërteta se gjitha ato ngjarje paralajmëronin një acarim të mëtejme të marrëdhënieve ndërpartiake, se

edhe më tej shqiptarët e këtushëm do përballeshin me komunikata absurde të udhëheqësive partiake dhe me akuza të ndërsjella nga më perverset. Nga komunikata e atëhershme e PDSH-së, lidhur me incidentin e ndodhur në Tetovë, shqiptarët e këtushëm kishin rastin të kuptonin jo vetëm atë se cilat ishin “selitë alternative” të partive të tyre – kafenetë – por edhe të shihnin se prej moti ishin hapur “bordelet” partiake ku shiteshin e bliheshin “kurvat” politike. Popullit iu dha rasti të shihte edhe se si himnizoheshin kryesuesit e PDSH-së, nga ata që e dëshironin këtë përçarje mes partive shqiptare. Ndërkaq, mbeti e habitshme si askujt nuk iu kujtua të shkonte edhe me larg me marrëzinë e të nënshtruarit: të propozonte që në çdo kafene ku kishin pirë kafe krerët e PDSH-së, ta viheshin pllaka përkujtimore, ku nxënësit e shkollave do vendosnin buqeta lulesh për të shënuar kalendarin e lavdishëm politik, i cili filloi me premtimet e shumta dhe përfundoi me 2001.

Për fat të keq, gjatë kësaj kohe kur PDSH-ja hapur tregoi adresën e “selisë së vet alternative”, të paktë ishin ata që kishin guxim të thoshin se aty ku “selitë alternative” të partive politike janë kafenetë, duhet pritur që vendimet të sillen nëpër “bordelet” e nëntokës politike. Dhe ai kolektivitet, fatin e të cilit e përcaktojnë “bordelet partiake”, nuk duhet të brengoset për ardhmërinë e vet politike - ai popull nuk ka ardhmëri, por është “kope” e cila vlen vetëm si numër, si fletëvotim, me të cilin mbushen kutitë zgjedhore. Pra, një kolektivitet i tillë do e ketë

vështirë të shpëtojë nga kthetrat e atyre që asokohe ia “lehtësonin shpirtin” duke shpjeguar se sulmin mbi restorantin “Dora” e paskëshin bërë “qarqe policore”, pa shpjeguar se vallë bëhej fjalë për të njëjtat qarqe të MPB –së, e cila i furnizonte krerët e PDSH-së me dosjet e “spiunëve” shqiptarë, apo për ndonjë rrymë të re antishqiptare në këtë ministri.

“Sido që të jetë me ngjarjet në ‘Dora’ dhe rreth saj duket se mahinë e mori djalli. Tash edhe nuk është e rëndësishme se kush është autori (individ – qitës i lirë ose ndonjë tjetër) e as se kush qëndron prapa tij (në është fjala për revoltë individuale, qërim hesapësh me prapavijë kriminogjene apo politike), duket ashiqare se trolli politik po dridhet pareshtur dhe në vend që të qetësohet janë të pritshme dhe të mundshme dëme edhe më serioze në rrafshin politik”, shkruan Iso Rusi në javoren “Lobi” duke vazhduar se: “ Kafshata duket se është e madhe. E gjithë ideja për paraqitje të bashkuar e të bashkërenduar të subjekteve shqiptare me relevancë më të madhe politike, me mundësi të ndikimit më të efektshëm në rrethanat politike me këtë – është vënë në pikëpyetje.

Nga ana tjetër, ideja për Këshillin Koordinues nuk meriton mbështetje vetëm për shkak të faktit se atë e ka hedhur Ali Ahmeti me shokë. Ajo në mënyrë shumë reale ofron mundësitë më të mira që nga njëra anë politikanët shqiptarë të japin maksimumin në implementimin e Marrëveshjes së Ohrit duke bërë kështu realitet përmirësimin e shumëpritur të statusit të shqiptarëve në Maqedoni

dhe, nga ana tjetër, me realizimin e këtij objektivi të krijojnë parakushte për krijimin e ambientit politik në një vend pa tensione ndëretnike, me mundësi që shoqëria aty të mbështetet në individin-qytetarin dhe parimet e demokracisë të tipit perëndimor. Një qasje e këtillë tashmë është vënë re nga bashkësia ndërkombëtare dhe është cilësuar si 'shpresëdhënëse'. Mirëpo, janë regjistruar edhe ngjarjet e fundit të cilat, si të tilla, këtë synim e relativizojnë dukshëm dhe po jepen shenja të një përmbajtjeje të qartë nga mbështetja e mëtejme në pritje të asaj se çfarë kahe do të marrin punët. Në këtë mënyrë fajin në rast të dështimit të idesë, do s'do, do ta mbajnë të gjithë njësoj, ata të cilët janë në Këshill, edhe si individë, edhe përfaqësues të atyre të cilët i kanë deleguar. Të gjithë do të jenë ai 'pleshti' nga ballina dhe kjo nuk do të ketë kurrfarë kuptimi sepse 'jorgani' do të digjet.”

Por siç duket, jorgani më ishte djegur. Mbase shkaku se PDSH-ja nuk njihte veprim tjetër politik përpos atë të dikurshmin, veprim që nuk mbështetej në të arrirat vetjake, por mbi rrëfimin se sa i “zi” ishte kundërshtari politik. Kështu që menjëherë pas përfundimit të konfliktit, ndodhnin gjëra të atilla, thuajse nuk bëhej fjalë për një shoqëri e cila një vit më parë u ndodh buzë greminës së luftës ndëretnike. E një vit më parë, përderisa jehonin krismat nëpër malet e Maqedonisë, kryesuesit e këtushëm partiak, ishin të pagojë dhe nuk u jepnin asnjë shpjegim shqiptarëve se çka ishte duke ndodhur dhe çka duhej të prisnin. Por, kur erdhi koha e paskonfliktit, kur

shqiptarët e këtushëm duhej të përballeshin me urtësinë që kishin nxjerr nga viti i mëparshëm - se pjekuria e udhëheqësve partiak nuk matet me atë se sa i bashkon kundërshtari, por sa mund të përballen me destruktivitetin vetjak - kryesuesit e partive vazhduan me të vetmen që dinin ta bënin siç duhej - kanibalizmin ndërpartiak. Prandaj, ngjarjet që ndodhën te kafeneja “Dora” (pa marrë parasysh kush dhe pse i pari shkrep armën), ishin tragjedia dhe turpi i subjekteve politike shqiptare. Këto ngjarje paralajmëronin se procesi i “rrugaçërimit” partiak do të vazhdonte edhe më tej. E ky rrugaçërim do u shërbente qarqeve antishqiptare të dëshmojnë se kjo ishte pasojë e një papjekurie kolektive, me të cilin argument përhapnin gënjeshtër se shqiptarët e Maqedonisë parapëlqenin anarkinë, nuk i nënshtroheshin rendit, institucioneve, rregullave dhe parimeve të një shoqërie të organizuar. Pra, në kohë kur institucione shtetërore qëllimisht ngadalësonin realizimin e Marrëveshjes së Ohrit, edhe atë vetëm sa të nxisin pakënaqësi brendashqiptare (për të devalvuar luftën e UÇK-së), në kohë kur institucionet shtetërore ishin të mbyllura për shqiptarët, kur vepronin sipas parimit “vetëm shqiptari i komprometuar është i përdorshëm”, partitë shqiptare i vazhduan zënkat aty ku i kishin lënë përpara konfliktit të 2001.

Nuk kishte dyshim se viti 2002 ishte ai kur partitë shqiptare duhej të përballeshin me destruktivitetin vetjak, me traumat dhe dilemat që sjell faza e pasluftës. Pra, do ta paguanin tagrin e

saktë për gabimet e bëra në të kaluarën, do e humbin mbulesën që i bënte nga jashtë të duken të brengosura për fatin e popullit të Maqedonisë, e në brendi të ishin vëllezër të lojërave më të pandershme politike dhe dyfytërsinë ta kishin shpallur motër të një gjaku. Andaj edhe shqiptarët e këtushëm, shpejtë e kuptuan se konflikti i 2001 shumëçka kishte ndryshuar, por jo edhe vetëdijen e disa udhëheqësve partiak që nuk njihnin thujse asgjë tjetër përpos privilegjet dhe mirëqenien personale. Aq më shumë, shqiptarët e kuptuan se partitë e tyre i çonin drejtë tunelit të “libanizimit” të shoqërisë shqiptare në Maqedoni. Dhe kjo nuk ishte e pamundur, sepse ato ishin vitet kur shqiptarëve nuk u mungonin armë, në një kohë kur nuk mungonin as mjediset politike joshqiptare, të cilat e dëshironin një militarizim të shoqërisë shqiptare, me qëllim që ta realizonin planin e tyre për ndarjen e Maqedonisë dhe për t’i sjellë shqiptarët në pozitë që të mos kenë ndonjë zgjidhje më të madhe por të marrin atë që do u jepej.

Më në fund, vrasja për qëllime partiake mes shqiptarëve kishte filluar shumë më herët: gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2000, kur partizanët partiak vranë të riun nga fshati Kondovë. Pra, vite më parë dikush armën e promovoi si “komponent të rëndësishme të demokracisë” dhe kjo që ndodhte në 2002 ishte vetëm vazhdimësi e bindjes të cilën e afirmoi PDSH-ja: se në demokraci fiton më i forti, më i pasuri, më i dëgjueshmi, më i pandershmi, e jo më i afti dhe më njerëzori. Me këtë ata bënë një mëkat, të cilin populli duheshte t’ua falë, por jo edhe

t'ua harrojë: udhëheqësia e PDSH-së ishte ajo që shqiptarët e Maqedonisë i legjitimoi si një kope pa kulturë politike, pa asnjë vlerë intelektuale, kulturore, shkencore...Sepse, të parën gjë që bënë pas ardhjes në qeverinë e Georgievskit në vitin 1998, ishte të kërcënonin dhe të maltretonin fizikisht ata më të pambrojturit – elitat kulturore dhe shkencore. Me këtë ndoshta edhe u ndihmuan atyre që kishin kokë që të kuptonin se, aty ku subjektet politike e parapëlqejnë heshtjen e njerëzve të kulturës, artit dhe të shkencës, nuk mund të flitet për pluralizëm politik, por për primitivizëm bajraktareskë. Nga ai primitivizëm mund të shpëtohej vetëm nëse arrihej pjekuria sa të pranohej hapur se shoqëria shqiptare në Maqedoni ecte rrugës së “partizimit” të të gjitha sferave jetësore, se për situatën e krijuar nuk mbanin përgjegjësi vetëm elitat politike, por edhe të gjithë të tjerat që dikur heshtnin dhe vazhdonin të heshtnin, duke harruar se nuk do të mund t'i ikin gjyqit të pagabueshëm të ardhmërisë, i cili saktë do i legjitimojë përpara gjeneratave të cilat do të vijnë nesër, e të cilët ndoshta, në vend që të sjellin lule, do të pshurrnin mbi varret e heronjve të “bajraktarokracisë”.

Këshilli Koordinues mbeti dëshirë e porealizuar e Ali Ahmetit. Ideja e tij për këtë Këshill u varros mes grindjeve ndërpartiake, të cilat s'kishin si mos ta çonin të mendonte se si duhej vepruar me tej. Ja çka shkruan analisti Agim Fetahu lidhur me këto ngjarje: “Te kota ishin përpjekjet e Ali Ahmetit për t'i bindur partitë të heqin dorë nga akuzat dhe të



kthehen në këshill. Ideja e tij për unifikimin e faktorit politik shqiptar tashmë kishte dështuar. Kanë dështuar edhe planet e këshillit për hartimin e listës së përbashkët të kandidatëve që do të dalin në zgjedhje. Mirëpo objektivat të cilat ia kishte vënë vetes Këshilli, vazhdojnë të jenë në qendër të platformës së partisë së re, njoftimi për krijimin e së cilës mbetet vetëm çështje ditësh. Zoti Ahmeti thotë se objektivat e tij vazhdojnë të jenë ato që ishin: ruajtja e paqes, implementimi i plote i marrëveshjes së Ohrit dhe integrimi i Maqedonisë në strukturat evropiane. Ahmeti thotë se tani nuk ka shume alternativa përveç krijimit të një partie e cila do të jetë e hapur edhe për anëtarët e partive ekzistuese. Por, ai thekson me vendosmëri se në partinë e tij nuk do të ketë vend për njerëz të korruptuar. "Ne kemi nevojë më shumë se kurrë për njerëz me vlera", thotë ai me cigare në dorë dhe me shikimin në një pikturë, në zyrën e tij në Reçicë të Vogël." (Javorja "Lobi", Nr. 67)

Ali Ahmeti shpesh do qëndrojë me cigaren në dorë përball asaj pikturë në zyrën e tij. Mund ndonjëherë t'i ketë ndodh që në thellësitë e asaj pikturë të shoh edhe rrugëtimin e vet nga azilanti, deri te ushtaraku, nga ushtaraku e deri te politikani. Dhe të ketë bë krahasime se kur e kishte pasur më rëndë: atëherë kur nga Zvicra ëndërronte se si do të kthehej në atdhe, apo atëherë kur nga malet ku jehonin krismat, paramendonte ditët e qeta që do i jetonte pranë familjes. Apo më vështirë e kishte tani kur duhej ta "fitonte" paqen në vetvete dhe atë me të

tjerët, kur ishte përballur me “ujqit” e vjetër politik që ishin në gjendje të hanin cilëndo kope “dhensh” vetëm të majmeshin e të mbeteshin të vetmit që u takonte gjahu i quajtur Pushtet. Nuk dihet se çdo ketë menduar ai i vetëm në zyrën e tij dhe duke qëndruar përballë pikturës së varur në mur, por mund të paragjykohe se ai asokohe nuk i njihte mirë “njerëzit e korrumpuar”, e as ata të cilët ngutshëm kërkonin të vinin kontakt me të që t’i shpalosnin meritat që kishin. Gjithashtu nuk dihet se kush i pari në atë zyre atij i kishte propozuar të themelonin BDI-në, por nuk ka dyshim se pas prishjes së Këshillit Koordinues të partive shqiptare, ai ngadalë filloi ta kuptojë se nuk mund të bashkoheshin ata që një dekadë kishin investuar vetëm në përçarjen e popullit.

Pra, asokohe Ali Ahmeti mësoi leksionin e parë të politikës shqiptare në Maqedoni: nëse e zë ngushtë kundërshtarin politik, ai i zbret pantallonat, e nëse të zë ngushtë, ta zbërthen rripin pa të pyetur. I ndodhur në situatë të mos ketë zgjidhje tjetër, pra kur e kishte harxhuar mundësinë të mbetet i panjollësor politikisht, ai bërë të vetmen që mundej: themeloi BDI-në, që të kishte edhe ai “tendën e vet” politike. Por tani më PPD-ja dhe PDSH-ja e kishin rimarrë veten. Këtë ua mundësonte edhe të qenurit në koalicionin e gjerë qeveritarë të udhëhequr nga Georgievski, e që u formua gjatë konfliktit të 2001. Këtë ua mundësonte edhe e vërteta se ata më ishin përqaftuar njëherë me Ali Ahmetin në Reçicë të Vogël, e që do vlente përgjithmonë që sadopak

populli t'i amnistonte për qëndrimet e tyre gjatë konfliktit .

Kryesuesit e PPD-së dhe të PDSH-së, e dinin se disa nga ish komandantët e Ahmetit nuk do jenë të kënaqur për shumë arsye me partinë e Aliut dhe do kërkojnë strehim në ndonjë nga partitë ekzistuese, andaj edhe filluan “gjahun” që të sillnin në partitë e tyre ndonjë komandantë me emër sa më tingëllues për zgjedhësit. Dhe kështu ndodhi. Disa nga ish luftëtarët u hidhëruan me Aliun pse ai aq shumë peshë i dha grupit “intelektual”, pse nuk arriti gjithë sa ishin, t'i emëronte nënkryetarë të partisë. Pra, me Aliun në njëfarë mënyre u hidhëruan shumë bashkëluftëtarë të tij, të cilët nuk e kuptonin atë që e dinte Ahmeti: se lufta kërkon trima, ndërsa politika diçka krejt tjetër. Dhe përderisa ai mundahej t'i bind disa nga bashkëluftëtarët e vetë se nuk bënin punë më “kallashnikët” në krahë, por “mitralozat” në kokë, PDSH-ja dhe PPD-ja i hapën dyert për të gjithë të revoltuarit ndaj BDI-në. Dhe kështu asokohe këto dy parti lavdëroheshin me atë se cili nga ish komandantët e UÇK-së ishte anëtarësuar në partitë e tyre ku ngutazi dilnin në rendin e parë partiak.

Mbase kjo edhe nuk duhet t'u përshkruhet si mëkat PDSH-së dhe PPD-së, sepse kryesuesit e këtyre partive ishin politikan e jo “misionarë”. Pastaj, vlerësuar objektivisht, kjo derdhje e vogël e ish ushtarëve të UÇK-së nëpër partitë ekzistuese shqiptare, ndihmoi që të vihej barazhesh mes BDI-së dhe partive tjera, e të mos mbante vetëm ajo

“hipotekën” se ishte parti e ish luftëtarëve të UÇK-së. Nga ana tjetër, kryesuesit e PPD-së dhe PDSH-së, e dinin se do u mjaftonte edhe bishti i “Ç-së”, që të dëshmoreshin përpara zgjedhësve se nuk ishin parti pa UÇK. Shikuar realisht, kjo edhe duhej prituri, dhe me siguri që ky fenomen kur ish varësit ushtarak, tani e braktisnin atë të cilit gjatë konfliktit i ishin përkulur, nuk do e habiste së tepërmi edhe Ali Ahmetin. Por gjithsesi që kjo do shkaktonte hutesë të popullata. Mirëpo, vetëm hutesë të përkohshme dhe jo aq të madhe sa të mos e kuptojë se ky ishte çmimi të cilin duheshite ta paguaj Ali Ahmeti pas formimit të BDI-së. Më në fund, ai kishte dy zgjidhjet e sipërpërmendura: ose të mbetej jashtë politikës e t’u lejonte ish luftëtarëve të vetë, të cilët donin të merreshin me politikë, të shpërndaheshin nëpër partitë ekzistuese, ose të futej në sferën politikë nëpërmjet derës së vetme – me parti politike. Ai e zgjodhi të dytën, gjë që me shumë argumente mund të dëshmohet si gabim, e me qindra argumente të tjera si rrugë e vetme e cila i mbetej pas shkatërrimit të idesë për këshill të partive shqiptare. Gjithsesi se vendimi të bënte parti të veten, atij do i kushtojë: ende pa e rimarr vetveten, ende pa zbritur nga Shipkovicica, Ali Ahmeti u gjet në mesin e lojërave politike të partive shqiptare. Pra, filloi beteja që të minimizohej roli i tij në UÇK, si dhe të shtrembëroheshin qëllimet dhe të arrirat e atyre që morën armët në dorë.

Dhe kështu shqiptarët e Maqedonisë edhe zgjedhjet parlamentare të 2002 i pritën sipas traditës

së mëparshme: me një parti të re. E ajo ishte Bashkim Demokratik për Integrim në krye me Ali Ahmetin, e cila për shumë arsye, në prapavijën e saj mbante edhe emblemën e UÇK-së. Si e tillë, ajo shpejt do bëhet partia më e parapëlqyer për shqiptarët e këtushëm dhe me shumëçka do e rikthejë në skenën politike atmosferën e 1990. Për shumë arsye, sa u përket shqiptarëve, 2002 ishte ai viti “zero” nga duhej filluar shumëçka nga e para, njësoj siç ishte viti 1990 kur shoqëria e shqiptarëve të Maqedonisë niste një ecje krejt ndryshe drejtë ardhmërisë së vet. Pra, BDI-ja nuk mund të mos bëhej një “lëvizje gjithëpopullore”, shkak se Ali Ahmetit shqiptarët e këtushëm ia kishin dhënë rinin e vet. Andaj nuk kishin si tani mos t’ia jepnin partisë së tij edhe besimin politik. Kështu që në njëfarë mënyre, nuk shtrohej pyetja se a do i fitojë zgjedhjet parlamentare BDI-ja, por sa do humbnin PDSH-ja dhe PPD-ja.

Faza parazgjedhore parlamentare e viti 2002, solli në mesin e shqiptarëve të këtushëm një mënyrë të re të veprimit, të cilën kryesisht e imponoi Ali Ahmeti me bashkëpartiakët e vet. E ajo ishte gjuha sadopak jo konfliktuoze. Më në fund, as kryesuesit e PDSH-së si dhe ata të PPD-së, nuk mund të ishin aq agresivë sa që ishin mësuar më parë, sepse kishin shumë “njolla” ende të dukshme në kapotën partiake. Pastaj, ata e dinin se çdo fjalë e madhe kundër BDI-së së Ali Ahmetit, mund t’u binte atyre mbi kokë, shkak se populli në këtë parti shihte ata që flijuan edhe jetën e tyre për të mirën e popullit.

Por, edhe “xixat”e vogla paralajmëronin se zjarri i grindjeve ndërpartiake më ishte ndezur dhe vetëm shtrohej pyetja se kur do merrte flakën e kahershme.

Kur flitet për fazën parazgjedhore të viti 2002, nuk duhet harruar se ajo kishte filluar muaj më parë, qysh gjatë diskutimeve parlamentare lidhur me ndryshimet kushtetuese që dilnin nga Marrëveshja e Ohrit. Por shumëçka lidhur me këto ndryshime hasi në gozhdë, sa nga shkaku se pala e etnitetit maqedonas nuk ishte e përgatitur të “gëlltiste” gjitha ato ndryshime, po aq edhe shkaku se PPD-ja dhe PDSH-ja donin që diskutimet lidhur me këto ndryshime kushtetuese, të jepnin efektin e vetë edhe në kthimin e popullaritetit të tyre tek zgjedhësit. Kështu që ato bënëin gara që të tregoheshin sa më “kërkuese” e së më këmbëngulëse në kërkesat e tyre, veçanërisht kur bëhej fjalë për preambulën e kushtetutës ku pala e etnitetit maqedonas assesi nuk pranonte “barazimin” e etnitetit të tyre me të tjerët. Dhe kështu, siç vlerëson analisti i “Lobit” me datën 12.11.2001, sa u përket ndryshimeve, në Maqedoni “ishte trandur mali, e kishte pjellë miun”. Mbase ky vlerësim i analistit të javores “Lobi”, shpjegon më së miri të arrirat e partive shqiptare pas gjitha grindjeve sa në mes veti, po aq edhe me kundërshtarët politik të etnitetit maqedonas lidhur me qëndrimet e tyre.

Sa u përket diskutimeve rreth ndryshimeve kushtetuese, vlejné të përmenden edhe shkaku se PPD-ja dhe PDSH-ja ato i përdori për të provuar forcat mes veti. Dhe për të kthye besimin te zgjedhësit e tyre në kohë kur në njëfarë mënyre, Ali

Ahmeti ishte i “izoluar” në Shipkovicë dhe nuk mundej lirshëm të vepronte politikisht. Ja si e përshkruan këtë periudhë të debateve rreth ndryshimeve kushtetuese analisti i javores “Lobi”:  
“Nuk do të dëshironim që inati i PPD-së të jetë vetëm rezultat i rivalitetit me PDSH-në dhe shprehje e marketingut politik-partiak, në funksion të zgjedhjeve parlamentare të vitit të ardhshëm. Mirëpo, fitohet përshtypja se ‘diçka po ngjet’ edhe me kryetarin e PDSH-së, Arbën Xhaferi: ‘Një është të thuhet se varianti i fundit i propozuar nga Solana, është i imponuar nga ai dhe përgjithësisht faktori ndërkombëtarë, e tjetër është që ai të lavdërohet si arritje historike. Arbeni e bëri këtë dhe kjo nuk mund të gëlltitet’- deklaroi për Lobin një funksionar i Prosperitetit. Mirëpo, pavarësisht nga kjo, në situatën aktuale, duket se një fjalë apo një prononcim i Ali Ahmetit do të mund të ndikonte në afrimpajtimin e qëndrimit shqiptar kur është fjala për variantet e ofruara për Preambulën, statusin e bashkësive fetare por edhe për ‘institucionin publik të shkollimit të lartë në gjuhën shqipe’ që, thotë një diplomat perëndimor, do të mund të sigurohej po qe se shqiptarët flasin me një zë. E, këta janë të ndarë: ca me Shtulin, ca me Fadilin. Fitohet përshtypja se nuk çajne fort kokën për ecejaket dhe bredhjet e studentëve dhe të brucoshëve nga një lagje apo zyre në tjetrën, në Tetovë ku veprojnë të dy universitetet, ai i EJK-it dhe Universiteti i Tetovës të cilët kurrësi të marrin ‘bekimin’ për punë nga ministri i arsimit, Novkovski!?”

Sigurisht se partitë shqiptare kishin mjaftë material të qortoheshin e t'ia nxirrini sytë njëra tjetër. Edhe pse PDSH-ja dhe PPD-ja ishin nënshkruese të Marrëveshjes së Ohrit, herë-pas herë, ato ndaj saj silleshin thuajse kurrë nuk e kishin lexuar. Bile Arbër Xhaferi shpeshherë do qëndrojë edhe në mes mohimit dhe aprovimit të saj. Kjo do u ndodhte partiakëve shqiptarë sepse ishin ngatërruar me lëmshin e situatës, të cilën e kishin krijuar vite më parë, e që më së miri mund të portretohej me dy universitetet në Tetovë: me atë që i përshkruhej si vepër PDSH-së – Universitetin e ashtuquajtur të Shtulit, dhe atë të Fadil Sulejmanit, që e kishin ngjizur të gjithë bashkë, por sa herë që përfundonin zgjedhjet parlamentare, përfundonte si fëmiu me shumë baballarë, e me mamanë “kurvë”. Si fëmijë nga i cili të gjithë hiqnin dorë. E në ndërkohë, harronin se populli vetëm atë universitet e ndjente si të vetin, se aty populli kishte investuar me vite.

Gjitha këto “rivalitete” të shtresuara nga vitet e kaluara, si dhe përkushtimi që ndryshimet kushtetuese t'i përdornin për reklamimin e vetvetes, i çonte kryesuesit e PDSH-së dhe PPD-së të bëhen brigje gjithnjë e më të largëta, ndërsa Ali Ahmetin urë që do u ndihmonte t'i tejkalojnë grindjet. Mbase në këtë fazë edhe filluan të bëjnë lojë me “misionarin” Ahmeti, duke kërkuar pëlqim nga ai për ndryshimet kushtetuese që ata vetë nuk kishin guxim t'i votonin, pse e dinin se do humbnin pikë te zgjedhësit e vet. Kështu që shpesh ndodhte që nga Shipkovicica malore të arrinte vendimi se çka ishte, e



çka jo, e pranueshme për shqiptarët.

Të mbajtura në një ambient të paskonfliktit, mes një zhurme kur shqiptarët ende nuk e kishin gjithaq të qartë se çka kishin fituar, e ku ndodheshin pas konfliktit të 2001, zgjedhjet parlamentare të 2002 përfunduan për PDSH-në më mirë seç shpresonin edhe optimistët më të mëdhenj: ajo fitoi shtatë vende në parlamentin republikan. PPD-ja ishte e përfaqësuar nga dy deputetë, ndërsa fitorja e BDI-së u kurorëzua me 17 deputetë. Një parlamentarë fitoi edhe Partia Demokratike Kombëtare, kështu që në përbërjen e re parlamentare, shqiptarët kishin fituar thujse maksimumin e përfaqësuesve të vet.

Shqiptarët e paszgjedhjeve parlamentare, shumë shpejt do kthenin kokën nga fituesi i bllokut maqedonas – LSDM-ja. Edhe atë jo pa arsye: nga kjo parti tani do varej se a do ndodhte pajtimi ndëretnik dhe se a do kishte guxim që në koalicionin qeveritarë të merrte “terroristët” e Ali Ahmetit, me të cilin ende nuk kishte guxim politik të kontaktonte asnjë nga liderët e partive të etnitetit maqedonas.

Spekulimet se PDSH-ja do bëhej pjesë e koalicionit qeveritarë, nuk ishin të pabaza. Sepse për LSDM-në, më të pranueshëm për koalicionin qeveritarë ishin “radikalët” e Arbër Xhafetrit, se sa “terroristët” e Ali Ahmetit. Pastaj, asokohe flitej se PDSH-ja ia kishte ofruar shërbimet e veta Branko Cërvenkovskit ende pa përfunduar numërimi i votave, por si politikan me përvojë, ky e kishte nuhatur se përjashtimi i Ali Ahmetit nga qeveria, do të thoshte ikje nga mundësia që të pranohet një reali-

tet i ri i rendit shoqërorë në Maqedoni. Prandaj mandatarin e atëhershëm qeveritarë, bëri hapin që do i kushtojë shumë LSDM-së në rënien e popullaritetit të saj te pala e etnitetit maqedonas, por do jetë investim kapitalë për të ardhmen e shtetit. Pra, Branko Cërvenkovski ftoi në koalicionin qeveritarë partinë e Ali Ahmetit, me çka edhe do duhej të bëjë veprimin më të rëndë të vetin politik: të ulej e të bisedonte me njeriun që mediat e kishin ngritur në simbol të tragjedisë më të madhe që i kishte ndodhur etnitetit maqedonas në historinë e tij.

Fotografite e botuara nëpër gazeta, ku shihej Ali Ahmeti se si miqësisht ia ndezte cigaren Branko Cërvenkovskit, do jenë thujse tronditëse për një pjesë të opinionit maqedonas. Në prapavijën e atyre fotografive, në të vërtetë mbetet edhe reliefi i fatit të këtij shteti. Si dhe e vërteta se LSDM-ja, të cilës mund t'i përshkruhet faji më madhorë pse Maqedonia arriti deri te konflikti i 2001 (e ku Branko Cërvenkovski ishte një ndër ata që nuk diti ta lexojë kalendarin e kërkesave shqiptare dhe durimin e këtij kolektiviteti), ishte forca politike e etnitetit maqedonas që flijoi të sotmen e vet partiake, për të ardhmen e shtetit. Flijim të cilin si me gomë do e shlyej mandatarin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, Nikolla Gruevski, i cili në koalicionin qeveritarë do merr PDSH-në, e cila nuk i kishte fituar zgjedhjet parlamentare në kampin politik të shqiptarëve. Kështu që Gruevski do shlyej edhe një marrëveshjeve të pashkruar që në koalicionet qeveritare të jenë dy partitë fituese të dy etnive

numerikisht më të mëdha – ajo e zgjedhësve shqiptarë dhe e zgjedhësve maqedonas.

Sa i përket koalicionit qeveritarë mes LSDM-së dhe BDI-së, ai mund shkurtimisht të përshkruhet edhe si bashkëqeverisje mes “tregtarëve” politik të Branko Cërvenkovskit, dhe “misionarëve” të Ali Ahmetit, të cilët ende nuk e dinin se misioni dhe tregtia nuk janë veprimtari që shkojnë bashkë. Por, edhe si të këtillë, ministrat e BDI-së arritën një rezultat thujse epokal dhe në kufi me të pabesueshmen edhe për shqiptarët: pas formimit të Universitetit të Evropës Juglindore, të legalizojnë edhe Universitetin Shtetëror të Tetovës. Si dhe punësimin e shumë shqiptarëve në administratën shtetërore. Këto të arrirë të partisë së Ali Ahmetit, do i bëjnë të padukshme lëshimet dhe dështimet tjera si parti qeveritare, por edhe do e dëmtojnë aq shumë partinë e Branko Cërvenkovskit, sa edhe do i humb zgjedhjet e ardhshme parlamentare të vitit 2006. Andaj, nëse Ali Ahmeti nuk ia doli që këto të arrirë t’i përdorte për të fituar pik politike te shqiptarët, partitë opozitare të etnitetit maqedonas mirë e shfrytëzuan legalizimin e Universitetit Shtetërorë të Tetovës që të dëshmonin se me Maqedoninë qeveriste vetëm Ali Ahmeti, e jo edhe Branko Cërvenkovski.

Kur bëhet fjalë për veprimin qeveritarë të BDI-së, duhet thënë se asaj i kishin rënë në hise t’i bënte jetë të gjitha ëndrrat që shqiptarët kishin ëndërruar dekada me radhë. Kështu që në njëfarë mënyre “dështimi” i BDI-së si parti qeveritare, ishte i

paralajmëruar. BDI-ja duhej të vazhdonte sjelljen e ligjeve që dilnin nga marrëveshja e Ohrit, të vepronte në përmisimin e përqindjes së përfaqësuesve shqiptarë nëpër institucionet shtetërore dhe ndërmarrjet publike, duheshte të zgjidhte statusin e dëshmorëve të luftës dhe familjeve që kishin humbur më të dashurit e tyre, duheshte t'i rreket punës për ndarjen territoriale..., pra shumëçka që e kundërshtonin thujtë të gjitha partitë e etnitetit maqedonas. Ndërkaq, për arsye të veta të ngushta partiake, thujtë të gjitha partitë shqiptare donin që Ali Ahmeti kësaj radhe ta humbte betejën. Kjo dëshirë më e flaktë ishte te kryesuesit e PDSH-së, të cilët si opozitarë, arrinin që edhe sukseset e Ali Ahmetit në njëfarë mënyre t'i përdornin për të reklamuar vetveten. Kështu që edhe legalizimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, ata e përdorën si "kundërrargument" ndaj BDI-së, duke harruar se paraprakisht kishin bërë çmos që ta varrosnin këtë fëmijë arsimorë që me aq sakrifica kishin arritur ta mbanin gjallë shqiptarët e këtushëm.

Kryesuesit e PDSH-së, ishin të pakënaqur me legalizimin e këtij Universiteti shkaku se nuk ishin përfshi të gjitha fakultetet dhe katedrat që me vite i mbante gjallë Fadil Sulejmani, e që ishin aq sa nuk i kishin edhe universitetet botërore me traditë disa qindra vjeçare. Pra, PDSH-aj ishte e pakënaqur kinse pse BDI-ja nuk kishte arritur ta legalizonte të tërë projektin e Fadilit, të cilin nuk do mund ta bënte as ministri i arsimit i ndonjë perandorie, e lere më Azis Pollozhani të cilit i duhej të luaj në shumë drejtime

që të bindte palën e etnitetit maqedonas se nëse nuk legalizohej ky universitet, ai do mbetej vatër e pakënaqësive të rinisë shqiptare.

Përderisa partitë shqiptare e dëshironin dështimin e Ali Ahmetit, ato të etnitetit maqedonas nuk arrinin t'ia falin dot Cërvenkovskit “mëkatin” e bërë. Nga ana tjetër, përderisa rritej entuziazmi i etnitetit shqiptarë që të shkohej më tej në korrijen e “fitoreve”, etniteti maqedonas, në njëfarë mënyre, e kishte humbur entuziazmin e parakonfliktit për ndërtimin e shtetit. Kjo atmosferë do e dëmtojë shumë qeverinë në efikasitetin e saj. Në mos më shumë, shkakun se çdo ligj duhej të sillej në fushë betejën ku përballej realiteti i ri me ndjenjat e etnitetit maqedonas se e kishin “humbur” shtetin, se Maqedonia gjithnjë e më shumë kontrollohej nga terroristët”e Ali Ahmetit. Në atë fushëbetë përplaseshin edhe ndjenjat e shqiptarëve që buronin nga bindja se ishte e vështirë me partitë maqedonase të merresh vesh për diçka, e ato të qëndrojnë mbrapa marrëveshjes. Për këtë situatë në masë të madhe do ndikoj edhe e vërteta se Marrëveshja e Ohrit kishte filluar më të zbehej, të humbej diku në përkthimin e saj që ia bënin krejt ndryshe ekspertët dhe politikanët e këtushëm, edhe atë varësisht nga përkatësia e tyre etnike. Kështu që Maqedonia vazhdonte t'i ngjajë “ujdhesës” të cilës për çdo gjë ia kishte fajin “deti” që e rrethonte. “Ujdhesë” e cila nuk kishte forcë dhe guxim politik të merret me rregullimin e brendisë së vet dhe prandaj analizon valët që përplasen mbi brigjet e saja. Maqedonia

vazhdonte të mbetej pengë i elitave të etnisë maqedonase të cilat - duke mos parë se nga dita në ditë shteti “kalbej” nga brenda dhe kurrqysh të qëndronte mbi themele institucionale - me devotshmëri mbanin llogari se si do të ndikonte në këto hapësira pavarësia e Kosovës dhe në ç'mënyrë do të zgjidhet çështja shqiptare në Ballkan.

Në tërë këtë llafazani shurdhuese mediale dhe “intelektuale” në relacionin Ballkani dhe Maqedonia në të, ndodhte diçka e mirë që duhet përshëndetur: qeveritarët e LSDM-së dhe të BDI-së kishin filluar të mësojnë dhe të kuptojnë se nuk është ujdhesa ajo që cakton lartësinë e valëve të mundshme, por valët janë ato që përcaktojnë fatin e ujdhesës. Pra, kishin nisur ta kuptonin se ujdhesa nuk duhet të merret gjithaq me detin përreth, por me përforcimin e brendisë së ujdhesës si parakusht të përballet edhe me përmytjet eventuale..

Duhej pranuar se edhe pas konflikti të 2001, edhe pse kishte nënshkruar Marrëveshjen e Ohrit, Maqedonia vuante shkakun se ajo në të vërtetë kurrë nuk kishte realizuar një dialog normal maqedonas - shqiptar. Pra, edhe pas kësaj marrëveshjeje, partitë e Maqedonisë, të ndara sipas ngjyrimeve etnike, ndjeheshin mes veti si “opozitë” e natyrshme e njëra tjetrës, politikën e ndërtonin mbi bindjen se e kanë për obligim ta mbrojnë të “veten” nga tjetri, e nuk ndjenin nevojë të gjenin emëruesin e interesit të përbashkët. Andaj edhe ndodhi që koalicioni qeveritar LSDM - BDI të vlerësohej sipas dy standardeve etnike: maqedonasit etnik ta vlerësonin Brankon në

bazë të asaj se sa do u ikte obligimeve që dilnin nga Marrëveshja e Ohrit, ndërsa Ali Ahmetin shqiptarët ta peshojnë sipas asaj se sa do arrinte të shkoj më tej kësaj marrëveshje.

Edhe pas 2001, si në rrafshin zyrtar, po ashtu edhe në “ekspertizat” që bëheshin nëpër kafene, vlerësimet e thëna lidhur me stabilizimin e këtij shteti kishin jehonë e të vërtetës se shtetin e udhëhiqnin “misionarët” e BDI-së dhe tregtarët e shkathtë politik të etnisë maqedonase. Pra, nga njëra anë qëndronte tabori i qeveritarëve të Ali Ahmetit, të cilët nuk vepronin si politikanë por si “misionarë” që duhet kujdesshëm të ecnin rrugës drejt ngritjes së shqiptarëve të këtushëm në rrafshin e pjesëmarrësve aktivë në qendrat e vendosjes, dhe nga ana tjetër, tregtarët e pastër politik të Branko Cërvenkovskit, që vepronin sipas logjikës – duhet matur mirë çka japim e çka marrim! Dhe kjo logjikë e Cërvenkovskit assesi nuk mund te shpallej e pavlefshme, por vetëm për shtete politikisht dhe institucionalisht të shëndetshme, e jo për një Maqedoni të sëmurë kronike që vuante nga një sëmundje e rrezikshme – jo barazia etnike.

Mundësia që Ali Ahmeti me shokët të dilnin nga hapësira e “misionit” politik, dhe të ngriheshin në rrafshin e politikanëve të suksesshëm, në shumëçka varej nga ajo se sa kuadrot e kësaj partie do dilnin nga pozita e të qenurit “kukull” në institucionet shtetërore. Apo thënë edhe më shqip – e tërë ajo varej nga guximi që veprimi partiak të dilte jashtë partizimit të të gjitha institucioneve ku

punësoheshin edhe shqiptarët. Si dhe nga gjindshmëria të flakej anësh bindja disavjeçare, tani më e ngulitur edhe në pjesën më të madhe të rinisë së këtushme, se diploma më e vlefshme që ta përcakton fatin jetësorë dhe profesional është librezja e partisë.

Përpos që duheshite të ndërtonin një rend të ri shoqërorë, “misionarëve” të BDI-së u ra në hise t’i bindin shqiptarët e këtushëm t’u besonin institucioneve shtetërore. Aq më shumë, t’i besonin shqiptarit që punon në këto institucione. Sepse ky mosbesim i kishte rrënjët e thella aq sa janë dekadat kur dihej si dhe cilët ishin ata shqiptarë që mund të ngjiteshin në piramidat e institucioneve shtetërore.

Se sa do të zhvishej politika shqiptare në Maqedoni nga elementet i “misionit” etnik, e do të vishte kapotën e politikës klasike, varej edhe nga ajo se sa Cërvenkovski i vitit 2002 e kishte kuptuar se në Maqedoni nuk vlente gjithaq të jesh “mangup politik”, sepse ende nuk kishte përfunduar “misioni” për stabilizimin e shtetit. Pra, varej nga ajo se sa elitat e etnitetit maqedonase e kishin të qartë se ky shtet nuk mund të kishte ardhmëri nëse “misionarët” shqiptarë dhe “tregtarët” politik maqedonas nuk fillonin të huazonin diçka nga njëri tjetri: misionarët të bëheshin ngadalë politikan klasik, e tregtarët politik të bëheshin nga pak misionar.

Shikuar nga ky këndvështrim, pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2002, në “ringun politik” të Maqedonisë më të suksesshëm ende ishin “tregtarët politik” të Cërvenkovskit. Për të qenë të tillë u ndihmonte përparësia shumëdekadëshe që kishin



ndaj shqiptarëve, si dhe veprimi i partive shqiptare në stilin se politika është profesion të cilin mund ta ushtroj cilido që ka qafë për kravatë dhe një gisht për të shtypur butonin e votimit në parlamentin republikan. Buton të cilin parlamentarët shqiptar shpeshherë e shtypin pa e ditur se pse thonë “po”, e pse thonë “jo”.

Por, mu kjo përparësi e rrejshme, deri diku ia mjegulloi shikimin Cërvenkovskit aq sa ai të mos vërente se Aliu me shokët ishin para rrezikut të mbeteshin edhe pa kapotën e misionarit edhe pa kravatën e politikanit. Se kanosej rreziku që shqiptarët e Maqedonisë të bindeshin se në këtë shtet nuk ia vlen të jesh as “misionar” as politikan, dhe të ndjeheshin si pronarë të ëndrrave të kota. Pra, të ndjeheshin si ëndërrues të cilët e kishin tradhtuar edhe ëndrrën e pasluftës së 2001, se Maqedonia do të jetë e tyre aq sa u takonte, e jo aq sa dikush do u jepte. E tërë kjo rrezikonte që Maqedonia të bëhej ëndërr e largët, ëndërr të cilën të gjithë e kishin ëndërruar mbrapsht. Ta bënte atë shtet për të cilin do të thuhet se e ndërtonin misionarët romantik dhe tregtarët e pakujdesshëm politik të cilët shisnin e blinin ardhmërinë e këtij shteti. Me çka edhe të huajt që kujdeseshin për stabilitetin e këtij shteti, do e kuptonin përfundimisht se Maqedonia e paskonfliktit - njësoj si edhe ajo e deridjeshmja - ishte më afër krenarë të dalë nga ëndrrat e kundërta shqiptaro - maqedonase, se sa shtet me vizion të qartë për ardhmërinë.

## Rrëfimi vazhdon

Gjyshërit e ardhshëm që do rrëfejnë për të kaluarën e tyre kur u kishin duartrokitur aktivistëve partiak, e që përbënin shumëngjyrshmërinë partiake të Maqedonisë gjatë një dekade e gjysmë pas mëvetësimit të saj, do e kenë edhe një përparësi: përralla do vazhdojë edhe pasi ata të kenë mbyllur pjesën e rrëfimit për pluralizmi demokratik, kur Maqedonia i kishte harxhuar dy fazat e kotësisë së vet dhe kishte arrit deri te 2001: tetëvjeçarin "demokratik" të ndërtuar me formulat e socializmit, e që kishte shenjë njohëse sundimin e LSDM-së me PPD-në, dhe fazën e dytë katërvjeçare të mbështetur mbi themelet e partizimit të shoqërisë, e të cilin partizim - me plotë entuziazëm dhe qind për qind suksesshëm - e realizuan VMRO-DPMNE-ja dhe PDSH-ja gjatë qeverisjes së tyre të parë 1998-2002. Nëse periudha e sundimit të Cërvenkovskit me aleatin shqiptar përpara konfliktit të 2001 mund të emërohet si "etnizim" i politikës (sipas parimit - vëllazërim ndëretnik i elitave politike), sundimi i Georgievskit dhe i Xhaferit - që e solli më pranë konfliktin e 2001 - veprimin partiak në baza etnike o çoi deri tek "dyqeverisja" - partitë më të mëdha etnike në qeveri të qeverisin çdonjëra me "principatën e saj

etnike”.

Gjatë qeverisjes tetëvjeçare të LSDM-së, shqiptarët ishin ikebanë politike në institucionet më të larta shtetërore, ndërsa gjatë qeverisjes katërvjeçare të Georgievskit, shqiptarët në pushtet u bënë partner të barabartë të VMRO-DPMNE-së në ndarjen e privilegjeve personale dhe dëshmuar se nuk dinin asgjë më shumë se të jenë “kamxhikë” për shpinën e shqiptarit. Me çka edhe "problemi shqiptarë" kaloi tërësisht në duart e sunduesve të “principatës” partiake shqiptare - PDSH-së. Apo thënë ndryshe: përvoja prej një dekade e gjysmë e sundimit multietnik në Maqedoni, dëshmoi se veprimi politik i elitave partiake shqiptare mbeti thuajse aty ku ishte në kohën e socializmit të hershëm: ose të jesh ikebanë politike - gjatë qeverisjes së parë të Cërvenkovskit - ose të zbatosh diktaturë partiake mbi popullin që prezantonin-, gjatë sundimit katërvjeçarë të koalicionit qeveritarë të prirë nga Georgievskit. Me çka shtrohej pyetja: a e kishin arritur elitat partiake shqiptare pjekurinë politike sa të kuptonin se pjesëmarrja në qeveri ka kuptim vetëm atëherë kur mund të "minisitrosh" me tërë shtetin - kur me çdo gjë je i barabartë me partnerin qeveritar. Pra, jo të të interesojnë vetëm kolltukët, por realizimi i koncepti që shqiptarin ta integrosh në të gjitha porët e shoqërisë.

Nëse pjesëmarrja e PPD-së në qeveritë e para konfliktit të Cërvenkovskit dëshmoi se shqiptari e ka të vështirë të bindet se mund të bëjë karrierë pa mos pasur “mentor” ndonjë maqedonas (nuk duhet

harruar se thujse gjithë ministrat e atëhershëm të PPD-së, më të nderuar e ndjenin veten kur i lëvdonte Brankoja, se sa cilido shqiptar), atëherë pjesëmarrja e PDSH-së në qeverinë e Georgievskit dëshmoi se shqiptari inferiorë shpejtë e drejton kamxhikun mbi shpinën e shqiptarit. Shkurt e shqip: nga aspekti politik, deri në vitin 2001, veprimi i partive politike shqiptare në Maqedoni, kishte emërues të përbashkët - dështimin. Me atë dallim se gjatë tetë viteve të pjesëmarrjes në qeveri, PPD-ja as bëri gjë as prishi diçka, ndërsa pjesëmarrja e "xhaxhit" Arbër në qeveri, lere që pak bëri, por dëmtoi shumë nga ajo e pakta që shqiptarët kishin. Në mos tjetër, duke i partizuar deri në përmasa më perverse, mori në qaf ato pak institucione që shqiptarët i trashëguan nga e kaluara.

Duke vepruar si lokalist, e i prirë nga ambiciet mbarëkombëtare, "xhaxhi" Arbër nuk e vërente se u ballafaqua me murin e lartë të premtimeve të dhëna dhe të pamundësisë që ato t'i realizojë. I zënë në kthetrat e ambicieve kolektive dhe interesave personale të "klerit" partiak, ai zgjodhi rrugën më të lehtë: të harrojë kërkesat e popullit, e të kënaqë interesat e elitave partiake. Me çka edhe e vulosi fatin e tij politik: në vitin 2001 mbeti "kapiten" i anijes partiake të cilën e kishte braktisur populli, e pas zgjedhjeve parlamentare të 2006, ishte drejtues i "anijes" partiake në të cilën gjithë detarët kërkonin me çdo kusht të bëhen pjesë e koalicionin qeveritar. Më kot njerëzit qëllimshëm thoshin se rreth sofrës partiake të PDSH-së janë ulur edhe grykës të atillë që

interesin e popullit e barazojnë me profitin personal, më kot disa paralajmëronin se anija e PDSH-së do të fundoset në detin e egër dhe të valëzuar të “maunokracisë” dhe të partizimit të të gjitha sferave të shoqërisë shqiptare në Maqedoni. Askush nuk i dëgjoi dhe as ua vari veshin atyre që thoshin se këtë det nuk do të mund ta fshehë nga sytë e popullit për gjatë kohë as zëri i qete i “strategut mendjendritur” që shpaloste “koncepte mbarëkombëtare”. Andaj edhe lideri me ambicie dhe mundësi reale të bëhet strateg i pakontestueshëm i shqiptarëve të këtushëm, nuk arriti më larg se të merr gradën e “avokatit më të denjë” të VMRO-DPMNE-së. Dhe prandaj, nëse PPD-ja e dikurshme mund të vlerësohet si filiale e telediriguar e LDSM-së, atëherë për PDSH-në mund të thuhet se përfundoi si Parti e Dëshpërimeve Shqiptare, si një degë shqiptare e VMRO-DPMNE-së. Dhe nëse kjo bëhej me qëllim që partitë shqiptare një ditë të shkriheshin në ato më të mëdhatë e etnitetit maqedonas, atëherë gjithsesi se ky proces do ndihmonte për ecjen drejt shumëpartizmit të Maqedonisë me parti të mirëfillta qytetare. Por, nëse kjo bëhej për arsye që çdonjëri të sundojë me kolektivitetin e vet etnik, atëherë Maqedonia do e gdhijë ditën kur nuk do të ketë nevojë për qeveri shumë etnike, por kur do ketë qeverinë për maqedonasit etnik në Shkup dhe atë që do qeverisë me shqiptarët në Tetovë.

Gjatë bashkëqeverisjes së viteve 1998 - 2002 me VMRO-DPMNE, në dy vitet e para, PDSH-ja arriti diçka që nuk duhet mohuar: ua ktheu besimin

shqiptarëve se mund të jenë partnerë i barabartë në ndërtimin e institucioneve shtetërore. Gjatë këtyre dy viteve hetohet një kthesë që kishte të bëjë me qëndrimin e administratës shtetërore ndaj qytetarëve shqiptarë. PDSH-ja, dhe veçanërisht Arbër Xhaferi, janë më të merituarit për themelimin dhe hapjen e Universitetit privat të Evropës Juglindore. PDSH-ja është partia e parë shqiptare në Maqedoni që ia doli të imponohet si partner i barabartë përballë palës maqedonase.

Por dështimi ndodhi atë çast kur kryesuesit e PDSH-së bënë atë që nuk e prisnin shqiptarët: duke pasur në dorë fatin e shqiptarëve të këtushëm, ata filluan të mendojnë vetëm për njerëzit që kishin librezën e tyre partiake. Kështu që nga “popull jointitucional”, shqiptarët e Maqedonisë përfunduan si popull i PDSH-së. Gjë që në njëfarë mënyre e mbushi gotën e frustrimit të tyre dhe i bëri gati që posa të vijë Ali Ahmeti, pa përtesë t’i përgjigjen thirrjes së tij dhe të merrnin armët në duar.

Andaj mund të thuhet se vetëm amatorët politik nuk mund ta shihnin se qeverisjet e këtilla në Maqedoninë multietnike, çonin drejt konfliktit ndëretnik, e jo drejt realizimit të konceptit shumëetnik dhe qytetarë. Amatorët politik nuk arritën ta zbërthenin me kohë se ku e çonte Maqedoninë edhe heshtja e parlamentarëve dhe e ministrave shqiptarë atëherë kur VMRO-DPMNE-ja e pyllëzonte Maqedoninë me kryqe. Edhe atë me kryqe të financuar nga buxheti shtetërorë, si ai me përmasa gjigante në majën e malit Vodno. Nga ai pyll me kryqe të larta,

as që mund të shihej se shoqëria shqiptare gëlltiste helm, se do të vinte çasti kur shqiptarët do të përjetojnë “helmim” të rëndë politik, nga i cili do të vjellin edhe të gjithë të tjerët. Mbase edhe nuk kishte si të mos vijë çasti i vjelljes: 2001 kur pa ndonjë thirrje të veçantë, por vetëm pas disa krismave në Tanushë, rinia shqiptare shkoi në mal duke i lënë PPD-në e PDSH-në vetëm me krerët partiak. U mbetën edhe selitë luksoze në Tetovë, si dhe mjaft kohë të mendojnë se si ndodhi që shqiptarët të kenë aq strategë e pak strategji, aq politikanë e aspak politikë, aq ministra e aspak pushtet. Të mendojnë edhe për atë se kush i pari harroi se edhe për shqiptarinë, Shkupi, e jo Tetova, është Maqedoni. Udhëheqësit shqiptarë patën kohë të mendojnë për shumëçka derisa dëgjonin krismat dhe shikonin aviacionin maqedonas si dëmtonte vendbanimet shqiptare, por dukej se nuk kuptuan hiçgjë më shumë se të vërtetën se kishin mbetur pa popull. Gjë që i çoi ngutshëm të shkonin të "raportojnë" te Ali Ahmeti në Prizren për të (pa)bërat njëdekadëshe. Dhe Ali Ahmeti, siç i ka hije një “nënë Tereze” politike, ua ktheu besimin e humbur tek shqiptarët duke ua shtrënguar duart.

Ajo që ndodhi pas marrëveshjes së Prizrenit - është histori! Dhe me të duhet të merren analistët dhe historianët. Kur jemi te analistët dhe komentuesit, duhet pranuar se për ngjarjet që kishin ndodhur, shqiptarët e Maqedonisë nuk kishin zbërthyes më të mirë se Arbër Xhaferi. Nuk kishte mendje që aq bindshëm dhe pagabueshëm mund ta komentonte të kaluarën, e asgjë të mos thoshte për

të ardhmen. Dhe kështu ai ndërtonte karrierën politike, gjë që mbase është e mundur vetëm në shoqëritë shqiptare. Por, ama shqiptarëve të Maqedonisë kurrë nuk u kishin munguar shpjegues të vonshëm të së djeshmes. Atyre u mungonin vizionarë politik, të cilët do mund ta përgatisnin popullin për atë që mund ta sillte e nesërmja. Mbase për shkak të kësaj mungese, edhe gjatë kohë pas formimit të BDI-së, do të dominonte pyetja, se vallë Ali Ahmeti me shokët, ishin ata që kishin vizion të qartë për të ardhmen e këtij shteti dhe të shqiptarëve në të. Dhe vallë këta të BDI-së do dinin si të "ministronin" me Maqedoninë, e jo vetëm me shqiptarët, vallë ata kishin aftësi ta nxirrnin shoqërinë e këtushme shqiptare nga lloçi i inferioritetit dhe atë ta vendosnin në rrafshin e qytetarëve shtetbërës, a e dinin si ta ndërprisnin procesin e rrugaçerimit të aktivitetit partiak.

Me ardhjen në pushtet, Ali Ahmeti, si askush tjetër më parë, kishte parakushte të ndihmonte në etablimin e një gjenerate politikanësh të pa komprometuar shqiptarë në Maqedoni. Sepse, në krahasim me kryesuesit e PPD-së që i nxori në sipërfaqe shtrëngata e tranzicionit, krahas asaj se Arbërin e bëri lider Tirana zyrtare me komentet e ATSH-së, Ali Ahmeti nuk i kishte borxh as Tiranës as Prishtinës. Bile mund të flitej për të kundërtën: ai ishte ndër të rrallët që së pari kishte la "borxhin" atdhetarë ndaj Kosovës, e pastaj kishte ardhur të shihte se çka mund të bënte për shqiptarët e tij në Maqedoni. Si i tillë, dhe nëse kishte arritur t'i



analizonte mirë dështimet e mëparshme të veprimit partiak shqiptarë, ai nuk do e kishte rëndë të zbulonte porosinë e parë të cilën duhej t'ia përcillte mandatarit Cërvenkovskit gjatë bërjes së koalicionit qeveritarë: Zotërinj, në Maqedoni më nuk jetojnë "shiptarçiqat", ata i harxhuat në dekadën që lamë pas! Kështu do e kishte më lehtë të shpjegonte edhe pozitën e vet, si dhe nevojën për integrim të ngutshëm të shqiptarëve në institucionet shtetërore. Pra, një integrim të mirëfilltë, e jo si ai i viteve të parakonfliktit, vetëm me disa kabinete ministrore. Pra, Ali Ahmeti do duhej ta kishte kuptuar se edhe populli tashmë ishte bërë më kritik, se nuk ishin shqiptarët ata të 1990 që mrekulloheshin nga patriotizmi llafazan i udhëheqësve partiak, as ata nga mesi i dekadës së nëntë të shekullit të njëzet, kur Arbër Xhaferi i shëtiste rrugëve të Tetovës duke u premtuar se Maqedonia o do fliste edhe shqip, o do e humbiste edhe ciriliken, kur herë e përdorte Universitetin e Tetovës për të nxitur revoltën e shqiptarëve të këtushëm, herë tragjedinë mbarëshqiptare – Kosovën.

Vetëdija se më nuk kishte "shiptarçiqat", ishte e rëndësishme edhe për vet Ali Ahmetin dhe shokët e tij: sa të kuptonin se në kutitë e votimit ku ia kishin dhënë besimin shumicë BDI-së, shqiptarët e vitit 2002 nuk kishin hedhur vetëm fletët votuese për partinë e Ali Ahmetit, por tërë mllefin ndaj elitave të gjeratëhershme partiake të cilat kërkesat kolektive i përdornin si çarçaf për të mbuluar "prostitucionin" e vet nëpër "bordelet" politike. Në zgjedhjet

parlamentare të vitit 2002, shqiptarët nuk kishin si të mos votonin për mitin e quajtur BDI. Nuk kishin si të mos votonin për ata që asgjë nuk kishin premtuar, por kishin bërë shumë. Që për disa muaj arritën të bënë atë që një dekadë të tërë kishin premtuar PPD-ja dhe PDSH-ja: ndryshimin e kushtetutës, ngritjen e pozitës së shqiptarëve në të barabartë me të tjerët.

Dhe si çdo gjë e mitizuar, BDI-ja në të vërtetë nuk morri vetëm votën e shqiptarëve, por edhe emocionet e tyre, edhe mirënjohjen e të përbuzurit ndaj atyre që ia kthyer dinjitetin, edhe shpresat e atyre që me padurim prisnin ardhjen e gjeneratës politike e cila di të bëjë parti shqiptare, e jo shqiptarët t'i bëjë parti. Më në fund, prindërit e të rinjve që përkrahën Ali Ahmetin gjatë luftës dhe pas saj, nuk mund të mos votonin për partinë të cilën fëmijët e tyre e adhuronin ashtu siç adhurohet "miti".

Rinia shqiptare nuk e ndjente BDI-në si parti politike. Ajo Ali Ahmetin e mbante si kalorës të gjatëpritur. E tërë kjo mund të ishte edhe përparësi edhe hendikep për BDI-në. Varësisht se si do ta përdorte këtë besim të popullit. Dhe varësisht nga ajo nëse kryesuesit e BDI-së e kishin kuptuar se aty ku politika ofron privilegje, mirëpo pa e nënkuptuar përgjegjësinë, në atë vend nuk bëhet politik por "prostitucion" partiak. Gjithsesi, pa anashkaluar edhe faktin se sa BDI-ja do t'i përmbahej listës së prioriteteve të veprimit politik në parlament dhe qeveri: implementimi në tërësi të Marrëveshjes së Ohrit, lufta kundër korrupsionit, ndërtimi i

mirëfilltë i një Maqedonie multietnike...

Ishte e qartë se pas konfliktit, shqiptarët ndaj BDI-së silleshin si i posadashuruari ndaj vashës me të cilën dëshiron të martohet: përderisa e ëndërron ta përvetësojë, ia sheh vetëm bukuritë, por sa më shumë afrohet dita e fejesës, fillon t'i vërejtë edhe të metat. Dhe në vitin 2002, kur BDI-ja u bë pjesë qeverisë së parë pas konfliktit në krye me Cërvenkovskin, pra kur "fejesa" mes votuesve shqiptarë dhe BDI-së ishte zyrtarizuar, populli kishte filluar t'i krahasonte ata që dikur ishin qeveritarë, me këta që kishin ardhur. Dhe ishte shumë më rigoroz në vlerësime. Kështu që qysh në fillim Ali Ahmetit dikush ia shënoi si minus emrat e njerëzve "të tij" që i solli në poste të larta qeveritare. Apo edhe atë se kishte lënë anësh "komandant" me nam e nishan. Kishte edhe qarqe të atilla që mendonin se Ahmeti gabonte që partinë e kishte hapur për të gjithë që dëshironin dhe kishin aftësi personale të jepnin kontribut në zhvillimet demokratike. Sepse me vite ishin mësuar partitë t'i shihnin si "klube" të mbyllura, ku u lejohet hyrja vetëm atyre që kanë librezën partiake.

I gjetur në mes të vetëdijes se qeveria kërkonte përvojë politike e jo trimëri luftarake, i përballur me kërkesat e "komandaturave" që donin t'i vinin në krye të betejave politike ata të cilët kishin luftuar, Ali Ahmeti bëri të mundshmen për të vënë baraspeshë mes grupeve të ndryshme të interesit, por mbase jo edhe të duhurën për të hapë rrugë për më të aftit: në institucionet shtetërore delegoi nga të gjithë

nga pak. Edhe politikan të mirëfilltë edhe “komandant” që e harxhuan mandatin në heshtje, duke mos treguar as se si i kalonin ditët në kabinetin e vet. Mbase me këtë ua vështirësoi punën edhe politikanëve të “ardhur para kohe”, siç ishte një Agron Buxhaku, i cili vështirë se do mundej aftësitë e veta t’i realizonte i rrethuar nga përfaqësuesit e “komandaturave” të ndryshme. Mbase Agron Buxhaku i takon një profili politikanësh që më së miri e dëshmojnë të vërtetën, se për mjediset e këtushme politike, ende ishin të papranueshëm politikanët klasik. Andaj ishte thujse njësoj i papranueshëm sa për palën maqedonase, aq edhe për disa qarqe të BDI-së. I ardhur nga “sallonet” politike të Evropës, do ishte i papërshtatshëm për “xhunglën” politike të Maqedonisë. Duke e kuptuar politikën si art i të mundshmes, ai shpejt do përballet me të pamundshmen: me kërkesat e disa bashkëpartiakëve që të bëhej ministër i cili do kujdesej vetëm për ta. Ai gjithashtu do përballej edhe me “tregtarët politik” të Cërvenkovskit, të cilët ishin mësuar më lehtë të bashkëpunonin me shqiptarët inferiorë, se sa me një politikan i cili shpjet ua zbulonte lojën. Andaj edhe bënë çmos që atë ta komprometonin. Bënë çmos që të çliroheshin nga një ministër, i cili ishte ndër të paktët nga radhët e BDI-së që e kishte kuptuar se duhej të “ministronte” me tërë Maqedoninë, e jo vetëm me shqiptarët në të. Të çliroheshin nga një ministër, të cilit nuk i nevojitej kohë të mësojë çdo të thoshte të jesh pjesë e kabinetit qeveritarë, po do i duhej kohë të kuptonte se ishte pjesë e një qeverie e

cila nuk kishte qëllim parësorë të qeveriste shtetin, por të mbronte interesat partiake. Dhe pas rënies së Agron Buxhakut si Ministër i Transportit dhe Lidhjes, BDI-ja filloi në njëfarë mënyre të “transportojë” ambiciet klanore dhe regjionale të partisë dhe të “ndërlidh” diçka të ngjashme me atë që shqiptarët e kishin parë në vitet e parakonfliktit. Dorëheqja e Agron Buxhakut shënon atë kufi kur edhe BDI-ja thujse iu kthye “parimit”, se mjafton të jesh anëtarë i kësaj partie dhe të të mbështesin disa bashkëpartiak të fuqishëm, që të bëhesh ministër. Me çka edhe filloi që rekomandimi i “komandaturave” të jetë më i vlefshmi për ngjitjen e individëve në piramidën e pushtetit. Dhe ndodhi që të ketë edhe “komandat” të tillë, të cilët arritën t’i “punësonin” si ministri dhe drejtorë të ndërmarrjeve publike shumë nga të afërmit dhe miqtë e tyre. Me çka filloi periudha e largimit të BDI-së nga zgjedhësit e saj dhe nga miqtë që shpresonin se ajo nuk do i bëjë gabimet e dikurshme.

Por, nëse shqiptarëve u nevojiteshin tetë vite që të vlerësonin se çfarë (nuk)bëri PPD-ja, katër vite që të vetëdijesohen se “klika” e Arbër Xhaferit kishte ambicie të bëjë parti vetëm me shkronjën "SH", Ali Ahmetit nuk do i jepeshin më shumë se dy vite që të mbronte, apo ta rrëronte “mitin” e porsalindur se nuk ka punë të cilës nuk mund t’i dilte në krye Abazi. Pra, zgjedhësit e 2002 ishin të ngutshëm, donin sa më shpejtë të bindeshin se BDI-ja ishte alternativa e tretë e shumëpritur. Shqiptarët e paskonfliktit kërkonin dëshmi se Ali Ahmeti, në

mos më shumë, e kishte kuptuar se kur ke dilema si të veprosh përballë “tregtarëve politik” të Cërvenkovskit, mjafton të bësh të kundërtën e asaj që bënin dikur qeveritarët e PPD-së dhe PDSH-së. Pra, do mjaftonte të imponoheshin si partnerë i barabartë.

Dhe mbase Ali Ahmeti bëri shumëçka më ndryshe se kryesuesit e mëparshëm partiak shqiptarë, por bëri edhe diçka të ngjashme me ata: nuk arriti që ta konsolidojë partinë e vetë, që ta nxjerrë nga organizmi i ngjashëm me atë të “lidhjes socialiste”, e ta çojë në rrafshin e një partie e cila i ka të gjitha strukturat. Në të vërtetë, BDI-ja erdhi në koalicionin qeveritarë ende pa mbajtur as kongresin e parë të saj. Që do të thotë, ende nuk kishte organe legale, ende nuk kishte “rreshtuar” ambiciet bren-dapartiake, ende ishte në rrafshin e “partisë së re në themelim”, gjë që nuk u interesonte gjithaq votuesve shqiptarë dhe as kundërshtarëve politikë.

Koalicionin qeveritarë i pas konfliktit të 2001, dëshmoi diçka që nuk e kishte pritur askush: partitë e këtushme ende nuk dinin ta ndanin interesin ditorë partiak, nga ai afatgjati që kishte të bëjë me ardhmërinë e shtetit. Dhe në vend që gjitha forcat politike të Maqedonisë të angazhoheshin që sa më shpejtë të realizohej Marrëveshja e Ohrit dhe pastaj shteti të ecte përpara pa barrën e mosmarrëveshjeve ndëretnike, ndodhi e kundërta: partitë opozitare bënë çmos që t’ia ngadalësonin hapin në rrugëtimin drejtë një ardhmërie pa peshën e grindjeve politike ndëretnike. Kuptohet, në këtë betejë që të dëshmo-

nin dobësitë e qeverisë së Cërvenkovskit, prinin dy partitë më të mëdha të atëhershme opozitare – VMRO-DPMNE-ja nga kampi politik i popullit maqedonas dhe PDSH-ja nga tabori politik shqiptarë. Dhe kishte diçka që e bashkonte veprimin e tyre antiqeveritarë dhe që e bënte të lidhet në një nyje: ajo ishte Marrëveshja e Ohrit. Përderisa Gruevski me partinë e tij e akuzonte qeverinë se i bënte lëshime BDI-së (lexo: shqiptarëve) më shumë se ç’kërkonte Marrëveshja e Ohrit, PDSH-ja sulmonte qeverinë se nuk ishte në vijën e frymës së kësaj marrëveshje. Dhe mund të thuhet se të dy partitë opozitare, arrinin rezultate te popullata: Gruevski te etniteti Maqedonas, i cili edhe ashtu çdo ligj që kishte të bëjë me avancimin e të drejtave të shqiptarëve të këtushëm, e përjetonte si “shqiptarizim” të shtetit, dhe Arbër Xhaferi te shqiptarët e padurueshëm të cilët donin të gjitha të realizoheshin menjëherë. Ky veprim i të kundërtave që kishte rezultat të përbashkët – dobësimin e pozitave të koalicionit qeveritarë – do tregohet i suksesshëm, gjë që do shihet gjatë zgjedhjeve parlamentare të 2006 kur LSDM-ja do përjetojë humbje marramendëse, ndërsa PDSH-ja do kthehet në skenën politike të shoqërisë shqiptare ashtu siç nuk shpresonte askush - më e fortë se kurdoherë më parë.

Se sa mirë ishte “koordinuar” bashkëveprimi opozitarë mes VMRO-DPMNE-së dhe PDSH-së, më së miri dëshmon e vërteta se derisa Gruevski bënte çmos të bllokojë miratimin e cilitdo ligji që kishte të

bëjë me Marrëveshjen e Ohrit, Arbër Xhaferi kurrë nuk e ndihmoi BDI-në në betejën kundër atyre të cilët donin Maqedoninë ta kthenin në situatën e para konfliktit. Kështu që VMRO-DPMNE-ja luftonte aktivisht në parlament, e Arbër Xhaferi këtë luftë e bënte duke ndenjur kryesisht jashtë parlamentit. Asokohe, veprimi opozitarë i VMRO-DPMNE-së dhe PDSH-së, me shumëçka i ngjante një partie të ndarë në dy degë, e të cilat kishin strategji të ndryshme të veprimit, por me qëllim të njëjtë: pengimin e realizimit të Marrëveshjes së Ohrit. Këto dy parti i dallonte vetëm një gjë: përderisa Gruevski hapur tregonte se kurrë nuk do i përkrahte ligjet “proshqiptare” që dilnin nga Marrëveshja e Ohrit, Arbër Xhaferi thujse asnjëherë nuk tregoi se çka nuk i pëlqente në ligjet e propozuara dhe cili ishte synimi i tij. Pra, përderisa Gruevski hapur thoshte se do bëjë çmos që të pengojë “shqiptarizimin” e Maqedonisë, Arbër Xhaferi nuk shpalosi thujse kurrë se me çka do e pengonte “maqedonizimin” e plotë të shtetit. Kështu që, gjatë miratimit të ligjit për ndarjen territoriale, VMRO-DPMNE-ja bëri çmos që ta bllokonte decentralizimin e shtetit. Ajo shkoi aq larg në verbërinë e saj dhe shpirtngushtësinë etnike, sa u be përkrahëse e atyre që organizuan Referendumin për bllokimin e kësaj ndarjeje territoriale, e të cilin me të drejtë disa e quajtën “referendum-dum”, sepse sikur ai të ishte i suksesshëm, mund të ndodhte edhe ndonjë “dum-dum” i ri në Maqedoni. “Më 2 shtator të vitit 2004 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë konstaton se,



në pajtim me ligjin, janë mbledhur numër i mjaftueshëm i nënshkrimeve për shpalljen e referendumit në të cilin qytetarët e Republikës së Maqedonisë do të prononcohen për kthimin ose jo të ligjit të vjetër për organizim territorial të shtetit, atë të vitit 1996 me 123 komuna. Kushti i vetëm kushtetues për shpalljen e detyrueshme të referendumit është grumbullimi i 150.000 nënshkrimeve. Meqë shteti bëri kontrollin dhe u tregua se nismëtari për shpalljen e këtij referendumi (Kongresi Maqedonas Botëror) grumbulloi për çdo rast 30.000 nënshkrime më tepër, referendumin nuk mund ta pengojë askush dhe asgjë. Partitë shqiptare në pikëpamje të këtij referendumi në shikim të parë u ndanë. Ajo kryesorja, BDI-ja, do t`u bëjë thirrje shqiptarëve në Maqedoni që të mos dalin të votojnë për referendumin. Lideri i PDSH-së deklaroi se partia e tij nuk do të bëjë thirrje për bojkotimin e referendumit, por tha se ai do të japë përgjigje në pyetjen nëse maqedonasit duan bashkëjetesë me shqiptarët. Për PDK-në referendumi dëshmon se maqedonasit nuk duan të jetojnë me shqiptarët dhe bëri thirrje për federalizimin e shtetit dhe bashkimin e të gjitha partive shqiptare në qëllimin që të shpallet qeveri e përkohshme shqiptare me seli në Shkup. Prosperiteti me siguri do të përcaktohet mes dy opsioneve të fundit.” (Iso Rusi, “Lobi” 03.09.2004).

Pra, edhe kësaj radhe, partitë shqiptare ishin të ndara. Dhe përderisa Ali Ahmeti thoshte se ky referendum ishte i dëmshëm për Maqedoninë, se kështu shteti mund të futej në spiralen e

referendumeve të pafundmë që herë do i organizonin maqedonasit etnik, e herë shqiptarët, Arbër Xhaferi luante me më shumë letra. Mbase shkaku se ishte në hall të madh: referendumin e përkrahte dhe pas tij qëndronte “partneri strategjik” i PDSH-së – VMRO-DPMNE-ja. Në një intervistë të dhënë asokohe për të përditshmen “Dnevnik”, ku qartësonte pozitën e PDSH-së lidhur me këtë referendum, në pyetjen gazetareske se “a do të rrinë PDSH-ja tërësisht anash nga referendumi”, Arbër Xhaferi mundohet që edhe “mëkatin” për organizmin dhe mbajtjen e referendumit t’ia hedh LSDM-së dhe nga ai mëkat ta shpërlajë VMRO-DPMNE-në, duke thënë “Do t’i shfrytëzojmë konfuzionin dhe situatën e krizës për t’i analizuar ligjet. Referendumin do ta abstrahojmë si variant që në asnjë mënyrë nuk do të jetë i suksesshëm. Nuk do të ketë sukses referendumi meqë do të jetë shumë vështirë për t’u arritur censusi. Pas referendumit qëndron LSDM-ja, e jo Todor Petrovi ose qytetarët. Është organizuar që të dështojë dhe që LSDM-ja pastaj të lëvdohet se e ka shpëtuar shtetin...” E në ndërkohë, të gjithë kryesuesit dhe aktivistët e VMRO-DPMNE-së ishin të angazhuar që të sigurohej numri i duhur i nënshkruesve të iniciativës për mbajtjen e referendumit, dhe kështu mbeti e paqartë se vallë Arbër Xhaferi donte të thoshte se udhëheqësit e VMRO-DPMNE-së ishin në punë të përkohshme tek LSDM-ja, dhe e ndihmonin Cërvenkovskin të mbante referendumin që do dështonte. Apo, sipas vlerësimit të Arbër Xhaferit, dilte se simpatizantët e

VMRO-DPMNES-së i bllokoi rrugët e Kërçovës dhe të Strugës, që ta ndihmonin LSDM-në të realizonte më suksesshëm ndarjen territoriale të shtetit!?

Jo se LSDM-ja nuk dinte dhe nuk kishte bërë lojëra të tilla politike, sa të mbulonte vetveten, duke lëshuar në vijën e parë të betejës politike naivët e VMRO-DPMNE-së, të cilëve u rritej temperatura sa herë që përmendeshin “të drejtat shqiptare”. Jo se “mangupët” e LSDM-së nuk kishin përdorur disponimin antishqiptarë të VMRO-DPMNE-së që aktivistët e kësaj partie të thoshin atë që donte ta kumtojë LSDM-ja – siç ishin protestat e shumta të mëhershme në lidhje me arsimimin superior në gjuhën shqipe, të cilat i fillonte LSDM-ja e i përmbyllte VMRO – DPMNE-ja me greva të urisë – por gjatë qeverisjes së koalicionit LSDM - BDI, Cërvenkovski e dinte se kishin kaluar kohërat e lojërave të tilla. Pastaj ai e dinte se nuk ishte në favor të tij që cilado parti të merrte pikë me letrën të cilën e kishin harxhuar – atë të “antishqiptarisë”. Jo pse atij gjithaq i pëlqente realizimi i Marrëveshjes së Ohrit, por pse e dinte se me përfshirjen e BDI-së në koalicionin qeveritarë, ai edhe ashtu e kishte vënë në bixhoz fatin e partisë së vet në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Pastaj, ai udhëhiqte një qeveri të cilën bashkësia ndërkombëtare e mbikëqyrte se sa i përmbahej Marrëveshjes së Ohrit. Andaj ai kishte dy zgjidhje njësoj të rrezikshme: ose ta çonte Maqedoninë përpara, sipas Marrëveshjes së Ohrit, me çka do e dëmtonte partinë e vet, ose ta bllokonte

këtë Marrëveshje, me çka do e shpëtonte partinë, por do e dëmtonte shtetin. Ndoshta ai zgjodhi rrugën e mesme: të blejë kohë për ligjet që nuk i konvenonin – si për shembull ai për zyrtarizimin e gjuhës shqipe - dhe ngutshëm t'i propozojë ligjet që medoemos duhej miratuar, siç ishte ligji për ndarjen territoriale të shtetit.

Dhe kështu, Maqedonia arriti deri te zgjedhjet parlamentare të vitit 2006. Në këtë vit ajo arriti si zonjë, e cila vështirë ia dilte që petkun e vjetër të parakonfliktit, ta zëvendësonte me atë të qepur sipas “modelit” të dalë nga Marrëveshja e Ohrit. Pra, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, Maqedonia kishte mbetur me hapin në ajër: as atje ku ishte para 2001, as aty ku e çonte Marrëveshja e Ohrit. Dhe partitë politike shpalosën listat e kandidatëve të tyre për deputet të ardhshëm në parlamentin republikan. Secili nga dymijë e gjashtëqind e njëzet kandidatët, shpresonte se do jetë përfaqësues i ardhshëm i popullit në institucionin më të lartë shtetërorë. Në atë tollivi listash dhe emrash për deputet të ardhshëm republikanë, bënë pjesë edhe të propozuarit e partive shqiptare, ku dominonin kandidatët e dy partive më të mëdha shqiptare në Maqedoni – ata të Bashkim Demokratik për Integrim dhe të Partisë Demokratike Shqiptare.

Në fazën parazgjedhore, këta kandidatë do prezantonin potencialin kadrovik të tridhjetë e një partive dhe dy listave të qytetarëve. Ndërkaq, 120 deputetët që do zgjidheshin me pesë korrik të vitit 2006, nuk do pasqyronin vetëm vlerat personale dhe

potencën e partive të veta, por edhe nivelin dhe vetëdijen politike të një shoqërie. Sepse me votën e vet, zgjedhësi nuk verifikonte vetëm vlerat e kandidatit dhe besueshmërinë ndaj partisë, por njëkohësisht dëshmonte edhe sa e kishte kuptuar se politikanin nuk duhet ta masësh nëpërmjet asaj që e thotë, por nga domethënia e asaj që e heshtë.

Kishte diçka që mundej lehtë të vërehej në listat e kandidatëve për deputetë republikanë, dhe që të gjithë ata i bënte të ngjashëm me njëri tjetrin, pa marrë parasysh përkatësinë partiake, apo etnike. Ajo është e vërteta se edhe në Maqedoni - si në shumë shtete possocialiste të këtyre hapësirave - profesioni i deputetit ishte një ndër më të dëshiruarit nga aktivistët partiak. Mbase për shkak se konsiderohej si më i sigurti dhe si veprimtari e cila nuk bartë asnjëfarë përgjegjësi politike. Vlerësuar nga përvoja e mëparshme demokratike, nga deputetët republikanë edhe nuk ishte kërkuar ndonjë aftësi e veçantë, përpos dëgjueshmërisë dhe besnikërisë ndaj lidërshtetit dhe të dinin ku ndodhej butoni për të votuar ashtu siç kishin marrë urdhër nga partia. Mundësia e daljes së shpeshtë në ekranet televizive, nga do i shihnin familjarët dhe dashnoret, ishte edhe një argument më shumë të faktorizoheshin edhe individë për të cilët as familjet e tyre nuk e dinin ç'vlerë kishin dhe cilat nga veprat e tyre jetësore i kishin ngritur në rrafshin e përcaktuesit të fatit të shtetit.

Dhe përderisa nga listat e kandidatëve të partive të etnitetit maqedonas shihej se ato nuk kishin

shkuar në skajshmëri - duke kandiduar edhe individë plotësisht të panjohur për opinionin - listat e partive shqiptare shprehnin ashiqare qëndrimet e elitave partiake, se partia e përcaktonte vlerën e individit, e jo individi forcën e subjektit partiak. Kështu që nëse shumicës së kandidatëve të BDI-së dhe PDSH -së ua nxirrje emblemën partiake, nga ata mbetej vetëm një emër e mbiemër, i cili nuk kishte asnjë domethënie për shqiptarët e këtushëm. Thënë më qartë: listat e kandidatëve shqiptarë për parlamentarë të ardhshëm, nuk shprehnin vlerat e vërteta të elitave politike dhe intelektuale të shqiptarëve të këtushëm, por hallin e udhëheqësve të BDI-së dhe PDSH-së për t'ua plotësuar dëshirën dhe ambiciet aktivistëve partiak, të cilët aktivitetin politikë e kishin kuptuar si mundësi për t'u punësuar si deputet apo ministër. Kështu që në listat e BDI-së u gjetën edhe kandidat të llojit të Fadil Sulejmanit, të cilët partitë i ndërronin si jevgu kuajt. Nga ana tjetër, lista e kandidatëve të PDSH-së shprehte qartë të vërtetën se kjo parti ende ishte në duart e atyre, të cilët rivalitetin ndërpartiake e kuptonin si përleshje mes dy "bandave" të cilat pretendojnë të kontrollojnë "lagjen" e biznesit dhe pushtetit që u takonte shqiptarëve të Maqedonisë.

Mbase listat partiake të kandidatëve për zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, më së miri dëshmonin të vërtetën se udhëheqësit partiak kishin mbetur peng i sistemit piramidial të vlerave, të cilin e ndërtuan me duart e veta gjatë dekadave të kaluara. Partitë shqiptare, duke dashur të mbroheshin nga njerëzit që kanë kokë dhe portret individual, muruan kalanë e

vetëdijes se “certifikata” partiake i mbulon të gjitha paaftësitë personale me çka edhe i rrënuan të gjitha standardet vlerësuese. Dhe në shoqërinë shqiptare u ndërtua një sistem piramidal vlerash në të gjitha sferat e jetës, i cili nëse papritur do të rrënohej, do ta bënte të dukshme se disa nga subjektet politike të shqiptarëve të Maqedonisë ishin shndërruar në pronë private të udhëheqësve partiak. Andaj edhe ky sistem piramidal vlerash nuk qëndronte mbi koncepte të qarta politike, por mbi autoritetin e njëshit partiak. Në të vërtetë, bëhet fjalë për një spirale të pafundme nga e cila edhe nuk mund të dilnin aq lehtë udhëheqësit e partive shqiptare, sepse ata vetë e përruruan bindjen se vetëm emblema partiake t’i hap dhe t’i mbyllë rrugët e suksesit profesional. Dhe udhëheqësit e këtyre partive thuajse kishin mbetur të ngujuar në kalanë e sistemit piramidal të vlerave, duke mos ditur si të shpëtojnë nga vetëdija e trashëguar prej së djeshmes ideologjike, se më lehtë e ke më të dëgjueshmit e paaftë, se sa me të padëgjueshmit që kanë vlera personale.

Zgjedhjet parlamentare, të pestat me radhë në Maqedoni, ishin të veçanta edhe shkak i përqindjes së madhe të atyre të cilët mbase edhe fare nuk ishin të interesuar të votonin. Nuk kishte dyshim se edhe emrat e kandidatëve në listat partiake ndikonin që të dominonte bindja se edhe pas pesë korrikut, asgjë nuk do ndryshonte, përpos gotës me ujë në foltoren e parlamentit. Ky mosinteresim ishte veçanërisht i theksuar tek elektorati shqiptarë. Anketat parazgjedhore tregonin se përqindja e votuesve

shqiptarë që do u drejtohen kutive të votimit, do jetë më e vogël në krahasim me numrin e pjesëmarrësve në zgjedhjet e mëparshme si dhe krahasuar me daljen e etnive tjera që jetojnë në Maqedoni – rreth katërdhjetë përqindë. Andaj edhe përfaqësuesit e institucioneve perëndimore nuk i shqetësonte gjithaq se cila parti shqiptare do i fitonte zgjedhjet parlamentare, sa mosdalja e shqiptarëve në zgjedhje. Kjo frikë e tyre kishte të bëjë edhe me përvojën e hidhur nga e kaluara, kur sa më i vogël ishte numri i atyre që votonin, aq më shumë rritej numri i atyre që i mbushnin kutitë e votimit në vend të zgjedhësve. Apo kur fituesin nuk e caktonin votuesit, por ata që numëronin votat.

Zgjedhjet parlamentare të 2006 ishin nga më të parashikueshmet. Dihej se LSDM-ja do humbë dhe se BDI-ja ende nuk e kishte harxhuar besimin te shumica e shqiptarëve të Maqedonisë. Kuptohet, do kishte edhe befasi të vogla, por që nuk e ndryshonin paragjykimin kryesorë, se Gruevski do fitonte shumicën e besimit të etnitetit maqedonas dhe se shqiptarët do ia jepnin edhe një mundësi Ali Ahmetit që të vazhdonte punën aty ku e kishte lënë. Befasitë ndodhën më shumë në kampin politik shqiptarë ku u pa se procesi i “rrugaçerimit” të aktivitetit partiak kishte arritur kulmin. Këtë nuk e dëshmonin vetëm listat e kandidatëve për deputetë, ku nuk mungonin edhe “muskujt” partiak, por edhe zënkat fizike mes përkrahësve partiak të PDSH-së dhe BDI-së. Ato konfrontime morën aso përmasash, sa duheshte të ndërhyjnë edhe ambasadorët e



shteteve perëndimore, të cilët kërkonin nga udhëheqësit partiak të distancoheshin nga ato konflikte. E ata me të vërtetë distancoheshin, por vetëm sa ishin përpara selive të ambasadave perëndimore.

Qershori parazgjedhorë i vitit 2006 do jetë shumë i nxehtë për partitë shqiptare të Maqedonisë. Njësoj si edhe lajmet e mbrëmjes nëpër ekranet televizive ku lajmësit në gjuhën maqedonase, zhurmshëm dhe me një dozë ironie, lajmëronin për incidentet e armatosura mes simpatizantëve të Partisë Demokratike Shqiptare dhe atyre të Bashkimit Demokratik për Integrim. Ata jepnin edhe pamje nga vendngjarja e incidenteve. Në ato pamje shihej ndonjë kandidati i përgjakur për deputet i BDI-së, i cili rrëfente se si e kishin rrahur dhe torturuar aktivistët e PDSH-së. Me zë të përvajtuar dhe i përlotur, i akuzonte udhëheqësit e PDSH-së për plagët e marra në trup dhe ato që do i mbeteshin në shpirt. Pastaj, në lajmet qendrore të mediave të këtushme, fytyra e tij e përgjakur ua lëshonte vendin udhëheqësve të PDSH-së, të cilët thoshin se aktivistët e partisë së tyre nuk janë përleshur me partizanët e BDI-së, por me policinë maqedonase e cila i përkrahë partitë në pushtet.

Lajmet qendrore në gjuhën maqedonase të muajit qershor të vitit 2006, vazhdonin me kërkesën e disa qarqeve politike të etnitetit maqedonas që vëzhguesit ndërkombëtarë të bëjnë dy raporte për (pa)rregullsitë e zgjedhjeve parlamentare në Maqedoni: një ku do vlerësohet kultura politike e

etnitetit maqedonas, dhe tjetri ku do vlerësohet shkalla e demokracisë së etnitetit shqiptarë. Apo thënë ndryshe, kërkonin që shteti të distancohej nga ajo që ndodhte në kampin politik shqiptarë. Në lajmet në gjuhën maqedonase u jepej vend edhe deklaratave politike se shqiptarët ende nuk janë të pjekur për zgjedhje demokratike dhe të lira, ku përfshihej edhe deklarata e kryeministrit të atëhershëm Buçkovski, i cili shprehte gatishmërinë t'u ndihmohej partive shqiptare që ta tejkalonin këtë "afrikanizim" të garës parazgjedhore, duke theksuar se me këtë e marrin në qafë Maqedoninë, e jo vetëm vetveten.

Pamjet të cilat i paraqisnin mediat nga aktiviteti parazgjedhorë i partive të etnitet maqedonas, ishin krejtësisht ndryshe nga atmosfera që dominonte te pala shqiptare: aktivistët partiak shëtisin nëpër lagjet e Shkupit dhe nëpër tregje, bisedonin me qytetarë. Mbase edhe ata e shitnin mallin e vetëm që kishin: premtimet e kota. Por, këtë e bënin të qetë. I kritikonin kundërshtarët politik, por pa i egërsuar simpatizantët e vet. Edhe ata e ëndërronin më ëndje grazhdin shtetërorë, por ëndrra e tyre sadopak ishte e vendosur në kornizat e një mirësjelljeje elementare politike. Pa dyshim se etniteti maqedonas kishte diçka që u mungonte shqiptarëve të Maqedonisë: elitat politike që i kultivoi gjatë dekadave të kaluara kur shqiptarëve u ishte përcaktuar vetëm profesioni i analfabetizmit. Por, kjo fare nuk do të thoshte se shqiptarët e këtushëm ishin në atë rrafsh ku i kishin vendosur disa aktivistë partiak.

Ditët e qershorit në vitin 2006 ishin të gjata, prandaj edhe lajmet qendrore të mbrëmjes mbeteshin pronë e ditëve me diell. Edhe në kanalet televizive në gjuhën shqipe, dominonin thujtë të njëjtë për incidentet ndërpartiake në mes simpatizantëve të PDSH-së dhe BDI-së. Njësoj si në ekranet që flisnin maqedonisht, edhe në ato të gjuhës shqipe, u pa fytyra e larë në gjak e një kandidatit për deputet të BDI-së. Fytyra e tij e përgjakur ngjante si e ardhur nga lagjet e rrezikshme të Bagdadit. Të njëjtën ndjenjë ta ngjallin edhe shtabet partiake, përplot vrima nga plumbat e automatikut, me xhama të thyer, në copat e të cilëve kishin mbetur pjesë nga fotografitë e udhëheqësve partiak. I plagosuri i BDI-së, disi turpshëm, por shqip dhe shumë më direkt se në ekranet në gjuhën maqedonase, i akuzoi udhëheqësit e PDSH-së për plagët e marra. Me siguri është i vetëdijshëm se gjaku në fytyrën e tij është njollë e turpër për gjithë shqiptarët e Maqedonisë. Pasi i thotë të gjitha që ka për t'i thënë, ekranin e mbulojnë fytyrat e qeta të kryesuesve të PDSH-së, të cilët shpjegojnë se janë në hall nga policia maqedonase e cila, sipas tyre, qenka vënë në shërbim të aktivistëve të BDI-së dhe i maltreton simpatizantët e tyre partiak. Pastaj, kryetari i kësaj partie i vlerëson si të pasakta pohimet se shqiptarët e Maqedonisë nuk kanë pjekuri politike të organizojnë zgjedhje të lira dhe demokratike. Këtë e dëshmon duke marr shembull zgjedhjet "skandinave" të organizuara në Kosovë. Ndoshta dëshiron të thotë se shqiptarët dinë të organizojnë zgjedhje të lira dhe demokratike, por këtë nuk ua

mundësojnë të “tjerët”. Mbase edhe kishte deri diku të drejtë, sepse në Maqedoni nuk ishin të pamundura kurdisjet nga shërbimet e ndryshme policore, të cilat ende ishin të kontrolluara vetëm nga etnitetit maqedonas. Por, edhe sikur të tjerët të ishin regjisorët e kësaj shfaqjeje të trisht parazgjedhore, nuk mund të mohojë e vërteta se rolet kryesore i luanin aktivistët e partive shqiptare. Nëse iniciuesit e incidenteve ishin individ nga të cilët nuk distancohej asnjë parti shqiptare, atëherë vallë kjo do të thoshte se këto parti ishin nën ndikimin e strukturave destruktive të etnitetit maqedonas?! Mbase më afër të vërtetës do ishte vlerësimi se duke i shpallur fajtorë të tjerët, partitë e shqiptarëve donin ta mbulojnë rruçërinë e aktivitetit të tyre parazgjedhorë.

Deklarata e kryesuesve të BDI-së dhe PDSH-së, lidhur me incidentet parazgjedhore, ishin thuajse të njëjta: të dy palët premtinin ardhmëri të ndritshme dhe betoheshin se do bëjnë çmos që zgjedhjet të jenë të lira dhe demokratike. Ishin të buzëqeshur, dinjitoz dhe të dehur nga duartrokitjet e simpatizantëve, të cilët i shëtisin me autobusë nga një vendbanim në tjetrin, në mënyrë që të mos rrezikonin të mbanin fjalime në sheshet e boshatisura. Selitë e partive shqiptare në Tetovë, ishin bërë si agjenci turistike ku paraqiteshin ata që donin një shëtitje falas nëpër Maqedoni. Por, vetëm nëse ishin të gatshëm shëtitjen ta paguanin duke mbajtur në dorë një flamur partiak dhe nëse pranonin zëshëm të brohorisin emrin e udhëheqësit partiak sa herë që u jepnin shenj “dirigjentët” e mitingjeve. Kryesuesit e fushatës

parazgjedhore të BDI-së dhe PDSH-së, pohonin se i kishin udhëzuar aktivistët e tyre të mos nxisin incidente, të mos përdorin dhunë. Këtë e thoshin në kohë kur rrugët e vendbanimeve shqiptare mbeteshin të zbrazura, sepse banorët e tyre qysh në periudhën parazgjedhore i trishtonte “festa” e pesë korrikut kur do duhej t’u drejtoheshin vendvotimeve.

Lajmet qendrore për ndodhitë e qershorit parazgjedhorë të vitit 2006, përfundonin duke lënë të njëjtën shije të hidhërimit tek shqiptarët. Pastaj shqiptarët dilnin nëpër kafenetë dhe çajtoret që t’i përfundonin analizat e veta politike. Çdo njëri zinte vend në kafenenë dhe në çajtoren e partisë së vetë. Dhe duke tymosur cigaret, e duke pirë çaj, shtronin pyetje nga më të ndryshmet. Si për shembull atë, se mos vallë qarqet destruktive maqedonase ishin infiltruar nëpër partitë e tyre dhe ua kurdisin këtë përleshje absurde ndërpartiake. Por, pyetja përnjëherë u dukej e palogjikshme: ata i njihnin “trimat” partiak të cilët për “nënë parti” nuk kursenin as plumbin. Ata i shihnin me sytë e tyre se cilët ishin ata që shëtisnin natën me vetura pa targa. Dhe më në fund, ata nuk donin të pranonin se kanë elita politike që nuk janë të afta t’i mbrojnë nga manipulimet e ndryshme. Andaj, vazhdonin më tej të shtjellojnë se cila mund të ishte arsyeja që aq i kishte verbuar udhëheqësit e tyre partiak deri në atë masë, sa ata të mos shihnin se qëmoti kishin mbetur peng i veprimtari partiak, i cili kishte marrë përmasat e një grindjeje të pamëshirshme edhe mes simpatizantëve të tyre. Pra, cilat ishin shkaqet që i bënë të mos

shohin se nuk ngritën parti që do i shërbenin popullit dhe do fitonin zgjedhjet, por ndërtuan sistem piramidale vlerash, i cili kishte për qëllim tërë popullin ta bënte shërbëtorë të partive, duke i mbështetur aktivitetet e tyre partiake mbi “muskujt”, e jo mbi “trurin” e aktivistëve të vet.

Në ato buzëbrëmje të nxehta të qershorit të 2006, lajmet qendrore ishin më të shikuara se kurrë më parë, thuajse aq sa edhe lojërat e kampionatit botërorë në futboll. Mbase duke shpresuar se do arrijnë të qartësojnë se ç’është duke ndodhur mes partive të tyre. Dhe shtronin pyetje nga më të ndryshmet. Pyesnin se vallë kryesuesit e partive të tyre nuk e shihnin se incidentet mes simpatizantëve të PDSH-së dhe BDI-së, ishin njollë mjaft e madhe e turpiti, e cila nuk do mund të fshihet aq lehtë nga fytyra e kulturës politike të shqiptarëve të këtushëm. Ata dyshonin edhe në largpamësinë e kryesuesve të partive të tyre. Dhe, përpos që e dinin se posa të lëshohej terri, duhej të ktheheshin nëpër shtëpitë e veta, prapë shumëçka u mbetej e paqartë. Sepse nata u takonte aktivistëve partiak, të cilët i stolisin lagjet me parulla dhe flamuj të PDSH-së. Që ashtu të stolisura, lagjet të prisnin mëngjesin e ardhshëm. Mëngjes i cili bëhej lajmës i një realiteti trishtues që kishte kapluar vendbanimet shqiptare në Maqedoni gjatë kësaj periudhe parazgjedhore. Shqiptarët e këtushëm shtronin shumë pyetje dhe nuk e dinin se cila nga partitë e tyre do i fitonte zgjedhjet. Mirëpo, ata e dinin se kush do jetë humbës: gjithë shqiptarët e këtushëm të cilët, partitë e tyre, e jo dikush tjetër,

i njollosën me turpin se janë kope e cila njih dhe respekton vetëm dhunën “demokratike”. Pra, zgjedhësit shqiptarë e dinin se viti 2006 nuk solli atë që ata ëndërronin: zgjedhje pa dhunë dhe votim si në ditë festive ku fiton më i miri e jo më i dhunshmi.

Si do që të jetë, zgjedhjet u mbajtën dhe përfunduan. Vëzhguesit ndërkombëtarë hartuan raportet e veta ku nuk harruan - kush e din për të satën herë - të shënonin se eksetet më të rënda ndodhën në mjediset ku votonin shqiptarët. As kjo e vërtetë nuk i pengonte disa parti shqiptare gjatë kremtimit të fitores. Edhe Tetova kremtoi fundin e zgjedhjeve. Simpatizantët e PDSH-së, me flamujt e vet partiak të lidhur me ato të VMRO-DPMNE-së, kremtonte fitoren e Gruevskit. Dhe PDSH-ja kishte të drejtë t'i gëzohej fitores së Gruevskit, sepse kishte dhënë kontribut që partia e tij të fitojë sa më bindshëm: në një vendvotim në Tetovës, ku me siguri do kalonte kandidati shqiptarë i BDI-së, shqiptarët e PDSH-së votuan kandidatin e VMRO-DPMNE-së. Me çka ndoshta u bënë edhe nismëtarë të një koncepti të ri shumetnik të zgjedhjeve në Maqedoni: që të votohej më i vlefshmi, e jo ai që kishte emblemën etnike të votuesve.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2006, PDSH-ja fitoi më pak vende parlamentare se sa koalicioni BDI-PPD. Por, edhe si humbëse në bllokun politik shqiptarë, partia e Arbër Xhaferit do jep edhe një kontribut të pakontestueshëm në etablimin e demokracisë që Maqedoninë ta kthente aty ku ishte para konfliktit të 2001: pranoi të bëhet pjesë e

koalicionit qeveritarë të Gruevskit duke e ditur se nuk ishte përfaqësuese e vullnetit shumicë politikë të shqiptarëve të këtushëm. Me këtë, PDSH-ja u dha ndihmesë atyre që donin t'ia lajnë borxhin Ali Ahmetit për konfliktin e 2001, u ndihmoi atyre që donin të dëshmonin se nuk ka forcë që mund t'i çojë të ndanin pushtetin me “terroristët” e Ali Ahmetit. Dhe kështu Gruevskit iu dha mundësia të përbuzte atë më të shenjtën që kishin shqiptarët: votën e lirë me të cilën do vendosnin se kush do i përfaqësonte në institucionet më të larta shtetërore.

Zgjedhjet parlamentare të 2006 nuk dëshmuuan se “vëllazëria” VMRO-DPMNE - PDSH ishte ajo e njëjta e parakonfliktit, por se kësaj radhe ajo ishte edhe më e thellë. Se ishte sforcuar më shumë se kurdo qoftë më parë. Për ata që kishin sy të shihnin, kjo u pa edhe gjatë fushatës parazgjedhore, kur sulmet e kryesuesve të PDSH-së ndaj Ali Ahmetit, ishin përqendruar që atij t'i shlyhej aura e UÇK-së. Për këtë ata kishin thirrur në “punë të përkohshme” edhe aktivistin e njohur shqiptarë Bardhyl Mahmutin, i cili u angazhua në PDSH posa filluan përgatitjet për zgjedhjet parlamentare të 2006. Dhe u pa menjëherë se ai nuk ishte kthyer në Tetovë që të qartësonte dhe përkrahte programin parazgjedhorë të PDSH-së, por që ta njolloste sa më shumë partinë e Ali Ahmetit. Pra, edhe njëherë u dëshmuua aftësia e kryesuesve të PDSH-së, që t'i përdorin njerëzit për nevojat e çastit, e pastaj t'i hedhin si të papërdorshëm. Siç ndodhi edhe me Bardhyl Mahmutin, i cili braktisi këtë parti me siguri jo pse



donte, po pse i kishte kaluar “kontrata e përkohshme” dhe duhej të shkonte nga kishte ardhur. Por, gjithsesi i bindur se punën për të cilën e kishin angazhuar e kishte kryer ndershëm. Ai tha për Ali Ahmetin gjëra të cilat nuk do pritej t’i thoshte njeriu që paraprakisht kishte pyetur Arbër Xhaferin se kush ia “kishte zënë bishtin te dera”.

Sido që të jetë, Gruevski pati guxim t’i thotë “jo” votës shqiptare, jo pse ishte i guximshëm, por pse Arbër Xhaferi i tha “po” veprimit të tij që të ç’vlerësonte vullnetin politik shqiptarë. Dhe kështu Gruevski bëri qeveri me partnerët të mbledhur nga majtistë të skajshëm, si ato të partisë së Xingos e Tito Petkovskit, e deri te djathtistë e parti pa fizionomi politike. Kështu edhe një herë u dëshmuua se shqiptarët dhe maqedonasit etnik, herë ishin shumë afër të nënshkruajnë marrëveshjen historike se kurrë nuk do merreshin vesh të, e herë aq lehtë pajtoheshin, sa të bëhej se nuk kanë bezdi tjetër përpos harmonisë së plotë. Andaj edhe krijohej përshtypjen se ata në të vërtetë nuk grindeshin shkak i ndonjë mosmarrëveshjeje, por vetëm sa mos t’i linin pa punë të huajt, të cilët kishin rolin e dadove të marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni. Shikuar nga ky këndvështrim, partitë politike shqiptare kishin rol të dyfishtë: sa të kontribuonin të mos mbeteshin pa punë diplomatët e ambasadave perëndimore, po aq edhe të thellonin grindjet mes shqiptarëve të këtushëm të cilët, të papunë si ishin, nuk do kishin për çka të grindeshin nëpër kafenetë e shumta ku e harxhonin kohën në pritje të ditëve më të mira.

Diku mes (mos)marrëveshjeve shqiptaro-maqedonase dhe grindjeve ndërpartiake shqiptare, mbetej Maqedonia në të cilën të huajt ndoshta nuk bënin asgjë më shumë, përpos që i testonin të gjitha “demokratizat” e mundshme, e që mund të ishin frutdhënëse në Ballkanin shumetnik. Pra, ata provonin edhe demokracinë klasike, u lejonin partive edhe të grinden, por vinte çasti kur “loja mbaronte”, kur partive u lejohej vetëm aq sa edhe fëmijëve të papërgjegjshëm, të cilët paraprakisht kishin dëshmuar se është e rrezikshme t’i lësh vetë të kujdesen për shtëpinë.

Mbase diçka e ngjashme do ndodhë edhe pas zgjedhjeve parlamentare, kur duhej të formohej koalicioni i ri qeveritarë. Pra, pasi morën fund të gjitha grindjet publike se cila nga partitë shqiptare duhej të hyjnë në koalicionin qeveritarë, mundë të ndodhte që në qeveria e Gruevskit t’i përfshiheshin thuajse të gjitha partitë shqiptare – BDI-në, PDSH-në dhe PPD-në. Pra, ishte e mundur që pas gjitha grindjeve parazgjedhore, pas plagosjeve dhe rrahjeve, pas thënieve të shumta ofenduese nga kryesuesit e PDSH-së në adresë të Ali Ahmetit dhe UÇK-së, pra pas gjithë asaj që i tronditi shqiptarët e këtushëm, kryetari i VMRO-DPMNE-së, kishte mundësi të realizojë atë që mendohej ta bënte Ali Ahmeti pas luftës së 2001 – t’i bashkojë partitë shqiptare dhe t’i çojë të harrojnë grindjet e ndërsjella. Me çka edhe njëherë do dëshmohej e vërteta se hidhërimi është i përkohshëm, ndërsa harrese e përjetshme. Se mjafton të mësohesh të harrosh që të arrish deri aty sa edhe

kur të ripërtërihet mbëmendja, të mos kesh dobi prej saj.

Cila do që të ishte përbërja e ardhshme qeveritare e Maqedonisë, mbeti e vërteta se mandatarin e saj atë e nisi mbrapshtë. Apo ndoshta bëri një lojë të suksesshme vetëm sa të dobësonte faktorin politik të shqiptarëve të këtushëm. Dhe mbase këtë edhe e arriti duke përfshi në qeveri PDSH-në, që i kishte humbë zgjedhjet në bllokun politik shqiptarë. Mandatarin Gruevski e nisi mbrapshtë formimin e koalicionit qeveritarë edhe me ndihmën e PDSH-së, e cila ende pa u mbyllur kutitë e votimit, vrapoi në selinë e VMRO-DPMNE-së nga u vetshpallë pjesë e koalicionit qeveritarë edhe pse e dinte se fituese është BDI-ja e Ali Ahmetit. Me çka Gruevskit i mundësoi të ketë pozitë të lakmueshme dhe të qëndrojë anësh përderisa partitë shqiptare grinden se cila ka legjitimitet që shqiptarët t'i prezantojë në institucionet më të larta shtetërore. Dhe nuk grindeshin mes veti vetëm përfaqësuesit e partive shqiptare, por debati morri përmasa mbarë maqedonase. Thua jse të gjithë përnjëherë harruan se Maqedonia nuk ishte ajo e para Marrëveshjes së Ohrit, se ishte krijuar një "traditë" demokratike të cilën nuk guxonte ta zhbëj askush: partia shqiptare që fitonte shumicën e votave shqiptare të ishte ajo që ftohej e para të bëhej pjesë e qeverisë së formuar nga partia fituese e etnitetit maqedonas. Pra, u përsëritë e njëjta tendencë si dikur pas zgjedhjeve parlamentare të 2002, kur qarqe politike maqedonase, donin t'ia mohonin fitoren BDI-së, duke e shpallur parti të

papranueshme për koalicionin qeveritarë, të papëlqyer nga mandatarin, shkak i së kaluarës së saj luftarake.

Njësoj si në 2002, edhe pas zgjedhjeve parlamentare të pesë korrikut të vitit 2006, askush nuk e kuptoi se kush e nisi këtë debat: udhëheqësit e PDSH-së, të cilët me çdo kusht dëshironin të bëhen pjesë e qeverisë së Gruevskit, apo qarqet antishqiptare që ende vuanin “plagët” e 2001, të cilët edhe një herë e provuan se vallë do mundën të marginalizojnë partinë e Ali Ahmetit, e cila mbase ua rikujton të shtënat e UÇK-së, ato të shtëna të cilat brenda disa muajsh arritën t’i jetësonin ëndrrat shumëvjeçare të shqiptarëve

Përderisa në zgjedhjet e 2002, Ali Ahmeti arriti t’i përballë të gjitha sulmet e atyre për të cilët ai ishte “terrorist” që e ka vendin në qelitë e burgut të Idrizovës, e jo në kabinetet qeveritarë, pas zgjedhjeve të parlamentare të 2006, ai nuk ia doli të përballë fushatën e ngjashme me atë të 2002-shës kundër BDI-së. Ndoshta shkak se kësaj radhe këtë fushatë kundër BDI-së nuk e udhëhiqnin qarqet politike të etnitetit maqedonas, por PDSH-ja e Arbër Xhaferit. Dhe Ali Ahmeti thujse iu nënshtrua vullnetit të opinionit të këtushëm të teledirigjuar nga VMRO-DPMNE-ja dhe PDSH-ja. Thujse nuk arriti t’u bëjë ballë atyre të cilët, njësoj si pas zgjedhjeve të 2002, e këshillonin mandatarin të mos bëjë koalicion qeveritarë me BDI-në. Atyre që u thoshin shqiptarëve se koalicioni qeveritarë, VMRO-DPMNE – PDSH do ndikojë mirë në

shëndetin e demokratizimit të shoqërisë së tyre në Maqedoni. Me çka, shumë vrazhdë i përbuzën votuesit shqiptarë dhe sa nuk u thanë se ata nuk dinin të kujdeseshin për shëndetin e demokracisë së tyre, se votën e tyre duhet ta verifikonte edhe një herë VMRO-DPMNE-ja dhe PDSH-ja.

Dobësimin e pozitive të subjekteve politike shqiptare kishin për qëllim edhe ata që u vunë në mbrojtje të rregullave demokratike dhe thoshin se askush nuk mund ta mohojë të drejtën e mandatarit të formojë qeveri me partitë të cilat ai i parapëlqen. Pra ata që pohonin se vlerësuar nga këndi i standardeve të demokracisë perëndimore, Gruevski mund të bënte koalicion qeveritarë edhe pa asnjë parti shqiptare në të, se ai mund të bënte qeveri edhe me dhjetëra shqiptarë “të ndershëm”, si në kohën e socializmit, të cilët ishin në shumicë jo vetëm në PDSH, por edhe jashtë saj, se Gruevski kishte mbulesë demokratike edhe për të mos përfillur votën e shqiptarëve.

Nuk kishte dyshim se Gruevski kishte mbulesë demokratike dhe juridike të mos e përfillë votën shqiptare, por ishte e pamundur të gjente mbulesë për “prapanicën” e cullakosur shumetnike të Maqedonisë. Ishte e pamundur t’ia dilte të ndërtonte institucione të qëndrueshme shtetërore, pa përfshirë në to edhe partinë e cila kishte fituar besimin e shumicës së shqiptarëve të Maqedonisë. Njësoj siç e kishte të pamundur të shpjegonte se ç’kuptim do kishin zgjedhjet parlamentare për shqiptarët e këtushëm, nëse mandatarin do mund të bënte qeveri

edhe me partinë shqiptare që ka fituar pakicën e votës. Ç’kuptim do kishte gara ndërpartiake mes shqiptarëve, nëse ata votojnë, por partitë maqedonase ua caktojnë përfaqësuesit e tyre në organet më të larta shtetërore? Vallë kjo nuk është një “film” i vjetër “neosocialistë” të cilin shqiptarët e kishin parë dekada me radhë, përmbajtjen e të cilit e dinin përmendësh dhe që kishte vetëm një porosi: ne mendojmë për të mirën e juaj.

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006 në Maqedoni, u zhbë një “tradihtë” demokratike e cila nuk duhej prishur: nëse votuesit e etnitetit maqedonas vendosin se cila parti e tyre do jetë bartëse e koalicionit qeveritarë, atëherë vota e shqiptarëve, përcaktonte partinë e tyre fituese që do bashkëqeveriste me Maqedoninë. Kjo “tradihtë” demokratike u mundësonte shqiptarëve të besojnë se edhe ata vendosin kush do qeverisë me shtetin ku jetonin. Ky rregull i pashkruar për mënyrën e qeverisjes së Maqedonisë, ishte shpërfillur vetëm njëherë më parë – pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 1998, kur partner shqiptarë i qeverisë së VMRO-DPMNE-së, u bë PDSH-ja që kishte më pak parlamentarë se sa Partia për Prosperitet Demokratik. Ky rregull i “ballkanokracisë” maqedonase, përfundimisht u prish pas zgjedhjeve parlamentare të pesë gushtit. Dhe nuk u prish atëherë kur PDSH-ja u bë pjesë e qeverisë, por në çastin kur partitë shqiptare lejuan që të diskutohej se cila nga ato duhet të bëhet pjesë e qeverisë së Gruevskit. Pra, u prish që nga çasti kur PDSH-ja doli në mbështetje

të qëndrimit se partia fituese maqedonase – e jo votuesit shqiptarë - është ajo që duhet të përcaktojë partinë shqiptare të koalicionit qeveritarë, .

Nuk kishte dyshim se askush nuk mundej të mohonte të drejtën e mandatarit që vet të vendoste se cilat parti do bëhen pjesë e koalicionit të tij qeveritarë. Se dilemat rreth përbërjes qeveritare marrin fund në çastin kur ai arrin të sigurojë shumicën e votave që do përkrahin kabinetin e tij qeveritarë. Por, për Maqedoninë kjo demokraci ishte ende e largët aq sa edhe rruga që atë e çonte drejtë anëtarësimit në Unionit Evropian. Dhe nuk kishte dyshim se edhe Maqedonia duhej të shkonte drejtë një demokracie të tillë, të pastër qytetare. Dhe ajo do ishte e mundur vetëm atëherë kur qysh gjatë fushatës parazgjedhore, PDSH-ja do e bënte publike se është vetëm “degë shqiptare” e VMRO-DPMNE-së. Një demokraci e tillë do gjallëronte në Maqedoni atëherë kur PDSH-ja do mbante mitingje të përbashkëta me Gruevskin, e jo siç bënte gjithmonë: mbulohet me flamujt disametrësh kombëtarë, e në të vërtetë dilte se i përkulej vetëm flamurit me “luanin” të VMRO-së. Vetëm kështu kryesuesit e PDSH-së do kontribuonin që të zhbëheshin partitë e pastra etnike në këtë shtet, kështu ata do jepnin kontribut historik në formimin e partive qytetare, me çka në zgjedhjet e këtushme nuk do kishte peshë përkatësia etnike e atyre që votonin dhe e atyre që zgjidheshin.

Gjatë gjithë kësaj zhurme rreth përbërjes së re të kabinetit qeveritarë, ndodhi diçka e papritur dhe “mahnitëse” që nuk duhet harruar, që dëshmonte se

çdo e keqe sjellë edhe një të “mirë”: kryesuesit e partisë së Lubço Georgievskit - VMRO-Popullores, që u nda nga VMRO-DPMNE-ja - publikisht pohuan se gjashtë deputetët e vet ia lënë në disponim Arbër Xhaferit. Dhe shtuan se këtë e bëjnë vetëm sa të pengojnë hyrjen e BDI-së në qeverinë e Gruevskit. Ky gjest “demokratik” i VMRO-Popullores, mbase i habiti të gjithë, por jo edhe ata që e dinin se Lubço Georgievskin dhe kryesuesit e PDSH-së, i lidhe kërthiza e përbashkët e mbijetesës politike. Se ata prej moti bënin çmos të defaktorizonin BDI-në dhe ta shpallnin të dyshimtë rolin e Ali Ahmetit gjatë konfliktit të 2001. Ky gjest ndoshta nuk u solli të mira shqiptarëve të Maqedonisë, ndoshta ata i hutoi dhe i çoi të pyesin veten se “vallë edhe kjo na qenka e mundur”, por ky veprim i Georgievskit, u krijoi pozitë më të favorshme kryesuesve të PDSH-së në bisedimet për përbërjen e re qeveritare. Dhe Ali Ahmetit ia dobësoi edhe më shumë pozitën negociuese me Gruevskin. Me çka ndoshta nuk u arrit rezultati i plotë - mënjanimi i Ahmetit nga skena politike e Maqedonisë - por u bë e mundur që njëra nga dy “degët partiake” të Lubço Georgievskit - ajo e PDSH-së - të sigurojë vende në qeverinë e Gruevskit.

Debati i pakuptimtë se cila nga partitë shqiptare duhej të bëhej pjesë e koalicionit qeveritarë, vetëm dëshmoi se Maqedonia ishte katandisur rrugës që të bënte njëqind hapa çmendurake mbrapa. Ky debat dëshmoi se Maqedonia kishte shumë mundësi, a e shfrytëzonte vetëm atë që të nxiste probleme edhe



aty ku nuk ishte e nevojshme. Dhe për këtë Maqedonia kishte ekipe kujdestare në të gjitha stinët: partitë e shqiptarëve të këtushëm. Partitë të cilat të linin përshtypjen se ishin shumë të egra ndaj njëra tjetrës, por edhe zbuteshin posa ndonjë parti maqedonase ua ofronte grazhdin e pushtetit. Mbase kështu e kishte “bajrakokracia”. E cila pas vetes linte plagët që duheshite t’i shërojnë ata që nuk e kishin kuptuar se jo se kryesuesit partiak nuk e donin dhe e harronin popullin, por nganjëherë ata i dehte joshja e pushtetit, e cila joshje i çonte të mos u kujtohet se njeriu lindë pa kolltuk.

Dhe kështu pra ndodhi që partia e cila kurrë nuk i kishte fituar zgjedhjet në bllokun politikë shqiptarë – PDSH-ja – të bëhej pjesë e koalicionit qeveritarë për herë të dytë. I pyetur “cili është shpjegimi” i tij për “ankesat e BDI-së, se më formimin e qeverisë aktuale nuk është respektuar vullneti politik i shqiptarëve” Arben Xhaferi ndër të tjerat thotë: “Kërkesat e tyre nuk kanë bazë as kushtetuese as demokratike. Në kushtetutën e Maqedonisë, ashtu si në kushtetutat e të gjitha vendeve demokratike mënyra se si duhet të formohen koalicionet qeveritare është në duart e partisë që ka fituar më shumti vota...”. (“Koha” 30 dhjetorë, 2006 f. 4). Gazetari në vend që ta pyes më tej se vallë kjo do të thotë se Arbër Xhaferi do pajtohej edhe me qeveri njëetnike të Maqedonisë, gjë që sipas tij ia lejonte mandatarit edhe kushtetuta edhe parimet demokratike, shkon me tej dhe pyet Arbër Xhaferin se a “mendon” ai “ se duhet të gjendet ndonjë

zgjdhje juridike në të ardhmen për formën e pjesëmarrjes së partive shqiptare në qeveri”. Lidhur me këtë, Xhaferi sërish tregohet mbrojtës i flaktë i kushtetutës dhe parimeve demokratike dhe thotë: “Ligjet në botë ndërtohen në bazë të disa standardeve që mund të përgjithësohen dhe që mund të vlejné për të gjitha shoqëritë dhe qytetarët kudo në botë. Këto standarde për nga natyra janë universale. Shqiptarët nuk mund të përjashtojnë veten nga ky parim, prandaj nuk kanë nevojë të shpikin modalitete specifike sipas tekeve të individëve apo të partive politike...” (“Koha”, 30 dhjetorë, 2006). Nga del se shtetet nxjerrin ligje që vlejné për të gjithë botën, se edhe parimi i Badinterit - si standardë që rrallëkund ekzistonte në botë - na qenka standard jouniversal dhe si i tillë i dëmshëm për shqiptarët, se në një Maqedoni ku asgjë nuk ishte normale përpos “kreaturë” anormale të shtetit, qenkan të vlefshëm standardet e demokracisë klasike. Apo, ndoshta tërthorazi, Arbër Xhaferi donte të thotë atë që e thoshin qarqet që ishin kundër Marrëveshjes së Ohrit: se Maqedonia duhej të kthehej aty ki ishte para konfliktit të 2001. Apo, ndoshta Arbër Xhaferi bënte vetëm atë për çka ishte i “paguar” nga pronari i vërtet i kësaj partie – nënkryetari i saj: t’u japë legjitimitet “teorik” gjitha veprimeve të PDSH-së dhe t’i shpall si antikombëtare të gjitha konceptet tjera të partive apo të individëve të këtushëm shqiptarë.

Më në fund, Arbër Xhaferi në qeveri dhe ai në opozitë, ishin si dy politikanë të ndryshëm që

vështirë u gjeje pika të përbashkëta. Njësoj si në vitin 1998, edhe pas zgjedhjeve parlamentare të 2006 kur partia re tij u bë pjesë koalicionit qeveritarë, Xhaferi do bëhej mbrojtës i kushtetutës dhe i të drejtës demokratike të mandatarit të zgjedh partinë e vetë të koalicionit qeveritarë. Kjo e drejtë ishte e shenjtë për Xhaferin, por vetëm kur mandatarët zgjidhnin partinë e tij si partner të koalicionit qeveritarë. Dhe duke mbrojtur ai këtë të drejtë, ua merrte shqiptarëve të këtushëm të drejtën vetë të përcaktonin se cila parti e tyre do i përfaqësonte në institucionet më të larta shtetërore.

Ç'është e vërteta, këtë të drejtë të mandatarit Gruevski, nuk e kundërshtuan as faktorët ndërkombëtarë, që edhe e shtoi hutesën tek shqiptarët e këtushëm. Ky qëndrim i ndërkombëtarëve i çoi shqiptarët të pyesnin veten si ishte e mundur në një shtet ku vlente parimi i Badinterit, qeveria të mos përfillte vullnetin politik të shumicës shqiptare. Por, ata që shtronin këtë pyetje, e kishin të kotë që prisnin përgjigje. Andaj edhe i nënshtroheshin logjikës së shëndosh politike, e cila thoshte se ndërkombëtarët këtë e bënë ndoshta duke e ditur se gjatë qeverisjes së LSDM-së me BDI-në, dukshëm ishte zbehur vullneti politikë te pjesa dërmuese e etnitetit maqedonas për të ndërtuar shtet të përbashkët me shqiptarët. Dhe kjo si pasojë e ndjenjës së tyre se Ali Ahmeti bënte ç'të donte në qeverinë e Cërvenkovskit. Ndërkombëtarët mbase donin që në këtë mënyrë t'ia kthenin entuziazmin shtetformues një pjese të opinionit maqedonas, e që e

kishte humbur shkaku i ndjenjës se BDI-ja e “shqiptarizonte” shtetin.

Por, ndërkombëtarët gjithsesi që nuk prisnin që përkrahja e tyre dhënë Gruevskit të merrte përmasat e injorimit të plotë të vullnetit politik të shqiptarëve të këtushëm. Ata nuk prisnin që PDSH-ja të tregohej aq mospërfillëse dhe arrogante ndaj popullatës të cilën pretendonte se e përfaqësonte. Kështu që ata nuk dinin si të ndalonin vrapin e Gruevskit që të dëshmohej përpara etnitetit maqedonas si “vojvodë” që do ia laj hakun Ali Ahmetit për 2001.

Por, çka do që të ishte në pyetje, ndodhi e pabesueshmja për shqiptarët: Gruevski e përbuzi vullnetin e tyre politik. Me çka arriti në njëfarë mënyre t’i “hjek” qafe shqiptarët dhe t’i çojë të merren me vetveten. Dhe filloi debati edhe mes shqiptarëve se vallë çka duhej të bënte Ali Ahmeti që të mbronte vullnetin politikë të shumicës shqiptare. Si i tillë, ky debat bëhej gjithnjë e më i thellë, më përçarës e më i pakuptimtë. Sa më shumë debati thellohej, aq më e qartë bëhej se shqiptarët e këtushëm ishin në mosmarrëveshje të madhe me vetveten. A në të vërtetë, pyetja të cilës duhej t’i përgjigjen ishte shumë e thjeshtë: vallë vetë do vendosin se kush do i prezantonte në institucionet më të larta shtetërore, apo këtë do e bënin mandatarët e etnitetit maqedonas, duke mos marrë parasysh se cila parti shqiptare i kishte fituar zgjedhjet parlamentare.

Shqiptarët e Maqedonisë në të vërtetë tani përballëshin me vetveten, me politikanët e vet, të cilët kur

ishite në pyetje pjesëmarrja në pushtet, ishin të gatshëm të shkelnin mbi cilindo interes të popullit që përfaqësonin. Pra, ata përballeshin me udhëheqësit e PDSH-së që nuk njihnin institucionin e përgjegjësish përpara popullit. E një politik që në emër të përfitimeve të përkohshme, flijon të ardhmen e popullit të vet, është politik mendjemadhe, pa ardhmëri dhe ushqehet nga gënjeshttrat. Siç ishte politika e PDSH-së, e cila që të mbulonte pjesëmarrjen e vet jolegitime në qeverinë e Gruevskit, merrej me armiq, njësoj si dikur, çdonjërin që kishte mendim të kundërt, e shpallte dështak, të gjithë që mendojnë ndryshe i shpallte të shitur, sepse edhe politikën e konsideronte si „treg“ ku mund të blihej edhe shpirti i njeriut, ku i gënjyeri dhe gënjeshtarët bënin këmbimin e mallrave të cilat sjellin përfitime të ngutshme, por që prishen shpjet, kanë afat të shkurt kohorë për përdorim.

Pa marrë parasysh se si do zhvillohet më tej dialogu politik pas vitit 2006, ishte e qartë se BDI-së i ra në hise të zhvillonte edhe një betejë: të qëndronte në kërkesën e vet që edhe qeveria e Maqedonisë të zgjidhet sipas parimit të Badinterit. Apo, që vota shqiptare të përcaktojë përfaqësuesit e vet në institucionet më të larta shtetërore. Këtë ajo duhet ta bëjë jo gjithaq për vetveten, sa për të ardhmen e veprimit politik të shqiptarëve të këtushëm. Si edhe për atë që të ketë kuptim organizimi partiak shqiptarë, dhe të ketë afekt votimi i tyre. Sepse, nëse vazhdon praktika që vota shqiptare të verifikohet nga mandatarët e etnitetit maqedonas, atëherë

shtrohet pyetja logjike: pse shqiptarët u dashka të kenë partitë e veta dhe pse duhet të dalin në votime.

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, shqiptarët e Maqedonisë u përballën me papërgjegjësinë e disa përfaqësuesve të vet partiak. Me arrogancën e udhëheqësve të PDSH-së që ishin vetëshpallur “pashallarë” demokratik, pronarë të çdo gjëje që kishte të bëjë me shqiptarët e këtushëm. Si të tillë, ata donin të mbeten të vetmit që punësojnë, që dënojnë, që përcaktojnë vlerat kulturore e shoqërore të shqiptarëve të këtushëm. Si të tillë ata vazhduan aty ku e lanë gjatë qeverisjes së parë në koalicionin qeveritarë të Georgievskit. Andaj edhe ngutazi donin t'i heshtnin të gjithë ata që thoshin se PDSH-ja ishte ajo që e ndihmoi Gruevskit të shkelë mbi vullnetin politikë të shumicës shqiptare, se kjo parti nuk u dha asnjë shpjegim shqiptarëve të këtushëm se pse ishte mospërfillëse ndaj votës së tyre.

Të lënë që të merren me vetveten, shqiptarët e paszgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, vazhduan grindjet mediatike në mes të „mirëve“ dhe „destruktivëve“, në mes „patriotëve“ dhe „tradhtarëve“, a në të vërtetë çdo gjë kishte të bëjë me pozitën mjerane të shqiptarëve të këtushëm, të cilëve edhe mëtej mendimin e lirë ua përcaktonte korniza partiake e PDSH-së, tani më e ardhur në pushtet. Ky debat nuk u lejonte shqiptarëve të shihnin se nuk bëhej fjalë për atë se cila parti do ishte më efikase si pjesë e koalicionit qeveritarë, por për atë se a do i përcaktonin përfaqësuesit e vet nëpër institucionet më të larta shtetërore vetë votuesit

shqiptarë apo, në emër të tyre, këtë do e bënin mandatarët qeveritarë. Që ta mbulojnë thelbin e debatit, kryesuesit e PDSH-së donin të heshtnin cilindo që i shpaloste të palarat e tyre politike, apo që argumentonte shërbimet që kjo parti ia bënte VMRO-DPMNE-së. Siç ishte rasti i publicistit Iso Rusi, i cili botoi një tekst ku mbronte qëndrimin se kryesuesit e PDSH-së kundërshtojnë nxjerrjen e ligjit për bashkësitë fetare, jo për të mbrojtur statusin e Bashkësisë Fetare Islame, por për t'i bërë shërbim Kishës Ortodokse Maqedonase dhe partnerit të tyre në koalicionin qeveritarë, partisë së kryeministrit Gruevski - VMRO-DPMNE-së. Në këtë kolumnë, si edhe në gjithë analizat e këtij autori, të cilat i karakterizonte një maturi dhe vrojtim jo i njëanshëm partiak apo etnik, Iso Rusi nënvizonte se “ ndërlidhja e PDSH-së në tezën se formula ‘një fe – një bashkësi’ është në dobi të BFI-së para së gjithash për të mbrojtur Islamin e vërtetë nga ai radikal, vetvetiu është e sforcuar”. Ai tutje shtonte se për islamistët radikalë, “nuk është e domosdoshme të kenë një bashkësi të re islame për të bërë atë që e kanë paramenduar”, andaj edhe nënvizonte se “frika e këtillë e PDSH-së përputhet me manifestimin tradicional të albanofobisë së djathtë maqedonase, jo rrallë të orientuar edhe ndaj islamit dhe të shprehur përmes pohimeve pas 11 Shtatorit të vitit 2001 se UÇK në vitin 2001 ka qenë tok me Al Kaedën (të cilën në atë kohë Xhejms Perdu e quajti “abuzim të tragjedisë amerikane”)

Nuk vonoi shumë dhe erdhi edhe reagimi i

PDSH-së lidhur me këtë tekst të Iso Rusit. Edhe atë siç i kishte hije kësaj partie: përplot helm dhe akuza në kufi të jonjerëzores, duke e shpallur Iso Rusin “pjellë (ne kuptimin biologjik) tipike eksperimentale e UDB-së së vjetër jugosllave e cila gjithandej nëpër hapësirat e ish-Jugosllavisë krijonte çifte për të lindë njerëz siç quante propaganda e atëhershme ”njeriu i ri socialistë”, “njeriu i ri jugosllav”, “njeriu i...” po populli i thjeshtonte këto terma duke i quajtur thjeshtë –kopila!”. Reagimi i PDSH-së përmbylej me një kanosje gjithashtu siç u kishte hije kryesuesve “demokrat” të kësaj partie, e cila prej moti, e jo vetëm pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006i, kujdesej edhe për pastërtinë e gjakut shqiptarë, e ku thuhej se “ti, Rusi dhe ‘mjekrat’ për rreth teje si Sedat Ramadani, Ramadan Ramadani, Beqa etj, nuk do të keni ‘gjumë’ të rehatshëm jo vetëm nga lidërshipi i PDSH-së, po edhe nga çdo aktivist i kësaj partie.”

Pra, ky reagim i PDSH-së, nuk kërcënonte vetëm autorin e kolumnës, Iso Rusin, por edhe të gjithë ata që shoqëroheshin me të. Ky reagim i kryesuesve të PDSH-së, mbante erë qelbësire të një qëndrimi fashist, mbështetej në mendësinë destruktive të udhëheqësve të kësaj partie, se emblema partiake ua mundëson atyre të vlerësojnë edhe nëse dikush mundet, ose nuk mundet t`i takojë një kombi, nëse është mjaftë i pastër etnikisht, nëse ka prejardhje të përshtatshme “arianite” dhe ngjashëm. Përpos kësaj, ky reagim shpaloste edhe atë që mbase Iso Rusi dhe të ngjashmit me të, ende nuk e



kishin kuptuar: se kryesuesit e PDSH-së nuk e kishin gjithaq lehtë siç e mendonin disa analistë, se mbase ata frymonin politikisht nën maskën e ngushtë që u mundësonte nga jashtë të dukeshin si nacionalistë shqiptarë, e në të vërtetë të mbeteshin rob të veprimit i cili di vetëm të njollosë, të asgjësojë, t'i heshtë të gjithë shqiptarët e Maqedonisë që mendojnë me kokën e vet. Pra, veprim i tyre dëshmonte se ndoshta ata ishin të ngarkuar me një rol të rëndë politik: përpara shqiptarëve të këtushëm të painformuar të tregoheshin si pishtarë të shqiptarisë, e në ndërkohë të bënin punën që dikur e bënin qarqet antishqiptare.

Andaj edhe mund të thuhet se gabonin të gjithë ata që kryesuesit e PDSH-së i vlerësonin nga këndvështrimi i politikanëve të angazhuar për të mirën e shqiptarëve të këtushëm dhe për të mirën e Maqedonisë, sepse shumëçka dëshmonte se ata kurrë nuk kishin qenë të “paguar” për atë punë. Mbase edhe nuk ishte këndvështrim i drejtë as ai që kryesuesit e PDSH-së t'i vlerësoje si liderë partiak, sepse ata vepronin si pronarë të një organizate fitimprurëse të quajtur PDSH-së, e cila prodhimin shumë të dëmshëm për shoqërinë e shqiptarëve të Maqedonisë, e shiste në paketa të stolisura me patriotizëm dhe simbole kombëtare. Andaj edhe mund të shpalleshin si dështuese dhe iluzioniste të gjitha analizat që shqyrtonin atë për çka mbase kurrë nuk ishin të interesuar kryesuesit e PDSH-së: liritë fetare, lirinë e mendimit të lirë publik, harmonizimin e marrëdhënieve ndëretnike në

Maqedoni. Veprimi i kryesuesve të PDSH-së, me shumëçka kishte dëshmuar se ata kishin qëllime krejt tjera: të shtonin terrin në tunelin informatikë e politik në të cilin futeshin shqiptarët e Maqedonisë sa herë që kjo parti bëhej pjesë e koalicionit qeveritarë.

Thjeshtë e shqip, mbase Iso Rusi dhe të ngjashmit me të, nga dëshira që të mos bëheshin pjesë e gazetarisë grindavece, mundoheshin të bënin të pamundur, dhe niseshin nga paragjykimi se ndoshta kryesuesit e PDSH-së nuk e dinin se çka bënin, kështu që në njëfarë mënyre pa dashje edhe u bënin shërbim për të mbuluar veprimin politik sipas të cilit, Arbër Xhaferi i merrte votat e shqiptarëve, duke fshehur mjeshtërisht se PDSH-ja nuk ishte asgjë tjetër përpos filijalë politike e VMRO-DPMNE-së dhe një “kompani” private e dy “pronarëve” të saj. Sikur Iso Rusi dhe të ngjashmit me të, të ishin më të vëmendshëm, sikur të analizonin kujdesshëm diagramin e veprimit politik të kryesuesve të kësaj partie, mbase qëmoti do e vërenin se për ç’arsye kryesuesit e kësaj partie kundërshtonin propozimet e përfaqësuesve ndërkombëtarë në Maqedoni që të respektohej vullneti politik i shumicës shqiptare në Maqedoni, për ç’arsye deklaroheshin se do e zgjidhin problemin e dëshmorëve shqiptarë të rënë në konfliktin e 2001, a në ndërkohë fare nuk u pengonte pse shteti maqedonas paguante harxhimet gjyqësore edhe nga parat e taksapaguesve shqiptarë për të mbrojtur të akuzuarit në gjyqin e Hagës për krime të bëra mbi shqiptarët. Sikur Iso Rusi të mos

mbetej besnik i bindjes së vet se veprimi publik nuk do të thotë se mund të sillesh si “kurvë” e pamoralshme që punon në shtëpi publike, qëmoti do e vërente se kryesuesit e PDSH-së kurrë nuk kishin pasur hallin e të drejtave fetare të shqiptarëve të Maqedonisë, por mbase brengë kryesore e tyre kishite qenë se si të përdornin ngjarjet tragjike të 11 shtatorit të vitit 2001 në SHBA, për t’i njollosur si “mjekroshë” të rrezikshëm “vehabistë” të gjithë ata që në të vërtetë kishin vetëm një mangësi: me vonesë e kuptuan se cilat ishin rezultatet e veprimit politik të kryesuesve të PDSH-së. Pra, Iso Rusi sikur mos ishte ai që është, njeri që u rri larg grindjeve brendashqiptare, qëmoti do e shihte se kryesuesit e PDSH-së, vepronin njësoj si edhe disa qarqe antishqiptare maqedonase, të cilëve çdo mjekër në fytyrën e myslimanëve të këtushëm, u ngjan me atë të Bin Ladenit. Qëmoti pra do e kuptonte se kryesuesit e PDSH-së mbase edhe nuk e kanë gjithaq lehtë, sepse duhej të manipulonin, të keqpërdornin sinqeritetin e të rinjve shqiptarë të pashpresë e të papunë, e në ndërkohë të mos shihej se flamuri me shqiponjën dykrerëshe në mes, vetëm ua mbulonte veprimin përbuzës, shkelës, shkatërrues të atyre pakë vlerave që kishin shqiptarët e këtushëm.

Iso Rusi, si edhe shumë të tjerë të ngjashëm me të, ndoshta vonë e kuptuan se jetonin në kohë kur qyqet bënin vezë në fole të shqiponjave. Sikur t’i ndërlidhnin kujdesshëm ngjarjet gjatë konfliktit të 2001 dhe ato pas zgjedhjeve parlamentare të 2006 kur Arbër Xhaferi e ndihmoi Gruevskin të mos përfillte

vullnetin politik të shumicës shqiptare në Maqedoni, Iso Rusi dhe të ngjashmit me të, do e vërenin se kryesuesit e PDSH-së i përkrahnin dhe i afirmnin vlerat demokratike perëndimore, por vetëm nëpërmjet parullave të mëdha proamerikane dhe proevropiane me të cilat e mbulonin mendësinë e vet leniniste. Se ata ishin në gjendje të gjithë shqiptarët t'i shpallnin "vehabistë" të rrezikshëm, spiun të serbit e grekut, "fëmijë eksperimental" të socializmit, vetëm që ta dendësonin mjegullën e hutesës brendashqiptare, vetëm që të mos shihej fytyra e vërtetë e disa veprimtarëve politik. E veprimtaria e disave prej tyre mbase kishte për qëllim që të gjithë shqiptarinë e këtushme t'i shpallte si një plehërishte të pavlerë përplot me spiun e tradhtarë. Me çka në fund do dilte se mbrojtës të mirëfilltë të lirive shqiptare në Maqedoni, ishin "vojvodët" e VMRO-DPMNE-së. Ata të njëjtit që karrierën politike e ndërtuan mbi parullat e ngjashme me atë: "Dhoma gazi për shqiptarët".

Mbase mund një ditë të del puna se shkronja SH(qiptare) në emrin e disa partive të këtushme, kishte qenë vetëm mbulesë për t'ua mundësuar kryesuesve të tyre t'i akuzojnë të tjerët për atë që bëjnë ata vetë. Mbase një ditë mund të del në sipërfaqe edhe e vërteta se shqiponja e stilizuar në flamurin e PDSH-së, ka shërbyer vetëm si mbulesë që të mos shihet në cilën fole është ngjizur dhe është rritur partia e Arbër Xhaferit. Dhe sa t'i hutoj shqiptarët e këtushëm që të mos vërejnë se PDSH-ja është po aq pro NAT-os e pro BE-së, sa edhe

VMRO-DPMNE-ja, sa edhe të gjitha partitë “leniniste” në këto hapësira, të cilat thonë se janë perëndimorë, a në të vërtetë popullin e konsiderojnë si kope të pavlerë që duhet “kullotur” ashtu siç i pëlqen “bariut”. Andaj Iso Rusi, e gjithë të ngjashmit me të, duhej ta dinin se jetonin në kohë kur kishte edhe veprimtarë partiak të cilët nuk ngurronin edhe të të vrisnin, e pastaj të të vinin në varrim, të të burgosin e pastaj të të nxirrnin nga burgu duke e përdorur edhe atë si veprim atdhetarë përpara zgjedhësve, të të kidnaponin e pastaj triumfalisht të të çlironin, duke dëshmuar kështu sa ishin të devotshëm në luftën kundër kriminit të organizuar. Andaj duhej kujdes i madh, se për fat të keq, ky lloj i politikanëve ngandonjëherë arrinte t’i gënjejë edhe diplomatët e huaj. Duke keqpërdorur atë se disa nga ata të gjorët nuk mund të paramendojnë se mund të ketë politikan të cilët janë kameleon aq të gjindshëm, sa në çastin kur t’i mendon se i ke parë ngjyrat e flamurit që fshehin nën sqetull, ata ngutazi futen nën shqiponjën. Dhe nga andej, të mbuluar me puplat e buta të shqiponjës dykrerëshe, ua masin pastërtinë e gjakut etnik të gjithë atyre që e kanë kuptuar se njeriu jeton që të arsyetojë lindjen, e të meritojë varrin. Sepse jo çdokush arrin të arsyetojë qumështin e nënës dhe të meritojë pastërtinë e dheut ku do prehet.

Mbase tërë këtë me vonesë e kuptuan edhe shumica e shqiptarëve të Maqedonisë si edhe disa përfaqësues ndërkombëtarë. Andaj edhe faktori ndërkombëtarë duheshite t’i tregojë Gruevskit se ai mund të ëndërronte cilëndo Maqedoni të dëshironte,

por në hartat e botës do mund të ekzistonte vetëm ajo që do ishte dëshirë edhe e shqiptarëve. Ndoshta këtë e bënë me vonesë, por ia thanë Gruevskit edhe atë, se ai edhe mund të mos e donte Ali Ahmetin, të kishte frustrime nga më të ndryshmet, bile edhe sedrën e njeriut që bartë në vetvete shumë paragjykime, por edhe si i tillë nuk do ia arrinte të çoj shtetin përpara duke injoruar BDI-në që kishte përkrahjen e shumicës shqiptare në Maqedoni. Dhe e çuan të ulej të bashkëbisedonte edhe me kryesuesit e BDI-së.

Pra, edhe pas Marrëveshjes së Ohrit, Maqedonia me shumëçka i ngjante një kështjelle shtetërore, të cilës çdo katër vite ia ndryshonin planin e ndërtimit. Kështu, qartë vëreheshin muret që kishte muruar çdo koalicion paraprak qeveritarë, e të cilët thuajse asgjë nuk i ndërlihdh mes veti. Andaj edhe ky shtet linte përshtypjen se ka muratorë, por jo edhe planë afatgjatë të ndërtimit, se ka mure, por jo gjithmonë të ndërtuar mbi themelin e njëjtë. Pra, të bëhej se ai që kishte gërryer themelet, nuk e kishte ditur se dikush ndryshe e kishte paramenduar kulmin, se ai që kishte ndarë dhomat ndëretnike, nuk e kishte parashikuar se çdo etnitet i këtushëm kishte planin e vet për rregullimin e tyre. Se çdo etnitetit kishte porositur mobiliet pa mbajtur llogari për madhësinë e vendbanimit dhe muret ndarëse të ndërtesës së përbashkët shumëtnike. Kishe pra përshtypjen, se përballesh me një ndërtesë të çuditshme shtetërore, me të cilën të gjithë njësoj ishin të pakënaqur dhe ku askush më nuk e dinte ku janë themelet fillestarë dhe

pse rrjedh kulmi. Shtet ku të gjithë së bashku shpresonin se ndërtesa do i përballte të gjitha shtrëngatat ballkanike, jo pse ishte e fortë, por pse e mbështesnin shtyllat e jashtme të institucioneve ndërkombëtare.

Në një Maqedoni të tillë, me shumë themele, e me kulm që nuk i përballte shinajet e mosbesimit ndëretnik, ndodhnin edhe çudira në kufi me të pabesueshmen. Edhe atë në kohë kur të gjithë duhej të kishin nxjerrë mësim nga ndodhitë tragjike në këto hapësira. Me çka njeriut i krijohet bindja se çdo gjë ecën e shkon përpara, por vetëm marrëzia dhe idiotizmi njerëzorë jetojnë në të njëjtën kohë, se për ato nuk kalojnë as vitet as shekujt. Kështu që, pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, shqiptarët u gjetën thuajse aty ku ishin përpara vitit 2001 dhe shtronin pyetjen: si t'ia bënin më tej dhe, si t'i shpëtounin majorizimit etnik. Dhe në vend të përgjigjes, u fanitej e vërteta se ndoshta Marrëveshja e Ohrit nuk ishte kornizë mjaft e madhe ku do mundë të vendosej piktura e plotë e ëndrrës së tyre për një Maqedoni ku ata do ishin të barabartë me tjerët dhe vetë do vendosnin për përfaqësuesit e vet nëpër institucionet më të larta shtetërore.

Maqedonia e pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, i ngjante një tende të vogël, ku zhvillohej një cirkë i madh dhe absurd politik. Si e tillë, ajo të dukej si tendë e stërmbushur me akrobatë, publikë dhe rekuizita. Andaj të bëhej se qëndronte si e fryrë, se pandalë luhatej dhe kishe përshtypjen se edhe një erë e lehtë e grindjeve ndëretnike, mund atë ta

përplaste për toke. E tillë dukej ndoshta edhe nga shkaku se në atë tendë, shqiptarët ishin ulur pa shikuar numrin e ulëses, pa ua caktuar atyre vendin zgjedhësit, por qarqet maqedonase.

Maqedonia e paszgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, ngjante në gjithçka nga pakë. Ky shtet herë dukej si kështjellë shtetërore ku çdo koalicion qeveritarë kishte planë për ndërtimin e saj, por të ndryshëm nga ai i ndërtuesve të mëparshëm, e herë të ngjante në një tende ku zhvillohej një cirkë i madh dhe i çuditshëm politik. Me çka, më së paku Maqedonia i ngjante një shteti të muruar nga mjeshtërit politik që e kanë kuptuar se shoqëritë shumetnike mundë të qëndrojnë në këmbë vetëm mbi themelet e respektit reciprok ndëretnik. Si i tillë, ky shtet më i çuditshëm dukej gjithmonë kur atë e qeverisin VMRO-DPMNE-ja dhe PDSH-ja. Dhe askush nuk e kupton pse ndodhte kështu. Vallë pse këto dy parti nuk kishin kapacitet të udhëhiqnin shtetin dhe çdo gjë u dilte nga duart, apo pse kishin ndonjë planë të fshehtë për ndërtimin e Maqedonisë. Apo, ndoshta kjo u ndodhte për shkak se kishte politikanë shqiptarë të ngjashëm me atë gjuetarin nga rrëfimin i Çerçilit: që e kishte shitur lëkurë e hienës ende duke qenë ajo e gjallë në mal. Dhe i cili kishte vdekur duke u munduar atë ta gjejë e ta vret.

Edhe pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006, Maqedonia do i ngjajë një kalaje shtetërore të muruar nga muratorë politikë që nuk kishin ndonjë vizion të qartë dhe projekt afatgjatë për të. Mbase shkaku i kësaj nga muret e kësaj kalaje shpesh binin rrënoja



dhe askujt nuk i ishte kujtuar që në hyrjet kufitare të  
vinte mbishkrimin: “Ndërtimi vazhdon! Keni  
kujdes, të mos u godet ndonjë tullë mbi kokë!”